

**NJË ANËTAR, NJË VOTË:
NJË PËRMBLEDHJE SHKRIMESH POLITIKE**

Një anëtar, një votë

Një përmbledhje shkrimesh politike

Përgatitur nga:

Dan Redford (me Katina Drenova)



Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-02-00104-00 me NDI

Botuar nga Shtëpia Botuese “PEGI”
Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2
Tiranë
Tel: +04 374947
Fax: +04 374947

Përgatitur nga Dan Redford (me Katina Drenova)
Foto Kopertina: Guri Daco
Faqsja: Vjollca Ruvina

ISBN: 99943-638-5-9

Opinionet e shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo NDI

Përmbajtja

• Parathënie	IX
• Dy fjalë për kontribuesit	XI
1. Hyrje	1
<i>Dan Redford</i>	
2. Shqipëria në prag të reformës politike	5
<i>Robert D. Benjamin</i>	
3. Përse anëtarët janë të rëndësishëm	10
<i>Mary O'Hagan</i>	
4. Valët politike dhe proceset përzgjedhëse në ndryshim Mbërritja në Britani e parimit “Një anëtar, një votë”	14
<i>Robert Evans MEP</i>	
5. Një anëtar, një votë - Përvoja e Partisë Konservatore të Britanisë së Madhe në nivel zone elektorale	20
<i>Alex Finnen MBE</i>	
6. Nga Dublini në Prishtinë - Perspektivat për “Një anëtar, një votë”	26
<i>Michael O'Reilly</i>	
7. Rëndësia e parimit “Një anëtar një votë” për partitë politike në Shqipëri	31
<i>Dr. Nick Ellison</i>	
8. Cinizmi dhe mbështetja ndaj “Një anëtar, një votë”	36
<i>Jonathon Carr –Brown</i>	
9. Reformimi demokratik i partive politike shqiptare - domosdoshmëri e kohës	40
<i>Prof.Dr. Rexhep Mejdani</i>	

10. “Një anëtar, një votë” - rruga e vetme drejt demokracisë	49
<i>Aleksandër Mexsi</i>	
11. Përse një anëtar, një votë?	54
<i>Ilir Meta</i>	
12. Sa e rëndësishme është një votë?	58
<i>Jozefina Topalli (Çoba)</i>	
13. Një anëtar, një votë. Disa konsiderata të përgjithshme	62
<i>Sabri Godo</i>	
14. Një anëtar, një votë, një tjetër (r) evolucion demokratik	66
<i>Genc Pollo</i>	
15. Pa zgjedhje demokratike në parti nuk ka zgjedhje demokratike në Shqipëri	70
<i>Gaqo Apostoli</i>	
16. Kryqëzimi i Demokracisë	74
<i>Ilir Zela</i>	
17. Demokracia fillon këtu...	79
<i>Bledar Doracaj</i>	
18. Mendësia e re e funksionimit politik dhe sistemi “Një anëtar, një votë”	83
<i>Arjan Kokoshi</i>	
19. E djeshmja dhe e ardhmja e politikës shqiptare	87
<i>Etleva Bisha</i>	

20. Një anëtar, një votë Demokracia direkte dhe demokracia me përfaqësim	91
<i>Arben Qirjako</i>	
21. “Një anëtar, një votë” - adoptim që nis nga njohja	195
<i>Arta Sakja</i>	
22. Përse duhet pikërisht tani parimi “Një anëtar, një votë”?	101
<i>Roland Bejko</i>	
23. Partitë politike dhe demokracia e brendshme e tyre	107
<i>Xhuljeta Jaho</i>	
24. Anëtarësia dhe vullneti i saj	112
<i>Florian Xhuti</i>	
25. Decentralizimi politik dhe zgjedhjet e drejtpërdrejta nëpërmjet sistemit “Një anëtar, një votë”	116
<i>Reiz Mulita</i>	
26. Mrekullia e demokracisë	120
<i>Elvis Mataj</i>	
27. Vota që ringjall demokracinë	124
<i>Andrea Stefani</i>	
28. Pafuqia fisnike e një parimi	127
<i>Mentor Nazarko</i>	
29. Mëdyshjet rreth parimit “Një anëtar, një votë”: Sfidë ndaj lidershit, apo ndaj strukturimit politik?	132
<i>Mero Baze</i>	
30. Pushtet i deleguar? Jo, pushtet i drejtpërdrejtë!	138
<i>Martin Leka</i>	

31. Mentaliteti i liderit “bajraktar” përballë “Një anëtar, një votë”	142
<i>Dritan Ylli</i>	
32. “Një anëtar, një votë” kundrejt deficitit të demokracisë	146
<i>Erion Veliaj</i>	
33. Nga parti leniniste në parti demokratike	150
<i>Kreshnik Spahiu</i>	
34. Një anëtar, një votë - Një rast studimor mbi Partinë Laburiste të Britanisë së Madhe që nga viti 1945 e deri më sot	154
<i>Dan Redford</i>	

Parathënie

Ka raste kur dalja e një ideje ndryshon në mënyrë dramatike tonin dhe përmbajtjen e dialogut politik të një kombi. Koncepti “Një anëtar, një votë” është një kësi ideje në Shqipëri. Në pranverë 2003, kur OMOV¹ - sikurse e quajmë ne që na pëlqejnë akronimet – u prezantua për së pari në seminarin trainuese të Programit për Menaxhimin Politik të National Democratic Institute for International Affairs (NDI), pjesëmarrësit mendonin që ai tingëllonte ‘i këndshëm’ por jo veçanërisht i përputhshëm për kulturën politike Shqiptare.

Si ndryshojnë kohët! Brenda pak më shumë se një viti, katër parti politike – në pushtet dhe në opozitë, të konsoliduara dhe të reja – kanë mbështetur publikisht futjen e sistemit “Një anëtar, një votë” deri në një masë të caktuar brenda strukturës së tyre politike. Por për të kaluar nga njëri hap tek tjetri kërkon më tepër sesa të organizosh një konferencë shtypi për t’i thënë botës se “Një anëtar, një votë” mbërriti.

Sistemi “Një anëtar, një votë” kërkon ndryshime vepruese dhe operacionale. Partitë politike duhet të dinë se sa anëtarë kanë dhe ku i kanë. Partitë duhet të kenë një sistem komunikimi efektiv – drejt dhe prej anëtarësisë së tyre. Partitë duhet të kenë sisteme organizative efikase për të menaxhuar këtë komunikim, për të organizuar shpërndarjen e informacionit për vendimet që merren, dhe të zhvillojnë votime të ndershme kur vjen momenti për to. Këto pjesëza nuk mundet të ndodhin vetiu. Ato kërkojnë kohë, por planifikimi dhe zbatimi nuk duhet që të zvarriten pambarimisht. Mjaft kohë ka kaluar dhe Shqipëria është ende duke pritur.

Thelbi i çështjes është: shoqëritë demokratike duhet të ndërtohen mbi institucione demokratike, jo me fjalë, por me vepra. Kjo do të thotë që partitë politike të ftojnë anëtarët e tyre të marrin pjesë aktive dhe të barabartë në vendimarrjen kryesore, përfshirë zgjedhjen e funksionarëve të lartë. Kjo gjithashtu nënkupton: organizata të shoqërisë civile që kanë dhe ndjekin kodet e sjelljes, media që luan plotësisht rolin e saj, qytetarë që janë të informuar dhe aktivë, institucione qeverisëse që janë të arritshëm, të përgjigjshëm dhe transparentë.

Ky libër i drejtohet sistemit “Një anëtar, një votë” si një sistem udhëheqës në forcimin e demokracisë së brendshme të partive politike. Brenda këtyre faqeve gjendet një gamë e gjerë ideologjish politike, institucione, moshë, gjini dhe madje kombësi të ndryshme. Kontributi i çdo autori është i mirë-menduar dhe konstruktiv. Qoftë vetëm për këto

cilësi ky botim përbën një përmbledhje plot vlera.

NDI i është mirënjohëse dhe falënderon Agjensinë e Shteteve Të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar në Shqipëri për sigurimin e fondeve që i mundësuan NDI-së organizimin dhe përgatitjen e shpejtë të këtij libri. Ne gjithashtu falënderojmë autorët për idetë e tyre dhe gatishmërinë për t'i bërë idetë e tyre pjesë të dokumentimit publik. Dhe, falënderimet e mia personale shkojnë për Dan Redford, drejtor i programeve politikë të NDI, i cili është forca reale mbrapa këtij botimi. NDI shpreson se momenti në të cilën vjen kjo ofertë intelektuale do të ndihmojë për të hedhur dritë mbi “Një anëtar, një votë” dhe do të formojë bazat për diskutime më të thella dhe më kuptimplota mbi politikat që do të vinin në praktikë sistemin “Një anëtar, një votë”

Jennifer L Butz
Drejtoreshë Vendore, NDI/Shqipëri
Tiranë, tetor 2004

¹ OMOV (anglisht) qëndron për One Member One Vote që në shqip përkthehet ” Një anëtar, një votë”.

Dy fjalë për kontribuesit

Politikanë Ndërkombëtarë

Robert D. Benjamin - Drejtor Rajonal i NDI për Europën Qendrore dhe Lindore

Robert Evans - Anëtar i Parlamentit European, Partia Laburiste Britanike

Alex Finnen MBE - Ish Menaxher Lokal i Partisë Konservatore Britanike

Michael O' Reilly - Ish Drejtor Kombëtar për Zgjedhjet, Partia Fine Gael, Irlandë

Dr Nick Ellison - Lektor Kryesor, Shkolla e Shkencave Sociale të Aplikuara, Universiteti i Durham, Angli

Jonathon Carr Brown - gazetar, gazeta britanike "Sunday Times", Mbretëri e Bashkuar

Mary O' Hagan, Drejtoreshë e Lartë Rezidente për Vendin, NDI/Serbi

Dan Redford - Drejtor i Programit për Zhvillimin e Partive Politike, NDI, Shqipëri

Politikanë kombëtarë

Prof Dr Rexhep Mejdani, - ish President i Republikës së Shqipërisë, ish Sekretar i Përgjithshëm i PSSH

Aleksandër Meksi - ish Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Illir Meta - deputet - ish Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Kryetar themelues i Lëvizjes Socialiste për Integrim

Sabri Godo - ish Kryetar themelues i Partisë Republikane të Shqipërisë dhe President i Asamblesë së Partisë Republikane

Jozefina Topalli (Çoba) - Nënkryetare e Parlamentit të Shqipërisë, Nënkryetare e Partisë Demokratike të Shqipërisë

Genc Pollo - Kryetar i Partisë Demokrate të Re të Shqipërisë

Gaço Apostoli, deputet - zv.kryetar i Partisë Social Demokrate të Shqipërisë

Illir Zela, deputet - kryetar i komisionit Parlamentar për Marrëdhëniet me Jashtë.

Politikanë të Rinj

Bledar Doracaj - Sekretar i Përgjithshëm i FRESSh dhe Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës Tiranë

Arjan Kokoshi - Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm të PSSH

Etleva Bisha - Anëtare e Kryesisë Themeluese të Lëvizjes Socialiste Për Integrim

Arben Qirjako - Nënkryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike të Shqipërisë

Arta Sakja - Anëtare e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë

Roland Bejko - Anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë

Xhulieta Jaho - Kryetare e Forumit të Grave Republikane të Shqipërisë

Florian Xhuti - Kryetar i Forumit Rinor të Partisë së Ballit Kombëtar Demokrat të Shqipërisë

Reis Mulita – Anëtar i Këshillit Kombëtar dhe Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë të PSD

Elvis Mataj - Anëtar i Kryesisë themeluese të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Kryetar i Forumit Rinor të LSI

Shoqëria Civile

Erion Veliaj - Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes, MJAFT

Kreshnik Spahiu - Kryetar i Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve. Drejtor i Bordit të ACAC

Andrea Stefani - Analist politik

Mentor Nazarko - Analist politik

Mero Baze - Kryeredaktor i Gazetës Tema

Martin Leka - Analist politik

Dritan Ylli - Redaktor Përgjegjës i editorialeve i gazetës “Panorama”

1 Hyrje

Një anëtar, një votë: Një përmbledhje shkrimesh politike

National Democratic Institute for International Affairs (NDI) filloi Nxijtjen e parimit politik “Një anëtar, një votë” në fillim të vitit 2003. Në fillim, përpjekjet konsistonin në organizimin e leksioneve dhe seminareve të gjalla të përjavshme, të zhvilluara gjatë shkollimit për menaxhimin politik. Me kalimin e kohës këto aktivitete u kthyen në ngjarje më publike që përfshijnë artikuj në gazeta dhe intervista, si dhe bashkëbisedime të shumta me aktorët kryesorë politikë.

Synimi i NDI-së ishte shumë i thjeshtë – reforma e brendshme e partisë nëpërmjet një metode të tillë, si “Një anëtar, një votë” t’u japë partive politike një shans për të ripërtërirë vetveten në rrugë të ngjashme me ato të partive politike në vende të tilla si Britania, Irlanda dhe pjesa tjetër e Europës. Si rrjedhojë partitë politike të funksionojnë në mënyrë më transparente dhe pluraliste duke shpresuar se një normë morale e tillë do të trasmetohet më tej edhe në qeverisje.

Synimi ynë i dytë ishte t’i gjallëronte pjesëmarrësit e programit të merrnin përsipër vënien në praktikë të këtij sistemi dhe t’u shpjegonin dobritë e shumta të këtij sistemi të ri kolegëve në partitë e tyre. Dhe për 18 muaj mund të themi se ata ia kanë dalë mbanë më së miri.

Sot, ndërsa e lëmë vitin 2004 prapa, shohim se njohuritë për këtë ide janë rritur në nivele të tilla që kanë çuditur mjaft prej nesh. Kur kjo temë u parashtrua për herë të parë, përgjigjet që morën ishin të ndryshme. Pikpamjet më serioze dhe të respektueshme varjonin nga ata që mendonin se kjo do të çonte në “konsolidimin” e pushtetit të udhëheqësve aktualë, deri në ata që do të hidhnin shprehjen kaq të përdorur në Shqipëri. “Ideja është e mirë por nuk i përshtatet mentalitetit shqiptar”.

Në Janar 2001, Qeveria Shqiptare nënshkroi marrëveshjen për Stabilizim Asocim me shpresën për të hyrë në Bashkimin Europian sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, më pas përparimi drejt integritimit mund të përshkruhet si fragmentar, për të mos thënë më shumë. Në fakt

shumë zyrtarë të lartë politikë në BE e kanë bërë të qartë se në qoftë se Shqipëria nuk arrin shpejt rezultate reale dhe të prekshme, ëndrra e saj për të hyrë në këtë “Klub European” do të ngrihet më shumë në shpresa se sa në realitete, edhe për shumë kohë.

Ndërsa do të ishte mirë që debati se si “të pilotojmë Anijen Shqiptare” drejt brigjeve të Europës të lihej mënjanë për një rast tjetër, çështja e reformës demokratike është një temë e spikatur e lidhur me çdo aspiratë integrimi. Reforma politike nuk është e lidhur vetëm me reformën e strukturave qeverisëse, por edhe me natyrën e vetë diskutimit politik. Në fund të fundit, reforma institucionale ka pak gjasa të realizohet nëse vetë ata që vënë në lëvizje këtë proces – politikanët – tregojnë veçse një interes të vogël për të.

Gradualisht është vënë re një pranim në rritje se “Një anëtar, një votë” nuk është një koncept i pa pjegueshëm, por një koncept që nëse transmetohet drejt, mund të sigurojë në Shqipëri qeverisje demokratike në nivel partiak dhe shtetëror. Në fund të fundit nuk mund të shpresosh të kesh një demokraci pluraliste, nëse mjetet që vënë në lëvizje këtë proces nuk janë në vetvete demokratike, apo nëse në politikë ka ende individë që mendojnë në mënyrë të heshtur apo tjetërsoj se Enver Hoxha e liderë të tjerë ishin kampionë të vërtetë të vlerave demokratike.

Pra reforma e brendshme e partive politike duhet të vendoset në qendër të diskutimeve politike. Në rast të kundërt, komenti i kohëve të fundit bërë nga një zyrtar i lartë i BE në Shqipëri se Shqipërisë, për t’u integruar në BE, do t’i duhen akoma edhe 15 vjet të tjera, në fakt, mund të jetë një vlerësim shumë optimist.

Duke pasur këto në mendje, një vështrim i parë se si diskutimi për “Një anëtar, një votë” është zhvilluar gjatë vitit të fundit do të na tregojë se sa larg kemi shkuar politikisht si vend. Në Kongresin e Partisë Socialiste në Dhjetor 2003, p.sh dy nga tre kandidatët për postin e Kryetarit të partisë parashtruan në platformat e tyre politike nevojën për të prezantuar lëvizjen “Një anëtar, një votë”. Kjo ishte hera e parë që një proces i tillë u propozua në një parti politike në Shqipëri. Ndonëse reagimi ndaj ideve të tyre parashikohej të ishte i vakët, fjalimet kurajoze të Mejdanit, Zelës, Ramës dhe Matajt në atë moment, sipas mendimit tonë, i dhanë tonin diskutimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje, duke theksuar “tregues” politikë, dobitë e të cilëve po i korrim tani.

Në Mars të vitit 2004, Partia e Re Demokratike i kërkoi NDI-së të fillojnë të punojnë së bashku për të prezantuar parimin “Një anëtar, një votë” në strukturat e partisë së tyre. Deri tani, ne kemi diskutuar me hollësi detajet se si mund të realizohet një bashkëpunim i tillë edhe së afërmi do t’i

zyrtarizojmë këto bisedime me një memorandum mirëkuptimi. Në fund të muajit gusht, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) përfshiu në statutin e saj një dispozitë për lëvizjen “Një anëtar, një votë” duke u bërë kështu partia e parë politike shqiptare që e bën këtë gjë.

Në shtator të dy partitë politike PS dhe PD hynë në këtë debat të rëndësishëm. Kryetari i Partisë Demokratike i shpjegoi Këshillit Kombëtar të Partisë se “Një anëtar, një votë” ishte i nevojshëm dhe se ata parashikonin ta zbatonin atë në zgjedhjet e degëve të partisë në vitin 2007. Dhe së fundi, ndërsa unë po përgatisja këto shënime mora vesh se Partia Socialiste në fuqi po diskuton këtë problem në Komitetin e Përgjithshëm Drejtues.

Sidoqoftë, na duhet të bëjmë dy paralajmërime të rëndësishme. Ndonëse dihet që çdo proces do të fillojë diku, për komunitetin ndërkombëtar është e vështirë të besojë se partitë politike në Shqipëri janë duke u reformuar pa pasur një deklaram të qartë se kur vetë udhëheqësit e lartë të partive do të paraqesin kandidaturën e tyre për t’u zgjedhur para anëtarëve të thjeshtë të partisë. Duke pasur parasysh përparimin e bërë dhe nxitjen mëtejshme që ne presim, le të shpresojmë se kjo kohë do të jetë e afërt. Paralajmërimi i dytë lidhet me pikëpamjen e shumë- përsëritur, kryesisht nga kritikë të reformës, të cilët thonë se parimi “Një anëtar, një votë”, do të shërbejë për të forcuar pushtetin e liderëve të partive. Ndoshta mund të vërtetohet që ata të kënë të drejtë dhe në se do të ndodhe kështu, atëherë do të jetë dëshira e anëtarëve të partisë që të jetë kështu- dhe ajo nuk mund të jetë e gabuar - së paku krahasuar me sfidat që përballohet aktualisht.

NDI në Shqipëri ka përgatitur këtë libër duke prezantuar pikëpamje dhe komente të politikanëve, komentatorëve politikë dhe komentatorëve të shoqërisë civile, vendas dhe të huaj. Në fakt, ky botim, siç e sugjeron edhe vetë titulli është një përmbledhje e eseve politike dhe si i tillë përfshin një diapazon të gjerë pikëpamjesh dhe opinionesh të cilat jo gjithmonë i pranojnë të gjitha aspektet e lëvizjes “ Një anëtar, një votë”. Do të dëshironin të falënderonim kontribuesit e këtij vëllimi për cilësinë e lartë të kapitujve të tyre respektivë. Do të kishim dashur të përfshininim edhe më shumë pjesëmarrës, por nuk na lejonte as vendi as koha. Ndoshta, në një stad të mëvonshëm, mund të na jepet mundësia të përfshijmë kontribues të tjerë për problemin “Një anëtar, një votë” apo çështje të tjera lidhur me reformën e partive politike.

NDI do të dëshironte të falënderonte individët e mëposhtëm për mbështetjen e tyre në përgatitjen e këtij botimi: Së pari, USAID-in dhe në veçanti z. Harry Birnholz, z. Bruce Kay dhe znj. Suzana Cullufi për mbështetjen financiare të një projekt të tillë të rëndësishëm dhe të kohës.

Dan Redford

Së dyti, Prof.as.Dr.Katina Drenova për punën me profesionalizëm dhe korrektësi në përkthimin dhe rishikimin e këtij botimi. Së treti stafin e NDI në Shqipëri dhe në Washington D.C për besimin që treguan për të mbështetur një temë të tillë. Falënderime të veçanta duam t'iu shprehim Zj. Jennifer L. Butz dhe Zj. Erin D. Mathews për komentet e tyre konstruktive përgjatë përgatitjes së librit dhe z. Guri Daco për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në përkthime dhe në përgatitjen për botim të librit në përgjithësi. Së fundi, jo nga rëndësia, iu shprehim falënderime partive politike shqiptare dhe njëqind pjesëmarrësve të programeve të menaxhimit politik pa mbështetjen, këshillat dhe miqësinë e të cilëve përgatitja e këtij botimi do të kishte qenë e pamundur të realizohej.

Synimi i këtij botimi është të nxisë diskutime më të gjerë politike për një çështje që është themelore për të realizuar reforma demokratike kuptimplota në Shqipëri. Nëse libri “Një anëtar, një votë - përmbledhje shkrimesh politike” do të bëhej objekt për debate serioze dhe zbatim në jetën politike shqiptare, atëherë synimi ynë fillestar do të kishte qenë i suksesshëm. Tani ju mbetet veçse ju, lexues të dashur, të gjykoni.

Dan Redford
Tiranë
Tetor 2004

2 Shqipëria në prag të reformës politike

Robert D. Benjamin

Shqipëria, në tranzicionin e saj demokratik, ka bërë hapa të rëndësishmëm ndonëse me hope. Atje ka shumë parti politike dhe zgjedhjet, megjithëse jo plotësisht demokratike, zhvillohen rregullisht. Shoqëria civile po rritet ndonëse ngadalë. Ka shpërthime të mediave të ndryshme, por ato kontrollohen nga interesa politike dhe private. Stabiliteti Politik pas trazirave të ashpra qytetare të vitit 1997 është përmirësuar por ende mbetet i brishtë. Tranzicioni demokratik i Shqipërisë ka bërë përmirësime të rëndësishme institucionale por vuan nga një shkëputje e madhe midis elitës qeverisëse dhe qytetarëve si dhe nga korrupsioni i lidhur me të. Politikat qeverisëse shpesh përcaktohen nga interesa private dhe jo publike. Institucionet e dobëta mundësojnë njerëz të paskrupull të zaptojnë burimet shtetërore. Strukturat ligjore për të luftuar korrupsionin janë hartuar por ato ende nuk zbatohen.

Diagnostikimi i mësipërm duhet të kuptohet në kontekstin e rrugëtimit shumë kompleks të Shqipërisë nga komunizmi autarkik në demokracinë moderne. Sigurisht që Shqipëria në këto 13 vjetet e fundit është përsosur shumë, duke u distancuar nga një lloj komunizmi veçanërisht i dëmshëm. Tani vëmendja është përqendruar në integrimin Transatlantik dhe European si treguesi kyç i konsolidimit të një rendi politik demokratik dhe të një ekonomie të tregut në Shqipëri. Për të plotësuar kriteret e caktuara për t'u anëtarësuar në NATO dhe BE, në aspektin politik, Shqipëria, ka nevojë për një sistem politik demokratik të bazuar në pushtetin e ligjit dhe të karakterizuar nga dialogu shumë partiak për çështjet e reformave të cilat mbi të gjitha përfaqësojnë dhe i shërbejnë interesit publik.

Është përgjegjësia e lidërshit politik shqiptar, që t'i plotësojë këto kërkesa. Është përgjegjësia e udhëheqësve politikë të vendit dhe partive politike që ata drejtojnë, që të hartojnë vizione për të ardhmen e Shqipërisë, të formojnë qeveri të qëndrueshme, të udhëheqin opozita luajale, të angazhojnë shoqërinë civile në çështjet e politikave publike

dhe të debatohet, të vendosin dhe të zbatohet legjislacionin në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

Partitë politike shqiptare kanë bërë përparime të rëndësishme në ngritjen e organizatave të tyre dhe konkurimin në zgjedhje, por ato kanë ende shumë për të bërë për të realizuar shumë nga detyrimet drejtuese të mësipërme. Dështimi në këtë sfidë lidërshipi do të thotë që ato të humbasin besimin e publikut. Kjo do të thotë gjithashtu zgjatja ose minimi i tranzicionit demokratik shqiptar dhe bashkë me të edhe reformave që janë jetësore për stabilitetin politik, zhvillimin ekonomik dhe integrimin në institucionet Europiane dhe Transatlantike. Një situatë e tillë nuk është e veçantë vetëm për Shqipërinë. Ajo është e njëjtë në të gjithë Europën Juglindore. Të gjetura midis kalendarëve të mbushur plot me zgjedhje, mijedise politike të paqëndrueshme, çështje të vështira të reformës dhe kërkesave të shpeshta ngulmuese për mediatorë ndërkombëtarë, partitë politike në të gjithë rajonin, përpiqen të hartojnë vizione të qarta se ku duan t'i çojnë vendet e tyre dhe të përgatisin disa receta politike dhe axhenda ligjore të cilat përcaktojnë konkretisht këto vizione. Ato mundohen të ndërveprojnë me grupet e shoqërisë civile me qëllim që të ndërthurin interesat kushtetuese në legjislacion dhe t'i përfaqësojnë ato me efektshmëri në organet qeverisëse.

Pavarësisht nga faktorët e jashtëm partitë politike, përfshirë edhe ato në Shqipëri, duhet të reformojnë vetveten që të mund të sigurojnë udhëheqje konstruktive që nxit politika dhe qeverisje demokratike - jo vetëm me fjalë, por me vepra. Shumë njerëz në Ballkan mendojnë se partitë politike nuk përfaqësojnë gjë tjetër veçse interesat e tyre, në formën e korrupsionit dhe hatëreve dhe ato në përpjekjet e tyre të pafundme për pushtet nuk bëjnë gjë tjetër veçse vënë në skenë ekuivalentin politik të grindjeve të pijetoreve. Në mënyrë paradoksale, në një kohë kur procese zgjedhore më të mira dhe rritja graduale, ndonëse e paqëndrueshme, e medias së pavarur lënë të kuptohet se vendimet e qytetarëve në rutinë e votimit janë gjithnjë e më shumë të respektuara, ata kanë kaluar përtej skepticizmit të shëndetshëm të partive, në dënim të hapur të tyre. Sidoqoftë, përceptimet e këqia të publikut për partitë, kanë të bëjnë gjithnjë e më shumë me qeverisjen e keqe, se sa me legjitimitetin e zgjedhjeve.

Siç u theksua më sipër, partitë politike shqiptare, sipas raportimeve kanë bërë një rrugë të gjatë për ndërtimin e organizatave të tyre. Megjithatë, për të siguruar një udhëheqje efektive politike dhe legjislative, partitë politike tani duhet të modernizojnë dhe reformojnë organizatat e tyre, kryesisht, por duke mos përjashtuar aspekte të tjera në tre drejtime kryesore. Së

pari, partitë politike duhet të liberalizojnë proceset e tej centralizuara të vendimmarrjes. Së dyti, ato duhet të institucionalizojnë mekanizma vetë - qeverisëse, për t'i bërë financat dhe funksionet e tjera të brendshme mjaft transparente dhe ligjërish të korrekte. Së treti; partitë politike duhet të sanksionojnë dhe të nxitin një iniciativë më të madhe midis anëtarëve të tyre për të arritur në emër të partisë tek qytetarët dhe grupet qytetare. Shkurtimisht, partitë politike në Shqipëri duhet të bëhen më demokratike brenda dhe më dinamike jashtë.

Gjatë këtyre 13 vjetëve të angazhimit të tij në Shqipëri dhe veçanërisht që nga viti 2000, NDI ka pasur mundësi të punojë me partitë politike udhëheqëse, të majta e të djathta, në pushtet dhe në opozitë, në nivel kombëtar e lokal për çështjet e vështira të ndërtimit dhe modernizimit të partisë NDI ka qënë i angazhuar gjithashtu edhe me shoqërië civile, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me shoqatën për Kulturë Demokratike si dhe në Shqipërië e Mesme me disa grupe qytetarësh në bazë. NDI ka punuar me pushtetin lokal për të zgjidhur çështjet e ngutshme që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën.

Nga puna jonë ne kemi nxjerrë shumë mësimë të rëndësishme. Së pari, udhëheqësit e partive politike të Shqipërisë janë përballuar me kriza ekonomike dhe politike urgjente, që jo gjithmonë lejojnë të gjykuarit strategjik për çështje afatgjata të lidhura me reformat dhe performancën e qeverisë dhe aq më pak. për mirëqenien e partive të tyre. Së dyti, partitë politike të vendit të mëdha e të vogla, në pushtet dhe në opozitë, veç e veç dhe të gjitha së bashku janë plot me njerëz të talentuar dhe parimorë- shumica e të cilëve të rinj dhe gra – të cilët kanë ide të qarta dhe bindëse se si të shtyjnë partitë e tyre përpara dhe se si ta çojnë vendin përpara. Fatkeqësisht këta elementë nuk inkurajohen mjaftueshëm nga udhëheqësit e tyre që të marrin inisiativa veçanërisht në nivel lokal. Kjo duhet të ndryshojë, mbasi mësimi i tretë i nxjerrë nga NDI është se OJQ-të dhe grupet e qytetarëve kanë njohuri për çështjet e reformës, kanë ide të rëndësishme, që duhet të përfshihen në programet e legjislativit dhe janë të gatshëm të mobilizojnë partitë politike në formimin dhe zbatimin sa më të mirë të reformave.

Shkurtimisht, me afrimin e gjysmës së dytë të kësaj dekade, Shqipëria është në prag të një periudhe dinamike të stabilizimit dhe modernizimit politik. Aftësia e saj për ta kapërcyer këtë prag nuk varet në talentet dhe vizionin e partive politike, mbasi të dyja këto janë të dukshme. Ajo varet kryesisht në dy faktorë të tjerë. Së pari, vendosmëria politike e secilës parti për t'iu angazhuar me shpirt e me vepra reformës. Së dyti, vullneti

politik i secilës parti për të punuar së bashku për zgjedhjet dhe proceset e tjera, për të forcuar institucionet qeverisëse të vendit dhe strukturën e tij politike.

Për të modernizuar sistemin politik p.sh. për të vendosur pushtetin e ligjit, për të siguruar një sistem elektoral me të vërtetë të paanshëm, për të ndërtuar praktikatat si dhe parimet e medias së pavarur, për të reduktuar korrupsionin në sektorin publik – do të thotë të shprehesh haptazi në emër të parimeve demokratike dhe t'i bësh ato reale dhe konkrete, duke pasur parasysh që “shtëpia jote” të jetë në kushte pune vërtet demokratike.

Mekanizmi “Një anëtar, një votë” është një proces demonstrues dhe praktik, ku partitë politike mund të praktikojnë ato që predikojnë. Me anë të këtij mekanizmi, anëtarët efektivë të një partie politike vendosin në mënyrë transparente, të strukturuar dhe të rregullt për probleme të tilla si: udhëheqësit e partive, zgjedhja e kandidatëve si dhe platformat e partive.

Lidershipi i disa partive politike në Shqipëri e ka miratuar publikisht mekanizmin “Një anëtar, një votë” dhe i është vënë punës për ta përfshirë atë në praktikatat e partisë. Ata pranojnë se mekanizmi “Një anëtar, një votë” do të forcojë komunikimin e brendshëm të partisë, do të aktivizojë anëtarët e saj, do t'i japë partive më shumë besueshmëri publike si përkrahës të reformave demokratike dhe në të njëjtën kohë do të forcojë pozitat e tyre si udhëheqës.

Çështja e fundit është kritike për të kuptuar pse mekanizmi “Një anëtar, një votë” është në përgjithësi i përshtatshëm për partitë politike, si kurse edhe për sistemin e partive politike në Shqipëri. Nga vetë natyra e tyre, partitë politike, ashtu sikurse dhe organizatat e tjera, sfidohen nga ndarje të brendshme për pushtet dhe vendim- marrje. Partitë politike Shqiptare e kanë paguar një çmim duke mos gjetur mekanizmat e përshtatshëm për të trajtuar mosmarrëveshjet e brendshme. Ndarjet dhe largimet pa dyshim që i kanë dobësuar partitë. Mekanizmi “Një anëtar, një votë” lejon fraksione brenda partisë për t'i paraqitur çështjet e tyre para anëtarve të partisë në mënyrë demokratike, të përgjegjshme dhe konstruktive, duke i dhënë mundësi partive politike të marrin vendime të rëndësishme të tilla si përzgjedhja e kandidatëve, dhe të qëndrojnë të bashkuara në proces. Kjo nga ana e saj, forcon pozitën e udhëheqësve, të cilët kështu tregojnë se janë të sigurtë në udhëheqjen e tyre duke i dhënë të tjerëve me shumë fuqi në vendime. “Një anëtar, një votë” nuk duhet të zërthehet si zvogëlues i rolit thelbësor të udhëheqësve të partive politike. Ata janë sërish të kërkuar për të sjellur vizion dhe udhëzime dhe të afirmojnë apo marrin vendime në bazë të konsultimeve të brendshme që sjell me vete sistemi “Një anëtar, një votë”.

Eshtë detyra e udhëheqësve të partive politike të tregojnë përkushtimin e tyre ndaj demokracisë duke mbështetur mekanizmin “Një anëtar, një votë” dhe duke e zbatuar atë në realitet. Kjo do të forconte partitë politike shqiptare dhe sistemin politik partiak në përgjithësi. Kjo do t’i poziciononte udhëheqësit politikë të vendit si mbrojtës të reformave demokratike të sigurtë se ajo çka ata predikojnë mbështetet në atë çka ata zbatojnë.

3 Përse anëtarët janë të rëndësishëm

Mary O'Hagan

Gjithësecili ka një përgjigje të ndryshme ndaj pyetjes: ‘Cili aset ka më shumë rëndësi për një parti politike?’ Disa mund të përgjigjen: ‘Një udhëheqës karizmatik’. Të tjerë mund të thonë: ‘Një mesazh i shkëlqyer’ apo ‘Shumë para’. Përgjigjia ime është: ‘Një anëtarësi e madhe dhe në rritje’. Një parti që ka vetëm një udhëheqës, një mesazh dhe një shumë parash është një parti që nuk ka shanse të jetë e suksesshme për një kohë të gjatë sepse anëtarësia e partisë është pusi prej nga nxirren veprimtarët, kandidatët dhe udhëheqësit e ardhshëm. Anëtarët janë burim idesh, energjie dhe rritje të mundshme. Ata janë mjetet me të cilat partia mund të jetë aktive në nivel vendor duke mbajtur një dialog të vazhdueshëm me qytetarët në periudhat ndërmjet zgjedhjeve. Anëtarët e partisë mund parandalojnë udhëheqësit e një partie qeverisëse të humbasin lidhjen me zgjedhësit dhe nga ana tjetër mund të parandalojnë udhëheqësit e opozitës të humbasin shpresën për fitore në të ardhmen. Shkurtimisht, anëtarët e partisë janë asetë më të rëndësishëm sepse pa ta nuk ka parti.

Nëse anëtarët janë asetë më të vyer që mund të ketë një parti, atëherë organizatorët e saj duhet të kenë parasysh se si t’i anëtarësojnë, si t’i mbajnë, si t’i motivojnë dhe si t’u japin detyra sa më me efektivitet. Është e lehtë që të përqendrohesh për të gjetur se çfarë duam që të bëjnë anëtarët për partinë: të frekuentojnë takimet partiake, të anëtarësojnë anëtarë të rinj, të mbështesin udhëheqjen, të dhurojnë të holla, të dalin vullnetarë në fushata dhe të votojnë për partinë e tyre në zgjedhje. Është po aq e lehtë të harrosh se çfarë duhet të bëjë partia për anëtarët e saj. Gjëja e vetme më e rëndësishme që mund të bëjë partia është që t’u japë anëtarëve mundësinë të thonë fjalën e tyre në vendimet partiake. Nëse anëtarët e partisë nuk mundësohen të kenë ndikim mbi vendimet partiake, ata nuk ka sesi të ndihen të vlerësuar apo të vlerësojnë partinë e tyre. Anëtarët e partisë që kanë të drejta sikurse edhe përgjegjësi, kanë më shumë gjasa të mbeten besnikë dhe të përparojnë brenda partisë: nga të anëtarësuar në veprimtarë vendorë edhe organizatorë dhe më pas kandidatë për këshillat vendorë

apo parlament.

Parti të ndryshme kanë mënyra të ndryshme për të përfshirë anëtarët e tyre në proceset e vendimarrjes. Në disa raste udhëheqësit e partisë vendosin t'u ofrojnë anëtarëve mundësi spontane për të marrë pjesë në vendimarrje. Në raste të tjera anëtarëve u jepen të drejta të patjetërsueshme për të marrë vendime të caktuara. Tek Liberal Demokratë, të drejtat e anëtarëve mbrohen me kujdes. Mundësia e çdo anëtari për të pasur të drejtën për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve të caktuara ishte një nga themelet mbi të cilat u ngrit partia, kur Social Demokratët dhe Liberalët u bashkuan në një parti të vetme në vitet 1980, në Liberal Demokratët. Ata ndoshta kanë statutin e brendshëm më demokratik të të gjitha partive më të mëdha në Mbretërinë e Bashkuar sepse kufizimi i pushtetit të udhëheqësve dhe rritja e pushtetit të qytetarëve të veçantë është mishëruar në filozofinë e Liberalizmit dhe formon bërthamën e ideologjisë mbi të cilën bazohet partia.

Çdo anëtar ka të drejtën e një votë për zgjedhjen e udhëheqjes së partisë dhe të disa prej funksioneve të tjera të saj. Çdo anëtar ka të drejtën të marrë pjesë në vendimarrjen lokale brenda degës së tij. Kjo përfshin vendimet mbi udhëheqjen lokale, përzgjedhjen e kandidatëve për parlament dhe këshillat lokalë dhe përzgjedhjen e kandidatëve për konferencën vjetore të partisë. Konferenca vjetore e partisë ka të drejtën të marrë vendime mbi politikat e partisë. Në këtë mënyrë anëtarët janë realisht burimi i çdo lloj autoriteti brenda partisë. Udhëheqësi jep llogari para anëtarësisë jo vetëm në momentet kur zgjidhet por edhe kur mandati i tij rinovohet. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për çdo Anëtar të Parlamentit qofshin ata të Westminsterit, Skocisë, Uellsit dhe atij Europian si dhe për çdo këshilltar. Asnjë politikë në asnjë nivel nuk mund të ndiqet nëse anëtarësia si një e tërë e kundërshton atë. Asnjë kandidat nuk mund të zgjidhet pa përkrahjen e anëtarëve vendorë.

Demokracia e brendshme vepron gjithashtu brenda grupit parlamentar të Dhomës së Ulët (House of Commons) dhe atij të Dhomës së Lordëve. Udhëheqësi i grupit në Dhomën e Lordëve zgjidhet nga të gjithë anëtarët e grupit. Shefi i disiplinës dhe kryetari i partisë¹ zgjidhen nga deputetët e partisë në Dhomën e Ulët. Të dyja grupet veprojnë sipas rregullave të votuara nga të gjithë anëtarët e grupeve. Këto rregulla kufizojnë hapësirat e udhëheqësit të kërkojë takime apo të vendosë programin e grupeve. Ato u sigurojnë të drejta anëtarëve të grupeve, të tilla si: të drejtën për të marrë informacion, mundësinë për të propozuar amendamente për sugjerimet

që vijnë nga udhëheqja dhe të drejtën të frekuentojnë dhe të votojnë në takimet e grupeve. Këto rregulla gjithashtu mundësojnë anëtarët e grupeve të thonë fjalën e tyre mbi mënyrën sesi burime të tilla si personeli apo paratë po përdoren.

Tradita e demokracisë së brendshme është kaq thellë e mishëruar në partinë Liberal Demokrate saqë një nga ish udhëheqësit tanë sot përfaqësues i lartë në Bosnje Herzegovinë, Lord Ashdown, njëherë e përshkroi procesin e udhëheqjes së partisë si ‘ të përpiqesh të jesh bariu i maceve’. Me këtë ai nënkuptonte se një parti e përbërë nga një numër kaq i madh anëtarësh me mendësi të pavarura dhe të armatosur me të drejta të konsiderueshme vendimarrëse nuk është lehtë për t’u udhëhequr. Udhëheqësi i partisë sonë duhet të bindë trupat e tij dhe jo t’i komandojë ata. Megjithatë, unë do të thoja se udhëheqja e mirë nuk është komandim edhe atëherë kur udhëheqësi ka pushtetin formal për ta bërë një gjë të tillë. Ajo është gjithmonë një proces dhe aftësi bindjeje. Statuti i partisë sonë thjesht garanton që të gjithë udhëheqësit tanë të veprojnë në këtë mënyrë, nëse duan apo jo.

Sigurisht që në një sistem demokratik anëtarët e partisë mund të marrin [dhe marrin] vendime që udhëheqja e partisë nuk i pëlqen. Kjo mund të ndodhë më shumë në konferenca partie ku mund të miratohen politika që nuk janë të lehta për t’u zbatuar. Një gjë e tillë mund të jetë e vështirë për udhëheqjen për ta menaxhuar, veçanërisht përpara medias. Demokracia në këtë formë nuk është gjithmonë një proces pa kokëçarje. Megjithatë ky nuk është një argument për të kufizuar të drejtat e anëtarëve, por është një argument për të rishikuar dhe azhornuar rregullisht politikat e partisë dhe për të siguruar që bashkësia e të gjithë politikave të miratuara nga konferencat të mos jetë e madhe, tepër e detajuar dhe e pamenaxhueshme.

Të gjithë Liberal Demokratët e gjejnë veten, ndonjëherë, në anën e të humburit nga vendimet e brendshme partiake, por ata i pranojnë ato vendime, sepse kanë pasur një shans të barabartë për të marrë pjesë në procesin e marrjes së tyre. Si rrjedhojë, kohezioni partiak është i lartë. Është tepër e vështirë për një fraksion të vogël të organizojë një grusht për të shtënë në dorë udhëheqjen apo të pretendojë pronësinë për një politikë sepse e gjithë anëtarësia është e angazhuar drejtpërdrejt në marrjen ose jo të kaq shumë vendimeve. Po ashtu, fushatat tona nuk drejtohen nga promovimi i imazhit të udhëheqësit. Degët tona vendore vazhdimisht përcjellin shqetësimet e komuniteteve lokale në instancat më lart nëpërmjet proceseve të bërjes së politikave. Fushatat tona, veçanërisht në nivel lokal, ndërtohen rreth çështjeve që prekin dhe shqetësojnë më shumë qytetarët.

Liberal Demokratët kanë mënyra për të parandaluar udhëheqësit e tyre të humbasin kontaktin me njerëzit e thjeshtë!

Ndoshta përfitimi më i rëndësishëm nga një nivel kaq i lartë demokracie partiake është se partia është shumë e motivuar dhe ka një bërthamë anëtarësh besnikë, që kanë bërë një progres të theksuar duke e ngritur partinë nga fillimet e saj modeste të fundit të viteve 1980. Partia ka pasur si prioritet kryesor zhvillimin e organizatave të saj në nivel lokal. Nga fillimet e saj të përqendruara në ‘kufijtë keltikë’ në Skoci dhe Anglinë jugperëndimore partia ka zhvilluar gradualisht qendra mbështetjeje në të gjithë vendin dhe tani ka përfaqësues të zgjedhur në çdo rajon. Këto arritje janë mbështetur në përpjekjet e palodhura të anëtarëve të partisë që kanë bërë fushatë për partinë në periudhat midis zgjedhjeve, shpesh për dy apo tre zgjedhje me radhë para se të mund të ndjenin shijen e fitores. Qenia e këtyre organizatave lokale me rrënjë të forta në komunitete do të thotë se, nëse vijnë momente zbrapsjeje ka gjithmonë një grusht njerëzish që mund të ngrënë sërish organizatën dhe të synojnë fitoren në zgjedhjet e ardhshme. Nuk do të kishte qenë e mundur të punohej në mënyrë të tillë, nëse anëtarët dhe degët nuk do të kishin gëzuar një shkallë të konsiderueshme autonomie në vendimarrjen e tyre dhe nuk do të kishin pasur besim në udhëheqjen parlamentare dhe kombëtare të partisë. Ky besim fitohet shumë më kollaj nëse anëtarët e dinë se do të kenë shanse të barabarta për të marrë pjesë në zgjedhjet e brendshme në parti dhe nëse udhëheqësit e tyre janë llogaridhënës ndaj tyre në periudhat midis këtyre zgjedhjeve.

Winston Churchill njëherë e përshkroi demokracinë si sistemin më të keq të mundshëm ndaj të gjitha alternativave. Nga pikëpamja e çdo udhëheqësi, demokracia është harxhim kohe, e pavolitshme dhe e çrregullt. Por ajo është gjithashtu motivuese, dinamike dhe krijuese dhe prodhon një nivel më të lartë stabiliteti dhe konsensusi se çdo sistem tjetër i shpikur deri me tani. Ndonëse Churchill diskutonte për sistemin politik në tërësi, eksperiencia e Liberal Demokratëve tregon se maksima e tij mund të zbatohet njëlloj në organizimin e brendshëm të partive politike.

Shënime:

¹ Këtu, kryetari i partisë nuk nënkupton pozicionin e udhëheqësit të partisë por atë të një zyrtari të lartë strategjik

4 Valët politike dhe proceset përzgjedhëse në ndryshim Mbërritja në Britani e parimit “Një anëtar, një votë”

Robert Evans MEP

Politika britanike ka përsuar një ndryshim tërësor në këto 25 vitet e fundit. Këto ndryshime kanë filtruar jo pak përmes partive politike sidomos kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e kandidatëve në zgjedhje dhe në numrat e përfshirë në mbarë procesin zgjedhor.

Hyrja e televizionit shumë-kanalësh, ndryshimet në orarin e bërjes së pazarit (shtatë ditë në javë dhe madje 24 orë në ditë) dhe një rritje e jashtëzakonshme e njerëzve të punësuar, kanë kontribuar në një pjesëmarrje shumë më të vogël në politikën partiake të çdo niveli. Kanë kaluar kohët kur qindra njerëz mund të vinin për të marrë pjesë në një mbledhje tek një cep rruge. Në mënyrë të njëjtë, grumbullimet e nxehta e të gjalla, madje edhe gjatë kohës së zgjedhjeve, tani i përkasin së shkuarës.

Kjo e keqe është po kaq e dukshme në nivelin e pjesëmarrjes në vetë zgjedhjet. Në vitin 1992 gati 80% e britanikëve e ushtronin të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme. Deri në vitin 2001 pjesëmarrja ra poshtë 60%, dhe shumë vëzhgues parashikojnë se në zgjedhjet e ardhshme pjesëmarrja ndoshta mund të jetë më pak se gjysma e elektoratit.

Duke i shtuar kësaj pikëpamjen se internacionalizmi i bën politikat dhe politikanët kombëtarë më pak përkatës, ndoshta nuk përbën shumë çudi fakti që të dy partitë kryesore në Mbretërinë e Bashkuar (MB) raportojnë një rënie të numërit të anëtarëve. Përkundrejt kësaj, numri i njerëzve që e shohin veten si politikanë premtues, qëndron po aq euforik si gjithmonë. Nëse, qoftë për Partinë Laburiste e qoftë për atë Konservatore, bëhet e mundshme një ‘zonë elektorale e sigurt’, shumë rrallë do të kishte të ngjarë të kishte më pak se njëqind kandidatë aspirantë që do të tureshin për të marrë emërimin (përzgjedhjen). Edhe në ‘zonat elektorale të pashpresa’ përzgjedhjet vijnë vazhdimisht pas konkurimesh të fituara ngushtë për shkak se përvoja e pjesëmarrjes në to është e pamatë dhe fushata sërish mund të jetë emocionuese.

Partia Laburiste e pati nisjen e saj njëqind vjet më parë si ‘Komiteti Përfaqësues Laburist’. Qëllimi i vetëm i themeluesve ishte që të arrinin të zgjidhnin anëtarë aktivë dhe të vendosur të sindikatës si anëtarë të Dhomës së Komunëve (Parlamentit) në mënyrë që këta të fundit të mbrojnë interesat e sindikatës që i mbështeti. Deri fare afër ka pasur zona zgjedhore parlamentare në pjesë të ndryshme të vendit që ishin gjithmonë ‘të rezervuara’ për bijtë (zakonisht të tillë) apo bijat e favorizuar të sindikatës lokale. Sindikata Kombëtare, tashmë e shkatërruar, e Minorëve dikur dominonte vendet parlamentare që vinin prej zonave të minierave të qymyrit. Në mënyrë të ngjashme, Anëtari i Parlamentit që përfaqësonte një qytet hekurudhor si për shembull Crewe ose York, do të ishte gjithmonë një mashinist i dikurshëm treni apo një punonjës hekurudhe.

Kjo ndodhte pasi Komiteti i Përgjithshëm Administrues i degës lokale të Partisë Laburiste ishte një organizëm delegatësh. Organizatat e lidhura (aleatet), Sindikatat, Kooperatorët, Shoqëritë Socialiste dhe degët e Partisë Laburiste kishin anëtarë në përpjesëtim të drejtë më anëtarësinë e tyre. Sindikatat e mëdha në këtë mënyrë tentonin të dominonin procesin dhe po të mos kishte arsye të veçanta, kandidati i tyre i preferuar do të dilte gjithmonë i pari. Një bllok delegatësh të Sindikatës që ndoshta përbënte edhe 50 % të gjithë delegatëve mundet që lehtësisht të votonin njëzëri në mbështetje të kandidatit të paravendosur prej tyre qysh përpara mbledhjes përzgjedhëse përfundimtare.

Gjatë viteve të qeverisë Konservatore të Znj.Thatcher (1979-1990) shumë prej sindikatave të mëdha luftuan kundër ‘malit’ me legjislacion anti-sindikatë. Anëtarësia e sindikatës ra në mënyrë të shpejtë ndërsa papunësia rritej. Ky dëshpërim u manifestua në protestat gjatë grevës së minorëve (1984) dhe dhe në kundërshtimin e poll tax¹ (1990) por që nuk sollli ndonjë rritje masive të anëtarësisë Laburiste.

Në vijim të tre humbjeve të rënda e të njëpasnjëshme kundër Konservatorëve (1979, 1983 dhe 1992) në Partinë Laburiste pati një lëvizje drejt një procesi shumë më të hapur përzgjedhjeje. Megjithë kundërshtimin e konsiderueshëm të brendshëm, Laburistët filluan ‘modernizimin’ e procesit të tyre të përzgjedhjes për të reflektuar më ngushtësisht pikëpamjet e anëtarësisë së thjeshtë Laburiste në vend të ‘bllloqeve të pushtetit’.

Nën udhëheqjen e Neil Kinnock dhe më vonë për pak kohë të John Smith, Laburistët ndryshuan prej një partie të opzites në një parti qeverisëse. Për ironi, deri në momentin e fitores së parë Laburiste në 1997, Xhon Smithi

kishte vdekur në mënyrë të parakohshme prej një ataku në zemër dhe Nil Kinoku i ishte larguar politikës britanike për t'u bërë një Komisioner European. Tani, pas dhjetë vjetësh në tryezën e BE, posti i tij do të merret prej Pitër Mendlesën (Peter Mendleson), një ish funksionar laburist dhe më vonë deputet, i cili ishte arkitekti i shumë ndryshimeve të brendshme të laburistëve. Toni Bler, natyrisht voli përfitimet e ndryshimeve për të fituar për dy herë radhazi, me plebishit, duke demoralizuar dhe diskredituar opzitën Konservatore.

Përfitimi nga ana e laburistëve i një shumice të re deputetësh në 1997 reflektoi ndryshimin në mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve. Një e katërta e 418 deputetëve laburistë ishin gra dhe kishte shumë më tepër ish-mësues dhe mjekë sesa kurrë më parë. Udhëheqësit e sindikatave dhe zyrtarët që punonin me kohë të plotë zëvendësuan gjithnjë e më shumë punëtorët e shtresave të ulta.

Një brez më parë, në degët lokale të Partisë Laburiste, kandidati mund të zgjidhej nga një individ i vetëm i fuqishëm apo nga një grup i vogël me influencë. Kjo nuk do të thotë se të gjitha përzgjedhjet firmoseshin dhe vuloseshin që më parë. Kishte, sigurisht, mbledhje në të cilat kishte konkurim të fortë rivalësh të ndryshëm, secili me një trupë të fortë mbështetjeje. Në mbledhjen përmbyllëse me pjesmarrje prej qindra vetësh dëgjoheshin fjalime dhe drejttoheshin pyetje për kandidatët. Zhvilloheshin një seri votimesh me sistem eliminimi, derisa njëri prej kandidatëve të triumfonte.

Me raste, nëse një kandidat nuk arrinte të krijonte besim apo një tjetër kandidat paraqitej shumë keq, ndodhte që të kishte edhe surpriza. Me dy (ose më tepër) fraksione konkurente, ishte gjithashtu e mundshme që delegatët të votonin qëllimisht kundra kandidatit kundërshtar për ta ndaluar atë të fitonte duke lejuar në këtë mënyrë një kandidat të tretë të dilte në krye dhe të mposhte dy konkurentët parësorë.

Tashmë, i gjithë ky proces është më i hapur dhe në fakt më kohë-harxhues për deputetët e ardhshëm. Për t'u përzgjedhur nuk është më e mundur që të shkohet vetëm në një mbledhje përmbyllëse, me mbështetje dhe shpresë të sigurt për të dalë mirë gjatë asaj nate të mbledhjes. Gjithnjë e më tepër kandidatët kanë nevojë që të kenë një dokumentim të qartë të punës brenda lokalitetit të tyre, si këshilltarë lokalë, brenda partisë së tyre apo të kenë një profil të lartë në ndonjë lloj aspekti tjetër. Udhëheqësit e këshillave lokalë, punonjësit e palodhur të partisë dhe madje dhe yjet e televizionit kanë më tepër gjasa të jenë më të preferuar sesa sindikalistët tradicionalë.

Procesi ka lëvizur drejt “një anëtar, një votë” Çdo anëtar partie në një degë lokale ka mundësinë për të hedhur votën e tij/saj për të zgjedhur kandidatin e ardhshëm. Kjo ka çuar në një numër të pallogaritshëm kontaktesh me elektoratin që në këtë rast janë anëtarët e thjeshtë të partisë. Kandidatët aspirantë që janë seriozë për të arritur fitoren mund të vendosin që të harxhojnë më shumë orë për të takuar sa më tepër anëtarë që të jetë e mundur, për t’iu kërkuar mbështetjen dhe për t’i nxitur ata që të marrin pjesë në konferencën përmbyllëse të përzgjedhjes. Përveç kësaj, vota postare lejohet për ata që për çfarëdo lloj arsyeje, nuk mund të marrin pjesë në konferencë.

E gjithë kjo ka avantazhin që gjithmonë e më pak kandidatë ‘të panjohur’ mund të fitojnë përzgjedhjen në zona të forta. Kandidatët me lidhje të forta lokale apo që janë të mirënjohur, priren të kenë sukses krahasuar me të tjerët, shpesh me më shumë vlerë, që i përkasin një zone tjetër. Si pasojë, tani është shumë e rrallë që një deputet Laburist në detyrë, të mos fitojë rizgjedhjen kur ai/ajo është bërë ‘deputeti/ja i/e njerëzve’ në vend të të ngjelurit peng i një grupi të vogël influence. Deputetët që punojnë pa u lodhur shpesh zhvillojnë mbështetje të fortë lokale brenda dhe jashtë partisë, e cila është shumë e rëndësishme në momentin e zgjedhjeve. Ka gjithmonë më shumë anëtarë që janë të përgatitur për të ndihmuar në fushatë nëse ata ndjejnë ‘pronësi’ apo janë të lidhur me deputetin/en e tyre dhe votuesit e thjeshtë janë më të prirur të rizgjedhin dikë të cilin e njohim prej veprimtarisë në komunitet. Fuqia e mbajtësit të postit është e fuqishme në Shtetet e Bashkuara dhe besoj se kjo gjë është në rritje edhe në Mbretërinë e Bashkuar. Ndoshta ky është rezultat i ngjashmërisë ndërmjet procesit përzgjedhës, ku laburistët kanë evoluar, dhe sistemit amerikan të primarive².

Ky sistem i përzgjedhjes funksionon mirë kur përzgjedhja do t’i shërbente caktimit të një kandidati në një zonë njëvendëshe³. Në një formë të ngjashme ajo u përdor fillimisht për të përzgjedhur kandidatët për Parlamentin Europian. Në vitin 1999 ishte e dukshme që Mbretërisë së Bashkuar do t’i duhej të shkonte drejt një sistemi proporcional për zgjedhjet Europiane në mënyrë që të ishte në të njëjtën linjë me vendet e tjera të Bashkimit Europian.

Në përballje me një kundërshtim të konsiderueshëm brenda vetë partive politike dhe prej Dhomës së Lordëve (dhoma e lartë e Parlamentit) qeveria laburiste vendosi për sistemin e listave të mbyllura⁴. Nën këtë sistem votuesve u kërkohet që të zgjidhnin mes listës së kandidatëve nën një etiketë partiake, dhe kandidatëve të pavarur. Renditja e listës ishte e paracaktuar dhe e pandryshueshme.

Më pas vazhdohej me një procedurë të komplikuar numërimi nën sistemin d'Hont, (emëruar kështu për nder të një matematikani belg të shekullit të 19-të). Në vija të trasha, në një rajon me tetë vende, një parti që fitonte 50 përqind të votës popullore do të fitonte 5 deputetë dhe një parti që fitonte 10 përqind fitonte një. Kjo u provua të ishte totalisht jopopullore. Partitë politike e patën thujtë të pamundur të mbanin siç duhej demokracinë e brendshme kur përgatitej lista dhe zgjedhësi u ndje i lënë jashtë procesit për faktin se nuk kishte mundësi të vendoste shenjën e tij të votimit në krah të emrit të një kandidati individual. Pjesëmarrja, në garën e parë zgjedhore nën këtë sistem ra deri në masën 23%. Hera e dytë e kësaj gare u rregullua disi me një pjesëmarrje më të pranueshme prej 39%.

Konservatorët Britanikë nuk kanë dalë më të fituar nën këtë sistem. Edhe ata janë ndeshur mes tyre për të gjetur një metodë përzgjedhjeje që të pranohet nga të gjithë seksionet, të majtë e të djathtë, brenda partisë së tyre. Në kontrast me këtë, partitë e vogla, Liberal Demokratët, nacionalistët rajonalë dhe të djathtët e avancuar kanë arritur t'ia dalin mbanë kur, nëse ndryshe, nuk do të kishin mundur.

Sistemi i listave lë vend për një listë më përfaqësuese kandidatësh, edhe nëse ata nuk do të ishin gjithmonë përzgjedhja e anëtarëve lokalë. Ndërsa listat e laburistëve për garën e dytë mbronin të zgjedhurit në detyrë dhe gjithmonë shpërblenin ata që kishin një reputacion lokal, Partia Konservatore u mundua të penalizonte këdo që shfaqej si shumë pro – European. Në listën e tyre të kandidatëve për euro-parlamentarë, kandidatët e tyre të djathtë anti-europianë ishin zakonisht të vendosur më lart në listë sesa anëtarët e tjerë të vjetër në detyrë dhe që shikohej se ishin në favor të anës tjetër të argumentit.

Në përzgjedhjen e kandidatëve për Dhomën e Komunëve, si konservatorët ashtu edhe Liberal-Demokratët u përpoqën që t'i bënin ekipet e tyre të reflektonin natyrën ndryshuese të shoqërisë Britanike. Të dy këto parti përzgjedhin shumë pak kandidatë të pakicave kombëtare dhe shumë më pak gra sesa Partia Laburiste. Bankierët, biznesmenët dhe avokatët ende duket se dominojnë listën e kandidatëve konservatorë, me gjithë përprjekjet e lodhshme që po bëhen për një rang më të mirë aspirantësh.

Është për t'u dëshpëruar që asgjë prej këtyre nuk duket se po reflektohet me një pjesëmarrje më të lartë votuesish ditën e zgjedhjeve. Elektorati shihet që gjithnjë e më shumë të jetë i pikëpamjes që votimi gjatë zgjedhjeve nuk do të sillte ndryshim të mjaftë dhe pjesëmarrja e

tyre nuk është e nevojshme. Ose ndryshe, ata mund të kenë përrshtypjen se gjithçka është pak a shumë e kënaqshme në Britani dhe nuk ekziston më i njëjti presjon për të marrë pjesë. Kjo do të thotë se, në mënyrë të pavetëdijshme, njerëzit janë më të prirur të votojnë ‘për ndryshim’ dhe më pak të prirur për të siguruar ‘status-kuo-në’.

Cilado qoftë arsyeja dhe cilado parti që e mbështet këtë, është shumë për të ardhur keq që mbas vitesh të përpjekjeve intelektuale, elektorati dhe qytetarët duken gjithnjë e më shumë apatikë kundrejt të gjithë procesit! Sidoqoftë, ‘demokratizimi’ brenda partive politike Britanike është i fortë dhe ende në evolucion. Partitë politike që nuk përshtaten me shoqërinë tonë në ndryshim nuk mbijetojnë.

Partia Laburiste, natyrisht, me shumë të drejtë kaloi në sistemin ‘Një anëtar, një votë’. Ne sigurisht tani kemi nevojë ta stërhollojmë atë për shekullin e njëzetënjëjtë dhe ta kthejmë vëmendjen tonë në fusha të tjera të shpërndarjes dhe llogaridhënies, për të siguruar një sistem demokratik që t’i rezistojë kohës.

Shënime:

¹ Taksë e nivelit lokal (taksë bashkiake/komunale)

² Primaries (angl.)– mënyra me të cilën përzgjidhen kandidatët Amerikanë për president, brenda partive të tyre

³ Vini re se një zonë zgjedhore që mbulohet nga një degë partie mund të ketë një ose më tepër vende për deputetë

⁴ Listat e paracaktuara të kandidatëve në sistemin proporcional

5 Një anëtar, një votë

Përvoja e Partisë Konservatore të Britanisë së Madhe në nivel zone elektorale

Alex Finnen MBE

Në këtë monografi të shkurtër do të trajtojmë ndikimin që ka pasur lëvizja “Një anëtar, një votë” në Partinë Konservatore të Britanisë së Madhe në nivel dege dhe zone elektorale partie, sepse sipas mendimit tim, është pikërisht zona elektorale e partisë ajo në të cilën zbatimi i lëvizjes “Një anëtar, një votë” pati ndikim më jetëgjatë dhe më të thellë. Në këtë artikull unë do t’i referohem zonës time elektorale të partisë në East Surrey në Anglinë Jugore si rast studimor.

Koncepti “Një anëtar, një votë” nuk është i ri. Ai është diskutuar për herë të parë në Partinë Konservatore në vitin 1959. Në atë kohë, Partia Konservatore ishte në pushtet. Sido që të jetë, lëvizja për ta përhapur këtë koncept në parti filloi të përqafohet nga anëtarët e partisë në zonat e saj elektorale aty nga vitet 1990. Kjo, sipas meje, ndodhi për dy arsye themelore; Së pari, ishte nevoja për t’u dukur, së paku, po aq demokratike nga brenda sa edhe Partia Laburiste; Së dyti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, ishte pakënaqësia e anëtarëve të thjeshtë ndaj “grushtit” që ishte organizuar nga një numër i vogël parlamentarësh dhe që kishte sjellë zëvendësimin e Margaret Thatcher si Kryeministre. Sipas mendimit tim, kjo e fundit, d.m.th zotësia për të ruajtur pushtetin¹ ishte gjithashtu një nxitës për udhëheqësin e atëhershëm të partisë William Hague, ta mbështeste këtë lëvizje. Mbasi ideja ishte rritur dhe ”ishte aprovuar”, nisi puna për formimin e njerëzve. Lëvizja “Një anëtar, një votë” duhej t’u shpjegohej anëtarëve të partisë, shumica e të cilëve ishin shumë konservatorë në kuptimin e plotë të fjalës. Me fjalë të tjera, duhej t’u shpjegohej se çfarë nuk shkon në sistemin egzistues dhe pse duhej kaluar në sistemin “Një anëtar, një votë”. Kjo, natyrisht, që nuk është një punë e lehtë, sepse në aspektin praktik ndryshimi do të nënkuptonte më shumë centralizim dhe më shumë transparencë, p.sh. për anëtarët e degëve lokale të zonës elektorale. Eksperiencia e Partisë Konservatore tregon se kjo periudhë formimi mund të zgjasë një deri në dy vjet, madje mund të hasë në kundërshtinë e fortë të disa qarqeve.

Arsyet e kësaj kundërshtie mund të ndryshojnë nga partia në parti. Unë mund të flas vetëm për Partinë Konservatore, megjithatë mendoj se sa herë që një sistem zevendësohet me një sistem tjetër padyshim që do të ketë shqetësime.

Për Partinë Konservatore, një nga sfidat më të rëndësishme ishte ajo lidhur me numrin e anëtarëve në nivelin e zonës elektorale si dhe në nivelin e kuotizacionit. Në vitin 2004² niveli minimal i tij ishte 23 euro për person në vit.³ Kushti për të pasur një listë qëndrore të anëtarëve, një element thelbësor ky për sistemin “Një anëtar, një votë”, do të nxjerrë një anëtarësi partie që tashmë do të mund të kontaktohet nga selitë udhëheqëse të partisë. Po kështu, udhëheqësit e partisë dhe organizatorët mësuuan për herë të parë gjendjen e vërtetë të anëtarësisë në zonën elektorale, që pësoi një rrënie masive në anëtarësi nga diçka rreth 1.000.000 vetë në rreth 400.000 vetë në vitin 2001.

Kjo rrënie shpjegohet me faktin se shumë nga të ashtuquajturit “anëtarë” ose nuk ekzistonin fare, ose në më të mirën e rasteve ishin simpatizantë të vakët të partisë.⁴ Në East Surrey, p.sh. një ndikim i drejtpërdrejtë ishte “fshirja” e menjëhershme nga lista e degës së partisë në Horley e rreth 700 anëtarëve. Deri në momentin e zbatimit të lëvizjes “Një anëtar, një votë”, të gjithë anëtarët e “Klubit Konservator” ishin regjistruar si anëtarë të partisë në bazë të taksës 0,5 euro të paguar si kuotë për secilin anëtar të “Klubit”. Në fakt, shumë nga këta anëtarë nuk ishin mbështetës të konservatorëve por ishin anëtarësuar në “Klub” thjesht sepse ai ndodhej në një vend të përshtatshëm dhe tregtonte pije alkoolike me çmime të ulta.⁵ Në fakt, veçanërisht, në zonat rurale, shumë degë të partisë ishin fiktive. P.sh. në fshatin Outwood një këshilltar lokal mbante të ngritur një degë duke paguar një kontribut vjetor prej 750 euro në vit dhe përveç hartimit të një liste emërore të anëtarësisë dhe emërimit të kandidatëve të qeverisjes lokale nuk organizonte as aktivitete politike e as sociale. Disa nga “anëtarët” e tij, si dhe ata të degëve të tjera, të cilët në vitin 1991 paguanin një kuotë prej 40 euro në vit, jo vetëm që nuk ishin konservatorë por në një rast flagrant madje ishte dhe një Këshilltar Liberal Demokrat.

Për ne, që ishim organizatorë të partisë “rrallimi” i radhëve të saj ishte një gjë e mirë. Unë, si veprimtar, kisha llogaritur se për vitin 1991, në bazë lokale, për të mbajtur kontakte dhe për t’i shërbyer çdo anëtar, na kushtonte thujse rreth 4.5 euro; pra këta “anëtarë” na kushtonin para. Kam vënë re gjithashtu se shumë njerëz u paguanin një kuotization “anëtarësie” një ose disa partive politike që propaganduesit elektorale të mos t’i shqetësonin në kohën e zgjedhjeve, duke menduar se këta të fundit do t’i konsideronin ata se militantë partie dhe nuk do të humbisnin kohë

me ta. Lëvizja “Një anëtar, një votë” kishte gjithashtu një ndikim direct në përmisimin e rezultateve të fushatës zgjedhore lokale.

Ndryshe nga sistemi i vjetër, një çift i martuar i cili në lëvizjen “Një anëtar, një votë” ishte i gatshëm të paguante 45 euro për t’u anëtarësuar në parti jo vetëm do të na ndihmonte të mblidhnim para në bazë lokale por edhe do të ishte i gatshëm të bënte më shumë në praktikë – që nga shpërndarja e fletushkave, pjesëmarrja në fushatën elektorale, pjesëmarrja në anketimet paraprake e deri në ditën e zgjedhjeve.

Në nivelin e zonës elektorale të partisë kishte dy grupe të tjera të cilat shpesh ndiheshin të kërcënuar nga sistemi i ri dhe nga sistemi i anëtarësisimit qëndror në veçanti. Në grupin e parë, në nivel sektori bënin pjesë Këshilltarët e pesë distrikteve dhe ata krahinorë, zgjedhja e të cilëve si kandidatë ishte në vartësi të anëtarësisë në nivelin e degëve të shoqatës së zonës elektorale. Shumica e këtyre degëve, që në fakt udhëhiqeshin nga vetë këshilltarët, kishin refuzuar të dorëzonin listat e anëtarëve të degëve të tyre, madje edhe tek shoqatat e zonave elektorale deri në momentin kur u zbatua një koutizacion i njëjtë si dhe një listë qendrore e anëtarësisë. Kjo sepse ata vetëm ashtu mund të rrimëroheshin si kandidatë në mbledhjet e përgjithshme vjetore të degëve të cilat bëheshin pak ose aspak të njohura dhe ndiqeshin vetëm nga pak miq dhe fshatarët e zonës. Kjo praktikë ishte mjaft e përhapur në zonat rurale. Këto mbledhje madje organizoheshin në dimër, një faktor tjetër ky për pjesëmarrjen e ulët në to. Zbatimi i votimit postar dhe shpallja e njoftimeve për zgjedhje nga zyra e shoqatave të zonave elektorale, pjesërisht në sajë të lëvizjes “Një anëtar, një votë”, së fundi e mbylli këtë praktikë të caktimit të këshilltarëve.⁶

Grupi i dytë i “Kërcënuar” ishin funksionarët e shoqatave të zonave elektorale. Aftësitë e tyre si dhe forca e tyre e vërtetë për anëtarësim dhe financat do t’i bëheshin të ditura udhëheqjes së partisë si dhe organizatorëve në selitë e partisë. Lëvizja “Një anëtar, një votë” zvogëloi influencat e tyre tek parlamentarët në fushata të tilla si zgjedhjet e udhëheqjes së partisë në rang kombëtar. Kjo sepse në vend që të mbështetej në këshillën e udhëheqjes së shoqatës së zonës elektorale për kë të votonte, udhëheqja e partisë shkoi direkt në bazën e anëtarësisë së partisë dhe kërkoi prej tyre kandidatin. Për më tepër lëvizja për një koutizacion minimum të përgjithshëm që ishte rezultat direkt i skemës së anëtarësisë qendrore, çoi menjëherë në një kontroll më të përqendruar nga Zyrat Qendrore të Partisë. Në praktikë kjo shtrirje drejt qendrës ka sjellë forcimin e kontrollit dhe rregullave nga qendra mbi të gjitha strukturat e partisë në nivel lokal.

Parimi “Një anëtar, një votë” nuk u aplikua në zgjedhjet e udhëheqësit të partisë deri në vjeshtën e vitit 2001, kur zoti Duncan Smith zëvendësoi

William Hague. Kjo zgjedhje kaloi në një proces me dy faza; në të cilin një mbledhje e anëtarëve të parlamentit shqyrtoi kandidatët dhe konkludoi në një listë prej dy kandidatësh e cila iu dërgua për votim me postë 400.000 anëtarëve të partisë, pjesa më e madhe e të cilëve votuan. Kjo bëri që David Davis, parlamentar konservator, të deklarojë në konferencën vjetore të partisë se zoti Duncan Smith gëzonte një mandat të tillë të cilin nuk e kishte pasur ndonjëherë asnjë nga udhëheqësit e partisë; një mandat që ia kishin dhënë mbi 250.000 votues në zgjedhjet “Një anëtar, një votë”.⁷

Ajo çka tregoi kjo zgjedhje e udhëheqjes dhe praktika tashmë rutinë e lëvizjes “Një anëtar, një votë” me anëtarët e partisë, për zgjedhjen e kandidatëve p.sh. në zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë së Londrës, është se ka nevojë për njoftime në kohë të mjaftueshme të zgjedhjeve (zakonisht duhet të përcaktohet data), planifikim të mirë dhe një organizatë partie efçente. Zgjedhjet e fundit për Kryetarin e Bashkisë së Londrës në 6 Maj 2004 mund të shërbejnë për ta ilustruar këtë. Theresa May, kryetare e partisë në atë kohë, e bëri të ditur programin e detajuar të brenshëm të partisë për këto zgjedhje që në Tetor 2002⁸. Në deklaratën e saj ajo tha se aplikimet për kandidaturat do të hapeshin të Hënën, në 21 tetor, dhe do të mbylleshin të Premten, në 29 Nëntor. Procesi i përzgjedhjes do të zhvillohej në Dhjetor dhe do të rezultonte në një listë me pesë kandidatë të fortë në fillim të muajit Janar 2003. Kjo listë do të kalonte në një proces “elektoral” në të cilin çdo parti e zonës elektorale të Londrës do të kishte përfaqësues me një listë prej dy kandidatësh.⁹ Këta kandidatë do të përzgjidheshin më tej me një votim me postë që do t’u dërgohej nga fundi i muajit janar të gjithë anëtarëve në Londër. Votimi me postë do të mbyllej në 18 Shkurt 2003 dhe rezultati do të bëhej i ditur menjëherë. Me fjalë të tjera, vetë procesi aktual i përzgjedhjes me një planifikim rigoroz do të zgjaste nja pesë muaj. Unë mendoj se kjo ishte një zgjedhje realiste për një parti e cila e kishte përdorur lëvizjen “Një anëtar, një votë” në menyrë graduale që nga viti 1999.

Ka pak gjasa që vendimet për të përqafular lëvizjen “Një anëtar, një votë” të anulohen ndonjëherë. Dobitë jo vetëm për partinë por edhe për anëtarët e saj, për sa i përket demokracisë, janë mjaft të qarta. Le të shqyrtojmë vetëm një faqe interneti të partisë¹⁰ “Cilat janë përfitimet e anëtarëve të Partisë Konservatore sot?” :

- “Një anëtar, një votë” për zgjedhjen e udhëheqësit të partisë
- Një votë në përzgjedhjen e kandidatëve për Parlament dhe për Parlamentin Europian
- Përfaqësim në bordin drejtues të partisë

- Një votë për idetë themelore të politikave për zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme
- Ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e politikave
- Një votë në zgjedhjet e shoqatave lokale të zonës elektorale
- Raportime vjetore nga udhëheqësi, kryetari i partisë dhe shoqatat e zonës elektorale
- Një komitet që kontrollon dhe siguron standarte të larta etike dhe figurë të pastër morale.¹¹

Natyrisht që jo të gjitha këto ndryshime mund t'i atribuohen lëvizjes “Një anëtar, një votë”, por zbatimi i saj ka sjellë në mënyrë të paepur zhvillime të një demokracie të brendshme të partisë në të gjitha strukturat e saj. “Një anëtar, një votë” i ka dhënë udhëheqjes dhe strukturave kryesore drejtuese të partisë një kontroll më të mirë të veprimit të shoqatës së zgjedhësve. “Një anëtar, një votë” i ka mundësuar vullnetarët e partisë në zonat elektorale dhe veprimtarët si unë të përqëndrohen në mbështetjen e anëtarëve të devotshëm, një pjesë e mirë e të cilëve, i dedikojnë shumë kohë punës vullnetare të papaguar si dhe grumbullimit të fondeve për partinë.

Për sa i përket vetë anëtarëve të partisë “Një anëtar, një votë” do të thotë se tani “zëri” i tyre dëgjohet në të gjithë partinë dhe se ata kanë një ndikim direkt në çështje kyçe të tilla si: Kush do t'i përfaqësojë si në parti ashtu dhe në pushtetin lokal e qendror. Për më tepër, tani që partia e di se cilët janë anëtarët e saj, ajo mund të komunikojë me ta më rregullisht dhe më me efektivitet se më parë, jo vetëm për të folur për politikën e partisë por edhe të konsultohet me ta për këto politika.

Shënime:

1. William Hague, parlamentar, nisi gjithashtu disa ndryshime të tjera në rregulloren për zgjedhjen e udhëheqjes që nuk kishin të bënin me “Një anëtar, një votë”. Këto ndryshime e bënë akoma më të vështirë zëvendësimin e udhëheqësit të partisë
2. Faqja në internet e Zyrës Qendrore të Konservatorëve; faqja në internet e shoqatave të zonave elektorale, p.sh Kingston dhe Surbiton, Brighton dhe Hove etj. Kuotizacioni për të rinjtë nën moshën 22 vjeç është i reduktuar
3. Kuotizacioni është minimumi i kërkuar për anëtarësi në lëvizjen “Një anëtar, një votë”. Kuotizacioni shtesë është i mundur dhe shpesh paguhet. Shoqata të zonave elektorale kanë dhënë dhe kotribute të tjera p.sh dreka private për

parlamentarët si nxitje për angazhimin e tyre.

4. Ndikimi në East Surrey ishte se anëtarësia ra nga 4400 në 1978 në rreth 2900 sot.
5. Në fakt dihej se shumë prej tyre mbështetnin parti të tjera politike.
6. Hapi i parë përpara ishte kërkesa që kandidatët për këshilltarë distrikti të intervistoheshin, përzgjidheshin dhe aprovoeshin për t'u përfshirë në listën e kandidatëve të miratuar në nivel zone elektorale. Kjo ndryshoi në mënyrë radikale cilësinë e kandidatëve. Kjo politikë u zbatua në East Surrey në vitin 1991, pra përpara lëvizjes “Një anëtar, një votë”. Ky rregull tani është përfshirë në statutin e partisë.
7. David Davis, parlamentar, konferencë shtypi e Partisë gjatë një dabati për shërbimet publike, tetor 2002
8. Deklaratë shtypi e Zyrës Qendrore Konservatore 17 Tetor 2002
9. I përzgjedhur më 24 Janar 2003; deklaratë e bërë në njoftimin për shtyp në 24 Janar 2003 nga Eric Pickles, Parlamentar, Ministër në Hije për Londrën.
10. Faqja e internetit Ipswich Conservative Association, Tetor 2004
11. Faqja e internetit Ipswich Conservative Associaton. Formulari për aplikim për anëtarësi

6 Nga Dublini në Prishtinë - Perspektivat për “Një anëtar, një votë”

Michael O'Reilly

Në vitin 1993, menjëherë pas zgjedhjeve të vetme të përgjithshme të pasuksesshme, Fine Gael, partia e dytë në numër në Irlandë, ngriti një Komision për Rinovimin të përbërë nga anëtarë dhe jo - anëtarë të partisë. Demokracia e brendshme ishte çështja kryesore në planin e punës së Komisionit. Një nga kapitujt e raportit përfundimtar të Komisionit mbante titullin “Një parti që i përket anëtarëve të vet” dhe ky parashtron një plan të gjerë pune për demokratizimin, përfshirë pjesëmarrjen direkte të anëtarëve në bërjen e politikave, zgjedhjen e udhëheqjes dhe përzgjedhjen e kandidatëve; tri shtyllat e demokracisë së brendshme të partisë.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit e deri më sot, Fine Gael kishte vepruar sipas sistemit me delegim vote. Sot është bërë e modës t'i hedhësh poshtë këto sisteme si jo demokratike, centriste madje dhe jo racionale. Ato, me të vërtetë, mund të jenë jo demokratike dhe centriste, por adoptimi i një modeli të veçantë të votës së deleguar nga partia, Fine Gael, në fillimet e viteve 80 kishte një arsye të qartë. Fine Gael ishte kryesisht një parti rurale, në një kohë kur Irlanda po urbanizohej me shpejtësi. Moderatorët e partisë e gjykuan të domosdoshme të propozonin kandidatë që do të ishin përfaqësues të popullsisë në përgjithësi, dhe jo vetëm të bazës mbështetëse rurale të partisë. Kështu partia “ngriti” me dhjetra degë urbane, secila me të drejtë vote të deleguar, duke iu kundërpërgjigjur anëmbajtjes rurale – veprim ky jo shumë demokratik por i rëndësishëm për përcaktimin e Fine Gael si një parti e qendrës me bazë të gjerë dhe me prirje urbane.

Megjithatë në fillimet e viteve 90 në partinë Fine Gael pati një shqetësim të përgjithshëm se sistemi me votë të deleguar po i merrte frymën. Në sistemin elektoral Irlandez, shumë konkures, me listë shumemërore elementë të veçantë të parlamentit ishin bërë mjeshttra për të krijuar degë të reja, votat e deleguara të cilave ata i kontrollonin plotësisht, kështu që prisnin rrugën çfardo konkurrence përpara se ajo të

fillonte të lulëzonte. Edhe shoqëria kishte ndryshuar. Kishin kaluar kohët kur mund të shpresohej se anëtarët e partisë do të rrjeshtoheshin kokëulur pas vendimeve të marra në shtabet udhëheqëse ose me kërkesë të anëtarve të parlamentit. Që Fine Gael të mbijetonte dhe të lulëzonte, ajo kishte nevojë për anëtarësi pjesëmarrëse. Komisioni vuri në dukje se *“ka një ndjenjë të përhapur gjerësisht në parti, se anëtarët konsiderohen si shërbëtorë të organizatës, roli i të cilës është kufizuar vetëm në mbledhjen e fondeve dhe në bërjen e fushatës elektorale në kohën e zgjedhjeve. Kjo është një pikëpamje tërësisht shkatërrimtare e cila duhet të përballohet me masa thelbësore dhe rrënjësore.”*

Dhjetë vjet më vonë, është interesante të shohim se ku ka pasur përparime. Në periudhën 1999-2003, Fine Gael shkarkoi dy udhëheqës partie. Anëtarësia e partisë nuk u përfshi në asnjë nga zgjedhjet që pasuan. Nuk është e qartë nëse rezultati do të kishte qënë ndryshe sikur anëtarët ta kishin thënë fjalën e tyre. Megjithatë, ky nuk është justifikim për mohuar anëtarit një të drejtë demokratike.

Megjithatë, në rastin e zgjedhjes së lidershipit, shumë gjëra vihen në diskutim. Të marrim lidershipin e vetë partisë; zakonisht ka një lidership defakto të partisë parlamentare dhe po kështu shpesh ka edhe udhëheqje të qeverisë. Ekziston një argument se anëtarët e partisë parlamentare duhet të kenë mundësi të zgjedhin lidershipin e tyre duke zbatuar gjykimin e tyre kolektiv si ligjvënës dhe politikanë profesionistë. Ka gjithashtu një argument tjetër që Parlamenti duhet të zgjedhë Kryeministrin, i padetyruar nga mendimi i një grupi të vetëcaktuar anëtarësh të partisë.

Ka një shqetësim të sinqertë që shtrirja e zgjedhjeve të lidershipit tek anëtarët në bazë do të reduktojë emërimin e kryeministrit të vendit në një garë popullariteti, që do të zhvillohet për disa muaj në salla, para auditorëve të mbushur me anëtarë partie të vetëzgjedhur. Pikëpamja tradicionale është se votuesit zgjedhin anëtarët e parlamentit të cilët, pas kësaj, bëhen të deleguarit e popullit për zgjedhjen e kryeministrit, i cili nga ana e vetë zgjedh qeverinë.

Argumenti, natyrisht është shumë i shtirë. Ai mbështetet plotësisht në hipotezën se udhëheqësi i partisë duhet të bëhet automatikisht Kryetar i Parlamentit dhe i emëruar i partisë si Kryeministër. Kjo është pikëpamja mbizotëruese (e politikanëve) në Dublin. Në një farë mënyre është ironike pse një hipotezë e tillë nuk u bë edhe p.sh në Prishtinë – ku komuniteti ndërkombëtar është kaq shumë i shqetësuar për “standartet” e qëndrimeve demokratike.

Në momentin kur hipoteza që një udhëheqës partie duhet të jetë i emëruari i saj për Kryeminister lihet mënjanë, rruga për pjesëmarrje

demokratike qartësohet. Në mënyrë të diskutueshme, shumë nga demokracitë parlamentare perëndimore janë kthyer në robër të presidencializmit kacavarës, i cili u duket njerëzve sikur mishëron të gjitha aftësitë e lidërshiptit dhe të gjitha idetë e nevojshme për të bërë një parti politike të suksesshme dhe një komb me shtetas të lumtur dhe të begatë.

Nuk ka asnjë arsye pse një parti të mos të ketë një president i cili zgjidhet në post për aftësitë e tij/saj si organizator ose si përfaqësues i anëtarëve të partisë, të cilët po ashtu zgjedhin një kryetar parlamenti për aftësitë e tij/saj parlamentare dhe një kryeministër për aftësitë e tij/saj qeverisëse dhe shtet formuese. Duket sikur presidencializmi bie ndesh si me avantazhet e një sistemi të vërtetë presidencial, ashtu dhe me ato të një sistemi të vërtetë parlamentar - dhe për rrjedhojë e pëson vetë demokracia.

Le t'i kthehemi shëmbullit të partisë Fine Gael të Irlandës. Kur "Një anëtar, një votë" u përdor për përzgjedhjen e kandidatëve, u kritikua mjaft nga disa anëtarë të vjetër të partisë, të cilët u alarmuan kur panë daljen e kandidatëve të rinj potencialë me çanta plot e përplot me aplikime të reja për anëtarësi. Përgjigjja pragmatike ndaj këtij shqetësimi ishte se janë pikërisht kandidatët që sjellin anëtarë të rinj, ata që i duhen partisë, pra njerëzit që tentojnë të zgjidhen mbi bazën e një sistemi konkurues të personalitetit.

Defekti kryesor i shndërrimit demokratik të Fine Gael është se Këshilli Kombëtar i Partisë ushtron shumë më shumë kontroll në përzgjedhjen e kandidatëve. Sistemi elektoral Irlandës (proporcional, me vota të transferueshme) kërkon që një parti e përmasave dhe ambicieve të Fine Gael të caktojë dy kandidatë në shumicën e zonave elektorale, mandje tre në disa prej tyre. Udhëheqësit e partisë, ndërsa janë të gatshëm të lejojnë anëtarët e partisë të zgjedhin një kandidat për secilën zonë elektorale, kërkojnë të ruajnë të drejtën për ta zgjedhur vetë kandidatin e dytë ose të tretë me justifikimin e drejtë të ruajtjes së balancave në shpërndarjen gjeografike dhe gjininë. Me fjalë të tjera, sistemi elektoral e bën pjesëmarrjen e plotë demokratike shumë të vështirë; një votë në një zonë elektorale të madhe mund të nxjerrë dy kandidatë meshkuj të moshës mesatare, të dy nga e njëjta zonë, kur shpërndarja ideale do të ishte një burrë, një grua, një nga veriu i zonës elektorale dhe një nga jugu.

Del qartë, për pasojë, se nëse duam të sigurojmë, demokraci të brendshme të partisë, qoftë në Dublin apo në Prishtinë, nuk mund të injorohen realitetet politike, e veçanërisht sistemet zgjedhore.

Zgjedhjet për Parlamentin e Kosovës janë vetëm pak ditë larg,

por rëndësia e tyre e vetme do të jetë të përcaktojnë forcën relative të individëve, lidhur me negociatat për statusin final në 2005. Është për të ardhur keq, që votuesve iu është ofruar një sistem zgjedhor, (nga OSBE dhe UMNİK) i cili përsa i përket pjesëmarrjes demokratike është më i keqi. Një zonë elektorale e vetme në të gjithë Kosovën me një sistem votimi me listë të mbyllur, i largon të gjithë stimujt për të përmirësuar proceset e demokratizimit të brendshëm të partive politike të Kosovës. S'ka rrugë më të mirë për t'i bërë qytetarët kosovarë të ndjehen të larguar nga politikanët e tyre. Autori i këtij artikulli parashikon një pjesëmarrje të ulët në votime.

Duke sugjeruar një sistem të tillë zgjedhor, Komuniteti Ndërkombëtar nuk kishte asnjë forcë që të mund të inkurajonte partitë kryesore politike në Kosovë të ndryshonin praktikën e tyre të famshme jo demokratike dhe të centralizuara. Megjithatë një parti, në mënyrë të njëanshme, vendosi të ndjekë rrugë demokratike. Në Qershor 2004 Aleanca për Ardhmëri e Kosovës (AAK), një parti e udhëhequr nga një ish komandant i UÇK, Ramush Haradinaj, organizoi mbledhjen e saj për të përzgjedhur kandidatët për zgjedhjet e Tetorit. Ai tha “Ne filluam një praktikë totalisht të re për të zgjedhur kryesinë e partisë dhe zyrtarët e saj ekzekutivë, si dhe për të hartuar listën elektorale. Bazuar në përkushtimin e AAK ndaj parimeve të demokracisë, pak kohë më parë vendosëm se mënyra e vjetër e emërimit të kryesisë dhe të ekzekutivit të partisë si dhe e hartimit të listës bazuar vetëm në vendimin e udhëheqjes nuk është më e pranueshme për ne”.

Sistemi elektoral i OSBE-së inkurajon përqëndrimin e vëmendjes në zonat urbane, ku edhe dendësia e popullatës është më e madhe. Këtu ka një rrezik real. Popullsia që jeton jashtë qyteteve mund të mbetet, në fakt, si një minoritet me përfaqësim të vogël. Sistemi me një zonë elektorale nuk mundëson afrimin e politikanëve me popullin; në fakt bën të kundërtën.

Është kjo arsyeja që AAK vendosi që të gjitha degët e partisë, nga të gjitha rajonet e Kosovës, të kishin të drejtë të caktonin dhe zgjidhnin kandidatët e tyre në listën shumëmemërore të partisë. Në Konferencën e Qershorit delegatët e këtyre degëve, si dhe ata nga organizatat e të rinjve dhe nga forumi i gruas së partisë, votuan me votë të fshehtë për të vendosur për renditjen në listën e kandidatëve. Secili delegat do të votonte për 25 kandidatët, që sipas tij duhet të ishin në krye të listës.

Është e qartë se ishte e pamundur që parimi “Një anëtar, një votë” të praktikohet në kushtet e një zone të vetme, të gjerë, të përqëndruar në dy ose në tre rajone dhe zbatimi i “Një anëtar, një votë” do të kishte rezultuar në një epërsi në numër të kandidatëve nga këto rajone.

Në Kosovë, sikurse dhe në Irlandë, sistemi zgjedhor kishte një ndikim

negativ direkt dhe të drejtpërdrejtë në mundësinë për demokratizimin e brendshëm të partisë. Mund të shpresohet se Kosova nuk do të zbatojë më një sistem të tillë zgjedhor dhe se sistemet e zgjedhjeve të partisë mund të përshtaten me një sistem zgjedhor më kombëtar demokratik. Reforma zgjedhore në Irlandë do të jetë më e vështirë. Sistemi aktual është fortifikuar dhe ka nxjerrë një tip parlamentarësh që kanë mundur t'i bëjnë ballë veçorive dhe që është shumë rezistent ndaj ndryshimeve.

Kjo shtrun përpara një çështje të rëndësishme. Një parti duhet të jetë një mikro kozmos i një vendi përsa i përket strukturave të saj demokratike. Nëse në demokracinë e një vendi ka difekte serioze, padyshim që këto difekte do të egzagjérohen në strukturat e partisë p.sh. nëse një sistem me listë përdoret në bazë vendi dhe jo rajoni apo qyteti atëherë është e pritshme që partitë, më së paku të ndjekin të njëjtin sistem. Nëse sistemi i votimit nuk është proporcional (p.sh. i pari në listë kalon në post) nuk mund të shpresojmë që sistemet e partisë të jenë më demokratike. Në këtë pikëpamje AAK e Kosovës ia doli mbanë të kapërcejë standartet e ulta të vendosura nga komuniteti ndërkombëtar por nuk mund të shpresojmë që në mungesë të reformës demokratike kjo experiencë të përsëritet në nivel kombëtar.

Vetëm zgjedhjet nuk e bëjnë një demokraci të zhvilluar, por sistemi elektoral përcakton cilësinë e demokracisë. Një listë shumë emërore në një zonë elektorale të vetme dekurajon shumë zhvillimin e demokracisë në bazë. Ajo favorizon grupe të vogla të politikanëve të fuqishëm në qendër dhe e largon pushtetin nga populli. E njëjta gjë ndodh edhe me partinë; pjesëmarrja demokratike do të thotë që anëtarët të votojnë për udhëheqësit dhe përfaqësuesit e tyre dhe që njerëzit e zgjedhur në këtë mënyrë të jenë të përgjegjshëm ndaj votuesve të tyre.

Së fundi, shumë parti gabimisht mendojnë se demokratizimi i brendshëm është një pengesë drejt suksesit. Natyrisht që kjo është e gabuar. Shpërndarja e pushtetit politik dhe dalja e qeverisë përfaqësuese kanë qenë shpesh nxitësit për arritje ekonomike me të shpejta. E ndërsa është e vërtetë se prosperiteti ka qenë i favorshëm për demokracinë, e kundërta është po aq e vërtetë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për partitë politike; ka fakte të besueshme që shpërndarja e pushtetit nëpërmjet demokratizimit të brendshëm çliron energji krijuese shumë të mëdha që çojnë në sukses elektoral. Është detyrë kyçe për komunitetin demokratizues që të bëjë studime serioze për këto çështje duke shpresuar se rezultati i tyre do të mbështesë përpjekjet për të rritur demokracinë dhe për pasojë respektin më të madh të publikut për partitë politike kudo që janë.

7 Rëndësia e parimit “Një anëtar një votë” për partitë politike në Shqipëri

Dr. Nick Ellison

Ky artikull i shkurtër do të shqyrtojë dy çështje thelbësore. Së pari, natyrën e parimit “Një anëtar, një votë”, meqë ky parim i demokracisë së brendshme të partisë, në potencë, zbatohet në të gjitha partitë politike. Së dyti, të punohet që parimi “Një anëtar, një votë” të lehtësojë reformën demokratike në partitë politike shqiptare.

Parimi “Një anëtar, një votë”, ndonëse në dukje mjaft i thjeshtë, mund t’i referohet një numëri të madh formash të ndryshme të organizimit të kontrollit demokratik brenda një partie politike. P.sh, nocioni se anëtarët e veçantë të partisë kanë të drejtë të votojnë për të gjitha problemet e politikës së partisë që nga zgjedhja e udhëheqjes e deri në çështjet e strategjisë politike dhe hollësitë e politikave, është vetëm një nga interpretimet e parimit “Një anëtar, një votë” dhe sigurisht një prej kryesorëve. Parti të tilla me të drejtë pretendojnë se ato përkrahin “Një anëtar, një votë” por parimi kurrësesi nuk gjen zbatim në të gjitha aspektet e organizimit të partisë.

Le të shohim si rast studimor se si parimi “Një anëtar, një votë” gjen zbatim në Partinë Laburiste. Partia Laburiste e ka adoptuar parimin “Një anëtar, një votë” për zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit të partisë që prej vitit 1993. Kjo do të thotë se në praktikë, çdo anëtar sindikate si dhe çdo anëtar i organizatës bazë të zonës elektorale parlamentare ka të drejtë të votojë për kandidatët, që janë në garë për udhëheqjen e partisë. Votat thjesht mblidhen në secilën sindikatë, organizatë bazë të zonës elektorale etj. dhe kandidati që ka fituar më shumë vota bëhet udhëheqës i zgjedhur për atë organizatë. Sidoqoftë procesi nuk mbaron këtu sepse në bazë të “Një anëtar, një votë” të gjitha rezultatet e sindikatave dhe zonës elektorale të degës së partisë shkojnë në një kolegji zgjedhor ku mblidhen me votat e anëtarëve Laburistë të Parlamentit. Secili seksion i partisë – sindikatat, zonat elektorale të organizatës bazë dhe anëtarët e parlamentit – zë 33% të votave në këtë kolegji, dhe udhëheqësi i zgjedhur

është ai që fiton shumicën e votave të kolegjit. Për t'u përmendur është fakti që kolegji zgjedhor "rrafshon" votimin e seksioneve të ndryshme të partisë. P.Sh, ka 4,1 milion sindikalistë – dhe 200.000 veprimtarë të zonës elektorale të degëve të partisë - por ka vetëm 350 parlamentarë laburistë. Kësisoj sipas parimit "Një anëtar, një votë" mund të arsytohet se anëtarët e parlamentit kanë më shumë peshë se sa p.sh 4 milion sindikalistë.

Le të marrim edhe një shembull tjetër. Si e siguron Partia Laburiste përfaqësimin demokratik të brendshëm në bërjen e politikave. Në pamje të jashtme krijohet përshtypja se anëtarët e zakonshëm të zonës elektorale të degës së partisë mund të zgjedhin delegatë për të marrë pjesë në Konferencën Vjetore të Partisë nisur nga fakti se është Konferenca ajo që në fund vendos për politikën e partisë. Në realitet, megjithatë, delegatet e konferencës duhet të zgjedhin disa prej tyre për në Forumin e Politikave Kombëtare të Laburistëve (FPKL). Vetë ky Forum vëzhgon punën e tetë komisioneve të Politikave të cilët i nxjerrin anëtarët e tyre nga FPKC, Qeveria dhe Komiteti Kombëtar Egzekutiv i Laburisteve. Është e qartë se këto përshtatje janë mjaft komplekse dhe për pasojë është e qartë se parimi "Një anëtar, një votë", në bazë të të cilit janë zgjedhur delegatët e Konferencës, nuk do të thotë se këta të fundit kanë shumë kontroll mbi bërjen e politikave të Partisë. Natyrisht, me t'u pranuar nga Komisionet e Politikave dhe me t'u miratuar nga FPKL, politikën i paraqiten konferencës për aprovim, por mbasi janë diskutuar gjerë e gjatë nga ekspertet në hierarkinë Laburiste të politikave, ka pak gjasa që ato të mund të ndryshohen.

Arsyeja pse i shqyrtoam këto dy shembuj nuk është se duam të jemi shumë kritikë ndaj parimit "Një anëtar, një votë" përkudrazi - por është e rëndësishme të qartësojmë atë çka realisht mund të realizohet duke zbatuar këtë parim si dhe atë çka nuk mund të realizohet. Ia vlen atëhere, të shtrojmë pyetjen "çfarë mund të pritet nga parimi "Një anëtar, një votë", dhe çfarë në të kundërt, mund të jetë e pamundur, madje e rrezikshme, për t'u zbatuar. Së pari, është absolutisht e drejtë që të gjithë anëtarët e partisë politike të kenë mundësinë të zgjedhin kryetarin e partisë dhe zëvendës kryetarin e saj. Pikërisht këtu parimi "Një anëtar, një votë" ka një avantazh të qartë mbi sistemet e tjera për zgjedhjet e drejtuesve, kryesisht sepse është transparent dhe i barabartë. Rëndësi ka gjithashtu se aty ku çdo anëtar ka një votë, udhëheqësi përgjigjet direkt para anëtarëve për veprimet e tij/saj. Logaridhënia është shumë e rëndësishme për çdo organizatë komplekse e cila nuk mund të drejtohet nga të gjithë anëtarët në kuptimin e vërtetë të fjalës në aktivitetin e saj të përditshëm. Përsa i përket bërjes së politikave, çështjet gjithësesi komplikohen edhe më shumë. Ndërsa në parim mund

të jetë e mundshme të organizohet formulimi i politikave në mënyrë të tillë, që të mundësojë çdo anëtar të votojë për secilën çështje të detajuar të drejtimit politik, në praktikë ka shumë të ngjarë të mos jetë efektive e veçanërisht kur kërkohet shpejtësi në reagim. Parimi “Një anëtar, një votë” mund të përdoret me efektshmëri si mjet për të siguruar që anëtarët e partisë të zgjedhin drejt për së drejti ata që vendosin për politikën e partisë, por jo për çdo aspekt tjetër të vetë politikave. Në këtë drejtim, një kombinim i ekspertëve të politikave, anëtarëve të qeverisë (ose udhëheqësve kur janë në opozitë) si dhe përfaqësuesve të zgjedhur nga anëtarësia e partisë duhet të punojnë sëbashku në komitetet e politikave.

Nga sa më sipër, duam të themi se parimi “Një anëtar, një votë” është i përshtatshëm në disa rrethana dhe jo plotësisht i përshtatshëm në disa rrethana të tjera. Parimi, duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të nxitë përgjegjshmërinë e udhëheqjes dhe t’u krijojë anëtarëve të partisë ndjesinë se kanë një lloj kontrolli mbi funksionin e udhëheqjes. Në të njëjtën kohë parimi duhet të sigurojë që udhëheqësit e partisë të kenë liri të mjaftueshme për të zhvilluar politikën inovative dhe fleksibilitet të mjaftueshëm për t’iu përgjigjur sfidave të paparashikuara.

Si mund të zbatohen disa nga këto ide në situatën politike aktuale në Shqipëri? Që me rrëzimin e komunizmit në fillimet e viteve 1990, Shqipëria ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt asaj që mund të karakterizohet si demokraci tipike e stilit perëndimor. Janë zhvilluar zgjedhje të rregullta dhe duket se partitë politike janë të gatshme të zbatojnë rregullat zgjedhore. Me fjalë të tjera, është vendosur një sistem i llogaridhënies demokratike bazë dhe është e qartë se ka pak gjasa për t’u rikthyer në regjimin totalitar. Megjithatë, Shqipëria mbetet një vend i varfër me një infrastrukturë të pa zhvilluar dhe mungesë relative të investimeve të brendshme. Në kushte të tilla, ku përmirësimet ekonomike e kanë të vështirë të zbatohen dhe ku, në fakt trashëgimia totalitare ia bën të vështirë partive politike të shkëputen tërësisht nga praktikën e së kaluarës, udhëheqësit e partive në përpjekjet për të rruajtur pushtetin tundojnë për të vepruar në mënyrë oligarkike, pavarësisht nëse bëjnë pak ose aspak përparime në çështje themelore ekonomike ose sociale. Aspektet më të vështira për t’u përballur përse i përket “oligarkisë” lidhen me prirjet e liderëve politikë për tu ngulur në poste të rëndësishme në strukturat partiake të cilat nga ana e tyre nuk kanë mjete statutorë për t’i lëvizur. Në kushte të tilla, egziston rreziku që ata të shkëputen si nga anëtarët e vetë partisë ashtu dhe nga elektorati në rang kombëtar. Në thelb ata bëhen të “vetë – përjetësuar” që s’është veçse një eufemizëm për “të papërgjeshëm” dhe “të fosilizuar” S’ka dyshim se vështirësi të këtij lloji i mendojnë institucionet politike edhe në Shqipëri.

Si do të mundet që zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë” të kontribuojë në çlirimin e këtyre tendencave oligarkike? Me tej çfarë versioni i “Një anëtar, një votë” do të ishte më i përshtatshëm për kontekstin shqiptar? Një nga avantazhet e skemës politike shqiptare është se partitë e qendrës së majtë nuk kanë një lëvizje punëtore të organizuar mirë me të cilën të mund të maten. Në të kundërt Partia Laburiste e Britanisë, e cila në fund të fundit doli nga lëvizja Sindikaliste Britanike, harxhoi shumë kohë në përpjekjet për të përshtatur interesat specifike të sindikatave në politikat e saj, dhe në strukturat vendim-marrëse dhe njëherazi në përpjekjet për të mbajtur parasyh pikëpamjet e anëtarve të zakonshëm që të mund të mbeteshin e pëlqyeshme, nga pikëpamja elektorale, për publikun britanik. Në mungesë të këtij faktori shtrëngues e majta shqiptare mund të synojë një lidhje më direkte dhe më “përgjegjëse” midis anëtarëve të partisë, nga njëra anë dhe udhëheqjes së saj, nga ana tjetër. Parimi “Një anëtar, një votë” është një element vital këtu, sepse ofron rrugën më të mirë për të ndërtuar marrëdhëniet midis anëtarësisë dhe udhëheqjes, bazuar në besim dhe përgjegjshmëri. Pra, anëtarë e partisë mbi bazën e parimit “Një anëtar, një votë” duhet të kenë mundësi të votojnë për postin e kryetarit dhe të nënkryetarit. I vetmi problem këtu është nëse udhëheqësve duhet t’u kërkohet të kandidojnë për t’u rizgjedhur pas një periudhe të caktuar kohe. Një sistem i vërtetë i përgjegjshmërisë demokratike do të kërkojë së paku që mbas një votë “mos besimi” të ndërmerret zgjedhja e re e udhëheqjes. Një mekanizëm më formal do të ishte me formën e votimit të detyrueshëm, le të themi, në çdo katër ose pesë vjet.

Siç e theksuam edhe më sipër, zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë” bëhet më i vështirë sapo del jashtë orbitës së zgjedhjes së lidërsipit. Duket se është e arsyeshme të kemi një far kontrolli demokratik në bërjen e politikave, e veçanërisht në kontekstin shqiptar, ku ka egzistuar një tendencë që politika të bëhej prapa “dyerve të mbylluar” dhe pa transparencë. Megjithatë, ka një kufi në zbatimin e kontrollit të drejtpërdrejtë demokratik mbi politikat. Kjo sepse nuk është praktike që anëtarët të votojnë vazhdimisht për çdo propozim politik. Kjo më së fundi çon në apatinë e tyre, sepse ata do të mërziteshin nga debate dhe diskutime të vazhdueshme. Po kështu ngadalësia dhe paafërsia në procesin e bërjes së politikave do të çonte në zhgënjimin e udhëheqjes. Në këtë rast do të arsytonim se gjithmonë ka nevojë të balancohet “demokracia” me “efektshmërinë”. Është fakt që politikat duhet të formulohen dhe të vlerësohen në mënyrë të përshtatshme. Kësisoj në bërjen e tyre, ka nevojë për rolin shumë të rëndësishëm të “ekspertit”. Për pasojë roli i parimit

“Një anëtar, një votë”, këtu do të reduktohet si më poshtë:

Anëtarët e partisë duhet të lejohen të zgjedhin përfaqësuesit e zonës elektorale të degës së partisë për në Konferencën e Partisë dhe përfaqësues të tjerë për në organet politika- bërëse. Si do që të jetë numëri i këtyre përfaqësuesve në komitetet politika-bërës duhet të jetë shumë i kufizuar, ku anëtarët e udhëheqjes dhe ekspertët e kooptuar të politikave të përbëjnë shumicën. Në këtë mënyrë kërkesat për demokraci të brendshme të partisë janë të balancuara nga nevoja për bërjen e politikave të mira dhe një manifest të qartë politik. Një sistem i tillë ka garanci sepse të gjitha propozimet politike miratohen nga konferenca, dhe nese vihet re se udhëheqja e partisë po bëhet uzurpuese ose po manipulon rezultatet e politikës në favor të vet, atëherë mund të kërkohej zgjedhje e udhëheqjes.

Një version i propozimit të mësipërm është i rëndësishëm për të gjitha partitë në kontekstin shqiptar, jo vetem si rrjedhim i vështirësive që po përballon vendi, të përmendura më sipër, por edhe sepse garancitë e brendshme demokratike janë tipar i të gjitha partive politike moderne në politikat demokratike liberale. Zbatimi “Një anëtar, një votë” dhe reforma të tjera të lidhura me të do të jepte mesazhin se politika shqiptare po lëviz drejt rregullave dhe normave demokratike të vlerësuara në Europë e më gjerë.

8 Cinizmi dhe mbështetja ndaj “Një anëtar, një votë”

Jonathon Carr –Brown

Përse Partia Laburiste Britanike përqafoi sistemin “Një anëtar, një votë” në mesin e viteve 1990? A kishte Neil Kinnock, udhëheqësi i parë reformator laburist, një pikëpamje progresiste për demokracinë? A besonte vërtet pasuesi i tij John Smith që anëtarët e thjeshtë të partisë duhet të formulonin politikën e partisë, si një kusht të parimit demokratik? Përgjigjia është e prerë, jo. Reformimi i një partie, largimi prej votimit në bllok dhe delegatët, ka fare pak të bëjë me parimet më të larta të demokracisë.

Demokracia, bashkë me partneritetin dhe progresin, mund të jetë retorika e përdorur nga udhëheqësit reformues për të organizuar trupat e tyre, mund të jetë kodra të cilën ata zgjedhin për të tubuar mbështetësit e tyre por nuk është një motivim parësor apo ndonjë kusht i domosdoshëm i asnjë programi reformues të udhëheqësve. “Një anëtar, një votë” nuk u jep anëtarëve të partisë pushtetin sikurse i’ua jep liderave. “Një anëtar, një votë” ua merr pushtetin sindikatave, zyrtarëve të partisë dhe degëve lokale të partisë dhe e rishpërndan atë tek anëtarët e thjeshtë të cilët nuk janë të organizuar dhe të informuar mjaftueshëm për të përdorur pushtetin me efektshmëri.

“Një anëtar, një votë”, nuk ka të bëjë me gjë tjetër përveçse me të renë dhe tendencën, dhe prija ndaj tij është një shenjë që tregon se njerëzit preferojnë që strukturat e tyre demokratike të jenë të thjeshta. “Një anëtar, një votë” nuk është më i mirë, apo më i keq se sistemet e mëparshme – është vetëm më i thjeshtë. Pyetja kryesore që çdo sistem demokratik që lind duhet të shtrojë nuk është: “A sjell “Një anëtar, një votë” formën më të pastër të demokracisë?” por : “Si e pasqyron “Një anëtar, një votë” shoqërinë tonë?”

Një demokraci e re mund të mos kërkojë në mënyrë të menjëhershme vendosjen e “Një anëtar, një votë”. Por, në një botë ku qytetarët janë gjithnjë e më shumë duke ndërprerë lidhjet e tyre me shtetin dhe kërkojnë

të drejtat dhe përgjegjësitë demokratike “Një anëtar, një votë” është një destinacion i dukshëm i çdo udhëtimi demokratik. Demokracia funksionale kërkon angazhim i cili nxitet nga sisteme që janë të njohur dhe të thjeshtë. “Një anëtar, një votë”i plotëson të dy këto kushte. Vota në bllok dhe përfaqësimi i deleguar nuk i plotëson këto. Kështu, motivimi parësor për vendosjen e sistemit “Një anëtar, një votë” është zhvendosja e pushtetit, dhe Partia Laburiste Britanike është rast studimor.

Në fund të viteve ‘70 dhe në vitet ‘80, procesi politikëbërës laburist gjatë kësaj periudhe ishte në venitje. Përzgjedhja e kandidatëve të partisë kontrollohej nga sindikatat dhe, degët lokale të partisë konsideroheshin prej anëtarëve si të burokratizuara dhe jotërheqëse. Çështje të politikave madhore si çarmatimi bërthamor, rishtetëzimi dhe të drejtat e punëtorëve dominonin axhendën laburiste megjithëse votuesit, veçanërisht ata tradicionalët e klasës punëtore, jepnin shenja të qarta që nuk mbështesnin prononcimet e saj majtiste. Gjatë kësaj periudhe blloqe majtiste të konsoliduar dhe me pushtet brenda laburistëve e kishin drejtuar elektoratin britanik tek, së paku, një udhëheqës laburist Michael Foot.

Pushteti duhej të shkëputej nga sindikatat e dominuara nga majtistët me votat e tyre në bllok – por t’i jepej..., kujt? Përgjigjja ishte anëtarëve më të moderuar. Por, sindikatat do ta kishin shpartalluar një rrëmbim kaq të dukshëm pushteti që në fazën e ngjizjes. Reformistë si Peter Mendelson dhe Tony Blair e kuptuan që një fushatë për të fuqizuar anëtarësinë kishte shanse më të mëdha për sukses.

Sindikatat nuk mund ta kundërshtonin atë pa u dukur plangprishës dhe anëtarësia nuk do të refuzonte një reformë dashamirëse në favorin e saj. Sidoqoftë, sindikatat nuk dëshironin përmirësime statutores të cilat do bësonin ndikimin e tyre edhe kur këto të fundit projektoheshin për të fuqizuar anëtarësinë. Si rezultat, ajo që pasoi ishte një seri betejash titanike mbi çështje statutores në dukje të parëndësishme.

Në 1983, Neill Kinnok propozoi “Një anëtar, një votë” për përzgjedhjen e deputetëve. Ky propozim u refuzua plotësisht. U deshën edhe gati 10 vjetë të tjerë derisa Xhon Smithi propozoi sërish sistemin “Një anëtar, një votë” në përzgjedhjen e deputetëve dhe ia doli mbanë të zvogëlonte votimin bllok të sindikatave në konferenca deri në masën 50% të votave totale. Ai gjithashtu bindi shumë udhëheqës të sindikatave që t’u jepnin anëtarëve të tyre mundësinë e votës individuale për zgjedhjen e udhëheqësve laburistë.

Këto ishin reforma të vërteta historike që pa dyshim çuan drejt transformimit të Partisë Laburiste. Sidoqoftë ato nuk çuan drejt transformimit për shkak se u votua për reformimin e politikave apo të

deputetëve. Ato sollën ndryshim për arsye se politikanë të moderuar mundën të ushtrojnë pushtetin dhe Toni Bler ishte udhëheqësi i parë laburist i zgjedhur nën këtë sistem të ri. Disa politikanë që ishin mbrapa këtyre reformave nuk e kishim motivimin të parimet e larta. Piter Mendelsoni, mësuesi i komunikimit laburist nën Kinokun, dëshironte rritjen e autonomisë së udhëheqjes sepse kjo do të rriste shpresat e saj në zgjedhjet e përgjithshme.

“Reformistët” e partisë argumentonin që anëtarëve më të adaptueshëm t’iu jepej më shumë influencë në raport me veprimtarët dhe sindikatat. Kjo nënkuptonte zgjerimin e “Një anëtar, një votë” në të gjitha aspektet e aktivitetit partiak dhe reformimin e Këshillave të Përgjithshëm Administrues të degëve, Konventave të përvitshme dhe Komitetit Ekzekutiv Kombëtar.

Në 1996, Komiteti Koordinues Laburist (KKL), shpalli “Laburistët duhet të bëhen partia e anëtarëve të thjeshtë”. Ajo duhet të pushojë së qeni “strukturë e mjegullt përfaqësimi”. Komiteti rekomandoi që partia duhet të përqëndrohet në mobilizimin e mbështetjes elektorale sesa të veprojë si një qendër opozite ndaj udhëheqesit. Rekomandimi më i spikatur i komitetit ishte ideja për të kthyer konferencën vjetore laburiste në një Konventë të stilit amerikan me pak funksione vendimmarrëse. Raporti i KKL-së bëri dy gjëra kryesore. Së pari, ekspozoi iluzionin që anëtarët e thjeshtë e kanë një pushtet në parti. Së dyti, tregoi se si, duke adaptuar kauzën e anëtarëve, udhëheqja mund të neutralizonte kundërshtarët e brendshëm potencialë.

Etosi i ri që u krijua, dhe që tani është i pamposhtshëm brenda laburistëve, është se anëtarët e partisë duhet të kishin të drejtë të thërrasin në pyetje ministrat dhe deputetët por të mos i vënë ata përpara politikave të detyrueshme. Partia Laburiste tani ka një forum trevjeçar të politikave të anëtarësisë që nuk ka fare të bëjë me manifestin e partisë dhe një konferencë kombëtare, të cilën udhëheqja e partisë mund ta anashkalojë me lehtësi. “Një anëtar, një votë”, në eksperiencën e Partisë Laburiste, ka nënkuptuar transferim real të pushtetit drejt qendrës. Kjo nënvizohet nga toni i theksuar i kundërshtisë ndaj një ndryshimi të tillë. Kundërshtimi përqëndrohet në tre argumente:

- a) Delegatët që përfaqësojnë elektoratin laburist e mbajtën udhëheqjen në kontakt me opinionin e votuesve.
- b) Anëtarët e partisë do t’i japin udhëheqjes rezultatet që ajo (udhëheqja) dëshiron sepse ata do të jenë shumë më pak të informuar sesa ata që vepronin kolektivisht nën emrin e tyre dhe kishin burimet e tyre vetjake për t’u informuar.

- c) “Një anëtar, një votë” do të dobësonte sindikatat dhe do të mohonte zërin e miliona mbështetësve.

Të gjitha këto argumente janë të vlefshme, të demonstrueshme dhe do të kishin qenë edhe më të fuqishme nëse politikanët dhe sindikalistët që i pohojnë nuk do të minoheshin prej dekadave të keq-menaxhimit të partisë. Dinosaurët politikë janë avokatë të dobët për status-kuonë. Sidoqoftë, ajo çka është shqetësuese është lehtësia me të cilën udhëheqja laburiste përdori sistemin e vjetër kur i shkoi për shtat.

I gjendur përballë perspektivës poshtëruese të anëtarëve të partisë që zgjedhin kandidatë “të papërshtatshëm” për Kryebashkiakun e Londrës dhe Ministrin e Parë të Uellsit, laburistët përdorën sistemin e vjetër zgjedhor të kolegjit duke lejuar sindikatat të “rregullonin” procesin e përzgjedhjes. Në 1997 Partia Laburiste përdori “vota të zeza” që t’u impononte anëtarëve të partisë Frank Dobson-in si kandidatin laburist për kryebashkiak dhe Alan Majkëllin si kandidatin laburist për Ministër të Parë të Uellsit. Frank Dobsoni u mund në zgjedhje nga Ken Livingstone – kandidati laburist që donin anëtarët, i cili në fund, kandidoi si Kandidat i Pavarur dhe fitoi me një plebishit. Dobsoni u minua kaq keq nga mënyra e përzgjedhjes së tij sa që mezi zuri vendin e tretë. Alan Majkëll fitoi shumë ngushtë zgjedhjen në Asamblenë e Uellsit por ishte një dështak dhe brenda disa muajsh humbi në një votim mosbesimit. Pasuesi i tij ishte popullori Rhodri Morgan, njeriu të cilin Partia Laburiste e Uellsit vërtet e dëshironte që ta përfaqësonte. Për ironi, Morgan dhe Livingstone tani pranohen plotësisht nga laburistët.

Është e debatueshme nëse popullariteti Morganit dhe Livingstonit është argumenti më i fortë pro apo kundra “Një anëtar, një votë” në një erë të demokracisë së përfaqësimit të pastër. Ndryshimi social nënkupton që publiku nuk ndryshon më nga elitat politike dhe dëshiron që të përfshihet në mënyrë më direkte përmes internetit dhe referendumeve. Argumenti më i fuqishëm për adaptimin e “Një anëtar, një votë” duket kur “nuk mbetesh prapa” nga elektorati juaj. Nëse ju jeni një parti tradicionale me një strukturë të dalë jashtë kohe, të lënë mbrapa është saktësisht ajo me të cilën ju do të përballeni në dy dekadat e ardhshme. Partia juaj nuk do jetë e aftë të reagojë shpejt dhe me efektshmëri ndaj anëtarëve të mësuar të votojnë në internet për qeverinë e ardhshme. “Një anëtar, një votë”, të paktën ka pamjen e modernes në një botë që marshon drejt pluralizmit, diversitetit dhe divergjencave.

9 Reformimi demokratik i partive politike shqiptare - domosdoshmëri e kohës

Prof. Dr. Rexhep Mejdani

Hyrje

Procesi i demokratizimit, në thelbin e tij, përbën një lëvizje të pandërprerë drejt shpërhapjes së fuqisë e “pushtetit” prej një grupi të vogël njerëzish drejt një bashkësie gjithnjë e më të gjerë. Suprimimi i peshës së votës për pronarët e mëdhenj, oborrtarët apo mbajtësit e ofiqeve shtetërore, heqja e kërkesës për kalimin e testit të shkollimit, për të drejtën e votës apo të moslejimit të votimit të grave, etj., përbëjnë vetëm një pjesë të mozaikut të lëvizjeve të mëdha e demokratizuese në ecjen e shoqërisë njerëzore drejt barazimit të fuqisë të të gjithë individëve me ushtrimin e parimit “Një njeri, një votë”. Kështu, p.sh., u deshën mbi 70 vjet përpjekje, mund e sakrificë, që nga thirrja elektrizuese në vitin 1848 e Elizabeth Cady Stanton për të drejtat e grave deri në betejën e fundit më 1920, për të arritur në amendamentin e 19-të të Kushtetutës së SHBA-së, që i garantonte edhe grave të drejtën e votës nëpërmjet mishërimit të parimit “Një grua, një votë”.

Zbatimi aktual në praktikë i parimit “ Një njeri, një votë”, përbën dhe simbolin historik të deklarimit të barazisë së fuqisë të të gjithë votuesve në moshë madhore, që jetojnë nën një qeverisje të përbashkët në një sistem politik pluralist e demokratik, pavarësisht nga niveli i pronësisë, bazamenti i edukimit, inteligjenca, etnia, feja, ngjyra, gjinia, etj. Pra, në këtë optikë demokratike, njerëzit që jetojnë së bashku, duke formësuar një bashkësi të caktuar në trajtën e shtetit, grupimit vendor, organizimit politiko-partiak, etj., duhet të kenë dhe të drejtën e detyrën për të ushtruar “së bashku” dhe në mënyrë të barabartë fuqinë e votës në përcaktimin e pushteteve përkatëse dhe të udhëheqjes së tyre, pavarësisht shkallës së kompetitivitetit individual. Por, nuk mund të harrohet që realizimi i këtij objektivi parimor, mishërimi në praktikë i kësaj të drejte njerëzore e politike, nuk ka qenë një gjë e lehtë, por një përpjekje titanike, e shoqëruar me ndeshje e sakrificë e mendjeve më të ndritura e

humaniste. Aberracionet, deri në shpërndarjen e barabartë të kësaj fuqie vote e pjesëmarrje, janë identifikuar dhe korigjuar, pra, në një proces të gjatë historik. Një “projektim” i veçantë i këtij procesi të përgjithësuar demokratizimi është dhe zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë” për bashkësi më të vogla, siç është dhe një parti politike.

Dy inisiativa për demokratizim partiak

Blokim inisiative në favor të “status quo”-së

Sipas korrespondentit politik Patrick Wintour të “The Guardian” (7qeshor, 2000), inisiativa e Çarls Kenedit (Charles Kennedy) për mbajtjen e një referendumi sipas parimit “Një anëtar, një votë” apo për zbatimin e demokracisë së drejtëpërdrejtë në të gjithë anëtarësinë e partisë Liberal-Demokrate për zgjedhjen e strukturave kyçe ekzekutive të saj u bllokua po nga struktura e tij ekzekutive...¹

Një revolucion i papërfunduar “një anëtar, një votë”

Sipas laburistit Philip Gould², në rivalitetin midis Toni Blerit (Tony Blair) dhe Gordon Braunit (Gordon Brown), pas vdekjes së kryelaburistit Xhon Smithit (John Smith) në 1994, ishte pikërisht “orientimi i veprimtarisë së tij sipas parimit “Një anëtar, një votë”, që krijoi realisht diferencën në kredencialet e zgjedhjes së tij”. Që kur ishte gjallë Smithi përpiqej ta ngadalësonte Blerin në entuziazmin e tij të ndryshimit, madje kur Bleri filloi të propagandonte me forcë këtë parim bazë të demokracisë së drejtëpërdrejtë, ai i tha: “Toni ju po tregoheni tepër intelektual lidhur me këtë çështje”... Por Bleri fitoi dhe vazhdoi në rrugën e tij të reformimit të partisë, saqë në korrik 1997 deklaroi në Darlington se edhe të gjithë vendimet e rëndësishme në parti duhet të merren nëpërmjet zbatimit të parimit “Një anëtar, një votë”. Po kështu, në dokumentin konsultativ të partisë për shekullin 21 ritheksohet se “qëllimi ynë duhet të jetë për ta rikthyer partinë në anëtarësinë e saj, për të fuqizuar rolin e anëtarëve të saj. Më shumë se kurrë, në shekullin 21, anëtarët e partisë duhet të jenë çelësi i të ardhmes tonë.” Një mendësi e re me kapacitete të thella reformuese, një revolucion i vërtetë demokratizues, por ende i papërfunduar nga barrierat e krijuara, kohë pas kohe.

Për një tranzicioni të mëtejshëm demokratik brenda partive politike shqiptare.³

Nga analiza e shumë parametrave, rezulton se Shqipëria po e mbyll fazën kryesore të tranzicionit të saj. Por, ndërkohë, duhet përsheptuar procesi i tranzicionit demokratik brenda vetë partive politike, sidomos i atyreve parlamentare, për t'iu përgjigjur jo vetëm evolucionit të shoqërisë shqiptare, në shumë segmente të saj, por dhe detyrave më të vështira përpara, e mbi të gjitha për të përballuar sfidat e integritetit. Vetëm kështu mund të transformohet më tej realiteti shqiptar jo me demagogji, trysni e manipulime, por me ide, veprim e reformim edhe në rrafshin politikopartiak. Vetëm kështu mund të rikthehet mbështetja dhe besimi në popull ndaj politikës, që në thelb kanë pësuar një tronditje jo të vogël, e shfaqur kjo masivisht edhe me një idiferentizëm kritik në rritje ndaj vetë politikës.

Në këtë situatë apatie e pakënaqësie, për demokratizimin e mëtejshëm të partive politike shqiptare, sidomos të atyreve me anëtarësi më të madhe, po behet e domosdoshme që, në përfaqësimin e çdo niveli, partiak apo qeverisës, të mishërohet realisht parimi i ekuilibrit të forcave, që nënkupton dhe insitucionalizimin e përfaqësimit e mendimit ndryshe apo të fraksioneve e korrenteve alternative në parti. Një element i rëndësishëm në administrimin e brendshëm të jetës së partisë është dhe funksionimi i plotë kolegjial i strukturave drejtuese të partisë si kundërvënie ndaj praktikës e teorisë së unitarizmit të drejtimit. Edhe argumenti i unitetit brenda partisë, i identifikuar me atë të uniformitetit, duhet përshtatur në përputhje me evolucionin e sotëm shoqëror dhe duhet zhvilluar brenda debateve, kompromiseve e konvergencave të mundshme të zgjidhjes. Po kështu, duhet rikonceptuar dhe vetë solidariteti në parti, si hapje e jo mbyllje, si etikë, besim e respekt i ndërsjellët, si dinjitet e mirëkuptim, si debat, tolerancë e diversitet. Ndërsa, komanda apo politika e forcës, nuk mund të përdoren si argument për të zbehur e luftuar mendimin ndryshe e oponencën, që janë të domosdoshëm për vetë procesin e demokratizimit të mëtejshëm të një partie politike. Kjo lidhet dhe me thelbin e partisë si një bashkësi vullnetare e njerëzve të lirë e të barabartë, përndryshe do të mbahen larg dhe një pjesë e konsiderueshme intelektualësh, aq të nevojshëm për zhvillimin e mendimit politik të partisë dhe të alternativave të reja të tij. Në këtë linjë, anëtarët e komitetit të përgjithshëm (apo të këshillit kombëtar) mund të zgjidhen nga Kongresi (apo Konventa) mbi bazën e listave të paraqitura nga kandidatët konkurentë për postin e Kryetarit të Partisë. Në të gjitha rastet duhet të garantohet përfaqësimi

statutor në to në mënyrë përpjesëtimore me mbështetjen, që gëzojnë platformat konkurruese shprehëse të mendimit alternativ. Një çështje tjetër është dhe ajo e transparencës së profilit e programit të partisë dhe e strukturave të saj drejtuese. Aq e vërtetë është kjo sot në kushtet shqiptare, saqë është mjaft e vështirë në shumë raste për grupimet politike kryesore për të përcaktuar krahun e tyre politik të majtë, të djathtë apo të qendrës. Në fakt, programi i partisë mund të ketë një divergjencë vetëm kohëshkurtër me atë të veprimit konkret politik apo qeverisës, por jo afatgjatë, sepse në fund të fundit kjo është dhe një çështje e ndershmërisë politike, e sinqeritetit dhe e moralitetit programor partiak para anëtarësisë dhe elektoratit përkatës.

Po aq i rëndësishëm për demokratizimin e partisë politike është dhe thellimi i karakterit elektoral të saj, krahas organizimit të partisë sipas strukturimit zgjedhor. Kjo nuk flet aspak për një prirje drejt dobësimit të strukturave të partisë në bazë, përkundrazi. Në përputhje dhe me sistemin tonë kushtetues parlamentar, ndryshe nga sistemi politik presidencial, strukturat në bazën e partisë mbeten po aq aktive, por organizimi i tyre përafrohet gjithnjë e më shumë me atë të strukturave të proceseve elektorale. Ndërsa, hapi më i rëndësishëm reformues në këtë kuadër është kalimi nga demokracia përpjesëtimore apo e delegimit në atë të drejtëpërdrejtë, pra në një proces zgjedhor apo vendimmarrës me pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të vetë anëtarësisë së partisë. E tillë, p.sh., mund të ishte për kushtet aktuale zgjedhja e kryetarit në nivel qendror apo vendor, apo e delegatëve të konferencave e të kongresit, me votimin e drejtëpërdrejtë të anëtarësisë përkatëse të partisë, pse jo dhe përzgjedhja e kandidatëve për deputetë ose këshilltarë. Krahas strukturimit organizativo-elektoral të partisë, në periudhën midis zgjedhjeve veprimtaria e angazhimi kryesor i partisë do të duhet të përqëndrohet në institucionet e përfaqësimit të saj, d.m.th., kryesisht në kuvend, këshilla qarqesh, bashkive e komunash, apo organet ekzekutive përkatëse qendrore e vendore, madje programi, ndihma e kualifikuar dhe mbikqyrja e partisë duhet të përçohet kryesisht nëpërmjet përfaqësuesve të saj në këto institucione e organe. Ndërsa në kongres (konventë) për kompozimin e strukturave drejtuese vendimmarrëse midis dy kongreseve (konventave) dhe përfaqësimin e mendimit ndryshe të votohet me lista të kandidatëve për kryetarë partie, siç veprohet me lista partie në zgjedhjen e këshillave të bashkive e komunave.

Por elementi më reformues e demokratizues në jetën e partisë, siç u theksua dhe pak më sipër, mbetet demokracia e tipit “Një anëtar, një votë” në kuptimin e vendimmarrjes që, jo vetëm zgjeron hapësirat e demokracisë, por dhe rrit përgjegjësinë e rolin e drejtëpërdrejtë të anëtarit të partisë.

Zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë”-domosdoshmëri për reformimin demokratik të partive

Në pikëpamje fundamentale, një parti politike, si çdo organizim tjetër shoqëror, është vetë anëtarësia e saj. Por kjo anëtarësi duhet të ketë edhe fuqinë reale për të marrë vendime mbi objektivat kryesorë, si një bashkësi relativisht e unifikuar. Pikërisht për këto arsye është mjaft i rëndësishëm, jo vetëm procesi i pjesëmarrjes, përcaktimit dhe delegimit demokratik të këtyre fuqive në rrafshin e drejtimit partiak apo institucional, por dhe rivlerësimi i autoritetit konkret të marrjes së vendimeve. Kjo nënkupton dhe rrugën apo procedurat statutoare që duhen ndjekur në mishërimin e këtij procesi e rivlerësimi. Ka dy rrugë: njera, që presupozon se fuqia votuese mbetet tek të gjithë anëtarët e partisë në sajë të ushtrimit të të drejtës njerëzore individuale apo parimit “Një anëtar, një votë”, dhe tjetra që mbështet në sistemin përpjesëtimor të votimit apo që nënkupton delegimin e përfaqësimit. Në një kuadër më praktik mund të përdoret dhe një sistem i përzierë apo dual, siç mund të jetë, për shembull, zgjedhja e anëtarve të Komitetit apo Këshillit në rang vendor apo qendror përkatësisht nga konferencat e partisë apo nga Kongresi (Konventa), ndërkohë që delegatët në këto organizma mund të zgjidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga e gjithë anëtarësia përkatëse e partisë. Kjo skemë mund të zbatohet edhe për rezoluta të rëndësishme, për ndryshime thelbësore statutoare e programore, përfshirë dhe simbolet e partisë. Për këto të fundit, p.sh., fillimisht mund të bëhet një miratim në strukturat e deleguara dhe më tej organizohet referendumi në të gjithë anëtarësinë e partisë.

Në kushtet e Shqipërisë kur ende nuk janë fiksuar limite kohore në ushtrimin e disa detyrave të veçanta drejtuese partiake, sidomos të asaj të kryetarit të partisë, kuptohet rëndësia e demokratizimit të mëtejshëm të drejtimit të partisë politike nëpërmjet zbatimit të parimit “Një anëtar, një votë”, që aktualisht është përfshirë për disa nivele zgjedhjeje në statutin e një partie të re, të LSI-së, por që akoma nuk është eksperimentuar në praktikë. Fillimisht, ky parim i fuqishëm demokratizues mund të zbatohet për zgjedhjen e kryetarit të partisë, dhe më tej të drejtuesve kryesorë, për miratimin e platformave zgjedhore apo të materialeve më kryesore të politikës partiake dhe hap pas hapi të shtrihet aplikimi i këtij parimi në të gjitha proceset zgjedhore partiake ose për të gjitha vendimarrjet më të rëndësishme. Sidoqoftë në të gjitha rastet e zbatimit të këtij principi, ajo që kërkohet të ndërtohet me kujdes dhe sipas kriteresh rreptësisht të përcaktuara është dhe rregjistri i anëtarësisë së partisë, pse jo në kushtet e sotme dhe kompiuterizimi apo database i tij. (Ky regjistër i anëtarësisë,

normalisht duhet të jetë në dispozicion të çdo anëtari të partisë në zyrat lokale e qendrore të saj dhe në internet).

Me zbatimin e këtij parimi, të fituar me aq mund e sakrifica në historinë njerëzore për zgjedhjet e përfaqësuesve të popullit në nivel qendror dhe vendor, në jetën partiake priten të ndodhin ndryshime thelbësore në mendësi, strukturë e rekrutim, që më tej detyrimisht do të pasqyrohen në mënyrë pozitive edhe në evolucionin e të gjitha segmenteve të tjerë të shoqërisë e shtetit. Në këtë mënyrë jo vetëm konsiderohet e barazohet vota e çdo anëtari, jo vetëm rritet përgjegjësia individuale në përzgjedhje, por dhe kontributi i tij në vendimarrje. Normalisht, një gjë e tillë duhet të rrisë edhe pjesëmarrjen cilësore e sasiore në partinë politike, sepse ajo që vihet re sot me strukturën aktuale partiake, është jo vetëm hezitimi relativisht i konsiderueshëm i intelektualëve për t'u përfshirë në jetën partiake, por dhe zvogëlimi apo ruajtja e “status quo”-së në numër e vetë anëtarësisë së partisë. Kjo dhe për arësyen e thjeshtë se vetëm një numër shumë i vogël anëtarësh marrin pjesë në jetën aktive politiko-partiake ose në strukturat vendimarrëse në nivel qendror e vendor (si delegatë në Kongres, Konventë ose konferenca, në komitete drejtuese apo këshilla, në kryesitë e partisë etj.). Për këtë arsye dhe përfaqësimi përpjesëtimor apo i deleguar në një kongres partie përbën në thelb një zbatim të sistemit pjesërisht të mbyllur, dhe për më tepër është pasqyrimi i një mendësie relativisht të vjetëruar në konceptimin bashkëkohor partiak. Vetëm me anë të zbatimit të parimit “Një anëtar, një votë” mund të krijohen hapja ose hapësira frymëmarrëse që të rikthehen të larguarit ose të vetëlarguarit, apo të futen anëtarë të rinj me kapacitete shumë më të lartë, sepse, në fund të fundit, ky parim u jep të gjithë anëtarëve një zë të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë për vendimet më të rëndësishme. Apo, për më tepër, ky parim ndihmon individët e talentuar e të devotshëm që të kapërcejnë shumë më lehtë barrierat e karrierës partiake, pengesat klanore ose neopotike për t'u përfaqësuar në kongres e në struktura të tjera. Nga ana tjetër, ushtrimi i këtij parimi ndihmon dhe në përmirësimin e strukturës drejtuese nga pikëpamja gjinore, sepse krijon mundësi më të mëdha për gratë, por ndikon dhe në përmirësimin e përfaqësimit edhe për grupet minoritare, deri dhe invalidët, apo, në përgjithësi, për të gjithë ata që kanë mundësi të reduktuara kontakti e mbështetjeje, përfshirë dhe atë financiarë.

Diskutimi për shtrirjen e parimit demokratik “një anëtar, një votë” shpesh pengohet me argumenta vështirësie e kompleksiteti, me faktin që realisht “djalli qëndron në detaje”. Në të vërtetë, ka njëfarë “paradoksi” lidhur me zbatimin e këtij parimi, sepse sa më gjerësisht të kërkohet të zbatohet ky parim, aq më kompleks e problematik bëhet ai nga pikëpamja

praktike e procedurale. Sidoqoftë forma më e thjeshtë e zbatimit të këtij parimi lidhet me zgjedhjen e kryetarit të partisë, që realisht rezulton vendimtare në procesin e reformimit partiak, sepse në shumë raste, të paktën në Shqipëri, nëpërmjet kryetarit përcaktohet ose të paktën perceptohet fizionomia e partisë. Prandaj, vetëkuptohet se një hap i tillë, me kompleksitet minimal zgjedhjeje nga pikëpamja praktike, është një zhvillim i parë pozitiv në demokratizimin e partisë. Por dhe lidhur me këtë nuk mungojnë argumentat kundër. Sipas tyre, në këtë mënyrë fuqizohet shumë kryetari, rritet përqëndrimi i pushtetit politik në duart e tij, por dhe mund të përkeqësohet llogaridhënia para anëtarësisë së partisë. Po kështu, një argument tjetër kundër është dhe se, nëpërmjet ushtrimit të parimit “Një anëtar, një votë” mund të ligjërohet “përjetësia” e kryetarëve të sotëm apo mund të bjerë rëndësia dhe “pesha specifike” e aktivistëve të partisë të tipit “derë më derë”.

Me strukturat e procedurat aktuale partiake, zgjedhja e kryetarit të partisë sot bëhet në periudha të caktuara, me kandidatë ose pa kandidatë konkurrentë. Por, megjithatë, siç ka rezultuar nga përvoja e deritanishme, në shumicën e rasteve një proces i tillë zgjedhjeje ka përfunduar si një çështje ose procedurë thjesht teknike me paravendosje për “ruajtje” vendi, madje deri me sjellje armiqësore ndaj çdo kandidimi alternativ! Parë në këtë plan, me zbatim të parimit “Një anëtar, një votë” ose jo, detyrimisht në praktikën shqiptare, për të shmangur dhe prirjet e shfaqura të autoritarizmit, nevojitet dhe një “mbrojtje” tjetër demokratike që lidhet me kufizimin kohor të mandatit të kryetarit ose me përfshirjen në sistemin partiak të një procesi të rregullt rishikimi e analize të udhëheqjes, së bashku me prerogativat përkatëse. Këto të fundit, së bashku me ushtrimin e parimit “Një anëtar, një votë” mund të ndihmojë në rritjen e llogaridhënies, ndërkohë që në strukturën ekzistuese një gjë e tillë ka vetëm karakter formal e demagogjik. Për më tepër, siç ka dëshmuar praktika e jonë pluraliste 14-vjeçare, është pothuajse i pamundur zëvendësimi i kryetarit apo “zbritja nga kali” e liderit në funksion, megjithë veprimet krejtësisht të gabuara të kryera më parë apo në vazhdim prej tij. Prandaj duhet të ligjërohet nga pikëpamja statutore dhe kufizueshmëria kohore e ushtrimit të kësaj detyre. Por ka dhe një kundërgument tjetër të një rrafshi më të lartë conceptualo-praktik. Praktikat e ndryshme kushtetueso-institucionale në zgjedhjen e presidentit apo kryetarit të një shteti demokratik me delegim përfaqësimi pra, nëpërmjet parlamentit, parlamentit edhe senatit, apo në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga populli, kanë treguar se, në ushtrimin e funksionit të tij, krahas ndikimit të personalitetit konkret, përcaktuese ka qenë e mbetet kryesisht baza kushtetuese-ligjore që “sistemon”

funksionimin e këtij institucioni e detyrat e tij dhe jo patjetër mënyra e zgjedhjes. Nga ana tjetër, në rastin e zgjedhjes nga populli i jepet më shumë forcë morale dhe neutralitet institucional, më tepër lidhje me qytetarin e thjeshtë e problemet e tij, vetë këtij pozicioni të lartë. E njëjta gjë vlen dhe për kryetarin e partisë, nëse sistemi rregullator e statuti i partisë kanë konsideruar e trajtuar dhe formulimet e duhura si kufizime statutore ndaj çdo prirjeje autoritariste. Gjithashtu, përsa i përket praktikës së kongreseve asnjë zbatim konkret i parimit “Një anëtar, një votë” nuk e përjashton atë apo i kundërvihet asaj. Ajo që synohet është moszgjedhja e kryetarit me votë të deleguar në kongres, por në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga e gjithë anëtarësia. Po të ndiqen procedurat aktuale delegatët pjesëmarrës, qoftë dhe të nivelit mesatar (nuk bëhet fjalë për të punësuarit e këtij niveli të partisë apo qeverisë së saj), mund të luajnë një rol shumë të vogël emancipues në konferenca e kongres, ndërkohë që fuqia e një grupi të vogël aktivistësh, ndonjëherë dhe mediokër, bëhet mjaft e madhe, deri “manipuluese” në fushatën zgjedhore për lidërshpin e partisë.

Lidhur me aktivistët e tipit “derë më derë”, sot mund të thuhet hapur se ata kanë një zë të veçantë në ngjarje të rëndësishme siç është p.sh. kongresi i partisë, madje dhe kur nuk janë delegatë, por thjesht të ftuar. Me reagimet e tyre, me zhurmat, fyerjet e intimidimet e llojeve të tjera mbi anëtarë të veçantë, në përputhje me interesa të udhëheqjes, ata sa ndihmojnë pozitivisht partinë në fushata zgjedhjesh parlamentare e vendore, po aq shndërrohen në një pengesë antidemokratike për shpалosjen e mendimit ndyshe dhe të alternativave të kandidimit. Në këtë mënyrë, edhe pse mjaft të domosdoshëm në shumë raste, ata nuk i shërbejnë, madje i bëhen pengesë, në këtë rast, reformimit e demokratizimit të mëtejshëm të partisë, duke mbetur partizanë të “status quo”-së në drejtimin dhe konceptimin e saj. Me zbatimin e parimit “Një anëtar, një votë” është mjaft e mundshme që aktivistët e mësipërm, në mungesë të “veçimit” e konsiderimit të tyre si më parë, edhe mund ta zbehin diçka punën e tyre. Ndërkohë që një kundërgargument më i përgjithshëm është fakti që nëpërmjet ushtrimit të këtij parimi merr fuqi shumë më të madhe e gjithë anëtarësia e partisë, pra dhe vetë ky grup aktivistësh. Pra, sipas këtij kundërgargumenti, ky parim, i zbatuar në mënyrë “luajale”, nuk ka pse të lëkundë fuqinë lokale (në lagje, rrugë, fshatra) të aktivistëve të tillë. Po kështu zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë” nuk e redukton ndikimin e organizatës së gruas dhe të rinisë, siç pretendohet jo rrallë, por, ndoshta, vetëm atë të disa drejtuesve të tyre në zgjedhjen e kryetarit apo të udhëheqjes së partisë. Nga ana tjetër, ashtu siç ka përqindje kandidimi apo përfaqësimi të gruas e rinisë

në struktura të partisë, edhe nëpërmjet zbatimit të parimit të mësipërm, jo vetëm mund të ruhen këto përqindje por, madje, sidomos, mund të përmirësohen ato, në sajë të votimeve të drejtëpërdrejta të grave apo të të rinjve. Ky parim mund të dalë epërsor dhe në ratifikimin e platformës zgjedhore, pas një diskutimi të hapur e përmbledhës kohë më parë, sado kompleks që mund të shfaqet ky proces. Madje, ky diskutim paraprak mund të rrisë jo vetëm pjesëmarrjen në hartimin e kësaj platforme, por dhe pjesëmarrjen në referendumin për ratifikim, dhe më tej në procesin zgjedhor për të mundësuar jetësimin e saj.

Pavarësisht argumentave pro e kundër, parimi "Një anëtar, një votë" si një parim i fuqishëm demokratik e pjesëmarrje-nxites shpreh një mundësi optimale reformimi e një qartësi konceptuale në të gjitha aspektet, edhe pse detajet në mjaft raste, në shikim të parë, mund të manifestojnë ndërlikime e vështirësi. Por i pari dhe më i rëndësishmi është veprimi kurajoz, përfshirja statutore e këtij parimi, dhe më tej, nëpërmjet zbatimit, vjen edhe korigjimi, rregullimi e thjeshtimi i detajeve, i procedurave komplekse në përputhje me përvojën e fituar dhe mangësitë e shfaqura. Ky është vetë thelbi i zhvillimit dhe emancipimit. Dhe në këtë rrugë ka ecur edhe zbatimi i parimit "Një njeri, një votë" në procesin e demokratizimit të sistemit politiko-institucional, prandaj nuk ka pse të hezitohet apo të mos besohet se po aq prodhime të vyera demokratike do të arrijë të gjenerojë dhe mishërimi i parimit "Një anëtar, një votë" në procesin e reformimit politiko-partiak.

Shënime:

¹ Patrick Wintour, Chief political correspondent, Lib. Dem. voting rebuff for Kennedy, The Guardian, Wednesday, June 7, 2000.

² Philip Gould, The Unfinished Revolution: How the Modernisers Saved the Labour Party, Publ. Abacus, 1999.

³ Për më hollësisht, shih R.Mejdani, Kontratë me vetveten, (në shtyp) Sh.Botuese "Toena", Tiranë 2004.

10 “Një anëtar, një votë”

rruga e vetme drejt demokracisë

Aleksandër Mexsi

Në momentet e vështira në të cilat ndodhet Shqipëria analiza e gjendjes, shkaqeve dhe rrugëdalja nuk duhet të kërkohen vetëm në strukturat e shtetit por dhe në ato të politikës në kuptimin më të gjerë. Për këtë arsye ne jemi thellësisht të bindur se pa u demokratizuar partitë politike, madje dhe levizjet që tërthorazi ndikojnë në jetën politike si aktorë ngacmues apo kritikë të saj, nuk do të ketë Shqipëri demokratike dhe përparim të shoqërisë shqiptare në kahje demokratike. Këto probleme kanë qenë shpeshherë temë e shkrimeve tona, pikërisht për shkak të ngecjes së mjaft proceseve demokratike, madje edhe të rrezikut që nga pseudopluralizmi ramizian të kthehemi në pseudopluralizmin e partive jo të demokratizuara, partive të individëve, apo grupeve të ngushta që i drejtojnë ato, kuptohet me doktrina (apo praktika) aspak demokratike.

Krijimi i partive të para në kapërcyellin e vitit ‘90 realizoi pluralizimin politik në Shqipëri, dukuri thelbësore e të cilit në kohën e sotme është numri i madh i partive, shumica me anëtarësi të vogël përgjithësisht të pa evidentuar, shkuarja e tyre pas dy partive të mëdha, deri tek hyrja në parlament me votat e tyre, që njëherazi dëshmon për platforma dhe sjellje politike të diktuar nga interesa jodemokratike. Sot me ecjen sidoqoftë përpara të shoqërisë në rrugën e reformimit drejt demokracisë, tregut të lirë dhe shtetit të së drejtës, për shkak të mangësive, gabimeve, çrregullimeve dhe fenomeneve të tjera negative që i shohim në deklaratat e pafundme të miqve tanë, të institucioneve ndërkombëtare dhe të vendeve apo bashkësive me zë në politikën globale, pra të atyre që na monitorojnë, janë shtuar kritikrat ndaj qeverisjes dhe partive politike brenda shoqërisë shqiptare, ashtu edhe brenda partive. Këto gjykime të ndryshme nga ai i liderave (termi leadership nuk është i përshtatshëm, sepse partitë janë njehsuar me liderin e vet) dhe i “pasuesve” të tyre, po bien shpërbërjen e partive të mëdha, por mbi të gjitha kanë bërë të ngutshme institucionalizimin e mendimit ndryshe, domethënë, brenda të

njëjtit program dhe statutit që trupëzon partinë, për çështje të ditës dhe ato të strategjisë, pra për qëndrime të momentit apo dhe afatgjata, të mund të paraqiten dhe shqyrtohen brenda rregullave të demokracisë propozime të ndryshme, pa etiketuar, si në kohën e diktaturës “armiç” bartësit e tyre, e pa i flakur, fyer apo mënjeluar ata nga jeta politike shqiptare.

Por, pranimi (tolerimi) i mendimit ndryshe do të ishte pa vlerë për demokracinë (ai të kujton dredhin famëkeqe të komunistëve shqiptarë në mesvitin 1990 : pluralizëm i ideve), nëse nuk do të institucionalizohet mendimi ndryshe, domethënë që në parti të mundësohet jo vetëm mendimi ndryshe, por që edhe bartësit e tij të jenë të përfaqësuar në strukturat e partisë, nga baza deri në majë, sigurisht për aq sa janë mbështetësit e tyre, dmth bazuar në votat që marrin ata në parti. Rasti më skajor do të ishte formimi i korenteve, grupimeve apo fraksioneve, pra grumbullimi rreth një liste që sidoqoftë do të karakterizohet nga mendësi, programe e propozime për veprime e strategji konkrete. Por në çdo rast do të jetë ballafaqimi demokratik me vota i propozimeve dhe kontrolli i rezultateve, ai që vlerëson dhe evidenton këto mendësi, programe dhe propozime dhe që krijon shumicat brenda një partie, shumica jo të përherëshme dhe që nuk përjashtojnë pakicat, sepse në një sistem shumëpartiak demokratik nuk ka vend për bolshevizëm.

Institucionalizimi i mendimit ndryshe realizohet dhe sigurohet vetëm me parimin “Një anëtar, një votë”, pa të cilin, me mënyrat sesi votohet deri më sot, brenda partive shqiptare do të vazhdojnë të krijohen shumica që mënjanojnë përfaqësimin e pakicave, pra pluralizimin dhe demokracinë brenda partive. Nga shumica që përvehtësojnë partitë deri tek mohimi i pluralizimit rruga nuk është e gjatë dhe këtë po e shohim përditë e më tepër. Në këtë rast nga pluralizmi i partive që përfaqësojnë një spektër të gjerë, qoftë dhe bipolar, kalohet në luftë të vërtetë kundërshtarësh mohues për të mbajtur vazhdimisht nën pushtetin e tyre popullin përmes instalimit të një regjimi.

Institucionalizimi i mendimit ndryshe që realizohet përmes votimit me votë të drejtpërdrejtë të gjithë anëtarëve të partisë apo të strukturave të saj për zgjedhjen e përfaqësuesve, domethënë e atyre që marrin vendime dhe drejtojnë, nëpërmjet parimit “Një anëtar, një votë” siguron pjesëmarrjen reale dhe aktive të anëtarësisë në jetën dhe veprimtarinë e partisë, afrimin e njerëzve me të njëjtat ideale por që rrijnë në një anë, pra gjallëron jetën e partisë, duke e bërë atë një forcë reale politike dhe shton përkrahjen nga elektorati. Vetëm në këtë mënyrë, me të vërtetë demokratike, sigurohet pjesëmarrja treguese dhe përbërëse reale e demokracisë.

Ka vite që e kërkojmë pikërisht këtë demokratizim të partive në

Shqipëri, madje kemi thënë shumë herë se pa parti të demokratizuara nuk do të ketë Shqipëri demokratike dhe të përparuar, nuk do të integrohemi në botën e demokracive perëndimore - NATO dhe BE. Në këtë mendim jam patundësisht i bindur. Refuzimi me kokëfortësi i këtyre parimeve, që i kanë shumica e partive të djathta dhe të majta perëndimore, na ka shtyrë deri në mendimin, mbase skajor, që liderat tanë janë të kënaqur me çka ju ka siguruar kjo lloj “demokracie specifike” dhe për arsye të ndryshme e shtojnë sa të mundin integrimin e Shqipërisë në BE. Çuditërisht brenda një nate, të gjithë liderat pranojnë me brohori këtë parim, ndërkohë që asnjëri nuk e vë në jetë, madje e shtojnë për vite me vonë me pseudopretekste. Mbetet ende enigmatike për ne që të arrijmë të kuptojmë se çfarë ka ndodhur, prandaj dhe jemi skeptikë për këto deklarime të tyre. Madje ata nuk kanë dhënë asnjë lloj shpjegimi për qëndrimin e tyre deri më sot dhe as dhe të tregojnë për çfarë e kanë fjalën, sepse nuk mjafton të pranosh një parim dhe gjithëshka vetëbëhet. Në fund të fundit nëse do të dëshironin të fitonin në zgjedhjet e ardhshme më shumë vota sesa deri më sot, nëse me të vërtetë duan të demokratizojnë partitë e tyre dhe t’i hapin ato, duke afruar jo vetëm ata që janë larguar dhe rrijnë mënjanë duke mbetur demokratë, por dhe të tjerë sidomos të rinjtë, do të duhej që menjëherë t’i vinin në jetë këto rregulla dhe po të mos i dinin dhe kuptonin do pyesnin ata që i dinë dhe i kanë kuptuar me kohë. Për të realizuar këtë nuk duhen ndryshime statutore sepse rregullat për kryerjen e zgjedhjeve të forumeve i caktojnë organet e larta të zgjedhura, për to duhet vetëm të jetë krijuar bindja për nevojën e tyre dhe të kenë mendësi demokratike, të cilën për fat të keq të shqiptarëve nuk po e demonstrojnë. Ka edhe më keq kur ndonjë ish-komunist i pareformuar dhe ithtarë i liderave thotë se ky parim forcon pushtetin e njëshit (kur është krejt e kundërta), ndërkohë që vetë njëshit e kanë kundërshtuar deri më sot këtë parim. Me këtë tezë dashakeqëse duan të na thonë më mirë kështu siç jemi.

Nuk mund të mos vërejmë dhe një dukuri tjetër lidhur me pranimin e këtij parimi dhe vënien në jetë të tij. Nuk kemi parë që në mediat shqiptare ndonjë nga analisto-opinivistët e shumtë të shprehet në mbështetje të kësaj kërkesë dhe të atyre që përpiqen për demokratizimin e partive, po kështu dhe politikanët. Nuk besoj se kjo është një ogur i mirë po të kemi parasysh rëndësinë që ka ky parim në momentin e sotëm.

Çfarë duhet bërë, çfarë propozojmë?

Së pari, sa më parë të qartësohen opinionet partiake dhe ai publik për mekanizmat e zgjedhjes së organeve përfaqësuese të partive në botën demokratike. Pra si votohet në bazë të parimit “Një anëtar, një votë”,

në të gjitha nivelet dhe në të njëjtën ditë, si formohen strukturat me të zgjedhur (dhe jo me të përzgjedhur) dhe ata “ me të drejtë” apo ex-officio (deputetë, ish-a, kryetarë bashkie etj), që janë përfaqësues realë me votë të elektoratit. Bashkësia e këtyre dy grupeve siguron mbështetje më të gjerë në zgjedhjet politike dhe ato vendore, në të cilat nuk voton vetëm partia por dhe elektorati. Po kështu duhet të sqarohen se cilat janë në këto parti organet kolegjiale vendimarrëse dhe politikëhartuese, pra nuk ka parti të njëshit si ia ka qejfi ish-komunistëve. Të kuptohemi, drejtuesit i zgjedh shumica, por ajo ndryshon kur gabohet dhe dështon dhe në të kundërt (kur ata nuk japin dorëheqje) i ndryshon baza . Kjo është dhe arsyeja që pas dështimeve në zgjedhje politike ribëhen ato të partisë nga baza deri në kongres edhe kur nuk i ka ardhur koha sipas statutit. Po kështu duhet të shpjegohet që parimi i mësipërm realizohet duke i dhënë anëtarit aktiv vetëm një votë (mundet edhe disa të tjera preferenciale apo mundet 10-15 për qind të numrit të vendeve që zgjidhen ose forma të tjera, të cilat mund të huazohen në përputhje me përvojën dhe mundësitë tona).

Në këtë mënyrë njësitë më të vogla të bazës (seksione, organizata) zgjedhin kryetarin dhe kryesinë e tyre. Degët, të njëjtën ditë në disa qendra, zgjedhin edhe ato kryetarin dhe kryesitë e tyre (mbi bazë kandidaturash të propozuara nga baza ose me Lista korrentesh) si dhe përfaqësuesit e tyre në Këshillat Kombëtare apo KPD...dhe delegatët që iu takojnë për në Kuvend apo Kongres..., ndërsa në to bashkë me anëtarësinë në të njëjtën ditë zgjidhet Kryetari dhe miratohet programi.

Së dyti, bëjnë mirë t’ia bëjmë të njohur anëtarësisë dhe opinionit publik këto mekanizma bazë të partive perëndimore me seminare, leksione, emisione televizive e deri dhe botime shëmbujsh të spikatur statutesh dhe rregulloresh, për të kuptuar zgjedhjet, specifikat dhe traditat që janë marrë parasysh në hartimin e rregullave, sepse të tilla mund të kemi edhe ne.

Duhet pranuar se vënia në zbatim e këtij parimi dhe rregullave që rrjedhin për pasojë, paraqesin vështirësi dhe kërkojnë kohë, por kjo nuk përbën arsye që të shtyjme në kalendat greke demokratizimin kaq të nevojshëm të partive shqiptare. Duke qenë se jemi përpara zgjedhjeve politike të viti 2005, vetë partitë duhet të jenë të interesuara për një proces të tillë dhe për këtë mund të kërkojnë edhe asistencë nga institucione të specializuara, si përsa i përket rregullave, ashtu dhe për hartimin e evidencave të sakta të anëtarësisë dhe për edukimin demokratik të bazës në këtë drejtim.

Duke realizuar këto, nuk ka se si të ndodhë që parimi “Një anëtar, një votë” të shërbejë vetëm si parrullë për të mashtruar anëtarësinë, shqiptarët dhe të huajtë se po bëjmë një hap përpara në demokraci.

Në qoftë se do të egzistojë vullneti dhe dëshira e mirë këto rregulla mund të vihen në jetë dhe në Shqipëri, çka do të përbënte një revolucion të vërtetë që do të përmbyste feudalizmin partiak, të vendosur këtu që në vitin 1944, dhe atëherë Shqipëria do ndryshonte për mirë dhe me shpejtësi.

11 Përse një anëtar, një votë?

Ilir Meta

“Gjithnjë voto për parimet të cilat mbështet, edhe pse ndoshta mund të votosh i vetëm për to, por ju mund t’i gëzoheni reflektimit më mbresëlënës se vota jote nuk vete kurrë dëm”

Xhon Kuinsi Adams

Reth 2500 vjet më parë, në Athinën antike një udhëheqës i quajtur Perikli mblodhi në Akropolin e famshëm të qytetit të gjithë qytetarët e saj të lirë, për të marrë sëbashku një vendim. Që nga ai moment e më pas, historia e njerëzimit u pasurua me një nga konceptet e saj më të mëdha dhe më demokratike, përfaqësimin e drejtpërdrejtë, i cili në rrjedhën e historisë ka evoluar dhe është pasuruar, duke arritur në kohën tonë në aplikimin shumëdimensional të standartit “Një anëtar, një votë”.

Politika pluraliste në Shqipëri ka një moshë të re dhe është ende në fazat e saj të para të zhvillimit. Para vitit 90⁷, shqiptarët mendonin vetëm për përmbysjen e sistemit komunist dhe instalimin e pluralizmit politik. Mungesa e një tradite demokratike dhe izolimi i thellë ishin faktorët kryesorë që kushtëzonin mungesën e nocioneve të qarta politike mbi ideologjinë, filozofinë dhe praktikat e ndryshme të funksionimit të forcave dhe grupeve politike në sistemin e liberaldemokracive perëndimore që na frymëzonin.

Vendosja e sistemit të votës së “lirë” është padyshim një arritje e madhe, por e pamjaftueshme për të mundësuar funksionimin e plotë të një demokracie komplekse dhe të zhvilluar. Këtë e ka vërtetuar çënim i shpeshtë që asaj i bëhet në kontekst të votimeve të përgjithshme për të zgjedhur të besuarit tanë në nivel qendror apo lokal, por edhe brenda vetë forcave politike, të cilat ende udhëhiqen nga liderë të palargueshëm, për

shkak të një vote të paragjykuar dhe në esencë të saj të manipuluar dhe të margjinalizuar.

Ndonëse kanë kaluar rreth pesëmbëdhjetë vite që nga koha e përmbyesjes së sistemit të “votës njëngjyrëshe”, përsëri politika shqiptare rreket përreth të njëjtit qerthull vicioz, pa mundur të dalë prej tij, duke mbetur në këtë mënyrë peng i një tradite dhe praktike që çënon demokracinë dhe interesat e publikut në vendimarrje, ku votuesi konsiderohet i rëndësishëm vetëm ditën e votimit dhe vlerësohet vetëm si një nocion abstrak numerik që të sjell apo të rrëzon nga pushteti, ndërkohë që duhet të ndodhë krejt e kundërta. Ai duhet të jetë në epiqendër të zhvillimeve të përditshme politike, pasi politika duhet të ekzistojë për qytetarin dhe mirëqënien e tij individuale dhe kolektive. Ajo, nëpërmjet mekanizmave të saj të qeverisjes dhe administrimit të delegimit të votës, duhet t’i garantojë atij siguri, zhvillim, mundësi dhe shanse të barabarta, drejtësi, dinjitet dhe solidaritet, pasi vetëm një shoqëri që zhvillon këto vlera mund të ecë përpara me shpejtësi, të arrijë kohën e humbur dhe të jetë e qëndrueshme.

Për këtë arsye, pra për të kthyer politikën tek qytetari, vendimarrjen tek publiku, pjesëmarrjen aktive tek anëtarësia, të cilat rrisin kohezionin social, integrojnë individin në një komunitet vlerash, ngrënë dinjitetin e tij dhe të shoqërisë, krijojnë lidhjen e nevojshme materiale, morale dhe psikologjike mes institucionit të qeverisësit dhe të qeverisurit, Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila është një forcë e re politike në formë dhe përmbajtje, ka sanksionuar në statutin e saj funksionimin e parimit më përfaqësues të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe vendimarrje, “Një anëtar, një votë”. Unë besoj se ky është një moment i rëndësishëm për zhvillimet e ardhshme politike dhe demokracinë në vënd dhe jam i lumtur që LSI është forca e parë politike në Shqipëri që do të implementojë këtë praktikë.

Me shpresën e mirë për ndryshim, kam pritur me vite që kjo të ndodhë në Partinë Socialiste. Kam ndjekur me vëmendje edhe deklaratimet e Partisë Demokratike për zbatimin e këtij parimi. Fatkeqësisht, këto dy forca politike kanë mbetur skllave të demagogjisë dhe paaftësisë për të ndryshuar. Ato nuk janë të afta të ndër marrin ndryshime të mëdha, sepse para së gjithash janë të vogla në përmbajtje dhe në interesat e ngushta që mbrojnë. Edhe konceptimi prej tyre i zbatimit të këtij parimi është i mangët dhe nuk përmbush qëllimin e tij. Në gjykimin dhe zbatimin tonë të parimit “Një anëtar, një votë”, ne nuk shohim vetëm shtrirjen e tij në pjesëmarrjen e të gjithë anëtarësisë në zgjedhjen apo votimin e liderit të partisë, as vetëm të drejtuesve të saj lokale dhe as vetëm të kandidatave

për pushtetarë të nivelit qëndror apo vendor, por angazhimin e tyre të plotë në hartimin e politikave të forcës politike, shprehjen e vullnetit të tyre nëpërmjet votës së drejtëpërdrejtë në të gjithë vendimarrjen e rëndësishme të partisë, që ka të bëjë me qëndrimet e saj politike, me pozicionin e saj në spektrin politik, me politikat zhvillimore, ato elektorale e ekzekutive të saj. Pra, për ne “Një anëtar, një votë” do të thotë pjesëmarrje e përditshme dhe e plotë e çdo anëtarit në tërësinë e jetës dhe funksionimit të LSI-së. LSI është parti e anëtarësisë, individëve dhe komuniteteve që janë pranë saj dhe mendojnë si ajo dhe jo e kundërta.

Lëvizja Socialiste për Integrim, që unë kam nderin të drejtoj, e ka marrë këtë vendim sepse është e bindur në vlerat që ai përfaqëson, hapësirën reale që krijon për ballafaqimin dhe zhvillimin e ideve dhe debatit sa më të gjerë politik dhe publik mbi çështje që kanë të bëjnë me fatet e vëndit dhe jetën e qytetarit, që garantojnë shprehjen e çdo mendimi, të drejtën për t’u pozicionuar ndryshe dhe për t’u pranuar nga tërësia e komunitetit politik ku kontribuon dhe realizon idetë, duke i dhënë fund përgjithmonë politikës së përcarjes dhe përjashtimit që ka pushtuar prej kohësh politikën e vjetër.

Pa dyshim që e vërteta më e madhe e një sistemi demokratik është fakti se asgjë nuk është perfekte, asgjë nuk është e përrjetshme, çdo gjë është elastike dhe çdo gjë është e përmirësueshme. Në këtë kuptim edhe vetë demokracia nuk është një sistem ideal, por më i miri që njerëzimi ka mundur të prodhojë dhe zhvillojë deri më sot. Duke marrë në konsideratë edhe faktin se demokracia në Shqipëri është ende e pamaturuar mirë, ekzistojnë ende reminishencat e një kohe të kaluar, ndikimi që lë pas një sistem, i cili ka ndrydhur dhe shtypur vullnetet e qytetarëve për pesëdhjetë vjet, une besoj se pjesëmarrja sa më e gjerë e individëve dhe komuniteteve në jetën e vëndit, pjesëmarrja e tyre në aktivitetin politik dhe ndërvarësia që duhet të krijohet mes saj dhe qytetarit, ku politika ka mandatin për të drejtuar, por jo pa konsensusin dhe miratimin e votuesit, krijon atë lidhje të qëndrueshme që e bën demokracinë sistemin më të avancuar dhe nxitës të zhvillimit dhe marrëdhënieve mes shtetit dhe qytetarit, punës dhe kapitalit, individit dhe komunitetit, publikes dhe private, në të gjithë spektrin e shoqërisë njerëzore.

Prandaj, në kushtet e Shqipërisë, është i domosdoshëm ky zbatim, pasi kjo e bën politikën e mbrapshtë të këtyre viteve të hyjë në një rrjedhë normale, më të kontrollueshme dhe më të përgjegjshme, shton alternativat e zhvillimit, duke i vënë ato përballë njëra-tjetrës jo si koncepte antagoniste, por si kontribute të integrueshme në hartimin dhe implementimin e atyre politikave që e çojnë vëndin përpara më shpejt, më mirë dhe me sa më pak

kosto sociale dhe ekonomike.

Zbatimi i këtij parimi i bën gjithashtu liderët e pazëvendësueshëm të partive historike të jenë të zbuluar përpara anëtarësisë së tyre, pasi do të duhet të japin llogari jo përpara një forumi të manipulueshëm “interesaxhinjsh politikë”, por do të jenë përgjegjës përpara masës së madhe të anëtarësisë së partisë që i mandaton dhe u delegon besimin e tyre për t’i drejtuar përpara dhe për të qeverisur me drejtësi në emër të tyre. Po ashtu, në rast të dështimit apo performancës së papërshtatshme të çdo lideri, anëtarësisë nuk i duhet të presë vendimet e forumeve të deleguara partiake, por nëpërmjet votës së tyre ata mund të zëvendësojnë këdo, që nga drejtuesi më i lartë në qendër e deri tek niveli më i ulët në bazë.

Unë besoj se kjo do ta bëjë LSI-në forcën politike më demokratike, më të avancuar dhe më të integruar në Shqipëri. Prandaj, kjo politikë e re synon që të krijojë në Shqipëri atë shtrat të qëndrueshëm të vlerësimit të çdo anëtari dhe të konvergimit të kontributit të gjithësecilit në një komunitet të madh dhe dinamik vlerash, diversiteti i të cilit e çon shoqërinë përpara dhe përbën garancinë kryesore për ndryshim.

Unë kam gjithashtu besim se koha kërkon angazhim dhe do të përfundoj komentin tim me një shprehje të një njeriu të mënçur që më ka mbetur në mendje: “në kohëra stresi dhe dhimbje njerëzit do të votojnë për të ndryshuar fatin e tyre”.

12 Sa e rëndësishme është një votë?

Jozefina Topalli (Çoba)

Demokracia nga vetë kuptimi i saj ka qënë një lëvizje drejt shpërndarjes nga pushteti i pak njerëzve tek një bazë gjithnjë e më e gjerë e tyre. Heqja e traditës fillestare në botë nga dhënia e një peshe më të madhe të votës së pronarëve të tokave tek një shkallë më e gjerë e tyre, heqja e kërkesës për të kaluar nga aftësia për të lexuar tek ushtrimi i të drejtës së votës për çdonjërin, e drejta e grave për votë etj., kanë qënë të gjitha lëvizje në drejtim të barazimit të pushtetit për të gjithë njerëzit. Praktika e sotme e votimit universal të të rriturve me “Një person, një votë” duhet parë si simbolika e deklaramit të principit të barazisë të pushtetit për të gjithë votuesit kur ata janë të destinuar të jetojnë së bashku nën një qeverisje të përbashkët, pavarësisht nga pasuritë e tyre, shkollimi, inteligjenca, rajoni, ngjyra, besimi fetar, gjinia, etj. Kjo vjen nga pohimi se njerëzit që jetojnë së bashku duhet të mbajnë kufijtë e pushtetit “së bashku” dhe të bëhen kështu të arsyeshëm, pavarësisht nga gara e konkurimi.

Pushteti nuk mund të trajtohet si dafinë (kurorë) që i jepet si shpërblim individëve më konkurrues. Ai është për t`u parë si një refren për t`u ndarë në mënyrë të barabartë. Ndërsa, deviacionet e sistemit pluralist në zgjedhjen e përfaqësuesve tek legjislativët dhe trupat e tjerë nga dëshira për një shpërndarjeje të drejtë e të njëjtë të pushtetit u njoh në Europë në mesin e shekullit XIX në fund të shekullit XIX, të gjitha vendet, me përjashtim të Britanisë së Madhe, Francës e ndonjë tjetër kaluan nga një formë në një formë tjetër të përfaqësimit proporcional si sistem elektoral. Sot 2/3 e vendeve në botë përdorin sistemin proporcional të zgjedhjeve.

Synimet e lëvizjeve më të mëdha në botë– ndryshojnë - nga format demokratike të qeverisë. Tipet e ndryshme të marksizmit, trockizmit, socializmit, anarkizmit, feminizmit dhe lëvizja liberale kombëtare, të ngritura kundër racizmit, imperializmit, kolonializmit, feudalizmit, dhe monarkive, kanë qënë emancipuar dhe frymëzuar nga të persekutuarit dhe të shtypurit e mëparshëm. Pra, të gjithë synonin zgjerimin e njohjes e të respektit tek të përjashtuarit e të shtypurit. Evolucionit i demokracisë ka

qënë në drejtimin e fuqizimit të të pafuqishmëve.

Por edhe këtu, pavarësisht parimit “Një anëtar, një votë”, gjërat nuk janë aq të thjeshta. Kjo së pari, për natyrën e sistemit elektoral. Kështu p.sh në zgjedhje kombëtare mund të kesh numrin më të madh të votave popullore, por zgjedhjet mund të fitohen nga krahu tjetër për shkak të sistemit. Jo në pak raste, deviacionet për shkak të sistemeve bëjnë që një votë në një zonë elektorale të ketë peshën e 3-4 votave në një tjetër zonë elektorale. Madje, nga lloji i sistemit varet edhe inkurajimi, mobilizimi apo jo i votuesit. Shpesh ndodh që p.sh të varfërit nuk votojnë sepse ata nuk gjejnë një shtëpi në një parti, dhe të tjerë sepse i mungon edukimi qytetar. Për disa, intensiteti politik është si intensiteti religjioz.

Në fakt, votimi është një sjellje e mësuar. Qytetarë të rritur nga prindër që kanë votuar rregullisht ka më mundësi që të bëhen votues të rregullt. Dhe, zakonisht, aktivistët partiakë nga të gjitha anët do të votojnë, sipas grupeve të anëtarësisë dhe do të inkurajojnë votimin. Për shumë qytetarë, votimi është më shumë detyrë se ritual, por, një evolucion më fundamental duhet të avancojë nëse votimi përdoret si një indikator i legjitimitetit të një demokracie që përmirësohet. Zëri i atyre, që nuk votojnë flet për mungesë herojsh apo ikonash në kampin politik; kjo nuk justifikohet. Po ashtu ata që nuk votojnë shprehin edhe mungesë besimi ndaj procesit elektoral dhe atij politik.

Problemet dhe debatet e lidhura me procesin politik elektoral të një vendi shkojnë paralel me vetë sistemin e zgjedhjeve brënda partive. Kështu, p.sh në qoftë se zgjedhjet në shkallë vendi kanë si motër kongresin në jetën elektorale partiake, Parlamenti si trup i përfaqësimit popullor ka këshillin Kombëtar tek Partitë politike. Ky këshill kombëtar del nga votimi prej delegatëve të kongresit. Po ashtu qeveria (ose ekzekutivi) në strukturën e shtetit ka analogen e vet tek kryesia e partisë (në strukturën partiake). Kjo kryesi zgjidhet nga këshilli kombëtar, ashtu si qeveria zgjidhet nga parlamenti.

Kryetari i qeverisë ka analog në strukturën partiake kryetarin e partisë. Këtu analogjia devijon sepse kryeministri zgjidhet nga parlamenti, kurse kryetari i partisë nuk zgjidhet nga këshilli kombëtar, por nga kongresi. Për t’i shkuar në mënyrë të vërtetë parimit “Një anëtar, një votë” në fakt ndryshimi duhet bërë në të dy anët. Si në sistemin elektoral që përdorim për zgjedhje politike në shkallë vendi, po ashtu edhe brënda partisë. Më afër së vërtetës e dimë që është sistemi propocional (që gjithashtu ka nënsistemet e tij, variante e formula të pafundme).

Po ashtu në zgjedhjet brënda partisë, kongresi në vetvete është një përfaqësi, vërtetë e votuar, por gjithsesi është delegim. Për kushtet e

vendit tonë, për mungesën e traditës e një sërë arsyesh të tjera nuk është e thjeshtë të mundësohet që çdo anëtar partie të votojë direkt për kryetarin e partisë dhe forumet drejtuese.

Megjithatë, është shumë e rëndësishme që të fillojmë të punojmë për ta bërë të mundur, të paktën, për kryetarin e partisë. Kjo ka shumë anë pozitive. E para kryetari do të marrë një mandat vërtet shumë të fortë, dhe po aq të vërtetë. E gjithë fushata, do bëjë të mundur një zgjim e mobilizim të të gjithë strukturës. Secili prej anëtarëve do të ndjejë përgjegjësinë e rëndësinë e votës së tij. E gjitha është edhe një ushtrim gjimnastikor fantastik i bazës dhe një ndërgjegjësim për rëndësinë e secilit anëtar. Ndërsa përsa i takon zgjedhjes së forumeve të tjera mendoj se edhe kryetari i besuar duhet të ketë të drejtën e mundësinë e përzgjedhjes së ekipit me të cilin dëshiron të punojë. Natyrisht kjo ka hapësirë për debat.

Në këtë ndërmarrje fushate partie, vetë partia duhet të ketë një regjistër korrekt anëtarësie. Po ashtu çdo anëtar duhet të ketë një kartë anëtarësie me elementët e sigurisë. Kjo, që për shumë vende të tjera është krejt normale, tek ne është një luks (në dukje). Në të vërtetë kjo s'është bërë e mundur as për qytetarin e thjeshtë për votimet vendore e politike. Megjithatë, kjo s' duhet të na dekurajojë. Edhe në qoftë se ky lloj parimi i aplikuar mund të gjejë shumë defekte në zbatim – e rëndësishme është të fillojmë nga puna. Në fund edhe vetë debati është një ushtrim intelektual.

Sa e rëndësishme është një votë?

Shumë qytetarë shpjegojnë mosvotimin e tyre duke thënë: “ Unë jam vetëm një person, dhe vota ime e vetme nuk ndryshon asgjë”

Por në fakt :

- Thomas Jefferson dhe John Quincy Adams, secili u zgjodh president vetëm me 1 votë në zonat elektorale.
- Me 1 votë Texas hyri në Bashkim më 1845
- Me 1 votë u bë e mundur që Kalifornia, Oregon dhe Washington të pranoheshin në Statehood.
- Një votë shpëtoi presidentin Andrew Johnson nga fajësimi në 1868
- Në 1876, me zgjedhjen presidenciale të kthyer në kongres, Rutherford B. Hayes fitoi me një votë të vetme, të dhënë nga kongresmeni i Indianës, ku vetë ai ishte zgjedhur vetëm me një votë.
- Një votë ndaj kufirit, bëri që të kalojë e drejta e grave për votë në Kaliforni në 1911.

- Një votë bëri Tennesse-në Shtetin e 36-të që ratifikoi amendamentin e 19 të Kushtetutës Amerikane që i jepte grave të drejtën e votës në 1920.
- Një votë shpëtoi Shërbimin Sekret nga eliminimi në 1941, vetëm një javë para sulmit të Pearl Harbor.
- Marzhi i fitores së John F. Kennedi mbi Niksonin në 1960 është më pak se 1% të votës.
- Një ndryshim i 1% të votave në 3 shtete do kishim bërë Aubert Humphrey president në vend të Richard Nixonit në 1968.
- Nga votuesit në 1980, 22% votuan për Jimmy Karter, 27% për Ronald Reagan, ndërsa 46% thjeshtë nuk votuan.

Këta shembuj, vetëm për SHBA flasin më shumë se çdo shkrim apo libër. Unë besoj se të gjithë në parim bien dakord se çdo opinion personi duhet të ketë të njëjtën peshë në çështjet e rëndësishme publike, përcaktuese. Sot ka një debat të madh edhe për teknologjinë kompjuterike. Kjo bën të mundur që votuesit të shohin në kohë reale se si rezultatet elektorale po progresojnë. Mendoj se përdorimi i një feedback-u të tillë i lejon votuesit të ndryshojnë në përgjigje të rezultatit (në kundërshtim me metodat tradicionale, ku pasi votohet, vota nuk ndryshohet).

Kështu, ky lloj votimi në parlamentin tonë ka bërë, që të vendoset përmes ndryshimit të votës, për shumë vendime të rëndësishme. Kjo hap një tjetër debat. Me të gjitha sistemet, me të gjitha devijimet, gjithsesi ushtrimi i të drejtës së votës është një ndër aktet më fisnike që ka një qytetar. Kjo e drejtë e shenjtë bën secilin prej nesh më përgjegjës për liderat tanë. Dhe, në qoftë se një vend ka zyrtarë jo të mirë, këta janë zgjedhur vetëm nga qytetarët e mirë që nuk kanë votuar. Pavarësisht nga të gjitha, demokracitë do të vazhdojnë të mbajnë zgjedhje dhe do t'i kërkojnë qytetarëve që të votojnë, për të përcaktuar politikat për të gjithë. Vështirësia me të gjitha sistemet e votimit mbetet për faktin se matematikisht çdo njëri mund të tregojë se nuk ekziston asnjë sistem tërësisht i kënaqshëm.

13 Një anëtar, një votë

Disa konsiderata të përgjithshme

Sabri Godo

Në epokën tonë ndryshimi i regjimeve të kundërta mund të ndodhë në periudha fare të shkurtra për shkak të faktorëve të jashtëm, siç janë luftrat, por edhe nga evolucione të brendshme të vrullshme e të befta. Në rastet e dyta mund të jetë decisive rënia fizike e diktatorit që zakonisht shoqërohet me rënien e diktaturës në tërësi. Shembja me luftra e diktaturave fashiste dhe shembja e diktaturave komuniste me evolucione të brendshme, provon se kalimi nga diktatura në demokraci në kohën tonë mund të arrihet në pak vite. Shpesh na thuhet se proceset demokratike në Angli, France, SHBA etj. janë zgjatur në shekuj, prandaj ne shqiptarët duhet të bëjmë më tepër durim. S'mund të bie dakord me një mendim të tillë, kur sjell ndërmend historinë botërore të viteve të fundit. Natyrisht çdo rregull ka një përjashtim, si p.sh. Korea e Veriut.

Demokracia në Shqipëri mund dhe duhej të ishte zhvilluar më shpejt. Forcat politike që qeverisën vendin në këta 14 vjet e ngadalësuan procesin. Thuhet se klasa politike është produkt i shoqërisë dhe s'mund të gjykohet e shkëputur prej saj. Pra, ishte vetë shoqëria shqiptare që e ka penguar procesin. Kjo llogjikë s'mund të hidhet poshtë tërësisht, po edhe s'mund të pranohet deri në fund. S'mund të biem në lojën e fjalëve “pula bën vezën dhe veza bën pulën”. Realiteti i 14 viteve të fundit, sipas meje, provon se shoqëria shqiptare ishte dhe është më e emancipuar se politika. Në vitin 1992 shqiptarët votuan mbi 70 përqind për demokracinë me vendosmëri e qartësi. Thirrja “të shkojmë në Europë” ishte gati unanime. Partia Demokratike që mori pushtetin, nuk përfitoi nga kjo rrethanë, nisi të deformonte demokracinë dhe solli zhgënjimin duke u dhënë revanshin kundërshtarëve politikë. Por socialistët filluan të shpërdorojnë pushtetin e të deformojnë demokracinë edhe më fort nga sa bënë demokratët në kohën e tyre. Shtatëdhjet përqind e shqiptarëve janë shkëputur nga këto forca politike, gjë që u provua në disa zgjedhje të pjesshme të vitit të kaluar.

Nga këta faktorë, më lind e drejta të them se shoqëria shqiptare është më e emancipuar se klasa politike që ka prodhuar ajo vetë aksidentalisht dhe nuk po gjen rrugën për të dalë nga ky rreth vicioz. Rrugëdalja e vetme është të zbatohet kriteri bazë i demokracisë “Një anëtar, një votë”. Mënyra më e thjeshtë do të ishte që kjo të ndodhte së pari në vetë partitë politike e të transplantohet pastaj në elektoratin në tërësi, ose këto parti të shkojnë drejt likuidimit për t’ua lënë vendin forcave politike të reja.

Rruga e gabuar e zhvillimit të partive

Identiteti politik i partisë, statuti që rregullon jetën e brendshme dhe ndërtimi strukturor janë tre elementët përcaktues të ekzistencës dhe zhvillimit të saj. Asnjë nga partitë politike në shqipëri nuk i përmbush këto kriterë sipas standardeve perëndimore.

Në momentin e krijimit të tyre partitë zgjedhën orientime dhe emërtime që përputheshin në mënyrë të mjegullt me prirjet e nismëtareve. U hartuan edhe programe të huazuara nga partitë homologe europiane. Por shumëshpejt programet u kaluan në harresë. Antikomunizmi radikal ose antikominizmi më i zbutur që shënonin në vitet e para kufirin ndarës, humbën peshë. Programet dhe ideologjitë u zëvendësuan nga lufta e ashpër për pushtet, “e djathta”, “e majta”, “qendra”, me ndonjë përjashtim, sot janë artifice pa përmbajtje.

Statutet e partive, që gjithashtu u huazuan nga homologet e pretenduar europiane, u keqpërdorën nga drejtuesit. Hapi i parë ishte të hiqeshin kufizimet në kohë në rizgjedhjen e kryetarëve dhe sekretareve. Kryetarët e partive morën në dorë përzgjedhjen e shefave lokalë të partisë, deputetëve e ministrave. U hoq parimi i ndarjes së pushtetit partiak me atë shtetëror, manipulimi u shtri deri në përzgjedhjen e delegatëve në konferencat lokale e të kongreseve. Asgjësimi në praktikë i statuteve ose përdorimi i tyre vetëm në raste kur u intereson shefave, i dha fund demokracisë së brendshme të partisë duke i lënë rrugë të lirë nepotizmit, klientelizmit dhe servilizmit.

Ndërtimi strukturor i partive ndoqi modelet e ish partive komuniste duke ndryshuar vetëm emërtimin e formave. Ky ndërtim vertikal i centralizuar, që provon se s’kemi dalë shëndosh e mirë nga komunizmi, pengon vetëveprimin individual të anëtarit të partisë dhe organizmave lokale që rrinë në pritje të udhëzimeve nga lart. E gjitha kjo do të çonte doemos në humbjen e vitalitetit politik të partive dhe në dobësimin përherë e më tepër të lidhjeve me elektoratin. Partitë mbahen në këmbë kryesisht

nga veprimtaritë politikë në qendër. Fryn erë vetëm në majat e drurëve kurse pylli poshtë mbetet i patrazuar. Nëse aty këtu shfaqet ndonjë nismë lokale ajo vihet menjëherë nën kontrollin e qendrës. Zhvillimi i partive, siç e parashtrova më lart çoi në praktikë në eliminimin e parimit “Një anëtar, një votë”.

Fraksionizimi i partive dhe i politikës në tërësi

Individë e grupime që nuk mund të durojnë më gjatë atmosferën brenda partive, zunë të shkëputen ose edhe të dalin si parti më vete. Nganjëherë këto kanë ndodhur edhe thjesht për arivizëm. Nga PD janë shkëputur katër grupime që u shpallën si parti më vete, nga PSD tre grupime e kështu më tej. Në PS ndodhi ndryshe; që në fillim u shkëputën prej saj disa grupe që krijuan tre – katër parti komuniste, kurse çarja e madhe e PS po ndodh tani, me krijimin e LSI të Metës. Mosbesimi i qytetarëve te partitë dhe prirja e trashëguar e shqiptarëve për bajraktarizëm çuan në fraksionizimin e politikës në tërësi, në krijimin e 65 partive, të shumtat inekzistente, por që gjithësesi shtojnë çoroditjen. Megjithatë politika në këta katërmbëdhjetë vjet është dominuar plotësisht nga dy partitë e mëdha, me disa satelitë përreth vetes, që diku u hapin edhe telashe.

Mbi procesin elektoral

Demokrati do të thotë respektimi i votës së individit, si baza e marrëveshjes qytetare për qeverisje të përbashkët. Duket se tek ne, për të arritur këtë objektiv jetik, behet luftë prej 14 vjetësh. Kjo është vetëm në sipërfaqe. Kushti kryesor i partive është marrja e pushtetit, qoftë edhe me manipulimin e votës dhe kontestimit e zgjedhjeve, si alibi për humbjen. Aktualisht debatohet për infrastrukturën zgjedhore, kodin elektoral, KQZ listat etj. Këto kanë rëndësi, por primare mbetet manipulimi brutal me para e presione gjatë procesit zgjedhor, e sidomos në numërimin e votave. Manipulimi që shkatërroi zgjedhjet nga viti 1994 e mbrapa, përjashtroi popullin nga qeverisja dhe i la rrugë të lirë tiranisë politike të një partie të vetme, që vë nën kontroll jo vetëm legjislativin dhe ekzekutivin por edhe sistemin gjyqësor. Kjo prishje e simetrisë së pushteteve çon nga pak e çdo ditë në shkatërrimin e shtetit të së drejtës, në anarkinë institucionale dhe në sundimin pa kushte të individit, e shoqëruar me rritje galopante të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Përfundime

Ne po bëjmë përpjekje të dhimbshme e të pasigurta për të vendosur parimin “Një anëtar, një votë”, që është kushti themelor i demokracisë në çdo kohë e në çdo vend. Mendoj se për të arritur këtë objektiv, në kushtet tona, duhet të përqendrojmë përpjekjet në disa drejtime të caktuara:

- Të arrihet ndërgjegjësimi qytetar se vota e lirë është i vetmi mjet për të kufizuar caqet e pushtetit, për të hequr qafe të këqiat që na rëndojnë dhe për t’i hapur rrugën progresit.
- Partitë politike s’kanë kuptimin e saktë të rolit të votës së lirë, të kohës që jetojmë dhe të asaj që janë duke bërë. Është koha që shoqëria civile të shumëfishojë përpjekjet e veta në mbrojtje të votës së lirë. Tashmë kjo luftë s’mund të jetë monopol vetëm i partive politike. Megjithatë demokratizimi i partive përsëri duhet parë si mjeti më i shpejtë e më efektiv për vendosjen e parimit “Një anëtar, një votë”.
- Liria e individit dhe vota e lirë garantohet me Kushtetutë. Duhet një fushatë e gjithanëshme dhe e pandërprerë që qytetarët të njohin kushtetutën dhe ta përdorin atë.
- Pluralizmi parlamentar është domosdoshmëri për një vend me demokraci të pastabilizuar. Kodi zgjedhor duhet të përkrahë praninë e tetë-dhjetë partive në parlament dhe të disiplinojë hyrjen në fushatë të partive që praktikisht s’kanë elektorat.
- Të luftohet abstenizmi. Vota është përgjegjësi individuale që s’mund të lihet në duar të të tjerëve, sidomos kur ke të besh me duar të pista. Të jesh shtetas e jo nënshtetas.
- Të zhduket manipulimi i votës, me përpjekjet e vetë votuesit dhe duke përcaktuar në kodin elektorat penalizime të rënda për manipulimet në të gjitha nivelet e strukturave zgjedhore.
- Mendoj se duke ecur në drejtimet që permenda më lart, do të arrihen rezultatet e kërkuara në zbatimin e parimit “Një anëtar, një votë”.

14 Një anëtar, një votë një tjetër (r) evolucion demokratik

Genc Pollo

Nëse pyet ata opinionistë që më së shpeshti komentojnë në media zhvillimet politike në vend pothuaj të tërë do të pohojnë se politika është në krizë dhe se politikanët janë të shkëputur nga populli. Nëse pyet njerëzit në kafene për politikën jo rrallë të përgjigjen me një shprehje sa të vjetër aq edhe vulgare. Nëse pyetet ndonjë kryetar bashkie, i ri në detyrë se çfarë lloj politikani është ai, përgjigja e tij shpesh thotë se ai nuk është politikan por “administrator”, ose “qytetar i zgjedhur” etj. Madje kam hasur edhe deputetë që broçkullisin naivitete të tilla. Më shqetësuese akoma, në se shihet pjesëmarrja në votime nga mesi i viteve 90 e këtej, vihet re një rënie e vazhdueshme që së fundi ka prekur shifrën 50%.

Pra ka një problem real të funksionimit të politikës pluraliste në Shqipëri. Më së shumti ai shprehet në përqendrimin thuajse absolut të shumicës së politikanëve në çështjet e pushtetit dhe të përfitimeve individuale që rrjedhin prej tij si dhe një luftë politike shume e personalizuar dhe minimalisht e tematizuar që haptazi synon marrjen e pushtetit ose mbajtjen e tij dhe shumë pak më tepër se kaq. Kush kujton fillimet e pluralizmit politik krahas rrëzimit të regjimit komunist kujton edhe optimizmin apo gati euforinë e atyre muajve. Që të ketë rënie të këtyre ndjenjave nuk është e papritur pasi kjo ndodh gjithmonë kur gjerat bien në shtratin e normalitetit. Për më tepër që shumë shpresa të asaj kohe ishin jorealiste.

Por hendeku i sotëm është një problem i madh, i dukshëm dhe i preکشëm. Shkaqet mund të jenë të shumta por mendoj se arsyeja themelore për distancën e krijuar midis debatit e luftës politike në Tiranë dhe njerëzve të thjeshtë është mosfunksionimi si duhet i mekanizmave demokratike të kontrollit, ku ai i zgjedhjeve parlamentare, megjithëse i pazëvendësueshëm është i rrallë e i mangët për të qenë efektiv. Një gjendje e tillë ushqen cinizmin e negativizmin, dekurajon aktivizmin qytetar dhe në fund të fundit dobëson pjesëmarrjen, elementin themelor

të demokracisë.

Në një pjesë të madhe janë partitë politike që vuajnë nga sindroma e deficiencës së mekanizmit demokratik të kontrollit dhe në një shkallë të lartë përgjegjëse për këtë *malaise* e krijuar në shoqërinë shqiptare. Në mungesë të një tradite demokratike të konsoliduar dhe me institucione të dobta e të kontrolluara nga individët edhe shkalla e përfaqësimit, e bashkë me të shkalla e legjitimitetit, filloi të bjerë në partitë politike të pasvitit 1991. Sot në plot raste mund të flitet për *party capture*, për zaptimin e forcës politike nga një klan i dominuar nga shefi partiak e përkrahësit e tij; klan i ngjizur jo nga ideja e përbashkët por nga mbrojtja e përbashkët e interesave vetjake. Kjo çon në atë që në vendimmarrjen politike që nga caktimi i kandidatëve në zgjedhje deri tek hartimi i kontratave publike gjithmonë e më tepër ndikon përfitimi imediat pasuror se sa një interes më i gjerë publik. Dhe dëmi më i madh që sjell një situatë e degjeneruar kësaj nuk është ai ekonomik. Dëmi fatal që mund të shaktohet është erozioni i vlerave të cilat nuk janë nocione abstrakte.

Përkushtimi për të shërbyer, ndershmëria në fjalë, toleranca për tjetrin janë vlera që në rast erozioni zëvendësohen me pasionin për të zhvatur, gënjeshtren sa herë lipset e pastrimin për të padëshëruarit. Kriza e vlerave ka pasoja imediate në krizën e përfaqësimit. Kur një qeveri apo legjislaturë merret vetë me punët e veta personalo-familjare dhe harron ata që e kanë votuar, ata që paguajnë taksa dhe thjesht të tërë ata që jetojnë në këtë vend atëherë fjala përfaqësuese humbet kuptimin e saj. Sa më sipër shpresoj se jep një përshkrim objektiv i gjendjes së jetës politike në vendin tonë. Shumë mund të argumentojnë me të drejtë si konstatime e analiza të tilla janë bërë me shumicë dhe ne na nevojiten kryesisht projektimi i rrugëzgjidhjeve dhe realizimi i tyre. Ky besoj është tehu që ndan politikanët me vizion e vullnet pozitiv nga ata që janë degradues të ketij zanati, i cili mund të mos jetë më i vjetri i botës por që sigurisht është ndër më të rëndësishmit e saj. Së pari duhet të jemi të qartë se asgjë nuk zgjidhet duke sharë politikën e duke u larguar prej saj. Të gjithë duhet të kemi parasysh se në një shoqëri e në një shtet çështjet e rëndësishme dhe kursi për çështje të mëdha e të vogla vendoset nga politikanët. Pa përjashtuar aktorë të tjerë shumë të rëndësishëm në çdo rast fjalën e fundit e ka ekzekutivi ose legjislativi të cilët, në një mënyrë ose një tjetër, përcaktohen nga vota popullore. Prandaj është një iluzion, madje në rrethanat e Shqipërisë një iluzion i rrezikshëm, të pohosh se “ më mirë jam larg politikës”.

Disa studiues mendojnë se pjesëmarrja e ulët në votime në SHBA apo

Britani lidhet me një përshtypje të elektoratit të atjeshëm se situata është e stabilizuar dhe rezultati i votimit nuk ndikon edhe aq e nuk prek jetën e përditshme. Nuk mund të them sa e vërtetë është për të tilla vende por më duhet të shpreh një bindje se në Shqipëri politika ndikon shumë më tepër se sa në një vend të Perëndimit. Prandaj është e përciptë të thuash se jam mirë larg politikës sic është mediokër apeli i disave për një distancim total nga politika dhe abstenimi masiv në ditën e votimit. “Nëse nuk merresh ti me politikë atëhere merret ajo me ty” thoshte personaliteti i shquar italian i pasluftës Pietro Nenni. D.m.th që në qoftë se shmangim veten nga vendimmarrja politike kjo do të bjerë në të tjera duar. A kemi besim se janë më të mirat? Jo dhe aq. Madje në Shqipëri me siguri që jo. Pra gjithçka duhet bërë që hendeuku, për të cilin folëm, të ngushtohet e të bëhet i kapërcyeshëm.

Në këtë përpjekje elementi i parë e madhor janë partitë politike. Ato janë nyja lidhëse midis shoqërisë aktive dhe shtetit. Ato janë gjithashtu edhe shinat e politikës pluraliste. Nëse kemi parti të cilat dëgjojnë anëtarësinë e tyre, janë të ndjeshme ndaj opinionit publik atëhere kontakti rivendoset, shkëmbimi gjallërohet e besimi ringjallet. Prandaj reformimi i partive politike shqiptare që synon shndërrimin e tyre në forume debati të ideve politike e të alternativave programore ku merr pjesë e i dëgjohet zëri anëtarësia partiake është receta më e mirë për këtë gjendje.

Në përvojën e Partisë Demokratike të Re një përpjekje e tillë u bë duke duke stimuluar e mbrojtur diversitetin e mendimit, të rrymave e të fraksioneve. Madje u aplikuan edhe formula staturore që në votimin e anëtarëve për në forumet drejtuese garantonin që një maxhorancë absolute të mos të mund të përjashtonte përfaqësimin e minorancave. Kjo formulë e re u testua në kuvendin partiak të vitit 2002 ajo ishte përgjithësisht jo fort e njohur për delegatët. Për më tepër që atëherë por deri diku edhe sot nuk mund të flasësh për fraksione të mbështetura në platforma. Sidoqoftë vullneti i mirë politik prodhoi një mekanizëm, i cili ndonëse nuk i dha menjëherë frytet e tij mund të shtrojë rrugën për zhvillime pozitive nesër.

Në 15 qershor 2003 në mbledhjen e kryetarëve të PDR u prezantua, debatua dhe u përkrah zbatimi i parimit “Një anëtar një votë”. Një muaj më vonë Këshilli Kombëtar i partisë e miratoi atë duke i hapur rrugë zbatimit. Një parim i tillë ka qenë propaganduar që herët nga z Aleksandër Meksi (kryeministër në vitet 1992-1997) .

Argumente në favor të tij janë hedhur edhe nga të tjerë personalitete publike dhe së fundi janë pomovuar aktivisht nga NDI, që po zbaton një

projekt për zhvillimin e partive politike në vendin tonë. Në fakt paraleli më i rëndësishëm i parimit një anëtar një votë është një qytetar një votë dhe mbi të bazohen të gjitha demokracitë moderne. Ishte forca e këtij parimi që 15 vjet më parë hoqi monopolin e pushtetit nga anëtarët gjysmë të rrjedhur të Byrosë Politike të PPSH. Të gjitha kundërshtimet që mund t'i bëhen sot zbatimit partiak të parimit “Një anëtar, një votë” mund të gjejnë paralelen e tyre tek kundërshtimet e udhëheqjes së PPSH në vitin 1989-90 për zgjedhje të lira e pluralizëm. Për PDR forcë shtytëse për këtë nisëm ishte pikërisht vullneti për të mos rënë në amullinë e njohur partiake dhe në një capture të forcës politike. Po aq fort ndikoi edhe nevoja për të institucionalizur një raport të ri me anëtarësinë dhe, shpresoj, me elektoratin.

Ky parim i jep mundësinë çdo anëtari të thjeshtë të partisë të jetë bashkëvendimmarrës në çështjet e mëdha partiake. Vota e secilit prej tyre do të peshojë si në rastin e përzgjedhjes të udhëheqësve të partisë ashtu edhe në përcaktimin e qëndrimeve politike kryesore. Nëpërmjet këtij mekanizmi secili antëtar i partisë nuk e ndjen veten thjesht një të regjistruar apo thjesht një kontributpagues por një zë që dëgjohet deri në majë. Nëpërmjet votës së çdo anëtari do t'i mbyllet rruga favoritizmit të klaneve brendapartiake që kanë asfiksuar demokracinë elementare brenda shumëpartive politike. Nëpërmjet këtij mekanizmi shpresoj të dinamizohet jeta e brendshme partiake e do të gjallërohen aktivitetet dhe ç'është më kryesorja do të spostohet debati tek platformat, idetë, alternativat dhe tek personat e lidhur me to pa e kthyer në një kopje madhore të kongreseve me planifikim. Nëse është e vërtetë se demokracia bazohet në bindjen se njerëzit e zakonshëm kanë cilësi të jashtëzakonshme atëherë parimi “Një anëtar një votë” përbën një hap madhor të saj.

15 Pa zgjedhje demokratike në parti nuk ka zgjedhje demokratike në Shqipëri

Gaqo Apostoli

Sot kryefjala e ditës e gjithë shoqërisë shqiptare është mungesa e standarteve demokratike për zgjedhje të lira dhe të ndershme, që ka çuar në kontestimin e vazhdueshëm të tyre nga organizmat dhe institucionet ndërkombëtare që monitorojnë Shqipërinë. Akuza reciproke për manipulim tërësor apo pjesor të zgjedhjeve parlamentare dhe lokale në vite kanë bërë të gjitha partitë pjesëmarrëse në to dhe sidomos binomi konfliktual PS & PD, që synon respektivisht të mbajë apo fitojë me çdo kusht pushtetin qeverisës. Lind pyetja: Cila nga partitë ka të drejtë në akuzat që i drejton tjetrës për parregullsi të mëdha dhe manipulim të procesit zgjedhor?

Përgjigjja është fare e thjeshtë: Të gjitha partitë kanë të drejtë në akuzat që i drejtojnë njëra tjetrës, sepse e gjithë politika shqiptare është e akuzuar dhe përgjegjëse për mungesën e standarteve demokratike për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kjo për faktin se brenda vetvetes, politika shqiptare, tërë partitë politike, nuk zbatojnë standartet demokratike në jetën e tyre të brendshme, në zgjedhjen dhe veprimtarinë e forumeve drejtuese dhe të leadershipit. Dhe kur këto standarte nuk zbatohen në vetë partitë politike, që duhet të jenë bashi i tërë veprimtarisë së shoqërisë, është e vështirë deri në pamundësi që ato të zbatohen në një shoqëri që aspiron demokracinë, sipas një logjike gati elementare: Pa zgjedhje demokratike në parti nuk ka zgjedhje demokratike në shoqëri.

Për Shqipërinë kjo është e evidente, që do të thotë se në këtë kohë të re të demokracisë dhe të pluralizmit, dita – ditës po shkërmoqen autokracitë politiko-qeverisëse, tërë politika shqiptare ka rënë në një ‘gropë potenciale’ nga e cila nuk mund të dalë vetëm me energjitë e mbetura , gati të shterruara të saj, tërë partitë politike të ndodhura në krizë totale vërtiten në një rreth vicioz duke mos prodhuar asgjë, përveçse demagogji dhe konflikt.

Dalja e politikës shqiptare nga ky rreth vicioz , nxjerrja e saj nga kjo

“grupë potenciale”, kërkon kombinimin e energjisë së mbetur brenda sistemit politik me energjitë jashtme të pjesëve të evidentuara të shoqërisë, ndaj së cilës ky system politik, forumet drejtuese dhe lidhshipi i tij ka qenë i mbyllur, gati hermetik, pa një komunikim të vazhdueshëm luajal, duke mos konsideruar këtu rekrutimet kompromentuese të elementëve të shoqërisë civile nga politika qeverisëse. Ky kombinim energjish do të mund të realizojë ridimensionimin e gjithanshëm politik dhe organizativ të politikës shqiptare, në rradhë të parë reformimin e tyre për të rritur parametrat dhe të solidaritetit në parti.

Në këtë kuptim do të konsideroja tepër të rëndësishëm konceptimin e partive si institucione publike që prodhojnë politikë për drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë, si pasuri që nuk mund të privatizohen, por që i jepen për menaxhim të përkohshëm një lidhshipi të zgjedhur në mënyrë demokratike. Mbi këtë konceptim do të duhet të nënvizionim se elementët apo kriteret thelbësore që përcaktojnë zgjedhjen e lidhshipit të partisë në cdo nivel të saj, qëndror apo lokal, janë:

- Zgjedhja e lidhshipit nga anëtarësia ndërmjet kandidaturave alternative;

- Transformimi i forumeve të partisë si Kryesi, Këshill Drejtues, Konferencë, Kongres etj në tribuna të mendimit të lirë politik të anëtarëve të tyre, për të evidentuar dhe seleksionuar politikën e vjetëruar dhe mbartësit e saj dhe për ta zëvendësuar me politika të reja zhvillimi;

- Realizimi i procesit të votimit përmes një infrastrukture demokratike të besueshme që shmang manipulimin;

Në sintezë, këto kriterë thelbësore përbëjnë parimin madhor të demokracisë direkte në veprimtarinë e partisë që shprehet në mesazhin: “Një anëtar, një votë”. Ky mesazh gjithnjë e më tepër po sensibilizon opinionin e gjërë publik për domosdoshmërinë e reformimit të partive politike shqiptare për të rritur parametrat e demokracisë në jetën e tyre të brendshme. Ky opinion publik po fiton një shkallë gjithnjë e më të lartë ndërgjegjësimi për reformimin e partive, duke kërkuar ndryshimin e politikës shterpë të partive dhe të lidhshipit konfliktual të tyre. Ndërsa vetë lidhshipi i sotëm politik e citon vetëm si një slogan këtë kriter kompleks demokratik sepse nuk është i gatshëm t’i përgjigjet kësaj kërkesë të kohës dhe të opinionit publik për një hapje të dymë të blinduara të politikës ndaj anëtarësisë dhe në tërësi ndaj shoqërisë, sepse kërkon ende të ruajë monopolin e kësaj politike për interesa personale dhe klanore, duke vazhduar të ruajë një shkallë të lartë hermeticiteti në vendimarrjet më të rëndësishme brenda partive politike.

Le t’i referohemi për këtë qëllim Partisë Socialdemokrate (PSD), si

forca e tretë politike në Shqipëri dhe në përgjithësi si një forcë moderatore dhe e ekuilibruar në politikën shqiptare. PSD gjatë muajve Shtator-Tetor 2004 po zhvillon konferencat e degëve të saj në rrethet e vendit për të mbërritur në Kongresin e saj të 4-ët në 13-14 Nëntor 2004. Për këto veprimtari u miratuan në Këshillin Drejtues Kombëtar të PSD modalitete procedurale ku qartësisht përcaktohet gjithëpërfshirja e anëtarësisë në konferencat e n/degëve të partisë në komuna, bashki dhe rajone të qyteteve të mëdha, ku vendimarrja të realizohet sipas parimit: “Një anëtar, një votë”. Sipas këtyre modaliteteve edhe në Konferencat e degëve të PSD në rrethe synohet pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të kartelizuar të partisë për vitin 2004. Gjithashtu konkurimi për lidhshirin e degës së PSD në rreth të përcaktohet me votim të fshehtë dhe konkurrim alternativ. Por si janë zhvilluar 25 konferencat e para të degëve të PSD (mbi dy të tretat në shkallë vendi), duke iu referuar modeliteteve procedurale të miratuara?

Numri i delegatëve në konferenca varion nga 45 deri në 100 pjesëmarrës, që tregojnë për një numër të reduktuar në raport me anëtarësinë e degës. Pra, në konferencat e degëve të rretheve të vogla marrin pjesë jo më shumë se 1 në çdo 4 anëtarë; në ato të rretheve të mesme jo më shumë se 1 në 6 anëtarë dhe në konferencat e degëve të rretheve të mëdha marrin pjesë jo më shumë se 1 në 8 apo 9 anëtarë. Kjo tregon se vendimarrja dhe zgjedhja e lidhshirit të partisë është shumë larg parimit “Një anëtar, një votë”.

Për sa më lart, del në konkluzionin se edhe konferencat e n/degëve të PSD në komuna, bashki dhe rajone qytetesh janë zhvilluar me mangësi të theksuara deri në falsitet. Për këtë mjafton t’i referohesh konferencave të n/degëve të minibashkive të Tiranës si dhe degës së qytetit Tiranë, të cilat kanë rezultatin më të dobët të PSD në Shqipëri dhe duke “i fshehur” pjesëmarrjes së plotë të anëtarësisë për gjykim dhe zgjedhje të lidhshirit sipas parimit “Një anëtar, një votë” përmes kandidaturave alternative. Drejtuesit, në këtë rast janë përpjekur të rifitojnë mandatin nëpërmjet kulisash, jashtë vullnetit të plotë të tërë anëtarësisë.

Nga 25 konferenca të degëve të PSD në rrethe në vetëm 3 prej tyre u zhvillua votim për lidhshir me kandidatura alternative. Mungesa e kandidaturave konkurruese ishte prezente në mjaft degë me rezultate të ulëta elektorale dhe ku kryetarët kanë nga 2-3 mandate që drejtojnë degën. Kjo tregon jo vetëm për krizë të lidhshirit të degëve por edhe për një personalizim apo klanizim të PSD, që kohët e fundit inspirohet edhe nga nivele qendrore që kanë krijuar një sinkronizim në këtë proces personalizimi të PSD. Po vihet re që shpesh, gjoja mungesa e infrastruktures për zbatimin e parimit “Një anëtar, një votë” po përdoret

si një justifikim për të mos iu nënshtruar gjykimit të tërë anëtarësisë në zgjedhjen e liderit të partisë, i cili nga ana tjetër inspiron asgjësimin e alternativës në konkurrim, me pretekstin se përçahet partia, kur është krejtësisht e kundërta: konkurimi i ndershëm me kandidatura alternative, rrit vlerat dhe energjitë e partisë.

Zbatimi i parimit madhor të demokracisë direkte “Një anëtar, një votë” do të ndeshë vazhdimisht barriera të forta të lidhshpimit ekzistues të politikës shqiptare, të cilët mbartin reminishenca të totalitarizmit dhe autokracisë dhe nuk e dësherojnë realisht zbatimin e këtij parimi sepse humbasin paketën e kontrollit mbi drejtimin e partisë. Ata dëshirojnë të zgjatin jetën në drejtimin e pushtetit politik përmes përfaqësuesve të anëtarësisë, të të ashtuquajturve delegatë, duke synuar që përmes manipulimesh e kulisash politike, mundësisht t’i emërojnë këta delegatë në mënyrë që të kontrollojnë pushtetin. Kjo do të thotë që Shqipëria nga sistemi 50-vjeçar i Njëshit pesëdhjetëvjeçar, ka kaluar në sistemin e Njëshave shumëvjeçarë prej të cilëve vazhdon të mbahet peng.

Sidoqoftë, sipërmarrja politike për zbatimin e parimit “Një anëtar, një votë” është një mision i rëndësishëm. Përmes tij do të viheshin në funksionim mekanizma procedurale politike dhe organizative që do të përpunonin dhe do të jepnin një produkt përfundimtar në veprimtaritë e rëndësishme të partive politike si konferenca apo Kongrese, duke krijuar një situatë të fitores së plotë, pa të humbur, pra krijimi i një situatë win-win-win. Kur brenda partisë krijohet një konkurim i ndershëm dhe zhvillohet një garë e pastër për në lidhshpim e saj, kur në këtë proces demokratik ftohet të marrë pjesë e gjithë anëtarësia, krijohet atmosfera e fitores pasi:

- tek çdo anëtar krijohet besimi se është pjesë e vendimarrjes brenda partisë dhe jo një manekin i komanduar sipas dëshirave të lidhshpimit duke synuar zbatimin sa me real të parimit “një anëtar-një votë”.
- në parti rritet kohezioni ndërmjet anëtarëve dhe ajo konsolidohet më tej pasi eliminohet tendenca e monopolizimit dhe personalizimit të lidhshpimit qëndror dhe lokal, duke i ofruar shanse gjithkujt të përballët me sfidën e konkurimit të vlerave politike.
- partia rrit maksimalisht reputacionin e saj në opinionin e gjerë publik duke treguar se është një parti që zbaton parimet e demokracisë, në radhë të parë brenda vehtes dhe se është e aftë t’i zbatojë këto parime edhe në institucionet shtetërore dhe tërë shoqërisë. Sepse pa demokraci në parti nuk ka demokraci në Shqipëri.

16 Kryqëzimi i Demokracisë

Ilir Zela

*“Vareni se përunj dhe përmbys pasurinë,
Pasuron dhe çliron, dhe forcon varfërinë
Se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:
Kryqëzoje Pilat, në Kalvar, Golgotha!”¹*

Kur do të bëhen shqiptarët të zotët të qeverisin vetveten e të mos pranojnë tiranët që t’i urdhërojnë? A janë demokratike e legjitime vendimet që “baballarët e kombit” marrin? A japin llogari të zgjedhurit para qytetarëve që i zgjedhin dhe sa shpesh e bëjnë këtë? A shpërdorohet mandati politik në funksion të interesit personal? Sa hapësirë kemi lënë që korrupsioni të infektojë të zgjedhurit? A përdoret mandati politik në përputhje me vullnetin publik? Çfarë sistemi politik kemi? A janë të vendosura qendrat e fuqisë brenda sistemit politik, apo ato projektojnë pushtet jashtë tij? Cila kategori njerëzish gjen kushtet më të mira për të realizuar vetveten, në kushtet që ofron sistemi ynë politik? Pse kaq shumë tension politik në vend? A marrin pjesë njerëzit në qeverisjen e vendit, apo një kastë qeverisëse ka marrë tiparet e një klase sunduese?

Në një trajtë të ngjashme këto pyetje duhet ta kenë sflitur e munduar shumë edhe imzot Nolin, larg diku, ndanë Harvard-Square. E si peshkop që ishte ai, nuk mund të mos vuante kur shikonte se njerëzit akoma pranonin t’i drejtonin e t’i sundonin, t’ju tregonin se ç’duhet të bënin dhe çfarë ishte me e mira për ta. Pas rreth 15 vitesh parademokraci, që të mund të bëjmë hapin e madh për të hyrë në një fazë të re, të ndritur të demokracisë sonë, ndoshta do të ishte koha, që të gjithë aktorët dhe faktorët e proceseve politike në Shqipëri, të rrefesheshin para varrit të Nolit. Se Noli ishte demokrat i ndriçuar, por ishte edhe peshkop shqiptar e shpirti i tij, endet kudo nëpër Shqipëri dhe na fton ta ndjekim në rrugën

e principeve të tij, të cilat ai kurrë nuk mundi t'i jetësojë.

Nuk besoj se ndokush do të më kundërshtonte në pohimin se Kushtetuta e vitit 1998, është arritja më e madhe e shqiptarëve në rrugën e demokracisë. Kemi arritur të endim rrjetën institucionale që parasheh një sistem demokratik në vend. Pushtete të ndara, por që ekuilibrojnë njëra-tjetrën, sanksionim të lirive dhe të drejtave të individit, pjesëmarrje të njerëzve në procesin qeverisës, kontroll parlamentar mbi ekzekutivin. Megjithatë, ne përsëri po vonohemi në gëzimin e fryteve të kushtetutës sonë, e cila është aq e mirë, sa ka arritur të sanksionojë përvojat më të mira të demokracive më të përparura. Mentalitetet dhe praktikatat e së shkuarës na tërheqin vazhdimisht prapa, ndërsa kushtetuta jonë na kërkon standarte që nuk ngajjnë aspak me të shkuarën tonë. Një fushë ku kjo manifestohet hapur, është gjendja e partive politike sot, të cilat nuk janë në gjendje t'i përgjigjen rolit që kushtetuta u jep në manaxhimin e pushtetit ekzekutiv dhe atij opozitar. Një vështrim i shkurtër mbi mënyrën e funksionimit dhe organizimit të tyre, të bind se *kemi të bëjmë me një shformim të proceseve politike për shkak të një mospërputhjeje mes sistemit politik që parasheh kushtetuta dhe mënyrës sesi janë organizuar dhe funksionojnë partitë politike si instrumente të pjesëmarrjes qytetare në procesin qeverisës. Ndaj dhe krizat riciklojnë vetvehten.*

1. Si hartohen politikatat?

Programet elektorale të partive hartohen nga një grup i vogël njerëzish në lidhshpirt të partive. Janë këta njerëz që përcaktojnë prioritetet, shpeshherë duke u bazuar thjesht në formulime arriviste të përealizueshme, të cilat thjesht kërkojnë të tërheqin votues. Jemi akoma shumë larg ndërtimit të politikave, të cilat do të buronin natyrshëm nga nevoja për zhvillim që përjetohet nga njerëzit, aty ku ata punojnë e jetojnë. Pra elitat drejtuese në thelb marrin përsipër t'u tregojnë anëtarëve të partive të tyre, se çfarë është më e mira për ta dhe komunitetet ku ata jetojnë e punojnë.

2. Si bëhen emërimet në postet e rëndësishme politike të ekzekutivit?

Praktika më shumë se 12 vjeçare ka treguar se kjo fushë mbetet ende një mjedis i rezervuar për liderët. Një kategori njerëzish, pa emër, pa fytyrë, pa dukje e pa vlerë, shihen të sillen gjithnjë rrotull njeriut që partia fituese ngjitet në pushtet?! “Mjeshtër” që hiqen si menaxherë të mundit, djersës së anëtarësisë së partive. Krijesa pa vetvete, genie që kopjojnë gjeste, sjellje dhe fjalë, marrin guximin të krijojnë klube që u atashohen strukturave

partiake, klube që më pas hyjnë brenda tyre e që zgjerohen papushim në ekzekutiv, në gjyqësor, në administratë, në biznese e kudo!!! Këta tipa fitojnë kredon e të të besuarve të “shefit të madh” që më pas përmes saj të abuzojnë, të imponohen, të emërohen në poste të rëndësishme, të hiqen si pronarë të partive, të cilat sa herë vijnë zgjedhjet, drejtohen tek anëtarët e thjeshtë për të mbledhur votat, përmes të cilave duhet ruajtur pushteti. Po pushteti i cilit?!

3. Si përzgjidhen drejtuesit partiakë, kandidatët për deputetë apo për në organet e pushtetit vendor?

Pavarësisht kongreseve, konkurimeve (apo gjoja konkurimeve) përvoja e këtyre viteve ka treguar se liderët historikë arrijnë të rizgjidhen sa herë ata dëshirojnë, si kur fitojnë zgjedhjet ashtu edhe kur i humbasin ato. Pra në thelb nuk zhvillohen zgjedhje për liderët, pasi rezultati gjithmonë është i njëjtë. Këta liderë arrijnë më pas të mbajnë pranë një rreth njerëzish, përmes të cilëve sigurojnë pushtetin e tyre mbi strukturat e tjera partiake në nivel qendror e vendor. Janë këta njerëz që u tregojnë anëtarëve të partive tona, se kush do të ishte përfaqësuesi më i mirë i tyre në parlament, apo në këshillin vendor.

Këto tre ilustrime të shkurtra na çojnë tek pyetja themelore: Si është e mundur që elitat drejtuese t’ia dalin që gjithmonë të kenë sukses për t’u imponuar? Unë e shoh shpjegimin e kësaj tek mënyra sesi janë ndërtuar strukturat organizative të partive tona. Në vitin 1991, kur partitë u krijuan, ata ndoqën si mënyrë organizimi të vetmin model që tradita ofronte- Modelin e Partisë së Punës, modelin e organizimit me celula vertikale. Thjesht u ndryshuan emërtimet e strukturave përkatëse. Bie fjala, “Komiteti Qendror” u zëvendësua me “Këshilli Kombëtar”, “Byroja e Partisë” me “Kryesi”. Kështu, nga një Parti Pune, përfunduam të kemi disa të tilla. Thelbi mbeti i njëjtë, kontroll i qendrës mbi vendimarrjen politike, në përzgjedhjen e njerëzve dhe në zhvillimin e karrierës.

Këtu qëndron edhe thelbi i ndryshimit që ne duhet të bëjmë. Unë e shoh zgjidhjen në të majtën e spektrit politik, jo thjesht se e majta ka debatuar më shumë rreth këtyre temave, por sepse e majta ka marrë përsipër realizimin e misionit të saj universal, për ta shpënë “pushtetin, pasurinë dhe shanset në duar të shumicës dhe jo të disave”². Ne nuk mund ta bëjmë këtë për shoqërinë tonë, nëse këtë nuk do ta bënim më parë për anëtarësinë tonë të partisë. Ndaj na duhet të lëvizim shpejt për t’u dhënë anëtarëve të partive tona të drejtën për të marrë pjesë në hartimin e politikave, në përzgjedhjen e drejtuesve dhe të kandidatëve për në organet

legjislative e vendore. Parimi “një anëtar, një votë” për organizimin partiak, si pasqyrim i parimit bazë të demokracisë - “një individ një votë”, është provuar të jetë rruga më e efektshme për ta bërë këtë. Besoj se do të kemi një situatë shumë më të mirë, nëse gjejmë kurajon për të ndryshuar. Krahas profesor Meidanit, në Kongresin e PSSH-së të dhjetorit 2003, unë kërkova që të fillojmë të lëvizim në këtë drejtim, me bindjen se do të arrinim të shëronim disa nga plagët dhe të krijojmë hapësira të reja për realizimin e objektivave tona, si forcë e së majtës.

Së pari, në hartimin e politikave dhe aplikimin e politikave- Nëse anëtarët e partisë do të përfshihen në këto procese, ata do të jenë në gjendje të përcaktojnë se çfarë është më e mira për ta dhe komunitetet ku jetojnë, por edhe çfarë është më e mirë për vendin. Pra anëtarësia duhet të jetë vendimarrësi i vërtetë për politikën dhe t’i diktojë qendrës se çfarë duhet bërë. Që veprimtarët tanë të mos mbeten më thjesht ekzekutorë të porosive qendrore, por të veprojnë si krijues të politikës së njerëzve. Kjo do të na lejonte më pas që anëtarësia të verifikonte nëse politikën e hartuara në këtë mënyrë po zbatohen apo jo, në interes të përmbushjes së synimeve politike. Vetëm kështu mund të merrte fund shakaja e hidhur “jemi parti e majtë, po zbatojmë politika të djathta”. Vetëm kështu dëshira mbarëpopullor për një shpejtësi më të madhe në procesin e afimit me Europën nuk do të mund të tradhëtoheshe më për interesa pushtetore të elitave të shkëputura nga vullneti i njerëzve. Partia jonë do të kthehej kështu gradualisht në një forum të hapur të politikëbërjes, ku natyrshëm do të tërhiqeshin edhe pikëpamjet zhvillimore të shoqërisë civile dhe intelektualëve të paangazhuar.

Së dyti, në zgjedhjen e liderit- Parimi “Një anëtar, një votë” do ta barazonte peshën e çdo anëtari të partisë dhe i bashkëshoqëruar me parimin e votëpërvimit periodik do të shtonte përgjegjshmërinë e liderit. Lideri do të detyrohej të shërbente në funksion të interesave të gjera, përndryshe vota e anëtarit nuk do ta ndiqte më. Do të merrte fund po ashtu edhe përdorimi i pushtetit ekzekutiv për të siguruar dominimin në parti, sepse është shumë e vështirë të lidhësh pas interesit të karriges së disa dhjetëra- mijëra vetë, në raport me 500 apo 600 vetë, të cilët bëhen “pronarë” e vullnetit të anëtarëve të thjeshtë.

Së treti, në përcaktimin e kandidatëve për në zgjedhjet e përgjithshme qendrore e vendore- Kush më shumë se anëtarët e partisë e dinë se me cilin kandidat do ta kishin më të lehtë për të mbledhur më shumë vota! Cili përveç tyre e di më mirë se cili i zgjedhur do të mund të punonte më shumë për avancimin e interesave të komuniteteve përkatëse! Besnikëria

e të zgjedhurve, nuk do të ishte më peng tek udhëheqja në qendër, por do të depozitohej tek vullneti i anëtarësisë dhe komunitetit përkatës. Pushteti i vërtetë do të zhvendosej pra, nga maja e piramidës tek njeriu i thjeshtë, me gjithë hallet dhe problemet e tij.

Duke theksuar këta elementë, jam njësoj i vetëdijshëm edhe për madhësinë e sfidës. Na mungon tradita për ta bërë këtë, jemi mësuar ta vemë theksin tek organizata si njësi bazë e partisë, jo tek anëtari si individ i lirë, i grupuar në një forcë politike rreth vlerave themelore që ka marrë përsipër të përfaqësojë ajo. Skifterët e pushtetit do të jenë të parët që do të përpiqen ashtu si kameleoni, për t'u adaptuar në mjedisin e ri që do të krijohet. Media do të ndjekë paguesin më të madh e po ashtu cilësi të caktuara të organizimit tonë shoqëror, do të kundërvihen.

Por duhet të gjejmë kurajon për të ecur në këtë drejtim. Përndryshe numëri i anëtarësisë sonë do të vazhdojë të bjerë, veprimi politik të bjerret, militantët do të ndihen thjesht të përdorur. Shpirti i imzot Nolit do të vazhdojë të endet mbi kokat tona dhe ne do ta përdorim emrin e tij kundër frymëzimit të tij të vërtetë, paçka se i kemi vendosur një shtatore pranë vendit ku mbliidhet dy herë në javë Kuvendi i Shqipërisë, me deputetë të cilët shpeshherë detyrohen të shformojnë karakterin e tyre, përballë peshës se presioneve që ushtrohen mbi ta. Do të na duhej ndoshta shumë kohë pastaj, derisa shpirtit të tij t'i shtoheshin shpirtrat e atyre që ndihen të tëhuajtur nga procesi politik në Shqipëri. Ndaj duhen ftuar të rrëfehen para varrit të tij, të gjithë ata që demokracinë, vazhdojnë ta konsiderojnë si mjet për të grumbulluar pushtet total, për të abuzuar me vullnetin dhe dëshirat e njerëzve, për të keqpërdorur të pavetëdijshmit. Nëse nuk e bëjnë këtë, aq më keq për ta! Do të dalin të tjerë ta bëjnë para tyre. Populli shqiptar ka votuar Kushtetutën e tij demokratike e do të arrijë një ditë t'i gjejë mënyrat për t'i dalë zot vetes, përmes saj.

Bibliografia:

¹ Fan Noli, *Marshi i Kryqëzimit*

² Tony Blair, 2004 *Labour Party Annual Conference*
(Konferenca e përvitshme Laburiste 2004)

17 Demokracia fillon këtu...

Bledar Doracaj

Në qendër të vëmendjes, jo vetëm të klasës politike, por edhe të mbarë opinionit publik shqiptar, janë tendencat e kohëve të fundit për të implementuar dhe zbatuar në kohë parimin “Një anëtar, një votë”. Një ide dashamirëse, e lançuar në kohën dhe momentin e duhur nga një institut shumë prestigjioz (NDI), është kthyer tashmë në një iniciative, e cila po gjen përkrahje dhe mbështetje jo vetëm nga individë brenda forumeve drejtuese të subjekteve politike, por edhe më gjerë. Implementimi në kohë i të gjithë elementëve përbërës të këtij parimi, kërkon një angazhim dhe vullnet të fortë.

Në një këndvështrim më të gjerë, kjo iniciativë nuk mund të jetë vetëm dogmë propagandistike në momente të veçanta, por ajo duhet të thithet, përpunohet e më pas të zbatohet sipas një skeme të qartë dhe efikase. Kur vetëm pak muaj na ndajnë nga fillimi i fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kur koha dhe zhvillimet e fundit politike kërkojnë ndryshime, kur votuesi ngre zërin dhe kërkon më shumë dinjitet, respekt dhe përgjegjshmëri nga përfaqësuesi i tij, është momenti që nga një iniciativë ambicioze të shndërrohet në një objektiv serioz për të tashmen dhe të ardhmen e afërt.

Realiteti dhe mentaliteti

Realiteti dhe mentaliteti luajnë një rol shumë të rëndësishëm në adaptimin dhe zbatimin e politikave apo ideve bashkëkohore. Duke njohur mentalitetin, pa e ndarë për asnjë çast edhe nga realiteti, mund të evidentojmë rrugën dhe mënyrën më të shpejtë dhe të drejtë për të arritur objektivin. Le të ndalemi në disa nga pikat apo momentet më pikante të këtyre dy elementëve të rëndësishëm, si pjesë përbërëse e parimit ‘një anëtar një votë’.

Mungesa e dialogut ndërmjet forcave kryesore politike, ka sjellë në

vëmendje të shqiptarëve klasën e lodhur dhe të pandryshuar shumëvjeçare politike në vend. Personalizimi i partisë nga ‘njëshi’ apo ‘njëshat’, si dhe përdorimi i favoreve dhe mjeteve politike në interes dhe shërbim të tyre, ka sjellë si pasojë zhgënjimin e anëtarësisë. Ky zhgënjim i njëtrajtshëm, i cili ka filluar 13 vjet më parë, po rrit në çdo betejë elektorale indiferentizmin e komunitetit - anëtarë ose jo të subjekteve - duke shkaktuar një paqëndrueshmëri dhe mos përputhje evidente nga ato çfarë pretendojnë subjektet në rezultatin përfundimtar. Vullneti politik, moral dhe shoqëror që gëzon klasa politike për të bashkëpunuar në përmbushje të kriterëve dhe standarteve bashkëkohore, në shërbim dhe interes të komunitetit, nuk është në nivelin e duhur.

Zgjedhja e liderit dhe lidërsipit të Partisë, jo me votë të drejtpërdrejtë, por me votë të deleguar, me njerëz që qëndrojnë shumë afër këtyre strukturave apo me poste të rëndësishme në administratën shtetërore, përbën pabarazinë më të madhe politike në raportet anëtar-lidërsip. I vetmi ‘lider’ që zgjidhet direkt nga anëtarësia është kryetari apo sekretari i organizatës të partisë në terren. Të tjerët, nëpërmjet një skeme tërësisht të kontrollueshme nga lidërsipi, zgjidhen në mënyrë ‘transparente’ përgjatë evenimenteve politike të subjektit. Madje, seksionet apo këshillat zonal në nivel vendor, zgjidhen me votë jo të drejtpërdrejtë, por të deleguar. Në shumicën dërrmuese, drejtuesi i këtyre forumeve zgjidhet i preferuari i deputetit apo i kryetarit të partisë së degës, duke anashkaluar votën e anëtarësisë.

Interpelancat apo ‘gjykatat e partisë’, si të gjitha strukturat e tjera, janë në shërbim dhe zbatim të urdhërave të lidërsipit, duke mos përfillur në disa raste dhe rregullat e shkruara në dokumentat bazë. Kur çdo strukturë nuk përmbush detyrat e saj dhe, në mënyrë abuzive, vihet në dispozicion të lidërsipit duke punuar në interes të tij, sjell si pasojë rrezikun evident të humbjes së demokracisë së brendshme në parti. Partitë politike në Shqipëri deri tashmë nuk kanë investuar për përmirësimin e sistemeve të zgjedhjes së strukturave, por i kushtojnë rëndësi përzgjedhjes së emrave duke i klasifikuar në ‘besnike’ dhe ‘ushtarë’ të këtij apo atij lideri. Kështu krijohet një lidërsip i një rangu më të ulët, me njerëz pa personalitet politik, moral, profesional e shoqëror, të cilët më shumë sesa alternativës që përfaqësojnë, i shërbejnë individëve. Ashtu sikurse theksova edhe më lart, serioziteti i individëve apo partive që përfaqësojnë, varet në mënyrë të padiskutueshme nga zbatimi i angazhimeve politike të bëra publike gjatë evenimenteve.

Indiferentizmi ndaj problemeve të komunitetit, ka bërë që të parët që kanë përkrahur iniciativën “Një anëtar, një votë” të jenë anëtarët e

thjeshtë të partive të rinjtë, anëtarë të forumeve rinore, që tashmë janë jo vetëm përkrahës të iniciativës, por edhe përçuesit dhe mbështetësit kryesorë të këtij parimi. Një pjesë e konsiderueshme e klasës politike deklaroi publikisht apo tjetërsoj, se duhet akoma edhe shumë kohë për të implementuar dhe praktikuar “Një anëtar, një votë”. Hezitimit të tyre për t’u ballafaquar me brezin e ri dhe energjik, të gatshëm për të marrë mbi vete përgjegjësitë politike, duhet t’i jepet fund.

Partitë në Shqipëri, sidomos në prag fushatash, kthehen në bunkerë izolimi për anëtarësinë dhe njerëzit e rinj. Ato hapen me urdhër nga lart vetëm për atë pjesë të ‘shoqërisë civile’ apo ‘anëtarë’ të cilët janë kandidatë potencialë për të marrë mandat politik të pamerituar e për të përfaqësuar partinë në institucione të ndryshme shtetërore.

Mentaliteti totalitar i liderit se, ‘partia është e imja dhe e di unë se çfarë bëj me të’, është një mentalitet dhe koncept i gabuar që po mban peng dhe ka mbyllur dyert për atë pjesë njerëzish me mentalitet dhe ide bashkëkohore. Zëvendësimi i politikave konfliktuale me politika bashkëpunimi dhe mirëkuptimi janë pjesë e rëndësishme dhe luajnë një rol të padiskutueshëm edhe në sfidat aktuale për Shqipërinë dhe partitë politike.

Implementimi dhe adaptimi

Kjo është faza më e rëndësishme, ku përveç vullnetit dhe përgatitjes profesionale të subjektit, nevojitet edhe ndihma e një eksperti ndërkom-bëtar. Në përfundimin e fazave të mësipërme jemi përpara aktit final të implementimit dhe adaptimit të pjesëve përbërëse të këtij parimi. Pas konsultimeve me anëtarësinë, përshtatjes nga një grup ekspertësh me realitetin dhe mentalitetin e vendit, eksperimentimin në një ose disa organizata apo njësi vendore, i drejtohem forumit më të lartë drejtues, kongresit për të marrë vendimin përfundimtar. Një element shumë i rëndësishëm për mendimin tim, është mënyra se si do të administrohet vota e anëtarësisë.

Patjetër, në nivel lokal dhe qendror do të jenë strukturat kompetente, por cila do të jetë risija që ky parim do të sjellë në këtë fushë. Padyshim, një proces transparent, i drejtë dhe i barabartë për të gjithë, ku çdo anëtar ka të drejtë të votojë dhe të votohet, do të ishte elementi më i rëndësishëm që gjithësesi do të jepte sinjale shpresë për të gjithë shqiptarët.

Barazi dhe transparencë për të gjithë, liri dhe jo kufizime apo censura për këdo që do të thotë mendimin e tij apo që kërkon të plotësojë një ambicie personale për të kandiduar për një pozicion politik.

Demokracia e gjerë dhe disiplina e fortë duhet të mbizotërojë në strukturat politike, ku të gjithë të jenë të detyruar të respektojnë mendimet dhe qëndrimet politike të kolegëve, por njëherazi të gjithë t'i përmbahen rregullave dhe normave bazë mbi të cilat funksionon subjekti. “Një anëtar, një votë”, do të krijojë për të parën herë institucione të reja në partitë politike, të cilat tashmë nuk do të emërohen apo zgjidhen në mënyrë jo të drejtë, por do të zgjidhen nga vetë anëtarësia me votim të drejtpërdrejtë. Pjesë të programeve dhe grupeve të punës do të jenë arritja e standarteve dhe ndryshimi i imazhit për subjektin dhe anëtarësinë që militon aty.

Arritjet

Progresi i bërë nga partitë politike në këto 13 vjet nuk është në nivelin dhe masën e kërkuar. Gjithsesi, ai është një progres që duhet përshëndetur, analizuar dhe marrë në konsideratë. Arritja më e rëndësishme e parimit ‘një anëtar një votë’, do të ishte barazia e padiskutueshme në pjesën më të madhe të saj ndërmjet Kryetarit të Partisë dhe anëtarit të saj. ‘Kontributi’, por edhe ‘përfitimi’ do të jenë në raport të drejtë ndërmjet tyre. Anëtarësia do të ketë mundësinë të ketë më shpesh në ‘gjirin’ e saj përfaqësuesin që e ka zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë, ashtu sikurse edhe përfaqësuesi do të jetë shumë më pranë tyre për të justifikuar besimin e votuesve.

Anëtarësi – Lider, tashmë do të jetë një binom shumë interesant, të cilët do të bashkërendojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin jo mbi baza interesi, por për të qenë sa më pranë zgjidhjes së problemeve të komunitetit. Në këtë mënyrë, ky raport do t'i shërbejë më mirë alternativës së subjektit, duke rritur kështu mundësinë për fitoren e radhës. Në përfundim të fazave të mësipërme ne mund të konstatojmë ndryshimin ndërmjet një sistemi politik në parti, dhe sistemit politik të implementuar apo adaptuar në një parti tjetër. Vërtetë, do të jetë një arritje e madhe jo vetëm për mjedisin politik shqiptar, por edhe më gjerë. Kjo risi do të sjellë po ashtu edhe më shumë standarte demokratike në politikën tonë. Është vërtetë bukur të udhëhiqesh nga ide bashkëkohore, të cilat kërkon t'i vësh në dispozicion të alternativës dhe subjektit politik tek i cili beson, jo vetëm për të tashmen por edhe për të ardhmen.

18 Mendësia e re e funksionimit politik dhe sistemi “Një anëtar, një votë”

Arjan Kokoshi

Ndjehem i privilegjuar kur mendoj se jam pjestar i kontigjentit të politikanëve të rinj të trajnuar nga NDI. Në këtë trajnim ne njohëm dhe përvetësuan një sërë mendësish dhe praktika të reja në veprimarinë politike në tërësi, në thelb të së cilës ishte menaxhimi politik. Ishte një përvojë e papërsëritshme në atë që unë e kam quajtur si arti i organizimit të mjeteve të thjeshta dhe mendësive të përparuara e moderne për një menaxhim funksional të veprimtarisë politike, karrierës dhe prezantimit politik. Shumë shpejt ne u prezantuam me sistemin “Një anëtar, një votë” dhe shpesh debatuar rreth tij si sistemi më demokratik në organizimin dhe funksionimin e një force politike. Për këtë nuk nguroj të shpreh mirënjohje për insistimin dhe pasionin e përgjegjshëm politik të drejtuesit tonë Z. Dan Redford. Ashtu sikurse mendoj se nuk është i rastësishëm ky bum i kësaj mendësie në arenën politike shqiptare në këtë periudhë.

Sistemi i njësisive bazë si formë e demokracisë së përfaqësuar

Pas përmbysjes së sistemit politik një-partiak dhe në vazhdim në tranzicion, forcat politike pa veçuar askënd, trashëguan si përvojë dhe mendësi të vetme, në ndërtimin e piramidës politike sistemin e organizimit dhe të përfaqësimit mbi njësitë bazë. Ky sistem i paraqitur si formë e demokracisë së përfaqësuar, në të cilin vota delegohet, deri diku funksionoi mirë, përse kohë ishte bashkëudhëtar me mendësitë idealiste të anëtarëve dhe të të deleguarve të tyre në struktura partiake apo institucione shtetërore. Mirëpo, jo vetëm për faktin se ky është një ekuilibër politik i paqëndrueshëm, por për arsyen themelore se ky sistem nuk vë në qendër të vëmendjes individin por njësinë bazë, shpesh individit, anëtarësia, nuk e gjente veten në përdorimin e mandatit të deleguar në hartimin e politikave apo qeverisje. Dhe shumë shpejt nxorën kokë fenomene si lehtësia për trafik votash apo influence. Në raste të tilla shpesh zgjidhjet

apo “tronditjet politike” nuk kanë ardhur nga “një paketë masash për korrigjime e reflektime”, por nga synimet për aktivizimin e formave të demokracisë së drejtpërdrejtë, sic është referendumi.

Zbatimi i sistemit “Një anëtar, një votë” dhe vështirësitë lidhur me të

Shpesh shprehet dëshira për aplikimin e sistemit “Një anëtar, një votë”, por pothuajse gjithmonë vihen barrierë mbi vështirësitë për implementimin e saj. Sigurisht barrierë ka. As që mund të pretendohet që një koncept i ri, një mentalitet i ri, një sistem i ri të ketë terren të përgatitur por si fillim duhet vullneti për pranimin e vitalitetit të këtij sistemi si pararendëse për përballimin e vështirësive që hasen dhe ecjen gradualisht në zgjerimin e implementimit të tij hap pas hapi. Gjithsesi nuk mund të injorojmë mungesën e kulturës së nevojshme politike dhe mentalitetit social si dhe mungesën pothuajse të plotë të infrastrukturës për implementimin e këtij sistemi.

Sistemi “Një anëtar, një votë” dhe politika shqiptare. Prirjet dhe nevoja për implementimin e tij

Në realitetin politik, jo të emancipuar, tendenca e parë që vihet re dhe rreziku më i madh që has një ide e re dhe e përparuar, është përdorimi apo shpërdorimi i saj nga trumbetimet apo gara për ta pranuar “në parim” apo “në themel të punës sonë”. Ky fenomen vihet re jo vetëm te ndonjë forcë e madhe politike që fillimisht deklarohet dhe më pas e anashkalon për afate kohore të tjera angazhimin në sistemin “Një anëtar, një votë”, por dhe të ndonjë forcë e re politike që për t’u bërë joshëse për terrenin politik kombëtar apo ndërkombëtar e nxjerr si kartën themelore këtë sistem e cila do aplikohet çuditërisht nga struktura të emëruara. Ndaj do të vlerësoja vullnetin për të hedhur praktikisht hapat e para konkrete në implementimin e sistemit “Një anëtar, një votë”. Partia Socialiste jo vetëm si partia më e madhe por dhe më demokratike, e prirur nga progresi, dëshmoi vullnet për implementimin e këtij sistemi në fushatën për përzgjedhjen e kandidatave të saj për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 dhe po punon për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme. Dhe kjo nuk është një rastësi, por është një rrjedhë llogjike në aftësitë e saj vetëkorriguese, në debate të hapura në çdo nivel dhe kundrejt çdo niveli në raporte mbështetëse dhe kundërshtuese që ndryshonin për çdo ngjarje dhe për çdo qëndrim, në dinamikë të brendshëm demokratik, ku dhe 3-vjet më parë u përgatit t’i drejtohej anëtarësisë për disa probleme dhe zhvillime politike në parti.

Nevojat për implementimin e sistemit “Një anëtar, një votë” si shprehje e demokracisë së drejtpërdrejtë vjen si domosdoshmëri për rritjen e përgjegjshmërisë të të zgjedhurve ndaj anëtarisë duke shmangur mundësinë e shkëputjes së elitës politike nga problemet dhe perceptimet e anëtarisë si dhe duke eliminuar mundësinë e korrupsionit të një grupi të vogël të deleguarish për trafik vote apo influencash. Sistemi “Një anëtar, një votë” do të sjellë kontributin e drejtpërdrejtë të anëtarësisë në qeverisje dhe ndërtimin e strukturave drejtuese në parti dhe duke qenë llogaridhënës përpara tyre bëjmë të gjithë anëtarësinë të jetë më pranë partisë dhe të tregojë më shumë interes për çështjet e partisë. Jo vetëm kaq por duke u ndjerë e përfshirë anëtarësia do të propagandojë veprimtarinë, qëndrimet dhe arrijet Po kështu politikën që do hartojmë do të jenë më pranë interesave të shtresave që përfaqësojmë. Ky sistem padyshim që, do të sjellë kandidatë të fortë jo vetëm se kompromentimi nuk mund të jetë masiv dhe se kontributi duhet të jetë i dukshëm, sistematik dhe i prekshëm, por edhe pse tërësia e komunitetit të anëtarësisë është e prirur drejt të mirave të përbashkëta në kontribute publike dhe larg interesave të shpërndara personale. Sigurisht që produkti do të jetë kandidatë të aftë gjë që do të shërbejë në veprimtarinë e mëtejshme në angazhimet e tyre publike. Në këtë mënyrë dhe kariera në parti nuk do të shikohet më si privilegj dhe qoshe e rehatshme dhe e sigurt për interesa të vogla apo të një grupi njerëzish të paaftë, duke vënë kështu në rrezik rezultatet elektorale. Sistemi “Një anëtar, një votë” do të sillte përfaqësues dhe drejtues të fuqishëm në autoritetin politik për realizimin e premtimeve dhe rritjen e nivelit të debatit në zbatimin e politikave dhe programeve në shërbim të elektoratit.

Sistemi “Një anëtar, një votë” dhe mundësitë e aplikimit në procesin e zgjerimit hap pas hapi

Mungesa e infrastrukturës për një shtrirje të gjerë të sistemit “Një anëtar, një votë” nuk do të thotë mos zbatimi i tij në zgjidhje të disa problemeve të përfaqësimit në nivel lokal dhe jo vetëm lokal, apo në propozimet për përfaqësuesit alternativë të partisë në fushata parlamentare apo vendore. Marrim një problem që haset në organizimin funksional të një force politike; - përzgjedhja në strukturat drejtuese lokale nga një forum i deleguar ku pjesa më e madhe nuk ka kontakte funksionale me veprimtarinë rajonale të kandidatit.

Kjo përzgjedhje do ishte më funksionale dhe do të sillte një zgjidhje komplekse të disa absurdeve njëherësh, nëse kandidatët do të votoheshin

nga anëtarësia e rajonit ku kandidatët e ushtrojnë veprimtarinë politike. Kjo do të sillte, para së gjithash, një kandidat cilësor si dhe të gjitha efektet e trajtuara më sipër në raportin individ-parti-anëtar-si- i zgjedhur. Kjo do të sillte dhe gjithëpërfshirjen e rajoneve në strukturat vendore, duke shmangur rrezikun e mungesës së përfaqësimit dhe më tepër akoma, ky përfaqësim do ishte në porpocion të drejtë me numrin e anëtarësisë që mbulon. Pra në tërësi rrit përgjegjshmërinë dhe veprimtarinë funksionale të strukturës së partisë. Po kështu mund të trajtohen dhe përzgjedhjet në struktura të ngjashme për të sjellë të njëjtat efekte pozitive në veprimtarinë e forcës politike dhe individëve të saj zgjedhës apo të zgjedhur në një infrastrukturë ekzistuese të mjaftueshme.

Sistemi “Një anëtar, një votë” dhe perspektiva politike

Tashmë debati i hapur për sistemin “Një anëtar, një votë” është një realitet në politikën më aktive dhe protagoniste shqiptare. Kemi reagime të drejtpërdrejta për përfshirjen e tij në axhendat më të afërta në zhvillimet politike dhe elektorale. Ka një ndjeshmëri gjithnjë e në rritje ndaj këtij sistemi në frymën e zhvillimit të demokratizimit të brendshëm politik. Sistemi “Një anëtar një votë” si një pjesë e organizmit të gjallë të demokracisë në forcat politike do të zhvillohet dhe do të pasohet me një sërë procesesh demokratizuese në koherencë me vullnetin civil për integrim në familjen europiane.

19 E djeshmja dhe e ardhmja e politikës shqiptare

Etleva Bisha

Kemi hyrë në një shekull të ri dhe ende vazhdojmë të kërkojmë qeverisje efektive, zbutje të varfërisë, jetë më të mirë për shqiptarët, dhe mbi të gjitha, kërkojmë ta shohim Shqipërinë të integruar realisht në një botë globale që ndryshon shumë shpejt. Përse kemi humbur kaq kohë dhe mbi të gjitha përse vazhdojmë të endemi pa e kuptuar se çdo ditë humbasim shanse që nuk kthehen më? Përgjigja më e shkurtër për këtë pyetje mund të ishte: kryesisht për shkak të politikës. E them këtë pasi Parlamenti, Qeveria, Presidenca, pra organizimi politik i shtetit janë pazgjidhshëmrisht të lidhura me mbështetjen që partitë politike sigurojnë nga shtetasit përmes votës së lirë. Ne nuk mund të vazhdojmë të vetkënaqemi thjesht me vendosjen e një shteti pluralist dhe demokratik në Shqipëri, pasi ne kemi nevojë të ndjejmë realisht atë që sjell një shtet i tillë: qeverisjen e mirë- transparente, të besueshme dhe garante të pjesëmarrjes së shtetasve të saj në vendimarrje. Ne kemi nevojë për zhvillim të qëndrueshëm të vendit, për t'u integruar në familjen europiane, për mirëqenie shoqërore, për dinjitet dhe paqe. Pra kemi nevojë për qeverisje normale.

14 vjet më parë shqiptarët arritën të fitojnë lirinë politike, e lidhur kjo me të drejtën që fituan për të vendosur se kush dhe mbi çfarë parimesh do t'i qeverisë, si dhe të lirisë së të shprehurit politik dhe shtypit të paçensuruar. Shqiptarët, të kufizuar aq rreptë për 50 vjet për të qenë pjesë e vendimarrjes politike, vërshuan drejt partive politike në fillim të viteve '90. Ata ëndërruan e shpresuan se më në fund, ata vetë, mund të vendosnin për të ardhmen e vendit të tyre dhe e shihnin angazhimin në partitë politike si një mundësi për ta arritur këtë.

Tani, pas 14 vitesh, të gjithë janë dëshmitarë të zhgënjimit nga politika dhe të faktit që një masë e madhe njërëzish janë larguar prej saj aq shumë sa që nuk preferojnë të shkojnë as në kutinë e votimit në raste zgjedhjesh. Edhe pse është e vështirë të identifikosh të gjithë faktorët që çuan në zhgënjim për mua thelbësor mbeten qeverisjet e shumta dhe shpesh të

dështuara, si dhe varfërimi i motivimit politik.

Shqipëria e pas '90-ës u bë pjesë e një bote globale dhe shqiptarët u bënë më të ndjeshëm për çështje që lidheshin me jetën, komunitetin, rrugën dhe familjet e tyre. Politika duhej t'i përgjigjej në të njëjtën mënyrë këtij ndryshimi duke i kushtuar vëmendje individit dhe jetës së tij, madje duke komunikuar drejtpërdrejt me të për të kuptuar realitetin dhe përmirësuar jetën e tij. Por politika shqetësohej për individin thjesht dhe vetëm në raste fushatash zgjedhore, kur premtonte dhe kërkonte votën në këmbim të premtimit. Ndërkohë shumica e shqiptarëve bezdiseshin nga tonet e debateve politike, nga lufta e çuditshme pa të ardhme e klasës politike shqiptare dhe ata pyesnin veten : “ç’lidhje kanë këto debate me jetën time?”.

Edhe sot pas 14 vitesh eksperiencash politike jam e sigurt që shumica e politikanëve shqiptarë nuk e dinë se politika duhet t'i shërbejë qytetarit, se publiku kërkon që të merren në konsideratë opinionet dhe shqetësimet e tij, se publikut i duhen shpjeguar vendimet politike që merren në emrin e votës që ka dhënë, se publiku do të ndjejë realisht se zëri i tij dëgjohej.

Për më tepër, mungesa e motivimit politik u shfaq ndjeshëm edhe tek anëtarësia e partive politike. Në parim partitë politike mirëpresin për anëtarësim apo kontribut të gjithë ata që duan të influencojnë mbi politikat dhe të thonë fjalën e tyre në vendimarrjet e rëndësishme politike. Anëtarë të partive politike mund të jenë individë, të rinj, studentë, intelektualë, punëtorë, të papunë, të moshuar, pra kushdo që aspiron një jetë më të mirë për vendin e tij dhe që nuk pret që zgjidhjet të vijnë thjesht “nga disa të tjerë”. Një parti që aspiron të rritet dhe zhvillohet i ka të domosdoshme idetë e reja dhe politikat praktike që në thelb vijnë nga gjerësia e këndvështrimeve dhe eksperiencave të anëtarëve të saj apo atyre që e mbështesin atë. Dhe në fakt, në këtë botë globale që ndryshon kaq shpejt idetë e reja, zgjidhjet efikase janë ato që garantojnë suksesin apo dështimin e partive politike. Në parim anëtarësia e partive politike duhet të luaj rol aktiv veçanërisht në programet dhe politikat e hartuara nga partitë politike dhe më pas po këta anëtarë duhet të trokasin në dyert e qytetarëve të tjerë për të kërkuar mbështetjen e tyre për zbatimin e programit politik përmes qeverisjes së vendit. Pra, e thënë ndryshe, një parti politike, në parim, fillon dhe mbaron tek tërësia e individëve që e përbëjnë atë.

Porse në praktikë, në realitetin shqiptar të këtyre 14 viteve demokraci, ideja e rolit të anëtarit të një partie politike në vendimarrje të rëndësishme politike është gati utopike. Një anëtarësi e gjerë e partisë krijon premisa që partia të mbetet e hapur, demokratike dhe të ruajë kontaktin me votuesit,

por në shumicën e rasteve anëtarësia është përdorur keqazi. Pagimi i kuotave dhe shtimi i rradhëve me anëtarë të rinj kanë qenë detyra kryesore të anëtarëve të partive në qeverisje apo opozitë. Përjashtohen këtu rastet e periudhave elektorale kur roli i anëtarit shihej pazgjydhshmërisht i lidhur me detyra në ndihmë të kandidatëve për deputetë, si dhe administrues së votës së zgjedhësve në qendrat e votimit. Nëse këtyre i shton edhe faktin që parimi i demokracisë së brendshme rrallë ka funksionuar në partitë politike, kuptohet që anëtarët ndihen gjithnjë e më shumë të pamotivuar.

Mungesa e demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare është manifestuar qartazi në rotacionin e kufizuar të lidershit, në pjesëmarrjen e dobët të grave dhe të rinjve në strukturat drejtuese, dhe mbi të gjitha në personalizimin e pushtetit dhe përqëndrimin e tij në duart e individëve të veçantë, kryesisht drejtuesit e parë të partive politike. Si rezultat jeta e brendshme e partive politike është shoqëruar me atmosfera konfliktuale, që zakonisht kanë çuar në ndarjen e partive, për më tepër kanë çuar në pasivitet dhe zhgënjim të anëtarëve të këtyre partive.

Të gjitha këto janë të mjaftueshme për të kuptuar se ka ardhur koha për ndryshim. Politika nuk mund të mbetet alternativë e disa individëve për të pasur një punë, jetë komode apo për të mbrojtur bizneset e tyre. Ajo nuk mund të mbetet pronë e disa individëve që krijuan fillimisht një emër publik pikërisht për shkak të angazhimit politik dhe më pas u bënë padronë të asaj force politike ku vendosën të angazhohen.

Diskutimet e kohëve të fundit mbi zbatimin e sistemit “Një anëtar, një votë” dhe madje përfshirja e këtij sistemi si normë statutore në programet e disa partive politike, është një moment shumë i rëndësishëm që mund të shënojë një kthesë serioze në demokracinë e brendshme të partive politike shqiptare, pra edhe në jetën politike në Shqipëri. Ky sistem u prezantua rreth një vit më parë nga NDI në Shqipëri, si një sistem mjaft efikas i zbatuar në disa vende të Europës Perëndimore, dhe shumë shpejt u bë pjesë e debateve politike shqiptare. Të zbatosh këtë sistem në partitë politike shqiptare do të thotë të rindezësh motivimin e anëtarëve të partive politike, të cilët do të ndjejnë që idetë e tyre kanë vlerë; do të thotë të gjenerosh politikanë të zgjedhur lokal apo deputetë etj, që së pari kanë bindur për vlerat dhe cilësinë e tyre “familjen politike” të cilës i përkasin e më pas zgjedhësit; do të thotë t’u rikthesh shqiptarëve besimin tek vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohen partitë politike e më pas t’i lësh të lirë të zgjedhin vetë qeverisjen më të mirë. Në fund të fundit vetëm parti me parime të qarta të demokracisë së brendshme mund të gjenerojnë qeverisje të ndershme dhe demokratike.

Megjithatë, zbatimi i sistemit “Një anëtar, një votë” do të jetë një sfidë

për partitë politike shqiptare. Përfshirja e këtij sistemi në statutet e disa partive politike apo të tjerave më pas është vetëm fillimi. Suksesi i këtij procesi do të varet nga angazhimi i fortë dhe serioz i lidershit politik dhe nga mbështetja e anëtarëve të partive politike. Zgjedhjet elektorale të vitit të ardhshëm do të ishin një rast i shkëlqyer për fillimin e zbatimit të këtij sistemi nga partitë politike në Shqipëri.

Mund të duket e vështirë por nuk është e pamundur. Duhet vetëm më shumë dëshirë e mirë për të kaluar nga një politikë e vjetër tradicionaliste në një stil të ri dhe të efektshëm të menaxhimit të politikës shqiptare. Ka ardhur koha që politikanët shqiptarë në tërësi të mendojnë më shumë si shqiptarë sesa si profesionistë të politikës. Të majtë apo të djathtë, të sukseshëm apo jo, ata duhet t'i japin të njëjtën përgjigje kësaj pyetje: “A do të punojmë për të ndërtuar një Shqipëri progresiste në zemër të Europës, apo do të vazhdojmë të mbetemi të izoluar prej saj?” Në fakt kjo duhet të jetë vlera e vërtetë e politikës shqiptare dhe jo vetëm e saj, por edhe e çdo shqiptari që dëshiron një të ardhme më të mirë.

20 Një anëtar, një votë

Demokracia direkte dhe demokracia me përfaqësim

Arben Qirjako

Në demokracinë e Greqisë së Lashtë qytetarët e lirë diskutonin dhe vendosnin për fatet e tyre në mbledhje të hapura ku ftoheshin të merrnin pjesë të gjithë. Në histori ky model ka hyrë si forma më e thjeshtë dhe më e pastër e demokracisë, si modeli i demokracisë direkte, demokracia e kulluar. Mbi këtë model Zhan Zhak Rusoi mbështeti një teori të tërë të organizimit të shtetit modern, edhe pse nuk e pa kurrë të realizuar.

Në vlerësim historik, demokracia e Greqisë së lashtë ka njohur dy degë të evolucionit të saj, të cilat janë kondicionuar nga i njëjti parakusht: rritja demografike vështirësonte aplikimin e diskutimit dhe vendimarrjes së drejtpërdrejtë (qytetarët e lirë të grumbulluar në qytete nuk kishte shesh që t'i strehonte).

Dega e parë synonte ngushtimin e rrethit të personave që merrnin vendimet. Midis qytetarëve të lirë dolën ca që ishin akoma më “të lirë”. Këta të fundit gëzonin të drejtën për të vendosur. Fundin e vet llogjik ky degëzim i evolucionit shoqëror e pati në ngushtimin drastik të rrethit të subjekteve vendimarrëse. Pasoja: u deshën revolucionet borgjeze që koncepti i demokracisë të rilindte.

Dega e dytë ka synuar ngushtimin e rrethit të çështjeve vendimarrëse. Njerëzit nuk merrnin vendim për çdo gjë që përcaktonte fatin e tyre, por vetëm për një rreth të kufizuar çështjesh. Në radhë të parë ata vendosnin për njerëzit që do t'i përfaqësonin dhe do të vendosnin në emër të tyre. Është ky degëzim i evolucionit shoqëror që i ka larguar njerëzit nga “sheshi” dhe i ka drejtuar ata tek “kutia e votimit”. Është ky degëzim që ka mundur t'i rezistojë veprimet erroziv të historisë dhe që sot e kësaj dite shërben si bazë dhe frymëzim për modelet moderne të vendimarrjes shoqërore.

Dega e dytë e evolucionit shoqëror të demokracisë na ka prezantuar, në etapë të caktuara historike, forma të ndryshme të demokracisë me

përfaqësim, me një ose më shumë shkallë përfaqësimi, të cilat në raste të caktuara i janë larguar shumë demokracisë direkte. Megjithatë, përpjekjet për të gjetur ilaç ndaj largimit nga forma e kulluar e demokracisë nuk kanë reshtur. Era moderne po na kthen për ditë e më shumë drejt eksplorimit të formave që rrisin shanset për vendimarrje të drejtpërdrejtë, ose që zbusin mundësitë e përfaqësuesve për t'i përcaktuar fatet njerëzore në mënyrë të pavarur nga vullneti i bazës që i ka veshur ata me pushtet.

Baza ka nevojë për më shumë mekanizma kontrolli, për më shumë ndikim mbi përfaqësuesit e vet. Instrument i tillë ndikimi është dhe sistemi “Një anëtar, një votë” i zgjedhjeve brendapartiake. Në sistemin demokratik partitë politike janë gur themeli i organizimit shoqëror dhe shtetëror. Partitë politike formësojnë, organizojnë, sistemojnë dhe implementojnë vullnetin politik të popullit. Por partitë politike kanë një defekt të lindur. Ato bartin me vete tendencën për të jetuar një jetë të vetën, të ndarë dhe të shkëputur nga njerëzit, një realitet “politik” të ndryshëm nga realiteti “njerëzor” i bazës. Kjo tendencë shkëputjeje apo kundërvënijeje është sëmundja bazë e partitokracisë, për pasojë, kërcënim serioz për demokracinë me përfaqësim.

Demokracia me përfaqësim ka nevojë për më shumë limfë që të jetojë, ka nevojë për fije të panumërta lidhjeje midis bazës dhe përfaqësuesve të saj. Këto lidhje duhet të jenë institucionale (statutore), por edhe të mbrojtura nga teknikat korruptive të përfaqësimit. Nëse baza duhet të vendosë për përfaqësuesit e vet, atëherë ky vendim duhet të jetë i vërtetë, jo fiktiv, i drejtpërdrejtë, jo me shkallë, jo i manipulueshëm.

“Një anëtar, një votë” në vetvete e plotëson këtë kusht. Çdo anëtar i partisë vendos në përmasë të barabartë për lidhshimin e tij. Vota është e barabartë, e drejtpërdrejtë, e fshehtë dhe e lirë. Rezultati është i pastër, i sigurtë, i pakontestueshëm: Partinë e drejton personi që ka mbështetjen më të madhe të anëtarësisë, jo personi që duan forumet, jo personi që duan delegatët. Brenda demokracisë me përfaqësim, ky është shembulli më i mirë i demokracisë direkte. Nëse baza, jo delegatët, jo forumet, përcakton drejtpërdrejt dhe në periudha të rregullta lidhshimin e saj, atëherë lidhshimi nuk mund të ketë një jetë të vetën, të ndarë dhe të shkëputur nga njerëzit.

“Një anëtar, një votë” që të funksionojë ka nevojë për plotësimin e dy parakushteve, për mbrojtjen nga dy rreziqe jetike. E para, vota nuk duhet kurrësesi të ndotet nga mekanizmat e korruptimit të saj. Ajo duhet të bartë vetëm vullnetin e lirë të votuesit dhe asnjë vullnet tjetër. Ajo nuk duhet të jetë e hapur, e blerë, e imponuar apo e kërcënuar. Ajo duhet të jetë privilegj ekskluziv i anëtarësisë dhe jo i “grupeve të gatëshme” të kandidatëve.

Së fundi, ajo duhet të udhëhiqet nga interesa madhore të partisë, nga e mira e përgjithshme dhe jo nga interesa meskine për ndikim apo përfitim personal, privat. Në të gjitha rastet kur mbi parimin “Një anëtar, një votë” do të veprojë qoftë dhe vetëm ndonjeri nga mekanizmat e korrupsionit, sidomos kur ky veprim do të bëhet i qëndrueshëm, “institucional” apo pjesë e kulturës politike të bazës a të përfaqësuesve të saj, në të gjitha këto raste parimi do të kthehet në të kundërt të vetvetes, demokracia në anti demokraci. Ilaçi për këtë rrezik është vetëm një: rregulla të qarta e të prera statutore, të zbatuara dhe të mbrojtura nga një detashment njerëzish fanatikë.

Rreziku i dytë vjen nga tepria. “Një anëtar, një votë” nuk është rivendosje e demokracisë direkte. Ai është mjet për t’u mbrojtur nga një pjesë e të këqijave që sjell demokracia me përfaqësim. Ai nuk e zëvendëson demokracinë me përfaqësim. “Një anëtar-një votë” duhet të kufizohet vetëm në zgjedhjen e lidhshimit politik. Por ai nuk mund të shndërrohet në mekanizëm të vendimarrjes politike. Nëse do të zgjerohet rrethi i çështjeve për vendimarrje nëpërmjet këtij sistemi, atëherë ai do të provojë shumë shpejt se është i mangët, i pasigurtë, i padrejtë, i pamjaftueshëm, i padenjë. Atëherë ai shumë shpejt do të imponojë nevojën për ndryshim, për largimin nga ky parim i “dëmshëm”.

Duke parë realitetin politik shqiptar, dëshiroj të evidentoj dhe një problematikë që mund të egzistojë në lidhje me implementimin e sistemit “një anëtar-një votë”. Mund të shtrohet pyetja se a është e “gatshme” politika shqiptare sot për të vënë në zbatim sistemin “Një anëtar, një votë”? Kjo pyetje ka lidhje me faktin se a është e gatshme antarësia partiake për të marrë këtë përgjegjësi?

Në demokracinë perëndimore, në partitë politike që zbatojnë sistemin “Një anëtar, një votë”, vihet re një përgjegjshmëri maksimale e anëtarëve në ushtrimin e pushtetit të tyre si dhe në plotësimin e të gjithë detyrimeve të tyre që rrjedhin nga qenia anëtar partie. Kjo ka të bëjë me kulturën e admirueshme politike të bazës së këtyre partive.

Në realitetin tonë politik a është e mjaftueshme kultura politike e bazës për të implementuar sistemin “Një anëtar, një votë”? Nuk mjafton që të regjistrohesh si anëtar i një partie dhe të konsiderohesh si i tillë më pas. Që të marrë një pushtet të tillë, antarësia duhet të plotësojë të gjitha detyrimet që përcaktohen nga statutet partiake. Pra, duhet bërë dallimi midis anëtarëve të partisë nga simpatizantët e saj. Është detyrë e strukturave partiake që, me rregulla të qarta dhe të prera statutore, të t’i evidentojë dhe t’i shpjegojë antarësinë për përgjegjësinë që do të marrin, para implementimit të sistemit “Një anëtar, një votë”.

Elementët e vendimarrjes mund të ndryshojnë nga koha në kohë dhe nga vendi në vend por e rëndësishme është se pavarësisht se realitetet demokratike mund të na ofrojnë sfida të reja, vëmendja dhe përpjekjet të jenë të vazhdueshme për të shkuar drejt idealeve. "Udhëtar"- thotë një proverb spanjoll -"rrugë nuk ka. Rrugët janë bërë duke ecur".

Jo shumë kohë më parë, në kongresin e një partie të djathtë të botës Shqiptare, kryetari i partisë i'u paraqit delegatëve (demokraci me përfaqësim) si kandidaturë e vetme. Delegatëve i'u kërkua që ta votonin kandidaturën "me aplauz". Kryetari u zgjodh me duartrokitjet e zjarra të anëtarëve të forumit të lartë. Në Greqinë e lashtë qytetarët e mbledhur në shesh, vendimet i merrnin "me aplauz". Megjithatë modeli i aplikuar në shekullin e 21 nga kjo parti shqiptare vështirë se do të jetë jetëgjatë. Anekdotat rreth tij besoj se do të jetojnë shumë.

21 “Një anëtar, një votë” adoptim që nis nga njohja

Arta Sakja

Vëmendja mediatike që po i kushtohet së fundmi në titra televizivë e tituj gazetash sistemit të të votuarit “Një anëtar, një votë”, ende nuk po arrin fatkeqësisht të shpjegojë realisht se çfarë ky sistem përfaqëson, ku dhe kur përdoret, kë stimulon dhe çfarë nxit vënia në funksionim e një mekanizmi të tillë votimi, ç’rreziqe paraqet dështimi në adoptimin e tij të parë, etj etj.

Kjo, sepse debati, siç ndodh rëndom në Shqipëri, shumë pak ka përfshirë politologët, më së shumti ai është ndërmarrë nga ata që shquhen për përplasje disarrokëshe që nuk kumtojnë brendi, por vetëm mbesin si gjurmë grafikash. Kaq amulli është krijuar rreth argumentit këto javët e fundit në median shqiptare, saqë për nga niveli i moskuptimit, paragonon me konfuzionin që shkaktoi një dekadë më parë teza mbi çekun e bardhë. Në këtë paralel konstatohet të jetë pëthithur nga masa edhe shija, edhe përshtypja: pozitive, por e paqartë.

Po kështu, përplasjet e nxituara në shigjetime edhe në nivele retorike, rrezikojnë të krijojnë një koncept të gabuar politik ndër shtresat që nuk kultivohen me leksione në shkencat politike dhe që për pasojë, nuk kanë mundësi të ndërtojnë konceptin e duhur, as të bëjnë analizat e duhura, por që realisht përbëjnë shumicën e popullsisë, që në fjalorin e politikës, shënohet edhe si votë.

Me këtë sistem në të vërtetë do të angazhohet të punojë fondi që përbën burimet njerëzore të partive politike dhe që do të ketë të bëjë më çështjen e organizimit të brendshëm të jetës partiake. “Një anëtar, një votë”, më së shumti i drejtohet masës që përbën anëtarësinë e thjeshtë të partive politike shqiptare dhe që do të përbëjë subjektin dhe objektin e aplikimit të këtij sistemi të votuari, i cili, si një hap i parë i mbarë, është shpallur i mirëpritur së fundmi edhe nga liderët politikë.

Është megjithatë anëtarësia deri në nivelin e “ushtarit Nemeçek”, që deri më tani është parë thjesht si entuziaste për lidhshpinin përkatës, e cila mbush e zbras sheshe, salla, kafene e ambiente të tjera, duke krijuar mes

brohoritjeve optimiste dhe debatit pasionant edhe aureolën e lidershipit ideal, por që fatkeqësisht edhe nëse ndikon, nuk arrin dot të vendosë në suksesin elektoral. Për këtë lind nevoja të trajnohet mbi votimin “Një anëtar, një votë” për të shmangur rrezikun e dështimit në adoptimin e tij të parë.

Lidershipit politik si hallkë të parë të suksesit a të mossuksesit të tij elektoral i duhet megjithatë, të frymëzojë pikërisht këtë masë, para se të kalojë në rrethin e të tretëve, të atyre që realisht vendosin rezultatin elektoral. Lidershipi duhet të përfshijë anëtarësinë në lojën politike, motivimin e aktivistëve lokalë, që për nga numri, shkalla e përkushtimit, vlera intelektuale, niveli i elitarizmit, apo thjesht për nga cilësia, ndikojnë në fuqinë dhe fytyrën e një partie.

Duket që kjo lidhje nuk ka funksionuar në frymëmarrje të zgjeruar në rastin Shqipëria. Duket që kontakti i lidershipit shqiptar është kufizuar në qarqe të mbyllura, gjë që ka ndikuar krahas të tjerave, në rrjedhje të pjesëmarrjes në votime në Shqipëri.

Pak histori shqiptare për sistemin “Një anëtar, një votë”

Sistemi “Një anëtar, një votë” u hodh si tezë për t’u integruar në statutin e Partisë Demokratike në Kongresin VI të saj, në platformën e paraqitur nga ish kryeministrit Aleksandër Meksi, e cila fokusohet kryesisht në çështjet e fraksionit. Delegatët e Kongresit, të papërgatitur e të patrajnuar më parë, gati në një mosnjohje totale të këtij sistemi votimi, nuk votuan pro tij. Në mars të vitit 2003, NDI nis një shkollë njëvjeçare për Menaxhim Politik me pjesëmarrjen e politikanëve të rinj nga të gjitha forcat politike shqiptare. Leksioni mbi sistemit e votimit, përparësitë që mund t’i sjellë sistemi “Në anëtar, një votë” forcimit të demokracisë së brendshme në partitë shqiptare (shpesh të kritikuar në këtë pikë) u shndërrua në një aksion politik. Një seri shkrimesh që kanë për autor Dan Redford, Drejtor i programit politik për NDI/ Shqipëria, si edhe studentë të kësaj shkolle, u pasuan nga seminare e biseda me synim sensibilizimin e politikës mbi dobite që mund të sjellë ky sistem për zgjerimin e demokracisë së brendshme në partitë shqiptare.

Në Dhjetor 2003, platformat e kandidatëve rivalë të Kryetarit të PS-së, Fatos Nano për postin e kreut të Partisë Socialiste, Rexhep Mejdani e Edi Rama, por edhe nënkryetari i FRESH, Elvis Mataj, kërkuan të futet sistemi i votimit “Një anëtar, një votë” në statutin e Partisë Socialiste. Por, ndryshe nga ç’kishte ndodhur disa vite më parë, në Kongresin e demokratëve, kur mekanizmi “Një anëtar një votë” ishte totalisht i

panjohur, delegatët socialistë, jo më për shkak të mosnjohjes, por sepse e panë si platformë të “armikut”, nuk votuan pro tij. Në korrik të vitit 2003, kryetari i PDR-së, Genc Pollo shpall se për zgjedhjen e postit të kryetarit, do të operojë mbi sistemin “Një anëtar, një votë”.

Në shtator të vitit 2004, LSI shpall sanksionimin në statut të parimit të zgjedhjes me anë të sistemit “Një anëtar, një votë”, gjë që kryetari i saj, Ilir Meta e kishte kërkuar në forumet e Partisë Socialiste edhe pak muaj më parë se të zyrtarizonte ndarjen nga PS.

Po në shtator të këtij viti, kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, deklaroi se në kongresin e ardhshëm “do të kërkojmë të miratohet në statut zgjedhja me anë të sistemit “Një anëtar, një votë” dhe se ky është një proces që kërkon regjistra korrektë. Ne jemi duke punuar për një plan që kemi me NDI që brenda dy viteve të hartojmë regjistrat. Do të shihet mundësi e votimit me postë për shkak të anëtarësisë që ndodhet ne emigracion sezonal”.

Nuk vonon, që më 1 tetor, nga mbledhja e kryesisë së Partisë Socialiste të Sarandës, kryetari i saj, Fatos Nano, të shprehet se do të nisë procedurat për të aplikuar sistemin “Një anëtar, një votë” “në procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për deputetë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005.

Sistemi një anëtar një votë, adoptimi në organizimet e brendshme partiake, sistem që afron drejtuesit me anëtarësinë e thjeshtë

Sistemi “Një anëtar, një votë” do të aplikohet pra, për zgjedhjet e brendshme partiake. Ai është i ngjashëm me mënyrën sesi organizohen zgjedhjet parlamentare apo ato lokale, ku e drejta për të votuar nuk është privilegj i dikujt për shkaqe hierarkike, sociale, racore, etnike, por është një e drejtë universale e sanksionuar në kushtetutë. Sistemi “Një anëtar, një votë” parasheh të drejtën për të zgjedhur strukturat drejtuese partiake ose më gjerë, të drejtën për të marrë vendime politike të rëndësishme nga e gjithë anëtarësia që paguan kuotizacionin për periudhën e paracaktuar në statut.

Pse duhet që partitë politike shqiptare të adaptojnë këtë sistem? Sigurisht që nëse partitë politike shqiptare kanë vendosur të jenë të hapur për këtë sistem, këtë nuk duhet ta kenë bërë thjesht për të fituar simpatinë e një organizmi ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe NDI, por sepse politika shqiptare duhet të këtë kuptuar që me mekanizmat mbi të cilat ajo ka operuar dhe ka organizuar deri më sot jetën e saj të brendshme, ka humbur lidhjen me anëtarësinë e gjerë të saj. Shkëputja nga anëtarësia ka sjellë pasojat e saj në rezultatet e votimit.

Politika shqiptare duhet ta kishte kuptuar më parë se vendimet në parti po merreshin gjithnjë e më shumë prej një rrethi të ngushtë njerëzish, që fatmirësisht apo fatkeqësisht janë më veprimtarët e saj, por që kanë tendenca të mos hapin rrethin, pasi ndjehen komodë në sigurimin e lehtë të votës së deleguar (të marrë në forma të ndryshme, jo rrallë herë dhe në mënyrë abuzive) e për ta përdorur më pas këtë votë për qëllime përfitimi.

Në këtë moment, lidershipi partiak në Shqipëri kërkon të zgjerojë vendimarrësitë në parti dhe kjo bëhet duke i besuar votën çdo anëtarit të partisë, pasi praktikimi i vlerave të demokracisë në çështjet e brendshme, sjell garanci më të mëdha për respektimin e këtyre vlerave në rast marrjeje të pushtetit.

Demokratët për këtë përzgjedhje duket të jenë nisur nga strategjia e tyre që synon shtimin e interesit të anëtarit të thjeshtë të saj tek politika, për të rritur besimin në performancën jo vetëm politike të PD, duke shpresuar se kjo do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes në votimet e ardhshme parlamentare, gjë që, referuar sondazheve, parathotë fitore elektorale të Partisë Demokratike.

Ata besojnë se duke u lejuar anëtarëve të PD-së të shprehin pikëpamjet e tyre, duke nxitur barazinë midis anëtarësisë, bazuar në rregullat e vëna përsa i përket vendimarrjes, me synimin e qartë të dhënies llogari të udhëheqësve para anëtarësisë, do të karikojnë anëtarësinë në rolin e saj të ambasadorit për të patur suksesin elektoral në zgjedhjet e 2005-ës.

Socialistët të konsumuar, jo thjesht prej jetëgjatësisë 7 vjeçare në pushtet, por edhe për shkak të moseficiencës qeverisëse, (kuptuar këtu mungesën në etikën qeverisëse, nivelin e lartë të korrupsionit, lidhjet me krimin e organizuar, cënimin e lirisë së shprehjes), por edhe tkurrjen e partisë nga largimi i fundit i një sërë deputetësh e drejtuesish të saj grupuar në LSI, lëshuan të detyruar tezën e përdorimit të sistemit “Një anëtar, një votë”, edhe “për t’u dukur në modë”, pasi është vështirë të besosh që Nano priti Berishën për t’u deklaruar pro një sistemi që iu bë i njohur anëtarësisë së socialistëve. Kreut socialist , iu kërkua me insistim që t’i këmbente “kongresmenët” objekt të humorit, me mendimin e përgjithshëm të anëtarësisë, por ai nuk e pranoi më parë.

Ndërsa dy partitë e reja (PDR e LSI) që kanë miratur tashmë në statutet e tyre këtë sistem, duhet të mos mbeten thjesht në rolin e ndjellësit.

Sistemi “Një anëtar, një votë”, çudibërja dhe rreziku i dështimit

Dihet që partitë politike janë organizime që përmbushin një sërë rolesh që burojnë nga procesi demokratik. Partitë duhet të ndërtojnë një

infrastrukturë që t’u lejojë të veprojnë me efikasitet, të zhvillojnë politika me identitet të qartë ndaj problemeve me të cilat ndeshet vendi, të kenë aftësinë të përfshijnë anëtarësinë, të trajtojnë aktivistët, të përgatisin fushatat dhe të mbledhin fonde.

Politika është përshkruar edhe si procesi i përcaktimit se “kush merr diçka, çfarë merr, kur dhe si e merr”(Boulding Keneth,-Tri pamjet e Pushtetit). Kjo teori, megjithëse e pastudiuar në Shqipëri, duket të ketë gjetur këtu zbatim të pandërgjegjshëm. Një nga shkaqet që e ka nxitur këtë, ka qenë sistemi i votës së deleguar në partitë politike shqiptare, i cili jo rrallë herë, ka ndikuar keqazi në mospasjen e demokracisë së duhur të brendshme, argument ky mjaft i debatuar për politikën shqiptare.

Unë besoj se sistemi “Një anëtar, një votë” do të sjellë rritje të interesit të anëtarësisë për politikën, do të shkatërrojë bazat që mbështesin pushtetin e mistershëm, do të nxisë një të menduar më ndërtues, do të sjellë kandidatë të fortë, do ta bëjë partinë më përgjegjëse, do të nxisë garën e hapur për të gjithë, do të krijojë zgjedhje të bazuara mbi aftësi dhe jo mbi para.

Sistemi mund të rrisë pushtetin e kryetarit, çështje që i bën dyshues kundërshtarët e sistemit për rastin Shqipëria, pasi profilet politike të lidershit partiak në Shqipëri, duket të jenë për ta, pengesa e zhvillimit demokratik të vendit, integritet etj etj. Por ajo që duhet të mbetet e qartë është se ajo që pengon, nuk mund të vijë, as të shkojë me këtë sistem, por në të kuptuarin e drejtë të përbërësve të procesit demokratik, ku kompromiset zëvendësojnë luftën e ashpër politike.

Në një diskutim të parë mbi mënyrat e adoptimit të këtij sistemi, kam shprehur rezervën e ruajtjes së konfidencialitetit të votës, në rastet e votës me postë, (si ndihmëspostier në Shqipëri mund të shërbejë edhe kali e gomari për vetë terrenin ku jetojmë dhe në mospasjen e infrastrukturës së duhur). Kam shprehur gjithashtu rezerva për mundësinë e vjedhjes së votës apo manipulimit të saj me anë të internetit (këtij luksi që një përqindje e vogël e anëtarësisë tonë aktuale e gëzon) edhe pse në këtë pikë, mungon eksperiencia e suksesshme, pasi ka vetëm 10 vjet që përdoret edhe në perëndim e herë herë nuk ka dhënë rezultatin e duhur (rasti i votimeve në Ontario, Kanada).

Por unë besoj se edhe një grup i vogël njerëzish me vullnet pozitiv e dëshirë të mirë për të ndryshuar mund të ndikojnë në ndryshim.

Pse besoj se ky ndryshim pozitiv do të sjellë hapje të garës, kandidatë të cilësishëm, më shumë gra e të rinj që kanë karizmën e duhur, një vizion apeluar, që komunikojnë me pasion e dinë të përdorin masmedian, që mbledhin opinione mbi aktivitetin e tyre, që identifikojnë modele sjelljesh

dhe adaptojnë sjelljen më të mirë, që ndërtojnë skuadrën dhe dinë të punojnë me të e në të , që duan realisht zhvillimin. Kam pranuar të bëj pjesë ndër njerëzit që i bëjnë gjërat të ndodhin, që do të mbështesin aplikimin e këtij sistemi, duke ndihmuar të kuptohet mirë dhe në përgatitjen e infrastrukturës së duhur për zbatimin e tij të drejtë.

22 Përse duhet pikërisht tani parimi “Një anëtar, një votë”?

Roland Bejko

Me sistemin klasik është abuzuar

Pas gati 13 vjet pluralizëm në Shqipëri janë të shumta shkaqet dhe arsyet pse qytetarët janë përfshirë në një krize besimi që i mban larg partive politike, por njëra prej tyre mendoj se ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të vetë partive politike. Në fillimet e pluralizmit pjesëmarrja në një parti politike ishte më së shumti një detyrim ideologjik dhe idealist i diktuar nga ndarjet klasore dhe ideologjike që kishte paracaktuar sistemi i diktaturës. Për një pjesë të mirë të qytetarëve u krijua ideja se pjesëmarrja në një parti politike do të thoshte shumë një vend pune i mirë, bursa për fëmijet, privilegje dhe të mira të tjera ekonomike që nuk mund t’i fitoje pa qenë anëtar partie. Ky lloj mentaliteti i dëmtoi partitë që kanë qeverisur pas 90-es veçanërisht në imazhin e tyre në raport me publikun .

Përse “Një anëtar, një votë”

I ka mbaruar koha modelit të partive që funksionojnë me ligjësitë e kohës së vjetër. Sistemi me delegim e ka humbur kredibilitetin dhe autoritetin e tij sot në Shqipëri. Këtë « nder » ky sistem e ka nga vetë protagonistët e tij. Është koha të ndryshojmë. Nuk është fjala vetëm për një ndryshim formal sa për të hutuar qytetarët e për t’iu thënë se me disa makjازه në fytyrën e udhëheqjes, apo me shtimin e ndonjë strukture me emër impresionues pranë partisë do të mund t’i bindim ata të na përkrahin, të anëtarësohen, apo të na votojnë. Përvojat e partive të rëndësishme në Evropë na mësojnë se për të shtuar radhët me anëtarë të rinj , dhe për të fituar sa më shumë vota ditën e zgjedhjeve dhe më tej për të qeverisur me efikasitet në dobi të të gjithë qytetarëve, duhen reforma thelbësore, duhen ndërhyrje vertikale, duhet distancim i qartë dhe me prova përveç

fjalëve nga dhe ndaj çdo gjëje që ka kompromentuar imazhin e partisë në të kaluarën.

Tani nuk kemi të bëjmë vetëm me faktorë ideologjikë në pjesëmarrjen e njerëzve në politikë, ky faktor është zbehur prej disa vitesh qëkur shoqëria jonë tentoi të luante në botën e tregut. Janë interesat ekonomike dhe pikëpamjet shoqërore ato që paraqesin dhe nxisin interesimin e qytetarëve për pjesëmarrje apo jo në një parti politike.

Sot gara është e vështirë. Fiton ajo parti që fiton sa më shumë qytetarë, përveç atyre që ka pasur. Duhet ndërruar forma dhe përmbajtja, dhelbi dhe shfaqja; pra jo vetëm imazhi në funksion të marketingut politik, edhe; pra lënda në funksion të tregut. Këtë bënë Laburistët Britanikë në 94, dhe të djathtët Francezë kur krijuan UMP-në; pra ndërruan sistemin e organizimit dhe të funksionimit të partive të tyre, duke e transformuar sistemin tradicional të delegimit dhe përfaqesimit me sistemin e votimit të drejtpërdrejtë “Një anëtar, një votë”. Është provuar dhe janë dhënë shumë argumenta për avantazhet e këtij sistemi. Njeriu i dëshpëruar, portretin e të cilit krijuam më lart, bëhet anëtar aktiv, kur beson, tek vota dhe e respekton atë. Kur ky njeri i dëshpëruar njoftohet dhe me pas bindet se këtej e tutje nuk do të jenë vetëm një grusht njerëzish parimorë apo klanorë që do të pyeten se kush do të jenë drejtuesit e partisë së tij, të parlamenteve lokale apo të parlamentit qëndror, të strukturave politike në të gjitha nivelet, ai do të ftojë edhe miqtë e tij në lagje apo në punë të bashkohet me të rreth një programi që shpreh dhe mbron interesat e tij pragmatiste.

Me sistemin “Një anëtar, një votë”, anëtari i vjetër nuk e pengon antarësimin dhe pjesëmarrjen e anëtarit të ri me frikën se mos i zërë vendin dhe për pasojë do të humbasë privilegjet që deri dje ia jepte posti partiak. Nga një pjesëmarrje më e gjerë Partia garanton mundësinë për të zgjedhur midis grupeve të interesit, vendos raporte partneriteti me, to në vend të raporteve të kontrollit që ushtroheshin dikur nga partitë autoritare të së kaluarës edhe të afert. Me këtë sistem anëtarët mbajnë përgjegjësi për udhëheqësin dhe udhëheqjen që vetë kanë dashur të zgjedhin. Pak më vonë ata do ta kuptojnë se kanë kështu udhëheqjen që meritojnë.

Sipas Rusoit, funksionarët, drejtuesit shtetërorë në çdo shtet kanë një prirje të pashmangshme ; « gradualisht duan të bëhen zotër të shtetit, ta shtien kontrollin dhe drejtimin shtetëror gjithnjë e më tërësisht në duart e veta. Pastaj (apo krahas kësaj) ata priren që, nëpërmjet shtetit, të bëhen edhe zotër të shoqërisë së vet, « padronë të shoqërisë».

Modeli “Një anëtar, një votë”, nëpërmjet pjesëmarrjes dinamike të anëtarit të saj në të gjithë veprimtarinë aktive politike të partisë i jep

shansin Partisë që e aplikon këtë sistem të zhbunkerizohet ; anëtarit do të shprehet gjithmonë nëpërmjet votës, vota e tij do të dëgjohet ; anëtarit do të jetë i rëndësishëm për partinë. Ky model i krijon anëtaresisë mundësinë të mbajë përgjegjësinë direkte për udhëheqjen që ka zgjedhur, dhe nëpërmjet zbatimit të llogaridhënies udhëheqësi i zgjedhur do ta fitojë apo do ta humbasë besimin e të gjithë votuesve.

Ky sistem e forcon vërtet liderin dhe ai shumë shpejt mund të tjetërsohet siç thotë Rusoi, por dy apo tre vjet kalojnë shpejt kështu që lideri do të japë llogari në rast deshtimi dhe do të ketë mundësi të rikonfirmohet nga gjykimi i të gjithëve në rast suksesi.

Pa energjinë jetike të veprimtarisë së anëtarëve, Demokracia në Parti fillon të dobësohet. Anëtarët demoralizohen dhe largohen nga partia për të hyrë tashmë në një mori organizatash private dhe jo private, ku ata do të ndiheshin më të qetë, më të dobishëm , me komodë ,më të vlerësuar, pse jo edhe më të paguar. Tashmë jemi në fazën kur qytetarët , sidomos ata që janë të aftë profesionalisht, kanë mundësi të jetojnë mirë edhe pa ndihmën e Partisë qoftë kjo edhe në pushtet. Prandaj mendoj se partia është ajo që ka më shumë nevojë për qytetarin e aftë sesa qytetari për partinë . Raportet janë përmbysur, në mos kështu kanë filluar të përmbysen me ridimensionimin kulturor si një mundësi që të krijon tregu, shoqëritë e hapura, teknika e lartë dhe brezi i ri që shkollohet dhe rritet në një menyrë më të shpejtë edhe se rritja normale biologjike. Por unë mendoj se në vend që të zbulojmë se kush ia ka më shumë nevojën tjetrit - qytetari partisë apo partia qytetarit, mund të themi se shoqëria demokratike do të ndihet e pa plotësuar pa pjesëmarrjen aktive të qytetarit në të gjitha nivelet, në të gjitha raportet, se përndryshe ç’kuptim do të kishte Demokracia si sistem pa Demosin?

Në shprehemi nga që e kemi këtë privilegj, sepse sipas Perikliut ; « ndërsa pak njerëz janë në gjendje të konceptojnë një vijë politike, të gjithë janë në gjendje ta gjykojnë atë ». Ne që jemi të zgjedhur në strukturat e larta të partive respektive e kemi për detyrë të konceptojmë një strategji politike. Anëtarët tanë dhe më tej votuesit, do të jenë ata që do të na gjykojnë.

Në sot mendojmë se avantazhet e sistemit “Një anëtar, një votë”, janë të dukshme ndaj sistemit tradicional të përfaqësimit, kjo nuk do të thotë se ky është sistem i përsosur. Por që aplikimi i këtij sistemi të ketë realisht sukses për të dhënë rezultatet e pretenduara në dobi të gjithë partisë duhet të mbrohet dhe të zbatohet me durim, në kohën e përshtatshme, dhe mbi të gjitha i shoqëruar dhe i rrethuar nga një vullnet pozitiv i strukturave përgjegjëse; për të pasur në rradhë të parë një klimë pozitive të shumicës,

për të ndërtuar një inventar të plotë dhe të saktë të numrit të anëtarëve, për të përcaktuar qartë modalitetet, strukturat dhe postet që do të votohen sipas këtij parimi.

Për Partinë Demokratike modeli i UMP-së franceze është më i adoptueshmi. Me këtë rast do të afroheshim së tepërmi edhe me filozofinë e ndërtimit të komitetit të politikave të zhvillimit dhe të hapjes reale të PD-së. Ky sistem e favorizon idenë e hapjes ndaj elitës, të rinjve të shkolluar, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të grupeve të tjera të interesit që dëshirojnë ta orientojnë kontributin e tyre për zhvillim në politikë. Ky sistem ndihmon edhe në krijimin e raporteve sa më të drejta të barazisë gjinore jo thjesht me 25% shin, por edhe me ballafaqim të vërtetë të vlerave dhe aftësive personale të grave që janë dhe duan të jenë aktive dhe të zgjedhura me meritë në politikë. Përveç se mënyrës së votimit për t'u zgjedhur nëpërmjet shanseve të barabarta, fuqia dhe kopetencat që merr kryetari i lejojnë atij të ndërtojë dhe të plotësojë ekipin drejtues me njerëz të aftë, por që për shkak të pamjaftueshmërisë së njohjes medjatiske mund të jetë më i dobishëm dhe më i beshueshëm për opinionin dhe për vetë partinë edhe se sa një drejtues që ndoshta ka përfitur nga zotërimi i një kapitali të mëparshëm politik. Pa një vullnet pozitiv dhe pa dashamirësinë e mjaftueshme edhe ky sistem mund të dështojë. Pastaj të zhgënjyerit mund t'u hapim rrugë mentaliteteve autoritariste dhe autokratëve që janë të gatshëm të shfaqen në raste të tilla si shpëtimtarët e të dëshpëruarve dhe ndëshkues të planprishësve. Mentalitetet hileqare nuk janë fantazi të momentit, por janë pjesë e realiteteve tona shoqërore dhe politike. Një arsye më shumë kjo për të na bindur se sistemi "Një anëtar, një votë", është demokracia e vërtetë, nga e cila do të dalë e dëmtuar filozofia e krijimit në mënyrë të sforcuar e elitës platoniane që shpesh është e sponsorizuar nga grupe të paqarta të interesit dhe monopolet ekonomike. Këto elita janë të prirura të instrumentalizojnë të gjitha llojet e pushteteve duke i vënë ato në shërbim të klaneve që i mbështesin. A nuk ndodh kështu sot tek ne? Përvoja na ka mësuar se çdo lloj elite ,qoftë ajo edhe më idealistja, kur nuk përfaqëson më interesat e shumicës që e mandaton, ka qenë e prirur të tjetërsohet në një oligarki të frikshme.

Demokratizimi real i partive do t'iu jepte mundësi qytetarëve të zgjidhnin, të gjykonin dhe të diskutonin platformat dhe programet e zhvillimit nëpërmjet mjediseve ku debati mes specialistësh apo edhe qytetarësh, do t'i bindte ata se në këtë parti të dëgjojnë, në këtë parti ti mund të shprehesh, dhe pas kësaj në këtë parti t'i mund të promovohesh, mund të ndihesh i rëndësishëm dhe mund të zgjidhesh. Sistemi "Një anëtar, një votë", do t'i kthente këto parti në parti elektorale, ku çdo degë do të

organizohej dhe do të funksiononte si një staf i përsosur elektoral, ku një vit përpara zgjedhjeve anëtari i partisë do ta dinte mirë vendin dhe rolin që do të luante ditën e zgjedhjeve.

Anëtari i partisë duhet të sqarohet se bashkësia jonë politike që quhet parti, funksionon si e tillë jo vetëm dhe thjesht për interesat e momentit të anëtarit apo militantit, por për jetësimin, nëpërmjet pushtetit të programit tonë electoral, në dobi të të gjithë qytetarëve, me dhe pa parti. Natyrisht edhe anëtari/militanti apo drejtuesi i partisë i ka të mishëruara interesat e tij brenda këtij programi për të cilin ai dëshiron të bindim të tjerët se është më i miri prandaj duhet votuar.

Sistemi, avokatinë e të cilit ne dhe NDI me përfaqësuesin e tij ne Shqipëri z. Dan Redford bëjmë prej disa kohësh, mendojmë se do të zgjithë shumë nga çështjet që perbëjnë problem për partitë tona, dhe liderët e tyre, ndaj të cilëve shpesh ngrihen akuza për manipulim dhe trafik votash në kongrese dhe në strukturat më të ulta të partive. Duke u konfirmuar me votat e anëtarësisë liderët e partive qendrore apo lokale do të jenë më të qetë dhe më të sigurt në misionin e tyre për t’u shërbyer votuesve.

Krijimi i edukatës dhe respektit për votën brenda partive do të ndikojë tek qytetarët për të pasur më shumë vlerësim për proceset e votimit dhe për zgjedhjet politike të të gjitha niveleve, do të rritet sigurisht pjesëmarrja në votime. Qytetari do të ndihet pjesë dhe faktor në vendimarrjen e partisë. Kjo do ta motivojë atë që nga një simpatizant në distancë të shndërrohet në një anëtar aktiv pse jo edhe pretendent për pjesëmarrje në nivele drejtimi. Në modelet e demokracisë së drejtë përdrejtë një nga parimet bazë është se shumica e « fortë » qeveris dhe drejton pakicën « e dobët», por duke u kujdesur që kësaj pakice ti sigurohet « mbrojtje » me ligje të veçanta. Sipas këtij parimi vendi që duhet të zërë pakica konkurrese duhet të jetë i përcaktuar në statut sipas rregullave që duhet të jenë të paracaktuara dhe të pa paragjykuara. Në statutin e UMP-së pakicë e konsiderueshme quhet atëherë kur ajo ka kapur 10% të votave. Në këto raporte bëhet edhe përfaqësimi në strukturat e partisë i kësaj pakice.

Përse tani?

Çështja e “Një anëtar, një votë”, duket se po merr terren së fundi edhe tek PD-ja pasi duket se lideri i opozitës z.Berisha e ka vënë re se për t’i rritur aksionet partisë që drejton, për ta bërë atë një forcë konkurrese që ta fitojë pushtetin me alternativën e saj, në vend që ta përfitojë atë nga dështimi i të majtëve në qeverisje, dhe mbi të gjitha për ta shndërruar

PD-në në një forcë kompetitive edhe per të ardhmen, nuk mjafton vetëm dëshira dhe thirrjet e sinqerta për pjesmarje, nuk mjafton vetëm lëvizja dhe zëvendësimi i disa figurave me disa të tjera shpesh me të njëjtin konsum mbi shpatulla, por duhet një formatim thelbësor i të gjithë strukturave të partisë.

Por edhe kjo do të ishte e pamjaftueshme nëse gjithsekush në detyrën dhe pozicionin politik që ka në parti besueshmëria nuk do ta ushtronte detyrën e tij me autoritet, me bindje, dhe me kredibilitet. Kjo parti kështu siç është, me këtë mënyrë funksionimi dhe organizimi me sistemin e delegimit, duket sikur e mbaroi misionin e vet. Ajo mbijetoi pas ngjarjeve të '97-es, dhunës dhe trysnisë që jo pak herë i kushtoi shumë. Ka filluar një etapë re. Shoqëria shqiptare ecën me një tjetër ritëm. Ne duhet të ndjekim ritmin e brezave dhe mentaliteteve sfiduese. Është bërë shumë për organizimin e PD-së pas '97 deri më sot, por të riformatohesh ndryshe nuk është mëkat kur konstaton mbylljen e Partisë. Është krijuar një traditë pozitive në marrëdhëniet me publikun për meritë të sekretarit përkatës, por të jesh më efektiv kërkon një tjetër vizion, informacion, staf me njerëz të aftë për ta bërë publikun të dallojë qartë mesazhin e opozitës. Shumë herë publiku nuk ka mundur të dallojë problemet parësore nga ato dytësoret, sepse intonacioni i zërit ka qenë i njëjtë për të gjitha çështjet, nga mos përputhjet, disa herë edhe të parakorduara, midis protagonistëve. Burimet njerëzore kanë qenë një praktikë e re për PD-në pas '98-ës dhe janë manaxhuar nga një personalitet i aftë dhe korrekt, por të ndertosh një strategji dhe një data base për ta « furnizuar » partinë me informacion mbi kontigjentet e duhura, me kapacitetet më të mira njerëzore, që ka partia, të dish p.sh. se sa studentë mbarojnë jashtë dhe brenda, sa prej tyre mund të merren me politikë dhe sa të tjerë do të jenë të gatshëm të ndihmojnë që kapacitetet e tyre intelektuale t'i kthejnë në vlera për zhvillimin e shoqërisë shqiptare, ja pra që ka nevojë për informatizim, dhe klasifikim të rezervave dhe kapaciteteve njerëzore etj. etj.

Ripërtëritja nuk do hezitim, ajo do aksion. Shekspiri ka thënë se “Bota është teatër, njerëzit janë aktorët, tani gjithësekush duhet të luajë rolin e tij”. Pikërisht tani është momenti për të guxuar, sepse jemi para Kuvendit të radhës. Formatimi i ri kërkon ndërhyrje ne statut. Sistemi «një anëtar një votë», modelimi dhe funksionimi ndryshe i partisë, nëpërmjet gjithëpërfshirjes, të djethtëve francezë iu dha një fitore bindëse në zgjedhjet e fundit të përgjithshme. Vlerat e këtij sistemi janë të dukshme. Avantazhet e tij gjithashtu.

23 Partitë politike dhe demokracia e brendshme e tyre

Xhuljeta Jaho

Përpara Shqipërisë dhe shqiptarëve sot shtrohet një sfidë me rëndësi jetike për të ardhmen e kombit tonë që është ajo e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ky proces realizohet nëpërmjet plotësimit nga ana e Shqipërisë të shumë reformave të cilat do të rrisin gradualisht shkallën e demokracisë në vend. Po a konvergojnë interesat politike që zhvillohen sot nga Qeveria dhe partitë e ndryshme politike në finalizimin e një qëllimi të tillë kaq të rëndësishëm?!

Kuadri i përgjithshëm i demokracisë

Demokracia si një sistem i ri i vendosur në Shqipëri, është e pa formuar mirë dhe e pa stabilizuar për shkak të sundimit të sistemit totalitar 50-vjeçar, i cili rrënjosi të njeriu ndjenjën e frikës dhe të nënshtrimit, krijoi ekonomi të centralizuar, sistem ligjor të ndërvarur nga politikat centrale, media të kontrolluar në mënyrë absolute dhe shkatëroi si koncept atë që është më e shenjta, pronën private.

Demokracia si një sistem ku vendimet merren nga një grup përfaqësuesish të zgjedhur, përfaqësues të një grupimi politik apo komuniteti të caktuar (minoritete), është sistemi që ka në bazë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, një votues realizohet nëpërmjet të drejtës së fjalës së lirë, zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, zgjedhje dhe heqjes paqësore të përfaqësuesve të zgjedhur nëpërmjet zgjedhjeve, të drejtës për të kandiduar në një post publik, të drejtës për të kritikuar mënyrën e qeverisjes, të drejtës për krijimin të shoqatave etj.

Por të gjitha këto të drejta që përbëjnë bazën e demokracisë, a e gjejnë shprehjen e vet në politikat dhe politikbërjen në Shqipëri?!

Periudha e tranzicionit, fatkeqësisht, na ka përballur me modelin më të keq të demokracisë. Klasa politike shqiptare nuk po kapërcen dot mbi interesat e ngushta partiake, dhe më keq akoma individuale, për të

realizuar ato parametra të demokracisë të sanksionuara në kriteret dhe kushtet e vendosura nga Bashkimi European për hapjen e bisedimeve të Stabilizim Asociimit. Që nga viti 1996 e në vazhdim nuk kemi asnjë raport të ndërkombëtarëve ku të mos theksohen të metat dhe parregullsitë e hasura gjatë zgjedhjeve. Ekonomia informale lulëzon ndërsa ekonomia formale është në kolaps. Për pushtetin gjyqësor, korrupsioni dhe mos respektimi i ligjit janë bërë normal dhe kanë marrë abuzivisht të drejtën e qytetarisë. Kjo ka çuar në humbjen totale të besimit të njerëzve tek drejtësia.

Administrata publike është një tjetër pengesë në rrugën e demokracisë tejet të politizuar, me emërimet dhe shkarkimet sa herë ka zgjedhje të reja. Moszbatimi i ligjit për statusin civil, ndryshimi i shpeshtë i ministrave dhe drejtorëve të drejtorive si dhe stafit në përbërje të administratës, sjellin mosefiçensë në punë dhe ngadalësim të zhvillimit të sektorit përkatës.

Krimi i organizuar është një tjetër problem i tranzicionit shqiptar. Varfëria ekstreme, pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe mosefiçenca e qeverisë është bërë shkak i zhvillimit të shpejtë të krimit të trafikut të qenieve njerëzore si ai i fëmijëve dhe grave. Droga kohët e fundit që po merr përmasa të frikshme.

Një nga shtyllat bazë të demokracisë janë edhe të drejtat e njeriut, që Shqipëria i ka ratifikuar në “Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut”. Por realiteti Shqiptar ofron shkelje të këtyre të drejtave duke filluar që nga e drejta për të votuar, keqtrajtimet e policisë, informimet publike, shkelja e të drejtave të grave të përfaqësuara në shifra shumë të ulëta në legjislativ dhe ekzekutiv, shkelja e të drejtave të pronës etj. Megjithëse në axhendat politike çështja e pronës zë një vend të rëndësishëm, në realitet, prona nuk ka vajtur tek i zoti. Ligji i miratuar për të është bërë pengesë për krijimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, dekurajon bizneset vendase dhe të huaja të bëjnë investime serioze, pengon zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit dhe gjeneron tensione sociale.

Sa më sipër janë produkt i politikave dhe politikbërjes të viteve të tranzicionit në Shqipëri. Partitë politike shqiptare dhe sidomos partitë që kanë pasur pushtet ndonëse në programet dhe strategjitë e hartuara i kushtojnë një vëmendje të veçantë hapësirës së këtyre programeve që ato të jenë në dukje sa më demokratike dhe të avancuara, në realitet janë ende larg parametrave të demokracisë. Demokracia, si e tërë, nuk mund të realizohet në qoftë se nuk demokratizohen të gjithë elementët përbërës të saj.

Kuadri demokratik brenda partive politike

Përveç partio-manisë që lulëzoi në periudhën postkomuniste, numri i të cilave mund të jetë një rekord për frymë të popullsisë, partitë kryesore të vendit dhe të tjerat me peshë të konsiderueshme në elektorat lënë shumë për të dëshiruar në demokracinë e tyre të brendshme. Format e organizimit të tyre, mungesa e një koncepti politik të avancuar, mekanizmat e brendshëm institucional dhe mungesa e mekanizmave llogaridhënës kanë bërë që kjo demokraci e brendshme të çalojë. Votuesi gjithnjë e më tepër po largohet edhe po bëhet indiferent karshi votimeve për shkak të mos materializimit të interesave të tij në politikat e zhvilluara nga partitë politike. Angazhimet e marra nëpër fushata elektorale nga kandidatët, më pas të zgjedhurit ka në mbetur demagogji fushate dhe nuk janë materializuar në projekte apo realizime të tjera ekonomike sociale apo kombëtare. Nuk kemi rotacion normal të drejtuesve më të lartë të partive që të vijë si rezultat i zbatimit të mekanizmave statutorë, por kemi zgjidhje të sforcuara të cilat lidhen me konjunkturën e brendshme partiake, grupet e interesave brenda dhe jashtë partisë që ndikojnë në politikbërjen e brendshme. Po t'i referohemi edhe rasteve të shkeljeve të statutit të partisë, i cili interpretohet në bazë të preferencave klanore dhe interesave të çastit, rezultatja nuk do të qe tjetër veçse kjo me të cilën përballemi çdo ditë. Egziston një mendësi, e trashëguar nga regjimi i kaluar, se maja e piramidës partiake i ka të gjitha aftësitë dhe mundësitë për të drejtuar, dhe shumë pak elementë të rinj mund të gjejnë hapësirën për të bërë ndryshime, dhe për të futur një frymë të re, një konceptim të ri, për të futur frymën e debatit konstruktiv dhe metoda të reja të organizimit partiak.

Në këto kushte ngelen pak shanse për të realizuar bazën e një demokracie të vërtetë dhe të qëndrueshme. Rezultat i politikave të ndjekura deri tani është e dhe ndarja e herë pas herëshme e partive të ndryshme shqiptare, pasi konfliktet brenda tyre dhe politikave të ndjekura për elementët që kërkojnë ndryshim brenda partisë, acarohen deri në largim të njëjës palë, pa gjetur konsensusin e nevojshëm në ballafaqimin e ideve dhe alternativave. Për pasojë kemi shkëputjen e njëjës palë nga trungu partiak bazë, dhe krijimin e partive të tjera të reja, në një ambient të tejmbushur me të tilla. Ky proces ka anët e veta pozitive dhe negative. Ndarja e parë që ndodhi në PD dhe ndarja e fundit në PS, mund të bëjnë të mundur që ndoshta buka e ardhshme e parlamentit të pas-zgjedhjeve të Qershor 2005 të mos ketë më parti mazhoritare në më shumë se 1/2 e tij. Kjo do të thotë që për çdo dekret apo ligj që do të kalohet në parlament, do të duhet një

bashkëpunim midis grupesh parlamentare apo partish të ndryshme, pra një konsensus më i gjerë dhe interesa më të mëdha. Aspekti negativ është se në këtë numër rekord partish shtohen edhe parti të tjera.

Por cili është mekanizmi që do të mund të vinte në lëvizje demokracinë e brendshme partiake, që do të bënte të funksionojnë dhe ingranazhet partiakë, për të rritur besueshmërinë dhe për të kthyer në votime të gjithë ata që sot e shohin me skeptiçizëm votimin për partitë e ndryshme shqiptare?!

Në fillim të vitit 2003 në programin e NDI për menaxhimin politik, pjesë e së cilës u bënë shumë anëtarë të partive të ndryshme politike, përfshirë dhe unë, u njohëm me sistemin e zgjedhjeve “Një anëtar, një votë”. Ky sistem ka të bëjë me zgjerimin e bazës së zgjedhjeve brenda partisë, për të bërë të mundur që çdo anëtar partie ta ndjejë veten të përfshirë në vendimarrje dhe të mos e delegojë votën e tij. Deri në atë moment në partitë tona politike, ky lloj sistemi ishte përmendur veçse në mënyrë sporadike, dhe pa i kushtuar një vëmendje të veçantë. Pjesë e debatit ishte dhe mënyra e realizimit dhe vështirësitë që mund të hasen në implementimin e një sistemi të tillë, dhe në infrastrukturën e nevojshme që duhet për ta aplikuar këtë sistem.

Duke qënë se të gjithë studentët e NDI ishin nga parti të ndryshme politike, të gjithë e përçuan këtë ide dhe këtë mënyrë shumë demokratike të funksionimit organizativ në subjektet e tyre politike. Nga diskutimet në forume të ndryshme partiake, nga seminarët e zhvilluara në të gjitha rrethet e Shqipërisë nga 12 studentë të trajnuar në Bullgari, dhe nga këmbëngulja e vazhdueshme e politikanëve të rinj, shumë parti politike duke e ndjerë të nevojshëm ndryshimin brenda strukturave të tyre të atrofizuara po e përqafojnë një nisëm të tillë. Sot mund të thuash se sistemi “Një anëtar, një votë” po bëhet një forcë lëvizëse brenda partive politike që tregon se brenda radhëve dhe strategjive të tyre ka filluar të zërë vend demokracia e brendshme.

Megjithatë, prezantimit dhe konsolidimit të sistemit “Një anëtar, një votë” si një element i rëndësishëm i demokracisë partiake, duhet t’i kushtohet kujdes që të mos të kthehet në bumerang në rastet e keqpërdorimit të tij. Kjo kërkon që partitë politike të përgatiten mirë nga ana statutore dhe e infrastrukturës, dhe njëkohësisht të bëhet njohja e këtij sistemi nga anëtarësia ku ajo do të aplikohet.

Si përfundim në qoftë se duam që tabloja e demokracisë së vendit të mos mbetet që është, në qoftë se duam që të shtrojmë rrugën për në Bashkimin Europian, rrugë e cila do të jetë e gjatë dhe e vështirë duhet

që elementët demokratikë të fillojnë të marrin jetë brenda partive politike për t'u reflektuar më pas edhe në qeveri dhe në të gjithë jetën e vendit. Një nga këta elementë është edhe parimi “Një anëtar, një votë”.

24 Anëtarësia dhe vullneti i saj

Florian Xhuti

Pritet dhe natyrisht do të realizohet funksionimi i sistemit “Një anëtar, një votë”. Megjithë debatin për kohën , kushtet teknike, pamjaftueshmërinë e infrastrukturës, i sigurt është fakti që politika shqiptare do të demokratizohet më tej nga aplikimi i këtij mekanizmi. Mendoj se çështja tani nuk shtrohet se cila nga partitë që veprojnë në spektrin politik shqiptar do ta bëjë e para të vetin këtë mekanizëm të shprehjes masive të votës së anëtarëve të saj.

Kur para dy vjetësh , përfaqësuesi i NDI në Shqipëri, z. Dan Redford fliste për këtë parim me anë të të cilit partitë realisht të demokratizuara të Perëndimit zgjedhin drejtuesit e tyre apo vendosin për çështje shumë të rëndësishme, na dukej sikur bëhej fjalë për një rregull që ekzistonte në një planet tjetër, zbatohet nga jashtëtokësorët dhe që aplikimi i tij këtu ishte pothuajse i pamundur.

Në rast se nuk do të kufizohemi vetëm në sipërfaqen e çështjes por do të shkojmë më thellë, do të konstatojmë se sistemi “Një anëtar , një votë “në thelb është proces klasik votimi ku qytetarët që kanë të drejtën e votës, zgjedhin përfaqësuesit e tyre për në parlament apo këshilla të tjera vendore. Pra kemi të bëjmë me sistem mazhoritar, ku në këtë rast kandidatët janë nga e njëjta parti, elektorati është anëtarësia e partisë dhe zona elektorale është shtrirja e partisë në të gjithë vendin.

E parë në raport të përgjithshëm efektet pozitive të sistemit për të cilin po flasim, janë disa herë më të shumta në numër se sa telashet që mund të dalin gjatë apo pas zbatimit të këtij parimi. Efektet pozitive që do të krijonte zbatimi i mekanizmit, që vë “në punë” të gjithë anëtarësinë e partisë , janë të ndryshme. Ne na duhet të vlerësojmë situatën që do të krijohet gjatë procesit. Le të fillojmë të analizojmë të dy palët që do të marrin pjesë në funksionimin e këtij sistemi. Në njërin anë do të jenë pretendentët për fitues dhe nga ana tjetër ata që do të bëjnë një prej këtyre kandidatëve të jetë udhëheqësi . Pra do të kemi një skenë ku të gjithë do

të jenë aktorë, si konkurentët dhe vlerësuesit e tyre. Në këtë rast nuk do të kemi një juri të ngushtë, por rolin e saj do ta luajë e gjithë anëtarësia e partisë. Në këtë mënyrë nuk do të ketë spektatorë, që megjithëse i tërheq shfaqja e dinë se ka një skenar të parashkruar.

Duke qenë pjesëmarrëse e gjitha në proces, anëtarësia bindet se partia nuk është vetëm e “njëshit” dhe e disa të tjerëve që rrijnë pranë tij. Dita kur anëtarësia thirret për të shprehur vullnetin e saj është një rast kur ata që shpenzojnë kohë për forcimin e partisë së tyre, realisht ndiejnë se kanë një shtëpi të përbashkët. Në këtë mënyrë manifestohet edhe lidhja e fuqishme e anëtarësisë me partinë. Pjesëmarrja në procese të tilla të rëndësishme siç janë zgjedhja e liderit, apo vendimi për çështje të mëdha, bën që secili anëtar të kuptojë se nuk është thjesht pjesë e evidencave të partisë, por ka në dorë një votë shumë të vlefshme, për të përcaktuar gjëra jo të vogla. Kështu si duket edhe kandidatët nuk do ta marrin aq lehtë synimin për të qënë në krye të partisë. Jam i bindur se do t’i takojnë vetëm të kaluarës rastet e shfaqjes së konkurentëve komikë që bëjnë sikur kandidojnë, e që siç dihet nuk bëjnë gjë tjetër vetëm krijojnë fasadën e konkurimit.

Me zbatimin e zgjedhjes së kreut të partisë nga të gjithë anëtarët e saj, ne do të shohim për herë të parë konkurrencën e platformave të secilit kandidat. Në fund të fundit ata do t’i prezantojnë mbështetësve të tyre një plan të qartë se çfarë do të bëjnë me drejtimin e partisë pasi të arrijnë të jenë kreu i saj. Deri sot politika shqiptare nuk ofron ndonjë shembull ku kandidatët për kryetarë të partive të caktuara të shprehen qartë për periudhën pas zgjedhjes së tyre.

Ç’është më e rëndësishme, secilit anëtar të partisë që do të votojë një kandidat të caktuar, përveç vlerësimit që ka për “emrin e mirë” që mund të ketë i preferuari i tij ka edhe një mundësi tjetër vlerësimi : “vizioni i liderit” që ai do të zgjedhë. Në këtë mënyrë konkurrenca dhe vlerësimi do të shfaqen në format e tyre reale të pandikuara nga pushtete të fshehta. Anëtarësia, lideri i ri i zgjedhur dhe mënyra se si do të drejtohet partia kësaj here kanë krijuar një raport më të qëndrueshëm. Kështu që secili votues do të ndjehet njëkohësisht edhe drejtues. Duke ditur më mirë se si do të drejtohet partia e tij nesër edhe anëtari i thjeshtë do ta ndiejë veten drejtues në raport me publikun e paangazhuar në politikë.

Aplikimi i “Një anëtar, një votë” sjell rritjen e pjesëmarrjes në votime

Motivi për të cilin aq shumë ka nevojë çdo pjestar në një formacion politik, do të marrë kuptim më të lartë. Masivizimi i të drejtës për të

votuar do të bëjë që shumica e anëtarëve të partisë të shohin me më shumë optimizëm të nesërmen. Jo pak raste ofrojnë demokraci të brishta, humbjen e dëshirës për të votuar. Shqipëria nuk përbën ndonjë përjashtim, përkundrazi mendoj se për shkak të demotivimit dhe mosbesimit se zgjedhjet do të sjellin zgjidhje, ajo vazhdon të shënojë kuota të ulta të pjesëmarrësve në votime. Nëse një pjesë e elektoratit që është e pa angazhuar nëpër parti të ndryshme politike do të votonte në mënyrë masive në këto organizma, atëherë besoj se do të kishim: Së pari një anëtarësi që do të ishte kontigjent i konsoliduar votuesish dhe së dyti do të ishin mesazherët më të mirë të partisë së tyre në elektorat. Ajo që do të vlerësoja si të rëndësishme është fakti që ne shqiptarët do të edukohemi me votën si të vetmin mjet demokratik për të bërë ndryshime.

Drejtuesit do të jenë llogaridhënës para zgjedhësve të tyre

Sistemet e zgjedhjes së liderit deri sot, ku delegatët janë të vetmit që ushtrojnë të drejtën për të zgjedhur, shoqërohet me fenomene që fillojnë të dëmtojnë demokracinë e partisë. Duke qenë një rreth i kufizuar njerëzish që vendosin, jo rrallë ndodh të ndërtohen marrëdhënie me mungesë të theksuar transparence ku shfaqet pushteti për shkak të njohjeve. Në qoftë se sistemi do të ishte “Një anëtar, një votë”, pjesëmarrja e madhe në proces do të sillte eliminimin e pushtetit sekret dhe do të shkatërronte trafikun e votës.

Po të shohim sot në të gjitha partitë politike në Shqipëri, ku sistemi i zgjedhjes bëhet me anë të votës së deleguar, përgjegjësia apo detyrimi i liderit ndjehet vetëm ndaj anëtarësisë së forumit që e ka zgjedhur. E kundërta do të ndodhte në sistemin për të cilin po flasim; vota e të gjithëve do ti bënte të zgjedhurit më të përgjegjshëm dhe më llogaridhënës. Detyrimi në këtë rast nuk do të ishte ndaj një salle me një numër të caktuar delegatësh, por një elektorat më i madh dhe me shtrirje gjeografike të gjerë.

“Një anëtar, një votë” për politikë të pastër

Një nga faktorët negativë që rrezikon sot politikën shqiptare është rreziku i uzurpimit të saj nga përfaqësues të fuqive financiare jo legale. Ky kontigjent do ta kishte shumë të lehtë të manipulonte një grup të kufizuar delegatësh, por asnjëherë nuk do të arrinte “t’i zinte sytë” të gjithë anëtarësisë së partisë. Sikurse ka thënë Abraham Linkoln: “Mund të gënjesh pak njerëz për gjithë kohën ose të gjithë njerëzit për pak kohë, por

kurrë nuk do të mundesh të gënjeshtë të gjithë njerëzit për gjithë kohën”. Kështu që sistemi masivizues i votës së anëtarëve të partisë në të njëjtën kohë minimizon edhe rrezikun e hyrjes së ”krimit në politikë”.

Nuk do të ishte aspak e lehtë për një lider të zgjedhur nga anëtarësia e gjerë që të devijonte platformën dhe programin e partisë. Asnjë udhëheqës apo grup i ngushtë njerëzish s’do të arrijnë të përdorin partinë për të forcuar pushtetin e tyre personal. Rastet e derisotme në Shqipëri tregojnë se “njëshi” bën ligjin. Pas zgjedhjes me sistemin “Një anëtar, një votë” drejtuesi do të jetë në një farë mënyre zbatues korrekt i asaj çka ka premtuar dhe për të cilën është votuar.

Megjithëse një element i ri për politikën shqiptare i prezantuar nga NDI, sistemi “Një anëtar, një votë” po diskutohet dhe kam bindjen që do të gjejë zbatim. Nëse aspirojmë të jemi pjesë e botës demokratike, në rradhë të parë plotësimi i detyrimeve për të qenë të tillë do të fillojë nga demokratizimi i brendshëm i partive politike. Niveli i këtij demokratizimi do të reflektohet patjetër edhe në jetën e institucioneve të ndryshme të vendit. Çdo përpjekje për të vonuar apo anashkaluar futjen e këtij mekanizmi mendoj se do të vonojë edhe plotësimin e synimit të shqiptarëve, integrimin euroatlantik. Kam përshtypjen se insistimi më i madh i iniciuesve të kësaj risije, pra i NDI, do të rriste më tej shërbimin e këtij institucioni ndaj shqiptarëve.

25 Decentralizimi politik dhe zgjedhjet e drejtpërdrejta nëpërmjet sistemit “Një anëtar, një votë”

Reiz Mulita

Imagjinojmë një çast, qytetarët votues, të cilët në mënyrë të lirë, ashtu sikundër përzgjedhin qeverisesin vendor (Kryetarin e komunës dhe bashkisë), të përcaktojnë orarin se kur i duan dyqanet hapur dhe mbyllur, ngjyrat e fasadave të pallateve, stacionet e urbanëve dhe oraret e tyre, prioritetet e zhvillimit urban, llojin e pemëve që zbukurojnë parqet dhe rrugët e qytetit, orientimin dhe drejtimet e zhvillimit të njësisë ku ata banojnë, etj.

Në rastin e imagjinuar dhe të dëshiruar njëherazi, mendimi i ofruar nga profesionistët teknikienë, mbështetet nga vullnetet e komunitetit dhe mobilizimi i tij për realizimin e programeve qeverisëse. Pa përmendur arsyet, kuptohet që efektet janë maksimalisht pozitive. Në këtë rast realizojmë një demokraci të drejtpërdrejtë në qeverisje.

Duke e zhvendosur vëmendjen në përzgjedhjet e drejtuesve dhe politikave partiake në Shqipëri, për analogji, do të konkludonim se nëse do të realizohej kjo mënyrë përzgjedhjeje dhe vendimarrje edhe në jetën e partive politike rezultatet do të ishin po të tilla.

Në një analizë të thjeshtë krahasuese midis shkallës së demokracisë në sistemin e zgjedhjeve për qeverisësit vendor dhe sistemin e zgjedhjeve të brendshme në strukturat e partive politike, vërehet së në partitë politike shkalla e demokracisë zgjedhore në vetë institucionet e partive politike, është më e vogël se në praktikat zgjedhore për qeverisjen.

Në fjalorin e përditshëm politik e qeverisës, qeverisjen e trajtojmë si institucionalizim të politikës. Parë në këtë këndvështrim, lind detyrimi i institucioneve të partive politike si gjeneruese të politikës për t’i paraprirë proceseve demokratizuese në jetën e vendit. Për hir të së vërtetës duhet pohuar se në Shqipëri mëson se demokracia në partitë politike dhe në jetën e vendit u ndërtua në një dekadë, teksa dëgjon udhëheqësit e partive politike, në përgjithësi, të spektrit politik të majtë e të djathtë, të mëdha e të vogla, të shprehen se partitë që ata drejtojnë bëjnë jetë

të brendshme demokratike, kanë vendimarrje demokratike dhe se do të ndërtojnë shoqëri demokratike, e kështu me rradhë. E ndërkohë dihet që ndërtimi i shoqërisë me demokraci politike e qeverisëse, është nga arritjet më të mëdha dhe më të përparuara në mekanizmin e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë njerëzore është arritur në shekuj mes përkrahesh dhe e kësaj përvojash pozitive. Mënyra se si janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe vendore, mënyra se si zhvillohen zgjedhjet në vetë partitë politike, shkalla e lartë e përqendrimit të pushtetit politik dhe administrativ nga shumicat partiake, mënyra se si operohet me administratën publike dhe civile, transparenca në vendimarrje, tregon se vendi është ende në fazën përgatitore të ndërtimit të demokracisë, madje në shumë tregues po aplikohet në mënyrë jo zhvilluese.

Decentralizimi i pushtetit politik dhe pavarësia e pushteteve qeverisëse në praktikën e vendeve me demokraci të përparuar, është përcaktuar si mekanizmi më efikas. Ai është cilësuar si matës i shkallës së demokracisë në një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë me sistem politik pluripartiak. Ndërsa shkalla e demokracisë në jetën e brendshme të vetë partive politike është reflektim i drejtpërdrejtë i shkallës së demokracisë në jetën e një vendi.

E thënë publikisht apo në heshtje, në Shqipëri, është fakt i padiskutueshëm që partitë politike drejtojnë jetën shoqërore e politike në nivel qendror dhe vendor, në qeverisjen qëndrore deri në njësitë më të vogla vendore. Kështu, partitë politike zgjedhin deputetët, qeveritarët, kryetarët e bashkive, dhe minibashkive, komunave, kryeqytetë, administratën publike dhe civile, përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, Komisionin Qëndror Zgjedhor, Kolegjin Zgjedhor, Entet Rregullatore, Këshillin Rregullator të RTV, etj. E thënë troç, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë partitë politike përzgjedhin drejtuesit e institucioneve kryesore qeverisëse. Ashtu sikundër edhe në sistemin politik uni parti, vetëm se në rastin konkret seleksionimi nuk bëhet nga një, por nga “disa” parti.

Përderisa partitë politike ndikojnë drejtpërdrejt në shkallën e demokracisë në vend, decentralizimi duhet së pari të fillojë nga jeta e brendshme e partive politike. Problemi që shtrohet lidhur me çështjen në fjalë, është ai i mekanizmit dhe matshmërisë së demokracisë së brendshme të partive politike. Të gjithë liderët aktualë, sot shprehen se partitë politike funksionojnë mbi bazën e demokracisë së brendshme, e ndërkohë nuk është e lehtë të kuptosh se edhe sikur të duash nuk mund të ndërtosh demokraci në jetën e një partie në një kohë relativisht të shkurtër.

Për shkaqe të së kaluarës dhe të tashmes të historisë së pluralizmit në vend, sistemi “Një anëtar, një votë” mund të jetë ilaçi më i mirë për

trajtimin e manisë dhe prirjes së lidërshiptit për përqendrim të pushtetit dhe praktikimin e decentralizimit ose demokracisë politike në jetën e vetë partive politike, në vend të përqendrimit të pushtetit politik a atij administrative, nga Ai.

“Një anëtar, një votë” parakupton që Kryetarin e Partisë ta votojnë të gjithë anëtarët e partisë. Në Shqipëri, kryetari i partisë në nivel kombëtar apo vendor nuk zgjidhet nga anëtarësia, atë e zgjedhin delegatët. Të gjithë e dimë sesi zgjidhen delegatët. Kryetari i partisë në nivel vendor përzgjedh delegatët që e zgjedhin atë kryetar, ai zonal zgjedh delegatët që e zgjedhin atë kryetar, e kështu procesi zinxhir i kontrollit të situatës në funksion të zgjedhjes së kryetarit të dëshiruar, me dije apo pa dije nga delegatët e çon ujin në mullirin e duhur deri tek “Ai”.

“Një anëtar, një votë” kërkon që vendimarrjet e partive politike për politikën kryesore të kenë miratimin e anëtarësisë së partisë më votë të drejtpërdrejtë. Asnjë nga partitë politike nuk e miraton në anëtarësi programin qeverisës apo të kundërshtisë opozitare. Anëtarëve të partisë i kërkohet vota për deputetët, kryetarët e bashkive dhe komunave, këshilltarët e tyre, por jo për programin dhe politikën, përzgjedhjen e emrave, e kështu me radhë. Pra demokracia është e mangët, e njëanëshme, vetëm detyrim, jo e drejtë për të përzgjedhur programe dhe emra, në rastin më të mirë është formale.

“Një anëtar, një votë”midis të tjerash, do të thotë efektivitet dhe legjitimitet. Sistemi në fjalë realizon përzgjedhjet më të mira për fitore. Votimi dhe pranimi nga anëtarësia i vendimarrjeve, automatikisht sjell mobilizimin e anëtarësisë për fitore, përndryshe fenomeni i çarjes në parti është i pashmangshëm, çka ndikon drejtpërdrejt në rezultatet elektorale. Shkalla e përsosjes së demokracisë në sistemin një “Një anëtar, një votë” kërkon edhe sensibilizim paraprak për vendimarrjet nëpërmjet votimit, me qëllim eliminimin e manipulimit masiv të anëtarësisë, sigurimit të një numri të caktuar mandatesh kohore, apo klasifikimit si i suksesshëm apo jo.

Institucionalizimi i sistemit “Një anëtar, një votë” është instalimi i legjitimitetit të qeverisjes së partive politike nga lidërshipti i tyre. Kjo është domosdoshmëri në kushtet e demokracisë së papjekur politike në vendin tonë. Arsyetimet e thjeshta që lidhen me çështjen në fjalë mund të vijojnë: A do të ketë shansin anëtari i partisë një nëndege të largët në veri apo jug të vendit të shprehet dhe të votojë vendimin që do të merit për koalicionin e ardhshëm parazgjedhor, të viti 2005?

Nëse çdo anëtari do t’i jepet mundësia që të votojë programet, politikën vendimarrëse, drejtuesit e strukturave në të gjitha nivelet, atëherë

ajo do të jetë më e vullnetshme, e obliguar, e mobilizuar, e pëgjegjshme, dhe efektive. Ndërsa vendimarrjet do të shndërrohen në evenimente transparente, do të tërheqin vëmendjen e votuesve, dhe do të krijojnë modelin e shembujve pozitive në komunitet.

Në të kundërtën, përveç rezultatit që në çdo rast do të jetë më i ulët, tregues të tjerë do të shoqërojnë ecurinë e jetës së brendshme të partisë. Modeli i zgjedhjeve nëpërmjet sistemit “Një anëtar, një votë” aktualisht ka edhe vështirësi objektive për t’u realizuar. Ai kërkon infrastrukturën fizike e financiare për t’u realizuar. Për më tepër ai kërkon përmirësimin e “infrastrukturës së ndërgjegjes” së anëtarësisë dhe së pari të lidhshimit të partive politike, çka përbën edhe vështirësinë më të madhe reale. Vlerësoj se është rasti që lidhshimi aktual i partive politike, nëpërmjet aplikimit të modelit në fjalë, ka rastin të demostrojë moshën e mendësive politike, që sikundër edhe jo rallë përmendet nga vetë “Ata”, nuk ka lidhje me moshën fizike.

Qyteti i Tiranës dhe çdo nëndegë e qyteteve në degët e partive nëpër rrethe mund të aplikojnë votimin e çdo anëtari për rastet e vendimarrjeve të rëndësishme, pa përfshirë rastin e zgjedhjeve të kryetarit dhe strukturave të tjera drejtuese. Të gjithë anëtarët e degës mund të marrin pjesë në konferencë, të jenë delegate, çka nënkupton vendimarrës, nëpërmjet votimit, duke e ushtruar demokracinë drejtpërdrejt. “Një anëtar, një votë” midis të tjerash parakupton disiplinë partiake, të lindur mbi legjitimitetin dhe pranueshmërinë e shumicës. Është kjo arsyeja që, parti të tilla si ajo Laburiste Angleze të cilës shpesh na pëlqen t’i referohemi si shembull i përparuar, praktikojnë modele të tilla.

26 Mrekullia e Demokracisë

Elvis Mataj

Mrekullia e demokracisë – provuar nga historia – është se ajo funksionon, nëse ndërtohet dhe përdoret ashtu siç duhet. Në ditët e sotme, duke hedhur një veshtrim mbi situatën në të cilën gjendet vendi ynë, jemi më tepër se të bindur që nuk po jetojmë një demokraci të vërtetë, aq më pak atë që në kontekstin e shprehjes së mësipërme do të mund të quhej “mrekulli”.

E gjithë kjo nuk rrjedh vetëm prej mënyrës se si partia-pushtet menaxhon qeverisjen, por shkon shumë më thellë, depërton deri tek parimet që partitë tona kanë përqafuar e i kanë bërë pjesë integrale të mënyrës së funksionimit të tyre. Një prej këtyre parimeve-motiv apo arsye është ai i delegimit të votës ose siç quhet” parimi i votës përfaqësuese”. Kjo duket se nisi të funksiononte në fillimet e hershme të proceseve demokratike në vendin tonë, jo sepse ishte mënyra më e mirë për të organizuar funksionimin e një partie, por për arsyen e thjeshtë se askush s’kishte vëmendjen e duhur për t’iu dedikuar kësaj çështjeje.

Njerëzit ishin mahnitur nga ideja e demokracisë, ku vetëm përmendja e fjalës ishte emocionuese për ta..., ku s’kish rëndësi se si kjo mënyrë e re qeverisje do të nxirrte Shqipërinë nga katastrofa e sapokaluar, s’kish rëndësi, madje, edhe nëse kjo fjalë do bëhej realitet apo do mbetej thjesht ëndrra e Shqiptarëve të sapodalë nga pesëdhjetë vjet komunizëm!

Ka kaluar më tepër se një dekadë që prej çastit kur ne nisëm të ecnim në rrugën e demokracisë. Ka kaluar e njëjta periudhë kohe gjatë së cilës s’kemi bërë asgjë për të nxjerrë vendin nga tranzicioni. Ndoshta ne gabuam! Ndoshta ne na duhej diçka më tepër se sa demokraci. Kështu që kur ne ta përbalnim këtë fenomen” më shume se demokraci” me rrethanat aktuale dhe realitetin , ndikimi negativ i këtyre të fundit, ta kalonte atë në nivelin e “ demokracisë”! Por kjo duket se është shume teorike, shumë përlllogaritëse dhe e verteta është ndryshe.

Duke u nisur prej konceptit të demokracisë, prej faktit që esenca e saj

është mundësia ku opozita shprehet lirisht, në çdo kohë, ndoshta jemi në gjendje të kuptojmë se cili element mund të bëhej rregullatori më i mirë për partitë dhe për politikën shqiptare. Ky është: Parimi “Një anëtar, një votë”.

Ky parim, me sa duket shumë më tepër se çdo parim tjetër, siguron një karakter bashkëpunues të vazhdueshëm të partisë. Kjo reflektohet në rezultate të tilla si : çdo anëtar i partisë është një anëtar vendimarrës jo vetëm për çështjet e rëndësishme politike, por gjithashtu edhe për zgjedhjen e kryetarit, kryesisë, përfaqësueve lokalë si edhe për kandidatët në zgjedhjet e pushtetit lokal dhe vendor.

Në këtë kontekst, parimi nënkupton që çdo anëtar ka të drejtën e një vote dhe dallon gjerësisht prej parimit tjetër ku individët/ anëtarët i japin apo i delegojnë një personi tjetër, autoritetin që të përfaqesojë mendimet e tyre me votën e tij. Parimi i delegimit të votës, në mënyrë evidente, lejon që një grup i vogël të ketë në duar kontrollin e gjithë partisë dhe aktivitetit të saj, të jetë grupi që vendos për drejtuesit “ e përhershëm” dhe që de facto është grupi që vendos për gjithçka: e rëndësishme apo më pak e rëndësishme qoftë ajo!

Dhe mbërrimë kështu në idenë aq të reklamuar e të përfolur në mediat tona , tepër të komentuara edhe nga ata persona që janë ushtruesit kryesorë të tij: monopolizimi i korsive! Dhe kjo, shkurt e shqip, përkthehet: Bolshevizëm brenda partive- Bolshevizëm në qeverisje- Bolshevizëm në mbarë Shqipërinë!

Por nëse dikur do të merresha së tepërmi me sheshimin e emocioneve që më shkakton kjo frazë, sot kuptoj se s`ka kohë për t`u emocionuar. Sot është koha të mbash qëndrim e të vendosësh. Është koha të ndryshosh.

Për shumë vite, dy partitë kryesore në Shqipëri PD-ja e PS-ja kanë abuzuar me besimin e elektoratit të tyre dhe të anëtarëve të tyre. Shqiptarët u mësuan të shihnin të njëjtat fytyra që qeverisnin, luanin, votoheshin, krijonin grupe manovrash, lobingje, elita dhe në fund ... përsëri votoheshin! Nuk ishte se njerëzit u besonin , ishte thjesht se përfaqesuesit e njerëzve i votonin ata.

Kështu, fatkeqësisht për ne dhe vendin tonë, pyetja-rezultat ishte: Po demokracia ku përfundoi? Është shumë e thjeshtë: Nese, sikurse thamë deri tani, rezultoi –aspak demokraci- brenda partisë, si mund të konvertohej kjo në – demokraci- në qeverisje?!

Njerëzit e panë se s`mund të bënin dot gjë pa hequr këtë klasë politikanësh-uzurpatorë. Ata nisën të lodheshin e të zhgenjeheshin prej politikës, braktisën kutitë e votimit, dhe anëtarësinë e tyre nëpër parti. Ajo që nisi të ndjehej, ishte se idealet e tyre mbetën thjesht ëndrra. Njerëzit

mund të dorëzoheshin dhe kjo s' ishte zgjidhje. Ata mund të bënin kompromisin dhe as kjo s' ishte zgjidhje. Gjithsesi duhej të ekzistonte një shpresë e re diku, një model i marrë nga ndonjë vend që ish rrahur me problemet e demokracisë më heret se ne, parimin “Një anëtar, një votë”.

Arsyet e lartpërmendura e bëjnë këtë parim, ndoshta jo më të mirin, por më eficientin dhe më të domosdoshmin, sidomos për vende të tilla si Shqipëria që kanë nevojë për demokratizime të menjëhershme në menyre që të kapërcejnë pengesat që ndalojnë procesin e zhvillimit dhe të integritit.

Është me se e qartë se ky parim do të përbejë një nga çelësat që do të zgjidhë krizën e vlerave dhe të përfaqesimit. Ky parim do të sjellë rritjen e interesit të përgjithshëm për aktivitetin politik. Ai, sigurisht do t'i bëjë më të përgjegjshëm dhe më llogari-dhënës politikanët tanë për vendimet dhe për detyrat që marrin.

Le të marrim një shembull nga e kaluara e pasur e politikanëve tanë demokratë e socialistë: s'ka rëndësi se çfarë thonë apo se çfarë premtojnë se do bëjnë. Vetëm diçka është e sigurt: Ata do votohen sërish nga miqtë e tyre në zgjedhjet e ardhshme! Dhe kjo nuk është aspak e drejtë, kjo nuk duhet të zgjasë më!

Ne kemi nevojë për politikanë të përgjegjshëm, për njerëz të punës që janë të aftë të sjellin ndryshime në realitetin shqiptar, që janë të aftë të ingranojnë Shqipërinë në rrugën e zhvillimit. Ne kemi nevojë për ata politikanë që kanë guximin të dalin e të japin llogari para votuesve të tyre për premtimet që kanë dhënë.

Po kërkojmë të kthehemi e të bëjmë të vërtetë, në menyre shumë më të avancuar, origjinën e fjalës politikan: Politikan do të thotë shërbëtor i popullit! Por nëqoftese anëtarëve të thjeshtë do t'u manipulohet e drejta e votës, atëhere kjo do të mbetet thjesht një utopi më shumë në sferën e mendimit politik shqiptar. Është kjo pra një arsye më tepër pse duhet të adaptojmë parimin “Një anëtar, një votë”, për të shmangur pushtimin apo përvetësimin e partisë nga klane të caktuara. Sot nuk është më koha për të vendosur censurë në procesin e votimit brenda një partie.

“Një anëtar, një votë”, do jetë “arma” e vendosur në duart e njerëzve e cila që do t'u mundësojë atyre mbrojtjen e të drejtave që gëzojnë, për t'i bërë të ndjejnë se idetë dhe veprimet e tyre janë të rëndësishme dhe kanë vlerë. Në ditët e sotme, është më se e nevojshme që anëtarët e partisë të kenë të drejta të barabarta vote, të kenë të drejta të barabarta në vendimarrje, në përzgjedhjen e drejtuesve dhe në kandidimin e tyre për t'u bërë udhëheqës.

Është kjo e vetmja mënyrë që e bën partinë të qëndrojnë e hapur ndaj ideve të reja , madje dhe ndaj atyre opozitare. Jemi kështu në gjëndje të kuptojmë se edhe nëse jemi pjesë e asaj “ minorance” që mendon ndryshe, ne kemi të paktën të drejtën të shprehim mendimin tonë e të votojmë për të. Parimi “Një anëtar, një votë”, ka në vetvete një tipar që e bën atë më eficient se çdo parim tjetër veçanërisht për vende si Shqipëria ku ka nevojë për më shumë transparencë e liri.

Ky parim bën të mundur që njerëzit të zhvillojnë aftësitë e tyre të vendimarrjes e politikëbërjes . Është kjo një arsye tjetër përse ai u përqaftua menjëherë nga LSI-së.

Që prej momentit që kjo parti ka përvetësuar parimin një anëtar-një votë, unë si anëtar i saj jam ndjerë me i konsideruar në marrjen e vendimeve dhe njëkohësisht më i përgjegjshëm për to. Shumë anëtarë të rinj kanë shtuar radhët e LSI-së pasi atje ka respekt për mendimin ndryshe si dhe demokraci në vendimarrje.

Jam i sigurtë që ka ndoshta shumë më tepër arsye e argumenta, që e bëjnë parimin “Një anëtar, një votë”, të përshtatshëm për partitë shqiptare.

27 Vota që ringjall demokracinë

Andrea Stefani

Nëse periudha e komunizmit mund të tipizohet me sloganin e mbretit drejt demokracisë është damkosur nga deviza e vullnetit gjithnjë e më shtypës të liderëve partiakë: “Partia jam unë”! Gjërat nuk kanë ndryshuar as shumë as edhe për mirë. Shqipëria përmbysi diktaturën komuniste por nuk arriti të përmbysë autoritarizmin. Autoriteti i diktatorit i simbolizuar me rrëzimin e bustit të Enver Hoxhës së vdekur, i hapi rrugë kulteve të gjalla të liderëve të rinj të politikës. Duket sikur Shqipëria ka pluralizuar vetëm sundimin duke e ramifikuar. Nga një sundimtari i vetëm që ushtronte shtypjen në emër të “diktaturës së proletariatit”, tani kemi shumë sundimtarë që ushtrojnë autoritarizmin e tyre në emër të “demokracisë”. Dhe është pikërisht maskimi me emrin dhe termat e demokracisë që e bën luftën kundër tyre gjithnjë e më të vështirë.

Shndërrimi i partive politike në vegla të ambicjeve për pushtet të prijsave është bërë sot gangrena e politikës shqiptare si dhe e demokracisë në Shqipëri. Nuk duhet harruar se sapo kemi dalë (13 vjet janë shumë pak) nga një regjim gjysëm shekullor ku Partia ishte Shteti. Ndërkaq nuk ka patur asnjë sistem politik ku roli i partisë dhe i liderit të saj të jenë glorifikuar aq shumë, të jenë ngritur aq lart (duke konkurruar madje edhe me vetë Zotin), sa nën regjimin komunist. Nënshtrimi që ngjallte ky kult nuk është çrrënjësor ende nga shpirtrat e njerëzve. Janë ende të shumtë ata që vazhdojnë të besojnë se shpëtimi nuk ju vjen nga liria, madje as nga Partia, por nga lideri që simpatizojnë. Ata vazhdojnë të besojnë se është lideri që bën demokracinë dhe jo ata vetë, qytetarët. Në vend që partia politike të jetë vegël e njerëzve, janë njerëzit që janë bërë përsëri vegël e partive dhe kjo e fundit, vegël e prijsave të tyre. Njerëzit hyjnë në parti më së shumti, jo që të kotribuojnë për demokracinë me lirinë e tyre, me mendimin dhe energjitë e tyre por, që të gjejnë te partia shpëtimin për hallet që ja u imponon një realitet tepër i ashpër ekonomik-social.

Sistemi komunist u përmbys por raportet njeri-parti-lider kanë mbetur po ato. Besimin në forcën apo afësitë magjike të liderit, mbeten premisë për krijimin e kultit të liderit “shpëtimtar”, të “Mesias” dhe e nënshtrimit me fanatizëm të verbër ndaj tij. Radhët e partive politike shqiptare janë mbushur jo me aktivistë të emancipuar nga shpirti i lirisë, por nga njerëz të nënshtruar që më së shumti, të kujtojnë mbushjen e legjioneve të ushtrisë romake me skllëvër në vitet e fundit të perandorisë. Në këto kushte nuk ka sesi roli i prijësit të partisë të mos ngrihet në rangun e një oligarku duke mbjellë përqark tij virusin e nënshtrimit. Dhe me marrjen e pushtetit ky virus i rrezikshëm antiliri, kalon edhe në shtet.

Nuk janë vetëm veçoritë e traditës politike në Shqipëri por edhe shumë faktorë të tjerë që i kalojnë kufijtë e saj dhe që kanë luajtur e luajnë një rol të fuqishëm në ringjalljen e autoritarizimit. Është mbi të gjitha vetë natyra e njeriut dhe e çdo organizate politike në përgjithësi. Shumë politologë të njohur kanë konstatuar se vetë organizimi dhe disiplina partiake kanë prirje organike për të zhvilluar autoritarizmin dhe oligarkinë. Njëri prej tyre, Robert Michels – i cili ka zbuluar edhe atë që quhet dhe ligji i hekurt i oligarkisë të cilit i nënshtrohet çdo organizatë politike – vërente se shpirti autoritar karakterizon domosdoshmërisht çdo organizatë të fortë. Po ashtu një lider mund të bëhet despot jo vetëm nga që është i keq. Me të drejtë është vërejtur se despotizimi i liderëve nuk ushqehet vetëm nga epshi vulgar ose egotizmi por më shpesh, është rrjedhojë e bindjes së thellë dhe të sinqertë në vlerën e vetvetes dhe të shërbimeve që kanë kryer për kauzën e përbashkët. Kjo vetndërgjegje, si dhe nënshtrimim, servilizmi apo duartrokitjet që i rrethojnë përgjithësisht liderët e partive, nuk mund të mos nxisin zhvillimin e ndjenjave vanitoze.

Natyra e partive politike, (ose më saktë fryma por jo ngjyra e tyre) është shumë e rëndësishme për demokracinë sa kohë që vetë partitë, edhe për shkak të traditës, merren shumë seriozisht prej shqiptarëve. Sepse fryma e partive politike ndikon drejtpërdrejtë në frymën e shtetit. Çështja është sesi të mposhten në jetën e partive instiktet autoritariste, thuajse genetike të çdo organizimi politik, por të fuqizuara nga tradita patriarkale dhe e kaluara diktatoriale shqiptare? Si të mposhtet ndikimi thuajse gravitacional i ligjit të hekurt të oligarkisë? Si të shpëtohen liderët të cilët mund të bëhen të rrezikshëm për demokracinë edhe pa qenë të vetëdijshëm për këtë?

Demokracia perëndimore është përpjekur të gjejë mjekimet e duhura për simptomat e sipërpërmendura. Një nga ato është zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë”. Nëse në shtetet e mëdha nuk është e mundur, ose është i mundur shumë rrallë, aplikimi i demokracisë direkte, kjo

nuk është e pamundur ose është e mundur më shpesh (veçanërisht me pasurimin e teknikës së telekomunikimit), në komunitete më të vogla siç janë partitë politike. Jo delegimi i votës por përdorimi i drejtpërdrejtë i saj nga anëtarët për çështjet më të rëndësishme politike, është mënyra e vetme për të shmangur jo vetëm abuzivizmin me pushtetin nga burokratët e lartë të partisë, por edhe fuqizimin e këtij pushteti në përmasa të pakontrollueshme. Shtrimi i problemit për domosdoshmërinë e zbatimit të parimit “Një anëtar, një votë” në partitë politike, është një moment i rëndësishëm në emancipimin e politikës shqiptare por ky është vetëm një fillim. Jemi vetëm në fazën thujse teorike dhe akziston gjithnjë rreziku që liderët shumë të fuqishëm partiakë, të publikojnë vullnet për zbatimin e këtij parimi jo që të fuqizojnë, por që të maskojnë mungesën e demokracisë në partitë e tyre. Nga ana tjetër, zbatimi i parimit “Një anëtar, një vote”, duke ju dhënë më shumë liri dhe atribut vendimarrëse anëtarëve të partisë, përmban të integruar edhe zgjidhjen e problemit të dytë, atë të çlirimit të partive nga superliderët e përjetshëm. Zbatimi i këtij parimi që ka në bazë lirinë e individit për një pjesëmarrje gjithnjë e më të madhe në vendimarrje, nuk mund të mos ketë për rrejdhojë edhe emancipimin me të madh të masës nga tutela e liderëve, pra edhe rritjen e natyrshme të presioneve konkurruese, demokratike dhe ndoshta edhe statutore, për ndërrimin e tyre. Dhe do të jetë një ringjallje.

28 Pafuqia fisnike e një parimi

Mentor Nazarko

Ndërsa po diskutohej për instalimin tek partitë shqiptare të parimit modern të funksionimit “Një anëtar, një votë”, dikush solli në bisedë shembullin e marrjes së drejtimit të partisë bolshevike ruse nga Stalini, pas vdekjes së V.Iliçit. Asokohe, megjithëse i zgjedhuri prej Leninit ishte Trocki, Stalini fshehu testamentin e babait të Partisë dhe zërave kundërshtues për shpalljen e tij kryetar ju përgjigj me votimin e postit të kryetarit në të gjithë anëtarësinë. Rezultati ishte tronditës: ai mori 93 % të votave.

Ka disa elementë të trashëguar prej kësaj partie që gjenden tek partitë tona kryesore organizuar sipas parimeve leniniste: anëtari paguan kuotizacionin, pranon programin dhe bën jetë partie në një organizatë, etj. Më tej: liderët partiakë kryesorë të tranzicionit, megjithëse të pangjashëm në shumë pikëpamje me Stalinin, po propagandojnë instalimin e parimit “Një anëtar një votë” në partitë respektive, por që për keqardhjen e tyre mbetet të bëhet në kongreset e ardhshëm dhe jo tani. Kushdo që i njeh si mjeshtra të manipulimeve të forumeve partiake si kongreset, Këshillat Kombëtarë apo kryesitë e partive, të opinionit publik, etj, i duhet të shohë ndonjë hile të re në këtë përpjekje konvergjuese të tyre për tu dukur modernë. Siç është lënia e një dere të hapur për veten pas zgjedhjeve të 2005-ës ku të paktën njeri prej tyre duhet të marrë përgjegjësinë e humbjes. Dera të çon tek rikonfirmimi më demokratik nëpërmjet votës së anëtarëve të thjeshtë në krye të partive. Dhe shembulli i Stalinit është pra një konfirmim i mirë për këtë truk të rradhës të liderëve shqiptarë Berisha, Nano që e lançuan këtë parim tani si ndonjë gjë të re, duke e refuzuar kur e propozuan rivalët politikë në kongreset e partive të tyre. Pra përtej analogjive të tjera duhet të dyshojmë në formula çudibërëse, që të vetme do të mund të ndryshonin realitetin aktual të partive shqiptare duke i demokratizuar ato. Ndoshta duhet parë mundësia e një reforme të gjerë që do të mbante parasysht edhe procesin e ndryshimeve shoqërore apo në

mentalitetin e individit, pasi nuk mund të ndryshojmë partitë pa mbajtur parasysh zhvillimet në sistemin ku ato linden, jetojnë, vdesin- në shoqëri. Partitë na interesojnë vetëm për atë rol që ato duhet të luajnë realisht siç thotë historia dhe manualët e demokracisë: për të krijuar presionin pozitiv të shoqërisë në institucione për ecje përpara, për rolin furnizues ndaj këtyre institucioneve me individë të spikatur, protagonistë të kësaj ecjeje përpara. Për të kuptuar se ku duhet të shtrihet reforma, le të bëjmë një analizë të thjeshtë.

Nisim nga mënyra sesi zgjidhen kryetarët e partive politike shqiptare në këto 15 vjetë pluralizëm. Kemi në njerën anë Partinë Socialiste që zbaton një mënyrë pak më demokratike zgjedhjeje, me kandidatë realë, pra me garë reale, megjithëse në përgjithësi janë të favorizuar kryeministrat kryetarë të cilët kanë mundësi të përdorin fuqinë emëruese në garantimin e rizgjedhjes. Ndërsa në historinë e opozitës nuk ka një rast të vetëm- me përjashtim të viteve të para të saj - që të jetë folur për garë reale dhe konkurim të ndershëm dhe kryetari themelues arrin të çimentohet në krye të partisë edhe për shkak të epërsisë mbi ata që mund të ishin rivalë të tij, epërsi diku intelektuale, diku në energji, diku në karizëm. Pra këta udhëheqës, megjithëse nesër mund të votohen edhe njëqind përqind nga anëtarësia e partive të tyre,- kanë kohë që nuk zgjidhen demokratikisht. Në një shikim më të gjerë, nuk mund të presësh partizanë të zgjedhjeve të lira në rrafsh kombëtar prej transformimit të këtyre individëve, të zgjedhur nëpërmjet procedurash jodemokratike, apo abuzimit me pushtetin ekzekutiv. Pra nuk mund të besosh në një shndërrim të tyre kaq të vrullshëm kah demokracia nëpërmjet parimit “Një anëtar, një votë”. Të dalë nga disfata zgjedhore apo qeverisëse, megjithëse me mbështetje elektorale të zvogëluar në zona super të sigurta-bastione të partive përkatëse, këta liderë afirmohen rrejshëm me mbështetje gjithnjë e më të lartë që i afrohet njëqindpërqindëshit në kongreset e partive të tyre të mbushur me burokratë partiakë. Atëheherë cili është ilaçi apo kura e ilaçeve për ta shmangur këtë gjendje, duke qenë se reformimi i sistemit politik shqiptar duhet të fillojë më së pari nga vetë partitë, ku mënyra e zgjedhjes së kryetarëve është vetëm njëri prej aspekteve, megjithëse thelbësor? Duke lëvizur në hapësirë,-si duhet kufizuar roli i shefave lokalë -luogotenentëve të partive që ndërtojnë në territoret që përfaqësojnë feude pushteti nëpërmjet zotërimit të politikës së emërimeve në njësitë qendrore dhe lokale të këtyre territoreve dhe vjeljes së favoreve që rrjedhin prej tyre? Sigurisht në forumet partiake duhen prurje të reja individësh me integritet që nuk vjen prej politikës, duke rritur rezistencën ndaj politikave personale të këtyre liderëve. Sigurisht duhet zgjerim i bazës së

vendimmarrjes dhe njerëzve të përfshirë në zgjedhjen e liderëve që të mos mbetemi në mëshirë të këtyre luogotenentëve. Pra duke e kaluar zgjidhjen tek anëtarët e thjeshtë: nga demokracia e përfaqësuesve që ka degjeneruar në një trafik gjigant influence, tek demokracia e drejtpërdrejtë. Votimi për zgjedhjen e delegatëve të kongreseve, të kryetarit të partisë dhe të kryetarëve të partisë së rretheve të bëhet sipas parimit “një anëtar një votë”. Por vetëm kaq është pak.

Ky ndryshim i madh, në mënyrë që të mos degjenerojë në shembuj të ngjashëm me atë të Stalinit, duhet të jetë pjesë e një procesi ndryshimesh që nisnin nga disa parime apo ide të tjera që e mbështesin parimin në fjalë. Pasi nuk është garanci vetëm fakti që me jetësimin e këtij parimi rritet në mënyrë të papërbalueshme kostoja e zgjedhjes apo e rizgjedhjes së të vjetërve për shkak të numrit më të madh të atyre që “duhen blerë”. Jo rrallë është spekuluar shumë me mbështetjen në bazë dhe ekziston rreziku i një spekulimi të ri të mbështetur në disa supozime mjaft realiste që të bëjnë ta shohësh me rezervë instalimin e veçuar të parimit “Një anëtar, një votë”. Së pari një proces i tillë votimi i shtrirë në tërë partinë kërkon një regjistrim të mirë dhe real të anëtarësisë. Në një vend ku regjistrimi i qytetarëve nuk është serioz megjithëse ekzistojnë detyrime dhe përgjegjësi ligjore për ta bërë një gjë të tillë, nuk mund të presësh të kryhet një regjistrim i përkryer në gjirin e partive. Më tej, nëpërmjet kalimit të votimit tek baza dhe abrogimit të “demokracisë së përfaqësuesve feudatarë” ekziston rreziku i shtimit të peshës së militantëve në jetën e vendit, duke rritur presionin për politikë të politizuar kuadri në jetën e institucioneve të vendit.

Jo zgjidhje e pjesshme, por globale

Ne na intereson demokratizimi i partive, jo thjesht dhe vetëm pasi na intereson mënyra e funksionimit të tyre, por sepse një cilësi e mirë e funksionimit partiak është parakusht për cilësinë e qeverisjes. Kjo cilësi pastaj është premisë e rritjes së cilësisë së jetesës së qytetarëve. Ritmet e ulta të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, incidentet e rënda në kursin e këtij zhvillimi, si piramidat, përpjekjet për ndryshimin e pushtetit me dhunë të armatosur, etj që kanë ndikuar në cilësinë e ulët të jetesës së qytetarëve, vijnë si pasojë e monopolizimit të udhëheqjes së jetës së vendit prej binomit të këtyre udhëheqësve. Ky monopolizim e ka bazën pikërisht tek forca e partive në jetën politike dhe institucionale të vendit. Nëse nuk do të ishte kështu, pra nëse forca e tyre nuk do të vinte prej partive, të dëshiruar për forcën pushtet ata do të kishin hequr dorë prej

posteve partiake dhe do të merreshin me veprimtari politike brenda institucioneve ligjore dhe kushtetuese, ku bëhet politika reale. Parë në rrafsh kombëtar, qoftë në hapësirë- hapësirën politike, qoftë në kohë-kohëzgjatjen e proceseve, legjislaturave, mandateve politike, etj, duhet të zvogëlohet rëndësia e partive dhe për pasojë e kryetarëve të tyre që marrin fuqitë si Anteu prej partisë, bazës së saj. Zgjidhja kalon nëpërmjet disa hapave të konceptuar me një llogjikë harmonike ku elektoralizimi i partisë, megjithëse jo shumë i praktikuar në Europë, pra kalimi në parti elektorale të tipit amerikan është moment kyç. Nëpërmjet tyre do të kishim funksionimin aktiv të partisë vetëm në kohë fushatash; kalimin e ballancës së forcës, të energjive, të cilësive më të mira njerëzore tek institucionet shtetërore.

1. Statutet duhet të sanksionojnë parimin e ndarjes së mandatit të kryeministrit me atë të kryetarit të Partisë për një periudhë të caktuar që duhet të koinçidojë edhe me evolucionin e dukshëm në mentalitetin e përgjithshëm dhe atë individual. Një hap i tillë justifikohet me periudhën e tranzicionit kur ende ekzistojnë reminishencat e partisë shtet; me nevojën e zvogëlimit të burimeve të forcës prej politikës së kuadrit për kryetarin ekzistues që e është mund të jetë kryeministër. Kjo ndarje siguron edhe ekzistencën e oponencës së brendshme parti-qeveri, e cila praktikisht është shuar në gjirin e PS. Në fund të fundit një ndarje e tillë do ta bëjë më pak oreksndjellëse detyrën e kryetarit të partisë.

2. Kryetari të dorëhiqet automatikisht në rast humbjeje të një fushate elektorale për pushtetin legjislativ. Kuptohet vlera e një propozimi të tillë: rotacioni në institucionet shtetërore do të imponojë rotacionin në drejtimin e partive. Kështu monopolizimi i partive prej të njëjtëve individë do të marrë një goditje të rëndë, por edhe të bazuar. Më në fund do të ulet dhe konfliktualiteti i pasqyruar në nivel kombëtar të atyre kryetarëve të cilët pasi i udhëheqin partitë e tyre drejt humbjeve elektorale, thërrasin më fort se ç' duhet për manipulimin e zgjedhjeve dhe destabilizimin e vendit.

3. Anëtarët e forumeve si KPD-të apo ekuivalentet e tyre duhet të zgjidhen nga Kongresi mbi bazën e listave të paraqitura nga kandidatët konkurrentë për postin e Kryetarit të Partisë. Në të gjitha rastet garantohet përfaqësimi në to në mënyrë përpjesëtimore me mbështetjen që gëzojnë platformat konkuruuese shprehëse të mendimit alternativ. Një masë e tillë, që ekziston në shumicën e partive perëndimore që pranojnë fraksionet në gjirin e tyre zvogëlon rëndësinë e kryetarëve, rrit konkurrencën brenda partive, zvogëlon shizmat, etj.

4. Deputetët e partive të jenë automatikisht anëtarë të forumeve më të larta. Si pasojë grupi parlamentar do të jetë struktura më e rëndësishme

politike dhe legislative e partisë. Për partinë në pushtet, kryetari i grupit parlamentar mund të jetë sekretari i përgjithshëm. Ndërsa për partinë në opozitë, si rregull, kryetari i partisë kryen edhe detyrën e kryetarit të grupit parlamentar. Për krijimin e qeverisë apo emërimin e ministrave dhe zëvendësministrave, kryeministri duhet të konsultohet më parë me grupin parlamentar duke konsideruar pikëpamjet e tij, përpara sesa të marrë hapat institucionalë në përputhje me Kushtetutën.. Të gjithë këto masa rrisin rëndësinë e institucioneve shtetërore në dëm të atyre partiake: politika reale zhvillohet dhe do të zhvillohet brenda tyre.

Mund të ketë edhe ide të tjera në këtë linjë zhvillimi të arësytimit politik. Kryesorja është të ruhet harmonia midis parimeve dhe ku asnjëri të mos konsiderohet si i një rëndësie unike. Dhe më së fundi duhet gjetur mënyra e afirmimit të tyre brenda partive kryesore, një detyrë fort e vështirë.

Disa përfundime

Krerët e partive të mëdha, mjeshtra të transformizmit politik ofruar në lloj lloj veshjesh- konsensuale, konfliktuale, moderatore, etj, po valëvisin flamurin e parimit “Një anëtar, një votë.” Vetëm partia e re LSI ka futur në statutin e vet një pjesë të këtyre parimeve, megjithëse mbetet të shikohet sesi do të zbatohen ato brenda saj në të ardhmen. E pra, që ky parim fisnik të mos degjenerojë për shkak të pafuqisë së vet, duhet shumë kujdes. Asnjë ide e vetme nuk mund të bëjë çudinë, një sistem idesh të harmonizuara, të zbatuara drejt po. Ndryshe rrezikojmë të shkojmë me vullnetin tonë, me duartrokitjet tona, në të kundërtën e asaj që dëshirojmë-në afirmimin e ri plebishitar të të njëjtëve udhëheqës. Megjithëse shoqëria ka ecur shumë përpara, megjithëse ka një presion të madh kulturor që vjen kryesisht prej atyre që kanë studiuar dhe studiojnë jashtë vendit do të kishim edhe të njëjtët qeverisës - protagonistë të statukuosë që le Shqipërinë mbrapa e që do të mund të largohet vetëm me revolta.

29 Mëdyshjet rreth parimit “Një anëtar, një votë”: Sfidë ndaj lidershipit, apo ndaj strukturimit politik?

Mero Baze

Prishja e rregullave të lojës jashtë partive, ka dëmtuar më shumë se mungesa e “demokracisë së brendshme” në mosndryshimin e lidershipit dhe keqstrukturimin e partive politike në Shqipëri. Për të parë realisht efektet e parimit “Një anëtar, një votë” duhet të jemi realistë në analizën e gjendjes faktike të partive politike në Shqipëri. Dy partitë e mëdha politike dhe imitimet e tyre, ndeshen në funksionimin e tyre, me dy probleme kryesore: me problemin e lidershipit dhe problemin e strukturimit politik të partisë. Për të qenë optimistë rreth parimit “Një anëtar, një votë” duhet së pari të shikojmë se çfarë ka shkuar keq tek kjo traditë e funksionimit të partive politike në Shqipëri dhe a mund të flasim realisht për një krizë lidershipi, apo për një krizë të strukturimit politik të partisë? Ta fillojmë nga e para.

Kriza e mekanizmave për ndryshimin e lidershipit

Të gjithë bashkohemi tek fakti se lidershipi i partive politike në Shqipëri ka mbetur i pandryshuar si për partitë 14 vjeçare të pluralizmit, ashtu dhe për partitë katërvjeçare apo katër mujore. Mekanizmi i ndryshimit të lidershipit në një shoqëri mbetet formalisht rezultati politik dhe votimi brenda partisë, mbështetur në këtë rezultat. Fakti që lidershipi nuk ka ndryshuar megjithëse partitë janë ballafaquar me rezultate të ndryshme politike, ka një histori specifike në Shqipëri, që lidhet më shumë me mungesën e rregullave të lojës jashtë partive politike, se sa me mungesën e rregullave të lojës brenda partive politike. Nëse marrim rezultatet e katër zgjedhjeve të para parlamentare, të cilat mund të përbënin shkak për ndryshim lidershipi, do të gjejmë shkakun real të këtij mosndryshimi.

Pas zgjedhjeve të para të lira në vitin 1992 lidershipi i Partisë Socialiste në opozitë ishte i detyruar të mbështetej rreth ideve të kryetarit të ri të asaj partie Fatos Nano, pasi në atë kohë ai ishte një hap më përpara

dogmatizmit të Partisë ish komuniste, dhe rezultatet e menjëhershme pozitive të zgjedhjeve lokale të Korrikut 1992, i jepnin atij legjitimitetin e kryetarit. Më pas në vitin 1993, ai u akuzua nën akuzën për korrupsion, me një procedurë të dyshimtë, por me një dosje të pasur. Ky arrestim, i cili përbën një mungesë të kulturës politike të partisë në pushtet në atë kohë, u bë shkak kryesor i ruajtjes së lidershit të zotit Nano në PS. Nëse Fatos Nano do të ishte i lirë, ne do të kishim eksperimentin e parë të ndryshimit ose përpjekjes për ndryshim të lidershit në pluralizmin në Shqipëri. Burgosja e tij dhe heroizimi prej skalioneve ekstreme, e bënë atë një lider të pakritikueshëm dhe Partinë Socialiste, një parti militantësh agresivë dhe revolucionarë. Një përpjekje e zbehtë e një grupi reformator në vitin 1996, dështoi pasi ishte në një linjë me politikën e partisë në pushtet, kështu që zoti Nano fitoi i vetëm nga burgu dhe pa kundërshtarë drejtimin e partisë në verën e vitit 1996. Por më shumë sesa burgosja e tij, fitorja e tij në Kongresin e verës së vitit 1996, kishte të bënte me mungesën e rregullave të lojës jashtë partisë së tij. Zgjedhjet e majit 1996 u destabilizuan dhe praktikisht u bënë të pavlefshme. Rezultatit galopant i Partisë Demokratike nuk ishte real, megjithëse ajo mund të ishte parti fituese. Ky zhvillim negativ, i hoqi klasës politike në Shqipëri shansin që lidershi i një partie të gjykohej nga rezultati politik. Fatos Nano nuk mund të shkarkohej nga partia e tij dhe nuk mund të jepte dorëheqje, pasi ai ishte tashmë një lider i paverifikuar. Rënia e zgjedhjeve të Majit 1996 ishte fillimi i rënies së mekanizmit të ndryshimit të lidershit politik në Shqipëri. Pas atyre zgjedhjeve, parregullsitë në zgjedhje dhe mospranimi i rezultateve ndoqën njëra-tjetrën dhe lidershi politik i dy partive të mëdha ka pasur gjithmonë të drejtë që të shmangë këtë mekanizëm në marrjen ose dorëzimin e mandatit në krye të një partie.

Zgjedhjet e vitit 1997 “të pranueshme për momentin” rikthyen de jure në krye të opozitës Sali Berishën, i cili tani do të duhej të drejtonte një parti në opozitë. Sprova e tij e parë, referendumi për Kushtetutën, i dha thujtë të drejtë atij, pasi thirrjes për bojkot iu përgjigj një masë e madhe dhe e paverifikuar elektorati. Nën akuza të besueshme se rezultati u manipulua, duke u shtuar artificialisht pjesëmarrja, Berisha arriti ta paraqesë atë si një sfidë reale të opozitës, ndërkohë që në disa zgjedhje të pjesshme lokale, kishte arritur sukses.

Zgjedhjet e tetorit të vitit 2000 u dominuan nga parregullsi masive që bindën realisht elektoratin e opozitës për manipulime. Po t’i shtosh kësaj bindjeje, edhe agresionin politik antiopozitar dhe përfshirjen e shtetit në lëvizje për të ndryshuar dhe kontrolluar lidershipin e opozitës, u bë shumë legjitime mbështetja që Sali Berisha gjente nga krahët më radikalë

të opozitës. Antiopozitarizmi si lëvizje politike u thellua dhe më deri në zgjedhjet e vitit 2001 kur Partisë Demokratike iu mor sigla e saj dhe iu dha një partie të emëruar nga qeveria si opozitare. Rezultati i zgjedhjeve të vitit 2001 ishte nga më të pandershmit për një proces elektoral. Rreth 40 mandate u dhanë nga Gjykata Kushtetuese në mungesë të plotë të seriozitetit për gjykim ndërsa fakte skandaloze flisnin për një manipulim me dhunë të votave. Pas kësaj beteje lidhshipi i opozitës ishte sërish në pozita të forta për t'u mbrojtur, pasi të gjithë e kuptonin se opozita po ndëshkohej nga një lëvizje shtetërore e cila synonte ndryshimin e lidhshipit të opozitës, përmes humbjes në zgjedhje. Pra përpjekjet shtetërore për ndryshimin e lidhshipit të kundërshtarëve, të cilat kanë filluar qysh në kohën që drejtonte Partia Demokratike dhe që u kthyen në sistem në kohën që qeveris Partia Socialiste, janë shkak kryesor për manipulim zgjedhjesh dhe mosndryshim lidhshipi. Të dyja partitë politike kur kanë qenë në pushtet, kanë ëndërruar një kundërshtar të dobët dhe kanë prekur zgjedhjet për të ndryshuar lidhshipin duke e shpallur humbës. Por në fakt këtu kanë dështuar, pasi duke dëmtuar mekanizmin e zgjedhjeve të lira ato i kanë dhënë imunitet lidhshipit aktual. Këto zhvillime flasin qartë se ne nuk kemi një krizë lidhshipi por një krizë të mekanizmave për të ndryshuar lidhshipin.

Kriza e strukturimit dhe ndikimi i modelit të komunizmit

Problemi i parë që lindi bashkë me pluralizmin në Shqipëri, ishte modeli i strukturimit të partisë së parë opozitare. Ajo ishte e detyruar të strukturohej sipas modelit të ish Partisë Komuniste, pasi atë kishte kundërshtar për të mundur. Nën këtë model Partia Demokratike u organizua me “organizata” që i quajti formalisht “seksione” me komitete rrethesh që i quajti këshilla dhe Komitet Qendror që e quajti Këshill Kombëtar. Pavarësisht emërtimeve, struktura politike ishte njësoj. Veprimtarët e saj u organizuan kështu në fshatra dhe qytetet dhe delegonin votën e tyre për strukturat qëndrore të partisë. Brenda këtyre strukturave mungonin gara dhe konkurrenca, pasi përveç rezultateve në grup, askush nuk ka mundësi të identifikohet personalisht. E strukturuar si një parti e centralizuar, ky model u shtri në të gjitha partitë dhe vazhdon dhe sot në partitë e reja që krijohen. Kjo krizë e strukturimit të partive, i largoi partitë e mëdha shqiptare nga strukturat elektorale dhe i ktheu në parti militantësh dhe njerëzish me ndikim, dhe shpesh dhe për arsye jopolitike. Kështu grupe interesi për një parti politike tani janë jo vetëm militantët, por dhe njerëzit e pasur, njerëzit e fortë, kriminelët, njerëzit e shtypit e gjithçka tjetër

që ndikon për të përmbytur një rezultat real zgjedhësh. Strukturat e partive politike zhvillohen në një orbitë tjetër nga strukturat e qeverisjes dhe vendimarrjes dhe shumica e qytetarëve nuk kanë asnjë interes për to, përveç rastit kur duan të përdorin pushtetin politik. Për shembull një fshatar shqiptar nuk ka asnjë interes për asnjë parti politike dhe programet e saj, pasi fshati nuk ka më asnjë lidhje me sistemin qeverisës në vend. Ai nuk taksohet, nuk kreditohet dhe nuk bën pjesë në buxhetin e shtetit. Për këtë arsye ai është i papërgjegjshëm kur shkon ose kur nuk shkon tek kutia e votimit. Strukturat politike në fshatra kanë degraduar kështu në struktura thuajse mafioze ose struktura force, por jo struktura politike. Ato shërbejnë për të rrëmbyer vota, por jo për të rritur autoritetin politik të një partie. Këto struktura, e ke të pamundur t’i ndryshosh, edhe sikur të kesh vullnet, pasi ato nuk janë prodhuar nga mekanizmi politik, por nga nevoja politike për të marrë vota të papërgjegjshme politikisht. Për të ndryshuar këtë situatë, më shumë se sa parimi “Një anëtar, një votë” duhet të shkojmë drejt partive elektorale, ku i përfaqësuesi i pushtetit të jetë figura qëndrore e partisë. Kështu siç janë partitë në Shqipëri, tek njerëzit funksionon ende ideja e komandantit dhe Komisarit, ku Komisari është më i rëndësishëm. Nëse ne do të shkonim drejt strukturave elektorale të një partie, kryetari i Grupit parlamentar do të ishte figura qëndrore e partisë, deputeti figura qëndrore e partisë në zonë, i zgjedhuri komunal më i rëndësishmi i partisë në fshat dhe lagje etj.. Kështu ne do të arrijmë të lidhim qytetarët me politikën, në mënyrë natyrale duke rritur interesin e tyre për zgjedhjet dhe përgjegjësinë e tyre për votën. Ndryshe ne do të shkojmë drejt degradimit të strukturave të partive në struktura që shesin dhe blejnë vota për zgjedhje. Në kushtet e një vendi me indeks të lartë korrupsioni siç është Shqipëria, kjo situatë mund të lejojë të qëndrojë në pushtet një strukturë mafioze për dekada të tëra, pasi njerëzit i shikojnë zgjedhjet si shans për të përfutuar strukturat politike dhe për të krijuar burokracinë opozitare.

Kam frikë se aplikimi i parimit “Një anëtar, një votë” për strukturat e partisë, pa i lidhur ato me strukturat e pushtetit, do të degradojë sërish strukturën politike në vend. Pra nëse në një zonë elektorale do të kemi një të zgjedhur të partisë sipas parimit “Një anëtar, një votë” do ta kemi shumë të vështirë që aty të kemi dhe një kandidat për deputet, serioz, nga kjo parti, pasi “komisari” i zgjedhur mund të shkatërrojë gjithçka. Do të jetë më mirë që i zgjedhuri i partisë të quhet ai që konkurren për deputet në atë zonë, dhe të krijohen struktura që furnizohen nga këto elementë. Ndryshe do të ndodhë një hendek i ri mes të zgjedhurve të partisë dhe të zgjedhurve të pushtetit dhe nuk do të kemi as ndryshim lidershipi,

pasi lidershipi aktual e siguron lehtësisht shumicën, sipas këtij parimi, as ndryshim strukturash.

Po e ilustrim me një shembull nga opozita. Partia Demokratike ka fituar në zgjedhjet e fundit qytete të rëndësishme si Saranda, Elbasani Korça etj.. Të zgjedhurit në pushtet janë figura të reja me reputacion që kanë marrë më shumë vota se Partia Demokratike. Po t'i verifikosh në këto momente, raportet e tyre janë në krizë me Partinë Demokratike, pasi interesat e lidershipit rajonal të kësaj partie janë më të vogla se interesat e lidershipit në pushtet të kësaj partie. Kështu megjithëse lidershipi partiak mund të jetë legjitim në këto rrethe, ai nuk është më legjitim se lidershipi në pushtet në këto rrethe, por në vend që këto dy lidershipe të funksionojnë bashkë, funksionojnë ndaras. Kjo krizë duhet të tejkalohet duke iu nënshtruar Partia Pushtetit, dhe jo Pushteti Partisë. Parimi “Një anëtar, një votë” në mungesë të strukturave të besueshme elektorale brenda partive duhet të merret i mirëqenë ai i zgjedhjeve parlamentare apo lokale dhe të merret si kriter fillimisht për karrierë politike. Nuk ka asnjë vlerë politike legjitimiteti i një lideri që sipas parimit “Një anëtar, një votë” fiton në krye të partisë dhe humbet në zgjedhje parlamenatre apo lokale. Kështu që është më mirë të marrim të mirëqenë rezultatin publik të partive se sa rezultatin e brendshëm të tyre. Por për të marrë këtë kriter duhet që të luftojmë që në vend të bëhen zgjedhje të lira, të cilat mes të tjerash janë kushti kryesor për verifikimin e lidershipit dhe për rezultatin politik të partive. Tendenca për të ndryshuar lidershipin e kundërshtarit duke vjedhur zgjedhjet, ka sjellë regres në këtë vend, po aq sa dhe tendenca për t'i detyruar të vjedhurit të pranojnë rezultatin e dhunshëm. Parimi “Një anëtar, një votë” duhet të zbatohet si parim që strukturon partitë politike në Shqipëri, por jo si qëllim në vetvete, por në funksion të strukturave elektorale. Fuqia e administratorëve të partisë duhet të dobësohet ndjeshëm dhe ata duhet të jenë kujdestarë të inventarit fizik të partisë, kurse kujdestarë të inventarit politik duhet të jenë të zgjedhurit e partive në struktura të pushtetit apo më të suksesshmit në këto gara. Kështu do të sigurojmë një mekanizëm që do të na çojë drejt konkurrencës duke hedhur përtej krahëve monopolin e lidershipit dhe strukturat centralizuese dhe jopërfaqësuese të partive politike. Kur të krijohet kjo traditë dhe kur të dobësohet ndjeshëm roli i koordinatorëve lokalë të partisë në përcaktimin e të zgjedhurve atëherë lidershipi i të zgjedhurve do të jetë shumë më autoritar se lidershipi partiak. Ky është momenti që mund të kthejë në organizimin e partisë, parimin “Një anëtar, një votë”. Kështu siç janë sot strukturat politike të partive, kalimi në këtë parim, fuqizon antivlera dhe ndihmon në ruajtjen e të njëjtit lidership, pasi nuk krijon interesa të reja. Po të bësh anketë

brenda Partisë Demokratike apo Partisë Socialiste për të zgjedhurit e saj në pushtet, strukturat e partisë janë gati t’i linçojnë, pasi ata përfaqësojnë më shumë se sa partia. Ky parim vlen i plotë për partitë në vend kur ato të jenë bërë tërësisht parti elektorale dhe jo parti seksionesh apo KPD-sh. Kalimi nga parti të centralizuara, në parti elektorale dhe pastaj në parti të strukturuar sipas parimit “Një anëtar, një votë” nxit konkurrencën dhe garën politike në vend. Aplikimi dogmatik i këtij parimi, në këtë gjendje të strukturës politike në vend mund të nxisë regresin.

30 Pushtet i deleguar? Jo, pushtet i drejtpërdrejt!

Martin Leka

Pas gati një dekade e gjysmë nga rënia e regjimit komunist dhe hapjes së Shqipërisë drejt Perëndimit, vendosjes së pluralizmit politik dhe përpjekjeve për një demokraci të zhvilluar, situata politike në Shqipëri vazhdon të ketë problematikën e vet të vecantë. Rruga e politikës shqiptare nga fillimi i viteve '90 deri sot, është përshkruar nga një trajektore, e cila jo rrallë, ka pësuar disa thyerje të mëdha, të cilat mund të kishin qenë fatale për vendin. Në koshiencën e qytetarëve shqiptarë vazhdojnë të ruhen të freskëta pikat kulmore të ngjarjeve të ndryshme, ku ata kanë humbur totalisht besimin tek politika, por duke mos humbur besimin tesh shpresa. Shumë prej këtyre rasteve, ndonjëra prej të cilave ende edhe sot përjetohet si dramë, kanë vënë në pikëpyetje vetë ekzistencën tonë. Ngjarjet e vitit 1997, kur në Shqipëri nuk mbeti njeri i paarmatosur dhe ku viktimat e shumta të kujtojnë imazhe të një “lufte civile”, apo sulmi i armatosur mbi institucionet shtetërore në fillimvjeshtë të vitit 1998 janë shembulli më i qartë dhe “etaloni” nga ku të gjithë duhet të dallojnë të keqen që mund t'i vijë një kombi nga papërgjegjshmëria e politikës.

Sigurisht, këto devijime “in extremis” të zhvillime politike e demokratike të Shqipërisë, i kanë rrënjët e tyre nga koha e largët e komunizmit, kohë e izolimit total, e intolerancës totale, e mungesës së kulturës dhe informacionit mbi pluralizmin e demokracinë, kohë e krijimit të mitit e kultit të individit, e pushtetit absolut, etj. etj. Zhvillimet e vrullshme të viteve '90, në këtë situatë e në këto kushte, nuk mund të sillnin produkte të tjera politike, përveçse të tilla, me prejardhje kulture e formimi nga regjimi i vjetër, i cili kishte krijuar në subkoshiencën e secilit dogmën si teori e autoritarizmin si praktikë. Shfaqja më konkrete e kësaj dukurie mund të vërtetohet në profilin e liderëve e udhëheqësve të tjerë të dy partive politike që na kanë qeverisur këto 14 vjet. Përmendëm pak më sipër vetëm dy nga ngjarjet më trishtuese e dramatike që e çuan vendin në buzë të greminës, por ka edhe plot fragmente të tjera ku devijimet nga

teoria dhe praktika e një demokracie të vërtetë, e kanë lënë Shqipërinë ende larg strukturave europiane e euroatlantike. Sigurisht, me këta shembuj nuk kemi sesi të krijojmë një “mjegull nihilizmi”, pasi çdokush është dëshmitar edhe i shumë arritjeve të rëndësishme të zhvillimeve në vend.

Me vendosjen e pluralizmit dhe krijimin e të parës parti opozitare në Shqipëri, u krijuan edhe parti të tjera më të vogla në numër e po kaq të vogla edhe në anëtarësi. Por pas zgjedhjeve të para pluraliste e në vazhdim, krijimi i partive të reja u kthye në një “virus”. Aq sa sot, vetëm pas 14 vjet të jetës pluraliste, në Shqipëri numërohen mbi 80 parti politike, që për nga territori, numri i popullsisë, përvoja demokratike, numri i votave në konkurim apo edhe nga vetë numri i atyre që kanë mundur të konkurojnë në zgjedhje, përbën një rekord më vete. Shumica e këtyre partive janë thjeshtë për evidenca statistikore dhe kaq. Atyre nuk i’u njihen programet, statutet, nismat, projektet politike, madje për të mësuar se kush i udhëheq ato, duhet të humbasësh shumë kohë, pasi për publikun janë krejtësisht anononimë. Ato janë thjeshtë, parti të paorganizuara, fiktive. Por, partitë e mëdha, ato që përfaqësohen dhe përballen me qytetarin në kutitë e votimit, vuajnë ende nga një sërë “sëmundjesh” teorike, programore, statusore e të drejtimit. Sot, është e vështirë të dallosh për nga mënyra e drejtimit të qeverisjes dhe reformave në vend, të majtën nga e djathta e anasjelltas. Partive u mungon një vizion i qartë, demokratik e shkencor i drejtimit dhe veprimit praktik. Ato tregohen shumë pragmatiste. Për hir të mbajtjes sa më gjatë të pushtetit, ato devijojnë shpesh nga parimet, nga programet e nga premtimet para votuesve e qytetarëve të tyre për interesa mesquine. Është kjo një ndër arësyet kryesore pse në mënyrë periodike, vazhdon të ketë rënie të numrit të votuesve në zgjedhjet e përgjithshme e lokale.

Një problem themelor dhe një shqetësim për qytetarët dhe forcat intelektuale e reformatore edhe brenda partive politike, vazhdon të mbetet mungesa e demokracisë së brendshme të vetë partive. Kjo është shfaqur herë pas here në partitë kryesore, ku prej tyre janë shkëputur disa herë grupe të ndryshme, duke krijuar edhe formacione politike. Kjo ka ardhur pikërisht nga mungesa e demokracisë dhe krijimi i një klime mbytëse për ide apo forca njerëzore që kundërshtojnë lidërsipet e partive. Për ta konkretizuar këtë, mund të përmendim faktin se pas 14 vjetësh, edhe pse kanë humbur disa zgjedhje, ashtu sic edhe kanë fituar, udhëheqës të partive kryesore politike janë po ata, Nano, Berisha, Gjinushi, Ceka, Xhuveli, Mediu, etj. Kjo dukuri, përpos mentaliteteve të vjetra që sundohen nga lidërsipet, vjen edhe nga mungesa e një parimi thellësisht demokratik “Një anëtar, një votë”, term që ka filluar të lakohet kohët e fundit.

Vetëm pak ditë pasi LSI sanksionoi në dokumentat e saj themelore parimin demokratik “Një anëtar, një votë”, këtë term e përdori në një forum partiak kryetari i PD-së dhe më pas, po në një forum të tillë, edhe kryetari i PS-së. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ndërmori ndonjë hap konkret për përfshirjen e këtij parimi në dokumentat zyrtare të partive përkatëse. Kjo të bën të arrish në deduksionin se kjo mund të jetë demagogjia e radhës, e përdorur thjesht në një përpjekje për ndryshim imazhi. Këto parti vazhdojnë të zbatojnë parimin e një demokracie përfaqësuese në vend të asaj direkte. Strukturat zgjedhin disa përfaqësues e këta disa të tjerë në piramidat strukturore të partive, gjersa vota e deleguar e mijëra e mijëra anëtarëve të partive apo simpatizantëve përfundon në nja 500-600 delegatë të një kongresi, më pas të nja njëqint e ca të tjerëve e kështu me radhë. Krijohet kështu një hendek i madh përfaqësimi, mjaft i përshtatshëm për manipulime e për krijimin e një “ishulli të garantuar” interesash për një pakicë, aq sa të krijohet përshtypja se këta udhëheqës nuk i lidh e afron kurrfarë parimi, përveç interesit, nga ku burojnë shumë fenomene mjaft të kritikueshme sot si korrupsioni, trafiket, monopolet, etj. Përvoja e dy partive më të mëdha tregon se sa të vështirë do ta kenë këto lidhshipe “historike” pranimin dhe zbatimin në praktikë të parimit “një njeri, një votë”. Po pse i tremben lidhshiptet këtij parimi? Logjika e trajtuar më sipër të bën të argumentosh se lidhshiptet i tremben ballafaqimit me elektoratin për disa arsye, ndër të cilat po mundohemi të përmendim disa:

- *Mungesa e realizimit të premtimeve përballë votuesve.* Kur të zgjedhurit e sotëm bëjnë fushatë elektorale, bëjnë premtime joshëse e nga më të pabesueshmet dhe pasi marrin mandatin, harrojnë jo vetëm ti realizojnë ato, por harrojnë edhe ato çka kanë thënë e premtuar në shkëmbim të votës. A mund të imagjinohet të përballet me elektoratin një “X” apo “Y” i zgjedhur, ai apo partia e të cilit ka premtuar rrugë e njerëzit udhëtojnë me kafshë pune(!), ka premtuar punësim e njerëzit enden rrugëve(!), ka premtuar shkollë të re e nxënësit bëjnë mësim edhe pa dyer e dritare(!), ka premtuar mirëqenie e njerëzit marrin bukë me listë(!)?

- *Mungesa e kurajos për të bërë transparente veprimtarinë.* Kjo në thelb është vijim i asaj çka thamë më sipër, por në vetvete përmbledh një mendësi e mentalitet të vjetër, sipas të cilit “udhëheqësit” nuk mund të ulen e të debatojnë me qytetarët, ata duhet ta zgjedhin vetë auditorin?! Kjo lloj mendjemadhësie e fodullëku tregon për paranojën nga e cila vuajnë këta lloj drejtuesish, siç edhe flet për një lloj kompleksi të fajit që ata kanë pikërisht për mosrealizimin e premtimeve përballë qytetarëve.

- *Frika nga humbja e privilegjeve.* Vazhdon të flitet vazhdimisht për

një sëmundje të rëndë të administratës së lartë e të politikës, korrupsionin. Si mund të përballet me elektoratin sot një i zgjedhur, i cili para një, dy, tre apo katër vjetësh iku nga bashkëqytetarët e tij që i dhanë votën me taksë në Tiranë e sot nuk i numërohen makinat personale, apartamentet, vilat apo pallatet e rrugët për pushime jashtë shtetit?! Sigurisht, në këto kushte, cdonjëri prej këtyre të zgjedhurish, do ta kishte humbjen e sigurtë e bashkë me të, edhe humbjen e privilegjeve.

Parimi demokratik “Një anëtar, një votë” mund të jetë fillimi i një “revolucion” demokratik të partive shqiptare. Kjo risi në politikën shqiptare kërkon jo vetëm një mjedis të përshtatshëm, por edhe një vullnet praktik për ta zbatuar. Përveç të tjerash, ky parim i rëndësishëm e jetik për të ardhmen, kërkon edhe një njohje paraprake të kësaj filozofie, për të bindur, e pse jo, për ta “detyruar” leadershipin të aplikojë pa hezitim pushtetin që rrjedh nga votimi i drejtpërdrejtë. Sepse shumë nga fenomenet negative me të cilat po përballet shoqëria e sotme e kanë burimin pikërisht nga aplikimi i derisotëm i “pushtetit të deleguar”.

31 Mentaliteti i liderit “bajraktar” përballë “Një anëtar, një votë”

Dritan Ylli

Është e qartë tashmë se votëbesimi në radhët e të gjithë anëtarësisë i jep më tepër siguri lidërshipt të një force politike qoftë për vendimet që merr, qoftë për ndjenjën e përgjegjësisë për t’i zbatuar ato. Duke pasur bekimin e të gjithë anëtarëve, një drejtues partie, por edhe forumet udhëheqëse të saj, forcojnë pozicionin në një mënyrë krejtësisht demokratike dhe jo nëpërmjet artificave ideore të manipuluar. Në Shqipëri ndodhemi përballë një tjetër realiteti. Deri tani ka mbizotëruar mentaliteti i liderit të pazëvendësueshëm. Ky mentalitet ka qenë gjithnjë i frikësuar dhe është ndjerë në pozita inferiore përballë parimit demokratik dhe bashkëkohor “Një anëtar, një votë”. Rrjedhojë e vazhdimësisë të sistemit monopartiak, ku idetë e “njëshit“, duhet të ishin patjetër të të gjithëve, edhe gjatë 14 viteve të pluralizmit nuk u bë shumë për ta goditur njëherë e mirë këtë mentalitet. Për ta larguar njëherë e përgjithnjë mentalitetin e liderit të pazëvendësueshëm, të trashëguar që nga koha e diktaturës së Enver Hoxhës dhe për t’i lënë rrugë të lirë krijimit të një mentaliteti të ri politik, partitë duhet të fokusohen tek anëtarët e thjeshtë, ose thënë ndryshe tek anëtarësia. Ajo ç’ka është më e rëndësishmja duket në ngritjen e një sistemi vertikal nga poshtë-lart ose anasjelltas, ku postet të fitohen për hir të meritës dhe jo për shkak të njohjes apo përafritsë me liderët politikë.

Frika e liderëve tradicionalë ndaj “Një anëtar, një votë”

Liderët e forcave politike kryesore në Shqipëri deri tani kanë ndjerë frikë nga vullneti i anëtarësisë. Duke dashur të ruajnë me çdo çmim gjithnjë karriget e tyre, Nano- Berisha, por edhe drejtues të tjerë të ndonjë partie më periferike, kanë qenë më tepër të interesuar në një përzgjedhje të delegatëve “të kontrolluar” për të vënë në krye gjithnjë njerëzit e besuar. Por, tashmë anëtarësia të cilët përpara se të jenë partiakë janë shqiptarë

- e kanë kuptuar që progresi i vendit po mbahet peng nga dinosauret konceptuale, por që vazhdojnë të jenë ende të fuqishëm si figura në forcat që udhëheqin. Në këtë moment anëtarësia gjendet përballë dy rrugëve. E para t'i braktisin këto forca politike, duke u lënë kryetarëve të përjetshëm vultat e partisë, pa anëtarë dhe pa vota dhe të kalojnë në një tjetër forcë më demokratike në mënyrën e organizimit dhe vendimet që merr. E dyta të braktisin rutinën e votimit, duke bërë një lloj “harakiri” me ndërjegjen dhe votën e tyre të lirë. Deri tani në Shqipëri ka ndodhur e dyta. Ky është shkaku që jo vetëm njerëzit e paangazhuar në forca politike, por edhe militantët “e thekur”, po largohen gjithnjë nga kutia e votimit. Dhe në zgjedhjet e fundit, ato lokale kryesisht partia në pushtet e akuzuar se po largohet gjithnjë nga shtresat e popullit, nga elektorati, nuk arriti “të numëronte” as votat e militantëve të saj.

Kundrejt kësaj situatë mosbesimi, në radhë të parë për realizimin e parimit “Një anëtar, një votë” më shumë se kushdo duhet të jetë i interesuar kryetari i partisë. Por, për të qenë i aftë për të realizuar këtë sistem demokratik, ai duhet të jetë i sigurtë dhe pa komplekse. Duhet të mos ketë frikë se nëse zbatohet “Një anëtar, një votë”, karrigia e tij mund të luhatet. Por edhe nëse ndodh e kundërta të ketë mençurinë dhe urtësinë të dijë të largohet, për t'i lënë vendin dikujt tjetër. Të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe koeficientët që e pasojnë atë në forumet drejtuese të një partie... Por, kjo mund të ndodhë nëse i lihet rrugë të lirë të gjithë njerëzve që mbajnë në xhep kartën e anëtarësisimit në një parti që të japin mendimin e tyre në mënyrë direkte dhe jo të tërthortë.

Në shtetet e zhvilluara përfundimtare po zhvillohet gjithnjë e më tepër parimi më themelor i demokracisë, “Një anëtar, një votë” edhe në sistemet përzgjedhëse të forcave politike. Si në Britani ashtu dhe në vendet e tjera të Evropës, po kalohet gjithnjë e më tepër nga vota e përfaqësuar në forumet e zgjedhura nga e gjithë anëtarësia. Ky sistem pavarësisht se tashmë po mbushen 15 vjet pluralizëm, deri para një viti nuk njihej gjerësisht në Shqipëri. Për të flitej vetëm në ndonjë rast të shkëputur, duke mos gjetur terren të përshtatshëm për t'u zhvilluar. Partitë politike, që u krijuan pas lejimit të pluralizmit, e ngritën sistemin organizativ mbi bazën e partisë nga edhe kishin “mbirë”, pra, sipas mënyrës organizative të Partisë së Punës. Ky sistem organizativ funksiononte mbi bazën e celulave (organizatave-bazë), të cilat e kishin të drejtën të zgjidhnin delegatët përfaqësues në konferencat lokale apo dhe kombëtare, që ndryshe quhet kongres. Sipas parimit “Një anëtar, një votë” secili prej anëtarëve të një force politike ka të drejtë të japë votën për organet drejtuese, qoftë në nivel lokal apo qendror. Një formë mjaft demokratike

dhe transparente, që sjell transferimin e pushtetit nga një pakicë njerëzish drejt gjithanëtarësisë së partisë në të gjithë vendin. Si rrjedhojë, partia nuk është vetëm e “udhëheqësve” dhe anëtarët nuk janë, thjesht, vegla të saj. Anëtarët nuk duhen vetëm në kohë fushatash, e pastaj të harrohen, të lihen pas dore. Çdo vendim i rëndësishëm, çdo zgjedhje e forumeve drejtuese, çdo marrëveshje partiake duhet bërë duke marrë parasysh dëshirat e anëtarëve.

Por, deri tani në Shqipëri zëri i anëtarësisë së thjeshtë të partive ka qenë i sfumuar nga vota e deleguar. Jo rrallëherë, vota e përfaqësuar ka rënë në grackën e manipulimit. Një shembull konkret është Kongresi i fundit i një parte të madhe, i mbajtur në dhjetor të vitit që kaloi. Tashmë dihet se delegatët-përfaqësues ishin thjesht dhe vetëm të manipuluar dhe nuk përfaqësonin mendimin e anëtarëve të thjeshtë, që i kishin zgjedhur.

Partia Socialiste, si pasardhëse e Partisë së Punës së Shqipërisë, por edhe Partia Demokratike, si partia kryesore që u krijua me lejimin e sistemit pluripartiak, nuk e implementuan sistemin organizativ mbi bazën e parimit “Një anëtar, një votë” Së pari, si një handicap i theksuar i mentalitetit që trashëguan nga sistemi monopartiak i vjetër. Dhe së dyti, si pasojë e inferioritetit të udhëheqësve të këtyre partive, nga lejimi i demokracisë së brendshme dhe pranimi i mendimit ndryshe. Frika dhe komplekset, që kanë krerët e këtyre partive se mos iu zë dikush tjetër karrigen, është bërë barrierë për marrjen e vendimeve të rëndësishme, bazuar mbi votën e gjithë anëtarësisë së partisë. Liderë kryesorë partish të mëdha po përmendin jo parimin “Një anëtar, një votë” por “një njeri-një votë”, duke dashur, thjesht, të sfumojnë vlerën e vërtetë të tij. Qëllimi i tyre është ta aplikojnë atë në forumet me votë të përfaqësuar, dhe jo në gjithë anëtarësinë. Këto duken më tepër si përpjekje dhe demagogji për të treguar se janë rinovuar, si dhe për të ulur vlerën e vërtetë të këtij parimi. “Një njeri, një votë” është parimi më thelbësor i demokracisë, duke mos i mohuar të drejtën e votës askujt që mbush moshën e caktuar nga kushtetuta e një vendi. Ndërsa “Një anëtar, një votë”, është një sistem që mund të realizohet brenda një partie politike.

“Një anëtar, një votë”, politika e së ardhmes në Shqipëri

Kundrejt kompleksit “të dy udhëheqësve të pazëvendësueshëm”, për herë të parë partia më e re e krijuar në Shqipëri, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), ka sanksionuar me forcë në statutin e saj zgjedhjen e

organeve drejtuese, nëpërmjet parimit “Një anëtar, një votë” Pavarësisht se ndodhet ende në hapat e para të krijimit të saj, LSI-ja po krijon një bazë mjaft perfekte të të dhënave mbi anëtarësinë e partisë, për të pasur mundësinë e aplikimit të këtij parimi. Nëpërmjet këtij parimi kjo parti ka theksuar se synon të tërheqë në forumet e saj njerëz me vlera, intelektualë që ta ndjejnë veten të lirë të thonë atë që mendojnë dhe jo të mendohen mirë e mirë nëse duhet thënë ajo që ato kanë në mendje, pasi dikujt mund të mos i pëlqejë.

E vërteta është se në popull është krijuar një mosbesim te politika. Kjo arsye ka sjellë braktisjen gjithnjë e më tepër të kutisë së votimit. Zbatimi i parimit “Një anëtar, një votë” duke gjetur terren-zbatimi në skenën politike shqiptare, mund të jetë një ndër mundësitë kryesore për rikthimin e besimit të njerëzve te politika.

Tashmë liderët tradicionalë duhet të shkëputen nga përzgjedhja e forumeve sipas “oreksit apo simpatisë së shefit“, dhe të mbështeten në vlerave që përfaqëson secili prej anëtarëve të partisë. Ndryshe politika do të vazhdojë të jetë peng i liderëve “bajraktarë“ njerëzit do të largohen gjithnjë e më tepër nga kutitë e votimit dhe demokracia në Shqipëri gjithnjë e më tepër do të jetë e kërcënuar.

32 “Një anëtar një votë” kundrejt deficitit të demokracisë

Erion Veliaj

*Të gjithë ne do të jemi në një gjendje të mjerë në se nuk mund
t'i besojmë anëtarit të zakonshëm të Partisë Laburiste të marrë
vendime brenda vetë Partisë Laburiste”*

Tony Blair

Është e vështirë, paçka se disa e bëjnë pa siklet, të trumpetosh ndonjë arritje kushedi se sa fisnike të demokracisë sonë parlamentare. Është po aq e sikletshme nga ana tjetër të numërosh për herë të një mijë e një gafat e strukturave politiko-partizane në Shqipërinë e këtyre viteve. Por ajo që duhet thënë medoemos është fakti se në sytë e qytetarëve të Shkodrës, Gjirokastrës dhe gjithë atyre të tjerëve në mes, vihet re një ‘deficit’ demokracie, fjala e tyre dëgjohet më pak, idetë e tyre nuk gjejnë vrimë në forumet e partive, dhe vendimet në Kuvend janë jo rrallë, aspak të ndjeshme ndaj nevojave të këtyre qytetarëve. Kollaj të fajësosh politikanët, gjë që unë e kam bërë me zell, por në fund të fundit shumica pranon se pesëmbëdhjetë vite janë ende pak kohë për të edukuar një masë të tërë politikanësh, që në fund të fundit ishin pjesë e strukturave politike para-demokratike/ish-komuniste – dhe normale kjo, se nga Marsi nuk do vinin. Në këtë aspekt shumëkush, e unë bashkë me ta, bërtasim për reformë radikale, efektive dhe të menjëhershme në sistemin politik shqiptar, për një perestrojka tashmë të vonuar dhe një hap i parë do ishte sistemi “Një anëtar, një votë”.

Në zemër të këtij propozimi qëndron e drejta elementare e secilit anëtar të një entiteti për të maksimizuar sasinë e cilësinë e përfaqësimit në atë entitet. Asnjë nxënës gjimnazi nuk i bashkohet sindikatës së minatorëve, dhe anasjelltas asnjë minator nuk ulet në senatet e shkollave të mesme.

Këta dy grupe nuk mundet (dhe as duhet) të përfaqësojnë njëri-tjetrin. Sidoqoftë, në grupet respektive të klasës apo sindikatës ata kërkojnë të dëgjohen, konsultohen dhe vendosin. Andaj, është më se e natyrshme që anëtarët e thjeshtë të partive shqiptarë të kërkojnë të zgjerojnë përfaqësimin e tyre në formën më themelore të mundshme – votimin e drejtëpërdrejtë për çështjet kryesore të vendim-marrjes. Sot unionet/sindikatat më të fuqishme në botë kanë zbuluar se legjitimiteti, kohezioni, dhe fuqia e tyre buron nga aftësimi i çdo anëtari për t’u bërë pjesë e rëndësishme e të tërës.

Prej kohësh ne të MJAFIT-it kemi sugjeruar se konflikti më i madh politik në vend nuk është mes partive sesa brenda vetë partive politike. Përplasjet reale nuk janë ato mes të majtës e të djathtës sesa ato mes të resë e të vjetrës, klishes dhe modernes brenda vetë partive politike. Në shumë raste, partitë politike kryesore në vend janë kthyer në organizma oligarke, levat strukturore të cilave janë veç në shërbim të fitores për liderat aktualë. Titujt s’kanë të mbaruar “Kryetari X fiton me 92%, kandidatë të tjerë s’kishte”, “Udhëheqësi Y i lejon kundërshtarit më shumë firma për përkrahje të hapur e më pak vota në votim të fshehtë” e të tjera çudira si këto. Për të ndaluar këtë dekadencë demokratike bëhet akute nevojja për “Një anëtar, një votë” për të zgjedhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë kandidatët e partisë për bashkinë, komunën, vendin e deputetit apo kryetarit të partisë. Kjo do të fuqizonte anëtarësinë e thjeshtë mbi ata që votojnë si delegatë nevojtarë dhe borxhlinj të vendeve të punës.

Viti që kaloi shënoi një numër gafash parlamentare, të cilat harrohen falë mangësisë në memorien tonë kolektive. Shumica e shqiptarëve do të kenë harruar ditën e votimeve se si votoi deputeti i zonës së tyre në lidhje me importin e plehrave, buxhetin e arsimit, çmimet e Telekomit, çështjen e pronave apo atë Çame. Kuptohet, grupe qytetare si MJAFIT duhet të angazhohen në krijimin e kujtesës kolektive rreth vendimeve dëmtuese të atyre që na përfaqësojnë, për të ndikuar në mënyrën se si votojmë ne si zgjedhës në të ardhmen. Sidoqoftë ky do të ishte vetëm një veprim ‘reaktiv’. Një qasje proaktive do të ishte adoptimi i “Një anëtar, një votë” brenda partive. Deputet do të gjenin legjimitet për të votuar në parlament, në se për çështje të rëndësishme anëtarët e partisë të mund të votonin paraprakisht nën një sistem të tillë.

Por duhet pranuar, partitë Shqiptare po i bëjnë ‘fresk’ tashmë idesë së hapjes ndaj shoqërisë civile, grave, të rinjve, medias, binzesit, apo të çdo grupi tjetër të marxhinalizuar që mund t’u shtojë atyre të shumë çmuarin legjitimitet. Çfarë ndodh realisht? Gratë në aneksin e majtë të Forimit të Grave, të rinjtë në aneksin e djathtë të Forumit Rinor, shoqëria civile në

tavolinën rrumbullake të javës tek hoteli i madh, dhe oda e madhe e partive mbetet e pandryshuar. Pra retorika mikpritëse nuk bëhet e besueshme për sa kohë që nuk adoptohen masa të tipit ‘Një anëtar, një votë’. Një anëtar i ri partie nuk i bashkohet asaj si diletant që hyn në një kazino ku luhet poker. Përkundrazi, pretendon se hyn në një organizëm ku luhet ndershëm dhe fitorja është e mundur. Prej kohësh sindikatat më të mëdha në botë e përdorin këtë sistem për të rritur si legjitimitetin ashtu edhe përfaqësinë e tyre. Adoptimi “Një anëtar, një votë” në Shqipëri do t’i provonte publikut se partitë politike nënkuptojnë me ‘hapje’ të partisë jo vetëm propagandë politike, por një dëshirë të vërtetë për të rigjeneruar partinë me anëtarë të rinj që vendosin, votojnë, garojnë dhe fitojnë në një sistem dhe nëpër një procesi të besueshëm. Mbi të gjitha do të shërbente si një ‘diskriminim pozitiv’ për gratë dhe të rinjtë që do të rivitalizonin jetën e brendshme të partive.

Dhe për ata drejtues politikë që nuk njohin zhargon tjetër përveç ‘integritit European’, sistemi “Një anëtar, një votë” do të mbarte një domethënie e cila do ta kthente këtë propagandë një realitet për integritimin european të vetë partive të tyre. Kryetarët respektivë të Partisë Laburiste në vitet ’90 Neil Kinnock, John Smith dhe Tony Blair, përveçse ditën të pasojnë stafetën brenda partisë, u bashkuan nga avokimi agresiv që i bënë sistemin “Një anëtar, një votë”. Sipas shumë politologëve ishte ky sistem që modernizoi në mënyrë të shpejtë Laburistët, të cilët deri në atë kohë po kalonin dekadën e dytë në opozitë. Kjo metodë e bëri partinë më transparente ndaj publikut, shuajti monopolin që kishin mbi partinë zyrtarët ekstremistë, dhe hapi dyert për ‘gjak të ri’ të cilët më parë nuk e shihnin veten e tyre si gjymtyrë e gjallë e trupit të partisë. Sot kanë dy mandate dhe me plot gjasa një të tretë. Kjo ‘modë’ e të ‘bërit demokraci’ u përhap shpejt në Evropë dhe të pakta janë ato vende ku kjo metodë nuk praktikohet. Jo vetëm kaq, po tanimë dhe vendime rutinë si emërimet e partive për komunën, këshillin e lagjes, rajonit, apo dhe për zgjedhje në burokracinë e parlamentit european bëhen nën sistemin “Një anëtar, një votë”. Pse jo, adoptimi i këtij parimi do të shërbente si një shenjë e mirëfilltë e vullnetit për integritim të politikës shqiptare.

Në terma konkretë, duke tërhequr mësim nga kjo përvojë, politikanët shqiptarë do të duhej të përvishnin mëngët dhe të angazhoheshin – për të mirën e jetëgjatësisë së partisë së tyre – në nxitjen e parimit ‘Një anëtar, një votë’. Në shumë aspekte kjo detyrë i ngjan privatizimit të një ndërmarrjeje shtetërore. Pasi humbet ‘legjitimitetin ‘ekonomik e financiar’, kjo ndërmarrje u shitet me aksione punëtorëve e menaxherëve të saj, të cilët të stimuluar nga aksionet që kanë, ngulmojnë fort që ta bëjnë kompaninë

të rigjenerohet dhe të rrisi fitimet. Në një mënyrë shumë të ngjashme, në se duan të sigurojnë të ardhme politike, partitë do të duhen t’i ndajnë aksionet (lexo këtu përgjegjësitë dhe vendimet) me anëtarësinë e tyre të bazës. Mbetet detyrë e forumeve drejtuese të partive, dhe jo veç e tyre, të modernizojnë dhe rinovojnë procedurat e brendshme. Kjo është një reformë që do të testojë kredibilitetin dhe kurajon e tyre politike për t’ju përgjigjur kërkesave të një publiku gjithnjë e më skeptik për sinqeritetin e lidërshpit politik.

A do të jetë i lehtë ky tranzicion? Disa parti, kryesisht të vogla e të reja, kanë filluar tashmë ta aplikojnë këtë rregull, dhe mendoj se kjo u ka rritur pikë në sytë e opinionit publik. Qytetarët po inkurajohen nga ideja se në të ardhmen mund ta shohin veten si pjesë e një partie që i dëgjon, konsulton dhe respekton mendimet e tyre. Kurse për partitë më të mëdha monolite druaj se do ta kenë më të vështirë të adaptohen. Në fund të fundit, duhet ta pranojmë se “Një anëtar, një votë” do të bëjë që pozitat e liderve të dy dekadave të tronditen medoemos, grushti i njerëzve që lëvizin levat e partisë patjetër që do të zgjerohet e rinovohet, krimi i organizuar dhe biznesi gri sigurisht nuk do të emërohen si kandidatura për shërbim publik, por shkëputja nga këto anomali është një çmim, të cilin duhet ta vlerësojnë vetë këto parti. Unë uroj të gjejnë kurajon dhe integritetin e duhur për ta ndërmarë këtë nismë. Për sa kohë që nuk e bëjnë, MJAFI do të duhet t’u rikujtojë vazhdimisht se mohuan një mundësi për të rritur legjitimitetin e tyre, për ta hapur partinë ndaj të resë e për të bërë një hap drejt integritimit politik dinjitoz në Europë.

33 Nga parti leniniste në parti demokratike

Kreshnik Spahiu

Shumëkush ka shfaqur skepticizmin tek ka vështruar përpjekjet e Institutit Demokratik Amerikan për injektimin e një modeli të ri në politikën shqiptare. Njerëz të lodhur e të raskapitur nga çekuilibret politike shqiptare kanë shprehur zhgënjimin e tyre e pse jo edhe protestën e tyre ndaj klasës politike për çdo përpjekje fiktive në lidhje me lëvizjet e tyre të kohëve të fundit. Viti 1991 do të pasohej me një partitizomani e cila i shtynte shqiptarët të anëtarësoheshin në lëvizjet e reja politike të sapo krijuara si revoltë ndaj regjimit të tejzgjatur komunist. Opozita e parë në atë kohë numëronte në radhët e saj mbi 100 mijë anëtarë. Gjithsesi ky nuk ishte veç një fenomen shqiptar po i shfaqur shpesh në shumë vende të rajonit.

Pas disa vitesh miliona njerëz do të zhgënjeheshin nga iluminizmi i tyre pasi e gjitha kjo nuk kish qenë gjë tjetër vecse një tufëzim politik i popullsisë për të legjitimuar pushtetet absolute të lidershipit politik i cili forconte çdo ditë e më shumë pushtetin e tij të përjetshëm. Statutet, kriteret dhe rregullat e antarësimit ndryshoheshin dhe riformuloheshin me qindra herë me përjashtim të mandatit të lidershipit politik i cili në të gjitha partitë shqiptare do të sanksionohej që zgjidhej disa herë pa limit. Dhe nuk do të mjaftonte, çimentimi i tyre statutor por shumë shpejt demokracia e brendshme e këtyre partive do të rrënohej dhe do të transformohej në demagogji që nga mënyra e sistemit të brendshëm zgjedhor.

Strukturat drejtuese të partive politike shqiptare prej shumë e shumë kohësh janë ekspozuar nga lidershipi si forume vendimarrëse por në të vërtetë ato nuk e kanë kryer në asnjë rast këtë funksion. Për sa kohë lidershipi politik e ndjente veten në krizë apo kërkonte të lante hesapet me kudërshtarët politikë brenda llojit në grupimin e tij politik atëhere thërritej një nga strukturat drejtuese të etiketuar ndryshe si këshilli i përgjithshëm, këshilli kombëtar, kryesia etj. Këto struktura janë keqpërdorur mediatikisht me qëllimin e vetëm për të treguar se lidershipi politik i partisë gëzon

mbështetjen e bazës dhe të gjithë partisë.

Në statutet e partive u amenduan dispozitet e rregullat e lojës për strukturat drejtuese të degëve të partive nëpër rrethe por ato kurrë nuk u ndryshuan. Kësaj fryme, në dukje demokratike, do t'i shtoheshin edhe afatet kohore për t'u zgjedhur si drejtues të degëve ku në disa raste nuk lejohej zgjedhja e tyre më shumë se dy herë në këto funksione. Gjithsesi një gjë ishte e sigurtë që kjo frymë dhe ky afat nuk do të mbrinte kurrë tek zgjedhja e kreu të partisë.

Në dedukson të kësaj analize mund të thuhet se në një hark kohor të më shumë se një dekadë sistemi mbi të cilën u ndërtuan dhe u zhvilluan partitë politike shqiptare nuk ishte gjë tjetër veçse një mekanizëm leninist i konsolidimit të rolit dominues të lideshipit duke i shpërfytyruar partitë politike shqiptare në të ashtuquajturën « një parti e një njeri ». Fytyra e këtyre partive do të njësohej vetëm e vetëm me krerët e tyre dhe fati i demokracisë, politikës, zgjedhjeve, ekonomisë, integritit të Shqipërisë mbeti në dorën e disa aktorevë të palëvizshëm nga politika të cilët, në emër të popullit dhe grupeve të tyre të politikës, mundën të indoktrinojnë dhe politizojnë mbarë shoqërinë si mënyrë e vetme e injektimit të doktrinës së tyre politike. Në të vërtetë, çdo ditë që kalonte, kjo po shndërohej në një pengesë reale të demokratizimit të jetës politike dhe zhvillimeve shoqërore në vend.

Shqipëria dhe shqiptarët nuk do të ishin ata të pas viteve 90. Ata do të integroheshin shumë më shpejt se partitë politike. Pas 13 vjetësh mijra e mijra shqiptarë u shkëputën nga anëtarësia e tyre fiktive në partitë politike e për më tepër çdo ditë e më shumë ata filluan të distancohen dhe bojkotojnë kutitë e votimit duke shprehur gjithmonë e më shumë revoltën ndaj sistemit politik në vend dhe nga ana tjetër, dëshprimin që ata kishin nga roli i partive politike shqiptare. Liderët politikë po shkonin drejt “privatizimit” të këtyre partive sa shpesh herë dominonte opinioni se largimi i njerit apo tjetrit do të shkatërronte apo mbyllte aktivitein a partisë që ata kishin drejtuar prej shumë kohësh. Keqpërdorimi i anëtarësisë dhe i militantëve kishte lodhur aq shumë publikun sa arriti pikun në janar shkurtin e vitit 2004 kur partitë politike shqiptare ndjeheshin të sfiduara edhe nga organizata jo qeveritare të cilat prej disa muajsh ishin bërë më popullore dhe se vetë ato, aq sa filluan të mblidhnin me mijra protestues jo më për probleme politike por në mbrojtje të të drejtave qytetare dhe në mbështetje të zgjidhjes së çështjeve sociale. Një rast i paprecedent në rajon dhe më gjerë që partitë të humbisnin mbështetjen dhe të sfidoheshin nga organizata e shoqërisë civile do t'i vinte ato në panik për ndryshe diçka pasi kjo do të ishte simptoma e një sëmundje të rëndë që po kalonin

partitë politike.

A do të ishte dhe jetë vallë parimi i rekomanduar nga NDI “Një anëtar, një votë” vaksina e cila do të mposhtë virusin vdekjeprurës nga i cili vuajnë partitë politike apo do të jetë një kurim thjesht dhe vetë propagandistik i cili do të keqpërdoret si shumë këshilla të tjera që vijnë nga miqtë e Shqipërisë? Kësaj pyetje përgjigjen më të mirë do t’ia japë koha por gjithsesi ne kemi eksperiencën, profesionalizmin dhe detyrimin për t’i parprirë asaj ç’ka do të ndryshojë dhe asaj ç’ka do të jetë fasadë e partive politike.

Në radhë të parë nëpërmjet sistemit “Një anëtar, një votë” i jepet kuptim votës. Historikisht, vota nuk ka patur kuptim në sistemet zgjedhore brenda partive. Humbja dhe zhvlerësimi i votës nga klasa politike në jetën e brendshme të këtyre partive është një nga shkaqet kryesore të shpërdorimit të votës më pas një zgjedhjeje elektorale. Ata që nuk respektojnë vlerat morale dhe juridike të votës brenda sistemit zgjedhor në parti sigurisht që do të bëjnë të njëjtën gjë edhe në fushata apo zgjedhjet parlamentare apo ato vendore.

Në Shqipëri, diktatura dhe tranzicioni krijuan një hendek mes publikut dhe politikës dhe një nga dhjetra arsye apo shkaqe sigurisht që është edhe mungesa e sistemit zgjedhor partiak “Një anëtar, një votë”. Ajo pjesë e shoqërisë e cila kishte dëshirë të qe pjesë aktive e politikës sigurisht që shumë shpejt u ndje e shpërfillur dhe garniturë e aktorve kryesorë të politikës. Anëtarësia e tyre nuk kishte vlera pa egzistencën e sistemit “Një anëtar, një votë. Sistemi i votës me delegatë në kongrese ishte një nga reminishencat e traditave leniniste të cilat lidershipi politik shqiptarë i kishte shumë për zemër kjo dhe për faktin e kulturës, shkollës dhe mentalitetit të cilin ajo trashëgonte. Aplikimi i sistemit “Një anëtar, një votë” sigurisht që inkurajon rilindjen e një mendimi të ri politik brenda partive politike dhe do të shërbejë që së shpejti të shpresojmë për një frymë dhe tendencë liberale në doktrinë, debat, zhvillime dhe organizimin e këtyre partive brenda tyre. Një demokratizim i tyre do të reflektohet në marrëdhëniet politike jashtë këtyre partive dhe sigurisht më pas në jetën parlamentare. Parlamentarizmi shqiptarë ka kohë që vuan nivele të mediokritetit, mungesë të profesionalizmit, të elitës, të pjesëmarrjes, të përfaqimit si pasojë e një ndrydhjeje që kanë grupet parlamentare të shkaktuara nga mosfunksionimi normal i rolit të brendshëm të partive.

Formalizimi i partisë, pjesëmarrja reale janë sfida të kohës të cilat kanë nevojë t’i nënshtrohen një procesi reformimi radikal. Fundja, demokracia kërkon pjesëmarrje dhe ajo nuk mund të arrihet pa zbatimin e sistemit “Një anëtar, një votë”. Kjo do të motivojë anëtarësimin e ri politik por

edhe pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimtarë. Koha e delegatëve në kongrese të cilat përfaqësonin vullnetin, sovranitetin, dëshirat, bindjet, qëndrimet dhe çdo gjë tjetër që lidhej me anëtarësinë e partisë ndoshta ka përfunduar një herë e mirë. Anëtarët e partive politike nëpërmjet votës së tyre mund të bëhen pjesë e çdo vendimi jo vetëm politik por edhe të zgjedhjeve të lidhshme. Kjo do të thyejë një hendek i cili është bërë barrierë për integrimin e këtyre partive në shoqëri dhe më gjerë. Partitë politike duhet të jenë shtyllat mbi të cilat shpesh ngrihen sistemet politike. Në mënyrë që këto themele të jenë shtrati për një shtet të së drejtës sigurisht që një kontribut do të qe edhe sistemi “Një anëtar, një votë”. Kjo skemë e re politike do të nxisë lindjen e forcave të reja politike përfaqësuese dhe do të ekspozojë dështimin e satelitëve të partive të mëdha të cilët nuk janë përfaqësues dhe nuk kanë anëtarësi. Kjo do të thotë një risi më shumë, e cila do të manifestohet nëpërmjet demokratizimit në marrëdhëniet mes partive, institucioneve, shoqërisë civile, për më shumë debat dhe alternativa të reja. Gjithsesi kjo mbart dyshimin nëse ky do të jetë shkopi magjik i cili do të ndryshojë përbërjen dhe rrymat e një klase politike në degradim siç është politika e Tiranës. Kjo vështirë të thuhet kur kemi parasysh që shumë rekomandime dhe sugjerime të miqve të Shqipërisë të jenë keqpërdorur nga politikanët shqiptarë. Pavarësisht nga rezervat mbi këtë alternativë të re për sistemin politik në Shqipëri do të na duhej t’i referoheshim Çurcillit “Demokracia është forma më e keqe e qeverisjes por është forma më e mirë që ne njohim deri tani”.

34 Një anëtar, një votë - Një rast studimor mbi Partinë Laburiste të Britanisë së Madhe që nga viti 1945 e deri më sot

Dan Redford

Shpesh thuhet se Britanikët nuk e kanë shumë për zemër ndryshimin e veçanërisht kur, ai bëhet me ngut. Në politikë, kjo natyrisht është e vërtetë dhe kur ne kemi pranuar nevojën për ndryshime, zakonisht ka qenë tepër vonë. Hyrja e Britanisë në Komunitetin Ekonomik Europian është një shëmbull. Antipatia ndaj ndryshimit është reflektuar edhe në zhvillimin e partive politike. Një analizë e shkurtër e historisë së Partisë Laburiste të Britanisë së Madhe gjatë viteve nxjerr në pah vështirësitë që mund të brejnë një parti kur ajo lejon që pushteti të mbetet në duart e një elite. Diskutimi i më poshtëm tregon se sa më shumë që partitë politike shkëpusin lidhjen e tyre nga baza e partisë, aq më të shumta janë gjasat që ato të mos i kuptojnë motivimet e qytetarëve të thjeshtë. Me fjalë të tjera, sa me demokratike të jetë një parti politike nga brenda aq më shumë gjasa ka që ajo të ketë kontakte me votuesit dhe për rrjedhojë të ketë sukses elektoral të qëndrueshëm. Kjo ese, është një thirrje me zë të lartë për të gjitha partitë politike shqiptare që të synojnë reformat e brendshme demokratike dhe ta zbatojnë ndryshimin më shpejt se sa e kreu Partia Laburiste e Britanisë në historinë e saj të kohëve të fundit.

Partia Laburiste Britanike u rikthye në pushtet në 1945 me të gjitha shpresat dhe pritmëritë që mund të këtë kushdo kur një parti ka fituar një mazhorancë parlamentare të shkëlqyer dhe veçanërisht kur kujtojmë se me këtë fitore ato kanë larguar nga posti i kryeministrit udhëheqësin e luftës së Dytë Botërore Winston Churchillin e pamposhtur. Megjithë realizimin e një sërë reformash thelbësore në asistencën sociale, gjatë viteve 1946-1948, partia brenda 6 vjetësh, u largua përsëri nga pushteti dhe qëndroi në opozitë për 13 vjet të tjera. Partia ishte grryer vazhdimisht nga një numër i madh dështimesh ekonomike kombëtare si dhe nga grindje të vazhdueshme të brendshme dhe intriga. Çfarëdo vlerash të kishte pasur debati, rezultati final në terma politike, ishte se votuesit kishin humbur besimin tek Partia Laburiste. Politikat që laburistët mbështesnin në vitin

1951, nuk ishin ato që parapëlqeheshin nga votuesit.

Megjithatë, kjo mungesë uniteti nuk ishte asgjë krahasuar me atë që do të ndodhte më vonë, në periudhën (1955-1962), kur nën udhëheqjen e një social demokrati të djathtë të quajtur Hugh Gaitskell, Partia Laburiste u konsumua nga pikpamjet e ndryshme ideologjike lidhur me çarmatimin atomik, riarmatimin e Gjermanisë, shtetëzimin dhe hyrjen në BE mosmarrëveshje që i bëjnë grindjet midis partive politike shqiptare të duken si lodra fëmijesh. Kongreset vjetore të Partisë Laburiste u kthyen me shumë në një ritual argëtimi, sesa në një forum për debat dhe diskutime të vërteta politike. Lufta ideologjike u bë më e ashpër kur fraksioni djathtist u përpoq (megjithëse pa sukses) të përjashtonte nga partia një nga udhëheqësit drejtues të majtë të kryesisë së partisë, Aneurhan Bevan. Dhe ishte Partia ajo që e pagoi çmimin e fundit për këto zënka, duke humbur në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1955 dhe 1959. Ajo që përcaktoi fundin e saj elektorale ishte se publiku e perceptoi atë të "shkëputur" nga bota moderne. Vendimi i Kongresit të Partisë të vitit 1959 për të ruajtur në statut një klauzolë që mbështeste shtetëzimin e industrisë ishte një shëmbull domethënës.¹

Megjithëse laburistët mundën të ribashkohen aty nga viti 1964 dhe të fitonin dy zgjedhje parlamentare të njëpasnjëshme, përsëri ata u përballën me shumë probleme të mprehta. Së pari, arësia kryesore e suksesit të tyre elektorale nuk vinte patjetër nga "dashuria" e publikut për laburistët, por më shumë nga shpërfillja e publikut për Partinë Konservatore të asaj kohe, që ishte brejtur nga skandalet dhe vështirësitë ekonomike. Kështu, themelet e Partisë Laburiste për fitore ishin hedhur në një bazament të paqëndrueshëm. Së dyti, vetëm dy vjet pas ardhjes në pushtet laburistët u përballën me një grevë rrënkthënëse të marinarëve dhe një krizë dërmuese në bilancin e pagesave, që e grryen thellë kredibilitetin e qeverisë si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Kjo periudhë u dominua gjithashtu nga grindjet të vazhdueshme të brendshme të partisë për politikën dhe personalitetet - p.sh. mosmarrëveshjet midis Kryeministrit Harold Wilson dhe zv/Kryetarit George Brown. Dhe natyrisht populli ndjehej i pakënaqur me qeverinë që mbështeste luftën në Vietnam. Kësaj nuk ishte aspak çudi që në 1970 laburistët të lëshonin edhe një herë pushtetin. Një analizë e debateve të partisë të kësaj periudhe tregon se laburistët ishin shkëputur nga baza e tyre. Natyrisht, po të mos kishte ndodhur kështu ata kurrë nuk do të kishin mbështetur luftën në Azinë Jug Lindore.²

Në fakt, me përjashtim të detyrës fatkeqe të vitit (1974-1979)³, kur për pjesën më të madhe të kohës laburistët ishin qeveri me minoritet, Partia Laburiste mbeti larg qeverisjes për pothuajse 27 vjet. Vitet 1970, deri në

fillimet e viteve 1980 ishin vitet kur partia grindesh brenda për brenda dhe kur njeri krah rrëmbeu mekanizmin organizativ të partisë.⁴ Më pas ata adoptuan politika qartësisht të majta të cilat disa do t'i përcaktojnë si të lidhura më shumë me dogma ideologjike sesa me nevojat e anëtarëve të thjeshtë të partisë ose votuesve. Nga fundi i viteve 1970, Partia Laburiste u lidh më shumë me një lloj sindikate militante dhe me “furnizues” të shërbimeve publike se sa me publikun si “konsumator”. Kujtojmë gjithashtu se, në vitin 1974 ata zhvilluan dy zgjedhje dhe fituan me një shumicë vetëm prej 3 vëndesh. Nuk është për t'u çuditur pra, që ata nuk ia dolën të nxitnin entuziazmin në elektorat dhe kështu në zgjedhjet e vitit 1979 humbën kundër radikalizmit populist të Znj. Margaret Thatcher.

Gradualisht u krijua bindja se Partia Laburiste ishte më e interesuar për t'u kujdesur për nevojat e ofruesve të shërbimeve ndaj publikut të tillë si mjekët, infermjerët, mësuesit sesa në vetë shërbimet që ata ofronin d.m.th. nëse këto shërbime ishin vërtet ato për të cilat kishin nevojë qytetarët. Sërisht kjo shkëputje erdhi sepse proceset vendimarrëse të Partisë Laburiste u përqëndruan në grupe të cilat shpesh nuk kuptonin kërkesat e votuesve të thjeshtë. Në vend që të diskutonin për ekonominë, për pjesëmarrjen e përbashkët në demokraci, shumë Bashki të qeverisura nga laburistët deklaruan me mburrje se qyteti i tyre tani ishte “një zonë e lirë” dhe siguronte burime të shumta për një shumicë çështjesh minore. Për pasojë në vitin 1983 Partia Laburiste pësoi disfatën me të thellë në historinë e saj.

Del pyetja: Si është e mundur që një parti e madhe si ajo Laburiste t'ia lejonte vetes të minohet periodikisht nga luftra politike grryese dhe të largohet nga përfaqësimi i nevojave të përditëshme të votuesve britanikë? Së pari, një faktor kryesor mund të jetë dështimi i partisë për të përfshirë anëtarët e thjeshtë të saj në udhëheqje dhe në bërjen e politikave si dhe dëgjimi dhe mbështetja vetëm në parlamentarët, udhëheqësit e sindikatave dhe në një bërthamë veprimtarësh në bazë. Po të mos kishin vepruar kështu me siguri të udhëhequra nga Roy Jenkins ose Antony Crosland do të kishin realizuar politika demokratike sociale më të moderuara në parti. Për pasojë ajo që skena politike britanike mori si shpërblim ishte një parti e dedikuar ndaj një sërë pikpamjesh socialiste më tradicionale të politikaneve të udhëhequr nga Michael Foot. Së pari, po të kishte ekzistuar një sistem i tillë si “Një anëtar, një votë” që në atë kohë do të ishte marrë një vendim i qartë lidhur me drejtimin që ata do të donin të ndiqej nga partia. Por ndodhi që një minoritet trockist, për të ndihmuar fraksionin e vet, mund të manipulonte me sukses rregulloren e partisë duke lënë për qark ndjesinë e “punëve të papërfunduara”. Së dyti, mund

të argumentohet se tre grupime politike të veçanta në parti punuan për t'u siguruar që bërja e politikave dhe zgjedhja e udhëheqësve të partisë të mbeteshin rigorozisht nën kontrollin e tyre. Ndonëse ata mund të mos kenë punuar qëllimisht për të realizuar këtë, rezultati përfundimtar i veprimeve të tyre ishte i njëjtë.

Grupimi i parë politik ishin anëtarët laburistë të parlamentit. Që nga koha e themelimit të Partisë në 1906 elektorati përgjegjës për zgjedhjen e udhëheqësve kombëtarë të partisë ishin vetë parlamentarët. Në fakt një proces i tillë vazhdoi deri në zgjedhjet për lidërsipin në vitin 1980. Asnjëherë anëtarët e thjeshtë të partisë nuk u konsultuan qoftë edhe formalisht. Madje, edhe në ato raste kur u konsultuan, mendimet e tyre shpesh u injoruan. Në fillimet e viteve 1970, Konferenca vjetore e Partisë (e cila supozohej të kishte fuqi absolute politikë-bërëse) herë pas herë do të dërgonte mocione që kundërshtonin anëtarësinë e Britanisë në BE gjithë kjo për t'i injoruar këto vendime kur partia të kthehej në pushtet në 1974. Pra shumë pushtet gjatë kësaj kohe mbeti brenda për brenda kufijve të grupit parlamentar të Partisë Laburiste.

Grupimi i dytë i madh ishin sindikatat ose më saktësisht disa kryetarë të pazëvendësueshëm të sindikatave. Ishin pikërisht ata që ushtronin pushtet, shpesh pa përfillur pikëpamjet e anëtarëve që ata përfaqësonin. Pranohej nga të gjithë që gjatë viteve 1950 udhëheqësit e dy sindikatave më të mëdha e mbajtën Gaitskell në pushtet. Këta persona dhe të tjerë si këta ishin ata që luanin rolin e lojës së “politikës” “të bërë në dhomat plot tym”, papërfillur as pikëpamjet e sindikalisteve të tyre,⁵ me përjashtim të një grupi renegatësh anëtarë të komitetit ekzekutiv të sindikatës dhe as të anëtarëve të partisë dhe të elektoratit për çështjet e diskutuara. Këta individë në kongreset vjetore të partisë do të votonin në emër të anëtarëve të tyre (të cilët në disa raste do të shkonin deri në disa milionë), për çështje të veçanta pa pasur asnjë miratim nga anëtarësia e tyre për to. Por, vetëm numëri i “votës së tyre në bllok” shpesh bënte që ajo të ishte përcaktuese në vendimin përfundimtar, si për politikën ashtu dhe për personin e zgjedhur. Kjo, natyrisht, ishte arsyeja pse Hugh Gaitskell mundi Herbert Morrison në zgjedhjet për lidërsipin në vitin 1955.

Grupimi i fundit, që ushtronte ndikim, ishin veprimtarët e partisë në degët e saj. Këtu, ata përhapën një kulturë të gabuar që thoshte se vetëm veprimtarët e partisë ishin të mirëinformuar për çështjet që do të votoheshin. Mendimi i tyre për anëtarët e thjeshtë të partisë ishte diçka e tillë “ju paguani kuotizacionet tuaja dhe mund të vini në mbledhje po të doni, por as që mos mendoni se do të mund të sfidoni këtu monopolin tonë të vogël mbi politikën si dhe lidhur me kandidatët për t'u zgjedhur.

Në degët e partisë u krijua një arrogancë e përgjithshme me anën e së cilës një elitë e vogël lokale do të mund të manipulonte rregullat statuoare për t'u siguruar se nuk do të sfidohej.

Pra nëse themi se e gjithë anëtarësia e partisë deri në mesin e viteve 1980 ishte 250.000 anëtarë, 1000 figura kryesore të mbështetura nga këto tre grupime (me pak se 1%) aktualisht ushtronin të gjithë pushtetin dhe vendosnin se kush do të ishte figura udhëheqëse dhe cila do të ishte platforma e partisë. Anëtarët e thjeshtë të partisë nuk ishin të përfshirë në këtë proces në asnjë fazë. Kjo është arsyeja që votuesit nuk votonin më zemër dhe largoheshin. Gjërat me së fundi do të majiseshin. Dhe erdhi dita kur në maj 1983 partia pësoi humbjen me të madhe që ka pësuar ndonjëherë në zgjedhjet e përgjithshme dhe që gati sa nuk shkaktoi daljen e saj si parti e tretë politike në politikën e Britanisë së Madhe. Në atë kohë pikëpamjet socialiste tradicionale të udhëheqësit të asaj kohe Michael Foot mund të ishin parapëlqyer nga shumë parlamentarë laburistë, udhëheqës të sindikatave dhe veprimtarët kryesorë të partisë. Por ato, për rrjedhojë edhe pikëpamjet e parties, nuk përputheshin me parapëlqimet e shumicës së votuesve të cilët dukeshin më të tërhequr nga morali populist i zonjës Thatcher.⁶ S'ka dyshim që paraqitja e laburistëve në zgjedhjet e përgjithëshme të vitit 1983 përshkruhet, nga një Ministër Laburist, si vetëvrasja më gjatë në histori.⁷

Pra mbasi arriti nadirin e vet politik, partia e kuptoi së duhej të modernizohej nëse dëshironte të mbetej një forcë e besueshme elektorale. Në dekadën e mëvonshme u bënë ndryshime për ta hapur partinë për anëtarët e thjeshtë, si përsa i përket bërjes së politikave, ashtu edhe zgjedhjes së zyrtarëve të partisë. Kulmi i këtij ndryshimi arriti jo nën udhëheqjen e Tony Blair, por çuditërisht nën udhëheqjen e John Smith në vitin 1992. Ishte pikërisht Smith ai që vuri në lëvizje idenë “Një anëtar, një votë” në përpjekjet e tij për ta shkëputur pushtetin e partisë nga sindikatat. Megjithatë, sistemi i ri u përdor për herë të parë për zgjedhjen e udhëheqësit të ri të partisë në vitin 1994, pas vdekjes së tij të parakoheshme.

Për mua si një këshilltar lokal i sapozgjedhur në atë kohë, ishte shumë e qartë se shumica e veprimtarëve të partisë donin që në ato zgjedhje të fitonte John Prescott i cili përputhej më shumë me vlerat e tyre socialiste tradicionale. Në atë nivel dhe në atë kohë dukej më e mundshme që një Prescott të mund të fitonte. Sidoqoftë, kësaj here “tenxheres”politike iu shtua dhe një element tjetër. Për herë të parë edhe anëtarët e thjeshtë të partisë mund të votonin. Votat e tyre ishin të barabarta në vlerë me ato të parlamentarëve, të udhëheqësve të sindikatave dhe të veprimtarëve të

partisë. Kur u numëruan votat në fund, megjithëse “tre grupimet tona të famshme” vazhdonin të mbështesni fort Prescott, u vu re se pjesa më e madhe e anëtarëve të thjeshtë të partisë kishin treguar një parapëlqim të qartë për Blair që doli edhe në fitoren e tij në raport dy me një. Ky ndryshim i madh u vu re edhe një vit më vonë, kur Blair modernizoi statutin e partisë, duke hequr prej tij klauzolën e famshme të shtetëzimit,⁸ e cila u kujtonte votuesve se Partia Laburiste ishte ende parti e “ndërrhyrjes së shtetit”. Ai i inkurajoi degët e partisë të zgjidhnin anëtarët e tyre në bazë të parimit “Një anëtarë, një votë”. Megjithëse hasi rezistencë, votat e anëtarëve të thjeshtë miratuan ndryshimin me një shumicë përsëri më shumë se “dy me një”. Partia e kishte zgjeruar bazën e saj duke përfshirë një elektorat partie që ishte shumë më shumë përfaqësues i komuniteteve vendore dhe që kishte përqafuar një program që përputhej më shumë me mendimet e votuesve.⁹ Kështu laburistët për shumë arsye të ndrushme ishin më në epërsi kur erdhën zgjedhjet e vitit 1997.

Shkurtimisht parimi “Një anëtar, një votë” mund të shpëtojë një parti politike nga zaptimi që mund t’i bëjë një elitë e grupimeve politike, shumica e të cilëve nuk janë të interesuar për suksesin e ardhshëm të partisë, se sa për të çuar më tej planet e tyre politike. Përdorimi i tij do të krijojë një parti që është përfaqësuese e anëtarëve dhe që kupton nevojat e komuniteteve lokale, që do të thotë se ata do të ofrojnë një program me të cilin qeveria të mund të sigurojë zbatimin e qeverisjes demokratike.

Nëse pritmëritë e qytetarëve janë se partitë politike shqiptare do të ofrojnë qeverisje demokratike, por ata vetë (qytetarët) e kanë të vështirë të realizojnë këtë situatë brenda organizatave të tyre. Atëherë ata presin shumë prej këtyre partive. Ajo që do të ndodhë në këtë rast do të jetë se ata do të sjellin në qeverisje të njëjtin mentalitet “të tejet-centralizuar”, i cili drejton vetë partinë. Është bindja e autorit të kësaj eseje se një parti jo pluraliste dhe e tejetcentralizuar ka gjithmonë gjasa të realizojë një qeverisje me stil jo pluralist. Pra ne duhet të atakojmë burimin-vetë partitë politike.

Me përmbysjen e komunizmit në 1991, pa dyshim që ka pasur përparime. Madje edhe komunikatat e organizatave ndërkombëtare, sado kritike që janë, përmbajnë të paktën një paragraf që komenton nivelin e përparimit drejt demokracisë së plotë që nga viti 1991. Megjithatë, në probleme kyçe të reformës institucionale për sa i përket partive politike, shkalla e ndryshimeve ka qënë më pak e bujëshme. Vendimet mbi politikat si dhe përzgjedhjet e zyrtarëve partiakë janë ende çështje të selive të partive. Pra ka ende shumë për të bërë. Kjo është arsyeja pse progresi i bërë deri tani në lidhje me “Një anëtar, një votë” është rëndësishëm. Të

gjithë ne duhet të sigurojmë që "Një anëtar, një votë" të mos të kthehet në një slogan politikë, siç po ndodh aktualisht me kërkesen për integrimin në KE. Po të ndodhë kjo atëhere synimi ynë do të këtë dështuar. Në të kundërt duhet të vazhdojë dialogu i shkëlqyer që tashmë ka filluar, duhet të shënohen pritmëritë dhe duhet të përcaktohen synime të arritshme të cilat të përfshijnë afatet kur ky sistem do të përdoret për të zgjedhur kryetarët e partive. Sot kemi një perspektivë ndryshimesh dhe do të jetë detyra e partive politike, në partneritet me donatorët ndërkombëtarë, ta realizojnë atë.

Shënime:

1. Shih Hugh Gaitskell; A Political Biography Williams P.M. Jonathan Cape London 1979, për një përshkrim më të detajuar të ngjarjeve në periudhën 1963 – 1995
2. Shih The Labour Government 1964 - A Personal Record, Wilson J.H. Weidenfeld and Nicholson, London 1971 për një version shumë të hollësishtëm të ngjarjeve parë nga këndvështrimi i kryeministrit të asaj kohe Harold Wilson
3. Pjesën më të madhe të kohës Laburistet ishin një qeveri në minorancë. Shih "The Labour Governmet 1974 – 1976 Wilson J.H Weidenfeld & L.Nicholson, London 1979.
4. Periudha 1970 – 1979 në historinë e Partisë Laburiste ishte e tillë që shpesh grupime të organizuara trockistësh zaptonin degët të partisë në vend dhe udhëheqja e partisë bënte pak ose aspak për t'i penguar.
5. Me përjashtim të një grupi të vogël renegatësh anëtarë të komitetit egzekutiv të sindikatës.
6. Një vështrim i shkurtër i manifestos së Laburistëve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1983
7. Rt.Hon. Gerald Kaufman
8. Ajo linte të nënkuptohej se Laburistet ishin ende një parti në mbështetje të "ndërhyrjes së shtetit"
9. Partia kandidoi numërin më të madh të grave kandidate të propozuar ndonjëherë dhe kjo solli që të zgjidheshin më shumë se 100 parlamentarë Laburiste.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Një anëtar, një votë : një përmbledhje shkrimesh politike / përg. Dan Redford. - Tiranë : Pegi, 2004.

184 f. ; 20 cm

ISBN 99943-638-5-9

I. Redford, Dan përg.

329(4) (082)

329(496.5) "1990/2003" (082)

329(=18:497.115) "1999/2003" (082)

321.7(496.5) "1990/2003" (082)